



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-lahut, të Gjithëmëshirshmit, M ëshiruesit!

MREKULLITË E KURANIT

LIBRI I TRETË

Muhamed Mutevelli esh-Sharavi

Botuar nga: Zëri Ynë

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit dhe përkthyesit Muhamed Jusufi

HYRJE.....	6
HARMONIA E UNIVERSIT DHE FORCA ALL-LLAHUT	8
NJERIU DHE FORCA.....	11
SHKENCA BASHKËKOHORE	14
MELEKËT DHE BETEJA E BEDRIT	18
Ç'ËSHTË TARIK-U	21
NATËN GJITHASHTU.....	23
ALL-LLAHU NA MBRON.....	27
VËSHTRIM NGA KRIJUESI.....	30
SHPALOSJA E SEKRETEVE	33
KTHEN SHIUN	36
EMHILHUM RUVEJDA	39
ALL-LLAHU ËSHTË KURTHUESI (KUNDËRVËNËSI) MË I MIRË	43
FUQITË E FSHEHURA NË BOTË.....	47
DISPOZITAT E XHIN-ËVE DHE MELEK-ËVE.....	50
Ç'KUPTIM KANË VËRSHIMET DHE TËRMETET	54
URTËSIA E KRIJIMIT	58
MAGJIA DHE SYRI NJERËZOR	62
EKSPERIMENTI DHE USHTRIMET	65

DISPOZITAT E JO NJERËZORËVE	68
URTËSIA TEK HARUTI DHE MARUTI.....	72
RASTI DHE LLOGARIA.....	75
E MIRA PËRFUNDON KËTU	79
ZILIA - SMIRA.....	85
NJERËZIT JANË DY LLOJESH	88
SHFAQJA E FUQISË NË UNIVERS	91
I JEP RISKUN ATIJ QË DO	94
SHKAQET NË VETE, JO	98
ALL-LLAHU NA PËRKUJTON FUQINË E TIJ	102
AJO PËR MUA ËSHTË E LEHTË.....	106
LIGJËRIME MBI KAPTINËN MERJEM	129
TAKIM ME FUQINË	134
MREKULLI PREJ KRIJUESIT	139
DHURIMI PA NDONJË SHKAK.....	142
PSE ERDHI MELEKU.....	147
MERJEMJA U FRIKËSUA.....	150
PËRBALLJA ME MREKULLINË	153
MREKULLIA DHE URTËSIA.....	156

DO T'IU MJAFTONTE MREKULLIA	159
PSE ATËHERË POLEMIKË?	164
DHE NUK BESUAN!	169
MREKULLIA E KRIJIMIT	173
SEKRETET E KRIJIMIT	177
MENDJA E TRASHËGON DITURINË	181
URDHËRAT E ALL-LLAHUT - MJAFTOJNË	185
MASHTRIMI DHE NJERIU	188
INSISTIMI NË MËKATE	192
ANALFABETIZMI I MUHAMMEDIT S.A.V.S.	194
MËKATI NDRYSHON	196
NJERIU DHE ARMIKU TIJ	200
SHEJTANI NUK KA PUSHTET MBI NE	203
MËSHIRA DHE SPROVA	207
MËSHIRA E ALL-LLAHUT ËSHTË SHTRIRË	210
ALL-LLAHU DHE MËKATARI	214
FARAONËT PËRSËRITEN	217

HYRJE

Autori i kësaj vepre (Allahu e mëshiroftë), ka qenë një dijetar që ka ligjëruar me një gjuhë të kuptueshme për të gjitha shtresat. Ai, personalisht, është marrë shumë pak me shkrime. Shumica e ligjëratave të tij janë regjistruar, gjatë komentimit të Kur'anit nëpër vende të ndryshme, dhe më pas, ato janë shkruar nëpër vepra të ndryshme. Stili i komentimit të tij, është i kuptueshëm për të gjitha nivelet, prandaj, shpeshherë, hasim në disa shpjegime të hollësishme dhe të thjeshta, ngase ai e dinte se, një pjesë e auditorit të tij, nuk ishin në gjendje që t'a kuptonin. Ky lloj stili i përdorur prej tij, fitoi popullaritet të madh në masë, dhe lirisht mund të themi se, ai ka qenë dijetari më i kërkuar, në mbarë botën islame. Ai ftohej të ligjëronte në shumë universitete, organizime dhe institute të ndryshme në botë.

Gjatë përkthimit të kësaj vepre, kam përdorur shprehje, që nuk janë në përputhshmëri me kuptimin e tekstit të gjuhës arabe, jo se nuk kam hulumtuar, madje edhe jam konsultuar me shokë, që janë njohës të mirë të gjuhës shqipe, por pa sukses. Gjuha jonë shqipe, në kohën kur duhej të merrte bazat e saj të shëndosha dhe të pajisej me shprehje të përgjithësuara, pati fatin të çensurohej nga shprehjet idealiste – fetare, nga pushtetarët komunistë. Për këtë arsye, gjuha jonë është e cekët përse i përket shprehjeve fetare, në veçanti, kur kemi të bëjmë me veprime të Zotit, i cili është Një i Vetëm dhe Të Cilit nuk i ngjason askush.

Si shembull, kemi në brendi të këtij libri, shprehjen ‘Shfaqja e Fuqisë’. Këtu bëhet fjalë, për vendimin e All-llahut xh.sh., kur dikujt i del në ndihmë. Fjala është për personat, që u janë mbyllur të gjitha rrugët, ose dyert dhe përnjëherë, atyre ju shfaqet Fuqia, e cila është shpresëdhënëse për të ardhmen. E kam shkruar me shkronja të mëdha, për t’a dalluar se është fjala për shfaqjen e fuqisë së All-llahut, e jo të njeriut. Ndërsa, shprehja ‘shfaqje’, sipas terminologjisë tonë të sotme shqipe, jep të kuptohet se kemi të bëjmë me trupa fizikë.

Libri në origjinal nuk ka fusnota, ato i kam vendosur për lexuesin tonë shqiptar, që t’a ketë më të lehtë të orientohet edhe me burimet e marra në Kur’anin Kerim. Gjithashtu, në fusnota kam vendosur edhe terma, të cilat nuk janë në gjuhën shqipe. Këto terma të tjera, jam munduar t’i shpjegoj gjithashtu, për t’ia lehtësuar lexuesit kumtimin e fjalës, ose të ngjarjeve, që mendoj se nuk janë, ende, në literaturën shqipe. Në përgjithësi ajetet kur’anore i kam përkthyer vetë, por, ka raste ku jam shërbyer nga disa prej përkthyesve të tjerë.

Herë pas here, nëpër faqet e këtij libri, do të gjeni fjali (ose paragrafe), që janë me ngjyrë të zezë më të theksuar, të cilat, janë fjalë të Zotit, të nxjerra nga Kur’ani Kerim. Gjithashtu, në brendi të librit, ka edhe fjali, që janë shkruar me shkronja korsive, të cilat, në të shumtën e rasteve, janë thënie të Muhammedit s.a.v.s., të cilat nuk janë drejtpërsëdrejti versete kur’anore, por ato kanë qenë të frymëzuara (të inspiruara) nga Zoti.

Përkthyesi

HARMONIA E UNIVERSIT DHE FORCA ALL-LLAHUT

All-llahu i Lartësuar dëshiroi të na tregojë për harmoninë e universit dhe Fuqitë e Tij krijuese. Për harmoninë e universit, i Lartësuari, në Kur'anin Kerim, na tregon: "Për ju, krijoi gjithçka ka, në rruzullin tokësor." ¹

Fuqia e Krijuesit, të cilën e shohim përmes mrekullisë në të gjitha krijesat, që krijoi i Lartëmadhëruari, është një prej sekreteve të jetës së kësaj bote. Përderisa njeriu është krijesë, dhe është qenie e kufizuar, sado të përparojë dhe zhvillohet, ai nuk mund të ketë përparim më shumë, se ç'dëshiron All-llahu i Lartësuar. Ai, i jep (njeriut) kur të dëshirojë, diçka prej sekreteve të jetës së botës materiale, në univers.

Disa njerëz, ajetin e lartëshënuar: "Për ju, krijoi gjithçka ka, në rruzullin tokësor", e kuptojnë në mënyrën e vet dhe debatin e tyre e shtrojnë duke thënë: njeriu ka ardhur për të dhënë kontributin e vet, me anë të participimit të tij në të, si p.sh: ai kontribuon në bujqësi, ose në shpikjet shkencore, të cilat njeriu i përdor për shërbimet e veta. Këto shpikje, njeriu i konsideron si rezultate të vetat, sikurse janë: aeroplanët, radio-televizionet, etj. Kemi shumë prej tyre, që mendojnë se këto vepra janë produkte të njeriut. Për t'a shprehur mendimin e tyre më saktë dhe më bindshëm, ata thonë se këtë vepër e bëri filani, ky ishte shpikësi i kësaj e asaj... Gjithmonë

¹ Kur'an, 2/ 29

sipas tyre, ai (zbuluesi) ka qenë një person i zgjuar, studiues i denjë, hulumtues i pa lodhur dhe së fundi ka arritur deri tek rezultati, që ne e përdorim.

T'i shohim këto, tani, radhazi dhe të mundohemi t'a shkoqisim këtë temë, duke filluar nga përbërja e tokës. Rruzulli ynë është i përbërë prej materieve të ngurta, bimëve dhe shtazëve (florës dhe faunës). Fillimisht zhvillimin njerzor e kemi si qenie që ushqehet me bimë. Pasi iu paraqitën shqisat shndërohet në qenie shtazore, dhe së fundi me anë të të menduarit fillon të bëjë përzgjedhjen midis alternativave për t'u quajtur njeri. Të gjitha këto, në vija të trasha, janë llojet e materies, që i sheh ose, të paktën, i ndien njeriu në tokë.

Tani për tani, nuk flasim për llojet, të cilat nuk shihen, sepse do të na nxjerrin nga tema, që kemi filluar të diskutojmë. Ne, kemi të bëjmë me materiet inorganike dhe organike si bimët, shtazët dhe njeriun, i cili ka vetëdije, mendon dhe është në gjendje të përzgjedhë.

Të gjitha këto lloje të materies, të sipërtheksuara, kanë të bëjnë edhe me njeriun. Këto veprojnë pa dëshirën e vet, bile edhe pa dëshirën e njeriut. Frymëmarrja, të rrahurat e zemrës, qarkullimi i gjakut, organet e tretjes etj., në të gjitha këto, vullneti njeriut nuk ka dorë. Ti nuk ke mundësi për t'a urdhëruar zemrën të punojë, ose të mos punojë. Nëse ndodh që zemra të pushojë përfundimisht, ti nuk je në gjendje t'a rikthesh atë të punojë. Kështu vlen edhe për frymëmarrjen, për organet e tretjes, e kështu me radhë. Të gjitha këto, janë jashtë kompetencave të qenies njerëzore, sepse këto nuk janë brenda atyre dhuntive, të cilat All-llahu i Lartëmadhëruar ia dhuroi njeriut. Urdhërat e tilla nuk funksionojnë. Vepro ose mos vepro, nuk vlejnë brenda kësaj përzgjedhje të lirë të dhuruar, këtu nuk kemi alternativë.

Materia inorganike, flora dhe fauna dhe pjesët e tjera, që janë në përbërjen të njeriut, nuk i nënshtrohen vullnetit të tij. Brenda këtyre normave përfshihet edhe rritja ose zhvillimi. Këto, nuk i nënshtrohen dëshirës së njeriut, këto janë kompetencë e rezervuar dhe janë të kornizuara. Askush, prej këtyre gjallesave, nuk mund të ndërhyjë në këtë përbërje.

Materiet inorganike funksionojnë vetëm sipas urdhërit, ato kanë marrë detyra të caktuara, gjithashtu edhe flora, i ka detyrat e veta të caktuara. Ti e hedh farën në tokë, ajo pastaj do t'a kryejë detyrën e vet, do të lëshojë rrënjë dhe më vonë do të mbijë, duke mos ndërhyrë njeriu. Se si ajo do të funksionojë, mund edhe të vërtetohet, pasi sot kemi mundësi t'a shikojmë atë se si funksionon, nëse e fusim atë në një epruvetë, në një prej laboratoreve të njeriut. Detyra jonë është që të hedhim farën në të, pastaj do të shohim, se si ajo vetë, sipas vullnetit të All-llahut dhe në harmoni të plotë, e kryen detyrimin e vet në univers.

Do të shohim, se si ajo dhe farërat e tjera, në të njëjtin kopsht, përdorin të njëjtin ushqim- ujin, por në fakt, vërejmë se secila bimë, e kryen detyrën e vet për mrekulli. Ato ndryshojnë në ngjyrë, në shije, në pamje edhe pse janë ushqyer në një kopsht dhe janë furnizuar me të njëjtin ujë.

Kjo është harmonia e jetës bimore dhe mënyra e zbatimit të detyrimeve të tyre. All-llahu i Lartësuar ka bërë që këto bimë, cilësinë e zgjedhjes, t'a kanë tek lënda e tokës. Ato, në mënyrë shumë perfekte dhe në harmoni të plotë, bashkëveprojnë me universin dhe kështu i kryejnë obligimet e tyre. Si bimët ashtu edhe kafshët, janë të lidhura ngushtë me gjithësinë ose universin. Secili i kryen obligimet e veta, sipas kësaj harmonie të caktuar prej All-llahut të Lartëmadhëruar. Qofshin ato, që vullneti All-llahut i Lartësuar i ka nënshtuar në shërbim të njeriut, ose jo. Kemi

krijesa, që nuk i nënshtrohen njeriut, sepse vullneti i All-llahut ishte i tillë. Edhe pse, kafshët e egra, nuk i shërbejnë njeriut, ato e kryejnë detyrën e vet në gjithësi (univers).

NJERIU DHE FORCA

Të shohim tani njeriun. Të gjitha organet, që nuk kanë të bëjnë me përzgjedhjen e njeriut, janë në harmoni të plotë me gjithësinë. Frymëmarrja, tek ai, është vepër spontane dhe atë e kryen pa vështirësi. Secili njeri, atë e realizon kudoqoftë, sa për nevojat e tij dhe pa vështirësi, atij nuk i duhet mund i veçantë për të arritur tek ajo. Kështu, është edhe me të rrahurat e zemrës, me organet e tretjes. Kështu, është me të gjitha organet, në të cilat nuk ndërhyjnë vullneti njeriut. Ato funksionojnë, qoftë njeriu i zgjuar ose duke fjetur. Ato veprojnë pa ndier nevojën e njeriut për asgjë, ato kanë sistemin e tyre të veçantë dhe në harmoni të plotë. Ato, do të veprojnë kështu, deri atëherë kur ndërhyjnë ai dhe i shkatërron ato. Njeriu mund t'a teprojë me ushqim dhe i shkakton dhembje lukthit, ose e stërmundon zemrën, ose merret me pirjen e duhanit dhe i dëmton mushkритë, e kështu dëmtime të tjera me rradhë, të cilat vullneti personal i njeriut, ia shkakton vetes. Ky i keqpërdor të mirat dhe begatitë e All-llahut, që Ai na i dhuroi ne. Ky do të ishte shembull ekuivalent, me të gjitha shkatërrimet që njeriu sjell, në përgjithësi. Për t'u bërë më interesant, ai ndërhyjnë në natyrshmërinë e proceseve natyrore dhe me paraqitjet ose ndërhyrjet, që ai bën, mundohet t'a mashtrojë veten e tij. Këtu, e ka fillin vepra e shkatërrimit. Çdo shkatërrim, fillin e ka tek pasionet e liga njerëzore. Nëse duam që t'i përmirësojmë ato, nuk do të duhej t'i ndjekim ligjet dhe rregullat, të cilat janë të vendosura prej personave si ne, por nga Ai, i Cili është

Krijuesi i të gjithëve. Vetëm, nëse bazohemi tek All-llahu i Lartëmadhëruar, do të mund të përmirësohemi në çdo gjë.

Por fatkeqësisht, njeriut i këndet më shumë të vazhdojë rrugën e pasioneve të tij, dhe me këtë, ai vendos midis të vërtetës dhe interesave, pasioneve e shijeve të dëshiruara prej tij. Kjo mënyrë e jetës, gradualisht është shtrirë në botë, derisa tani kemi të bëjmë me një shtrirje shumë të gjërë të kësaj dukurie, gjë që e vërtetojnë veprat e shumta kriminale. Sikur, secili njeri, të merrej me vetveten e tij, nuk do të kishte asnjë të varfër ose të uritur në botë. Por, jetojmë në kohën, që dikush tërheq nga vetja më shumë se sa i takon për një ditë. Kështu, ndodh që, dikush, për një ditë të sigurojë shpenzimet e tërë jetës së tij. Këtë njeriu e bën, si të thuash, për t'u siguruar, për t'a ndier veten më shumë të sigurt. Sikur të kishte dijeni mbi të vërtetën dhe të dinte se sigurimi dhe e nesërmja e tij, është në duart e All-llahut xh.sh., nuk do t'a bënte. Nga e di ti, o njeri, se ndoshta, atë që e bllokove dhe sigurove për veten tënde për të nesërmen, nuk do t'a humbë All-llahu, kurse atë që sot nuk e ke pranë vete, ndoshta, All-llahu do të begatojë me të, brenda vetëm pak orësh. Siguria e njeriut dhe e vërteta mbi të, duhet të lidhet me All-llahun e Lartësuar, e jo me sigurinë materiale. Fuqia e All-llahut është në vullnetin e Tij, Ai të jep ose të merr. Ai, do të begatojë, sipas vullnetit të Tij.

T'i kthehemi, sërish, ajetit të Zotit: "Për ju krijoi gjithçka ka në rruzullin tokësor."

I Lartësuar i All-llahu, krijoi gjithë ç'ka në tokë e në qiej, dhe për këtë nuk kemi kurrfarë dyshimi. Askush, nuk mund të pretendojë se ka krijuar token ose qiejt, diellin ose hënën, kurrësesi as ujin, apo të ketë krijuar diçka të gjallë në tokë. Sikur këto, vërtet, të mos ishin krijuar nga All-llahu, dikush mund të thoshte se, ai i ka krijuar këtë apo atë. Vetë fakti, se askush gjer tani, nuk ka

pretenduar se ka krijuar dikë ose të paktën një shenjë, bën që supozimi: se i tërë krijimi i përket i All-llahut të Lartëmadhëruar, të jetë i vërtetë. Prandaj, rreth krijimit nuk kemi kurrfarë polemike, krijimi është bërë prej Atij, që ka mundësi dhe fuqi, krijimin e bëri All-llahu i Lartëmadhëruar, që prej shfaqjes së vullnetit të Tij për të krijuar, ose prej kohës kur shfaqti dispozitat për vazhdimësinë e krijimit.

Nëse dikush pretendon se ai e ka mbjellë këtë pemë hurmeje, i themi: prej nga e solle farën? Do të përgjigjej: prej pemës që ishte e mbjellur diku, e kështu me rradhë, deri tek pema e krijuar së pari, të cilën e ka krijuar i Lartësuar. Fuqia e All-llahut xh.sh., është ajo që e solli atë fillimisht, e më pas, ti e përgatite tokën për t'a mbjellë farën. Kështu, ti kryeve detyrën tënde, duke e përgatitur terrenin, kurse pastaj fara, vetvetiu, do t'a kryejë detyrën e vet, duke përsëritur veprimtarinë e vet, që nga dita e parë e krijimit të saj.

Disa njerëz, thonë se tani, ajo që u tha, nuk është e vërtetë, pasi tani shkenca ka sjellë lloje të reja, të cilat i krijon nga vaksinimi dhe i shndërron ato, nga një lloj në llojin tjetër, ose, nga një lloj fare, bën diçka tjetër. Vaksinimi i një fare me farë tjetër, ose ajo tjetra, konsiderohen që të gjitha krijesa të All-llahut, që janë krijuar nga momenti parë. Çdo ndërhyrje që mund t'a realizosh, duhet t'a konsiderosh si mundësi që All-llahu t'a ka mundësuar, ndërsa ti, nuk ke krijuar asgjë të re, edhe pse je munduar të bësh një ndërhyrje në përmirësimin e farës, ti vetëm ke përdorur ato elemente, që ishin të krijuara nga All-llahu i Lartësuar.

SHKENCA BASHKËKOHORE

Nëse tani, kalojmë tek zbulimet më të reja bashkëkohore, shohim se të gjitha ato, janë brenda dispozitave dhe ligjeve të universit. Ai, i cili shpiku aeroplanin, nuk i krijoi shtresat qiellore të atmosferës, që aeroplani të fluturojë në to. Gjithashtu, nuk është ai, që krijoi materien e aeroplanit, që t'i japë vetes të drejtën për t'a quajtur krijues. Ajo, që është krijuar, është dhuratë e dhuruar nga Fuqia e All-llahut xh.sh., i Cili na ka mundësuar që të mund të veprojmë, me ligjet që disponojmë. Ai, pastaj na ka dhënë fuqinë dhe energjinë e mundësisë së shpikjeve. Ajo, që mund të thuhet për aeroplanin, mund të thuhet edhe për shpikjet e tjera. Njeriu pra, nuk e krijoi materien, e as ato ligje dhe dispozita të gjithësisë, por ai vetëm shpik krijimet e All-llahut të Lartësuar, që janë në gjithësi, dhe ato nuk arrihen ndryshe, përveçse me vullnetin e Tij. Ai ia shpalos sekretet e Tij në univers, atij që Ai dëshiron.

I Lartësuari, në Kur'ani Kerim, thotë: "Për ju krijoi gjithçka ka në rruzullin tokësor." Kjo vepër përputhet plotësisht me këtë realitet, që para se të zbriste Kur'ani, kështu vazhdoi pas zbritjes së Kur'anit dhe kështu do të vazhdojë deri në ditën e kataklizmës.

Pra, gjithsecili që pretendon se ka krijuar diçka, pretendon diçka të gënjeshtërt dhe jo të vërtetë. Në shumë kapituj të Kur'ani Kerimit, All-llahu xh.sh., na tërheq vërejtjen, duke na treguar se krijesat e dukshme të universit janë shumë stabile dhe precize. Njeriu mendon se ato nuk ndryshojnë kurrë, si për shembull: dielli, hëna, toka dhe uji. Të gjitha këto shenja, janë krijuar për jetën e njeriut në tokë. Atëherë, kur të përfundojë kjo jetë, do të vijë kataklizma që do t'a ndryshojë tokën, qiellin, ujin dhe çdo gjë, që na rrethon. Do të përmbysët kjo jetë, do të fillojë një jetë tjetër, që do të shoqërohet nga të tjera ligje. Jeta e re, do të vazhdojë me begati të tjera, të cilat

gjithashtu do të shoqërohen nga shkaqe të panjohura për ne. Veprat do të transferohen në kujtesën e njeriut dhe çdo gjë, që do të t'i kujtohet, do t'a ketë para vetes. Nëse do të dëshirojë diçka, do t'a shikojë, pasi ajo në çast do të shfaqet para tij. E tërë kjo, do të vijë nga Fuqia e All-llahut xh.sh., e kurrësesi nga forca jote, e imja, e atij, etj.

Harmonia e universit, burimin e ka në Fuqinë e All-llahut të Lartësuar. Ai, vazhdimisht, na përkujton Fuqinë e Tij, sepse kjo ishte edhe arsyeja e vetme e krijimit të krijesave dhe shenjave në univers, me qëllim që të na përkujtojë Fuqinë e Tij. Në to, ka zbritur edhe shkaqet sipas proceseve natyrore, të cilat janë si një lloj preteksti apo alibie, për t'i besuar këto shkaqe apo jo. Për këtë arsye, na dërgoi pejgamberë, që të na përkujtojnë se, Ai, i cili na krijoi është All-llahu i Lartësuar, dhe se ne jetojmë prej Tij, që prej fillimit në këtë botë, dhe pastaj, jeta jonë do të kthehet përsëri tek Ai. All-llahu do t'i ndihmojë të gjithë ata, që e besuan në këtë botë, edhe në ahiret.

Para se të flasim për mundësitë e All-llahut xh.sh., dhe çfarë Ai na prezanton neve, dëshiroj që të ndalem shumë pak, rreth debatit të madh, që është zhvilluar midis orientalistëve për mbështetjen, që All-llahu xh.sh., ua dha besimtarëve, me anë të melekëve, në betejën e Bedrit. Disa orientalistë, këtë ngjarje, e konsiderojnë si jo të vërtetë, sepse beteja nuk përkon me realitetin e betejës.

Na është e njohur se, një melek që ka mbështetjen e All-llahut do të mund t'a shkatërrojë një qytet të tërë njëherësh, prandaj (orientalistët thonë): si është e mundur që All-llahu të dërgojë një numër aq të madh melekësh, në një betejë të vogël, siç ishte ajo e Bedrit, ku numri i të vrarëve ishte pak mbi shtatëdhjetë? A mundet të përcaktohet se cili e mbyti tjetrin, cili musliman e mbyti mushrikun dhe cili melek e bëri atë?

Atyre iu përgjigjemi: Ju kurrësesi nuk do t'a kuptoni urtësinë, se si u ndihmuan muslimanët, në këtë betejë, nga melekët. Një gjë, na është shumë e saktë, se melekët u dhanë kurajo muslimanëve për të luftuar, sepse kurejshitët politeistë kishin një numër të madh fisesh dhe ishin shumë më shumë në numër, se muslimanët. Melekët iu dhanë kurajo për shkak të numrit të madh (të kundërshtarit) të tyre, ndërsa vetë ngjarja ishte prej All-llahut të Lartëmadhëruar, i Cili është i Dituri i sekreteve dhe i së ardhmes. Ajo dituri, padyshim, se përkon me rezultatin. Ishte në dijen e Tij, se një numër i palës kundërshtare, do të dilte nga rreshtat e tyre, dhe do të kalonte në mbrojtje të fesë së All-llahut.

Gjithashtu, ishte në dijen e Tij, se ata do të luftojnë në emër të Tij, dhe kështu do të ishin fitues dhe ngadhënjimtarë të fesë Islame. Qëllimi i kësaj lufte ishte që ata t'a kuptonin, se ishin në palën humbëse dhe të mohimit të së vërtetës, pasi All-llahu atyre, ua kishte vulosur zemrat dhe ata vazhduan me mosbesim. Sot, ne ata mund t'i krahasojmë me kriminelët e luftës, ose mercenarët, sepse ata që duhej të luftonin ishin paguar, për t'a luftuar fenë e All-llahut xh.sh. i Lartëmadhëruari e dinte, se ata, ishin armiq të përbetuar të fesë së Tij. E dinte se ata kishin ardhur për t'a luftuar All-llahun dhe Pejgamberin e Tij.

Këta mercenarë dhe armiq të përbetuar ishin në këtë shënjestër, kurse të tjerët nuk u ekzekutuan, ngase nuk e kishin atë armiqësi të theksuar, si shembulli i atyre të paguarve ose injorantëve. Kur ne themi, se melekët iu dhanë kurajo muslimanëve, dhe se ata ishin në krahun e tyre, kjo është mëse e vërtetë. Kur ne themi se, melekët kanë marrë pjesë aktive në betejë, kupohet se ata edhe kanë mbytur jobesimtarë, kanë mbytur ata persona, që nuk i arriti shpata e muslimanit. E nëse, kjo vepër, nuk i përkon forcës së melekëve, ajo përkon me arritjen e qëllimit dhe urtësisë. Sikur, i Lartëmadhëruari, të dëshironte t'i shkatërronte të gjithë mosbesimtarët në rruzullin tokësor, do t'a

bënte atë, vetëm me një shprehje: 'Bëhu!' Por, këtu qëllimi nuk ishte për të gjithë pabesimtarët, sepse Ai e dinte qysh më parë, se disa prej tyre do të udhëzohen dhe do të bëhen pjestarë të kësaj feje dhe do të luftojnë në emër të All-llahut të Lartësuar.

Na kanë ngelur edhe disa pyetje: Nëse kjo do të ishte e vëretetë, pse atëherë All-llahu nuk i mbyti ata (armiqtë) para se të luftoheshin (nga besimtarët), kur Ai e kishte atë mundësi? Përgjigja është fare e lehtë. I Lartësuari All-llah, dëshiron që feja të ngadhënjejë nga vetë besimtarët, e nuk dëshiron që ngadhënjimi të vinte prej Fuqisë së Tij absolute. Sikur t'a përdorte absolutizmin e vet, Ai nuk do të kishte dërguar pejgamberë. All-llahu pret që njerëzimi t'a kuptojë mesazhin dhe t'i bindet Atij me dëshirën e vet. Që ne të shfaqim respekt-nënshtrimin ndaj Tij, me vullnetin tonë të lirë, dhe në të njëjtën kohë, të posedojmë alternativën tonë të veprimi, për t'a bërë, apo për mos t'a bërë, një gjë të tillë.

Nëse e bëjmë dhe e pranojmë, Ai do të na ndihmojë, sepse Ai na ka premtuar se do t'i ndihmojë besimtarët, duke i mbështetur me mbrojtje dhe kurajo. Ai, me këtë dëshiroi që, ne besimtarët të jemi të bindur në vete dhe në forcën që mund të posedojmë, që nga çlirimi i Mekkes dhe Siujdhesës Arabe, deri tek pjesët e tjera të botës. Për këtë arsye, iu dha kurajo me anën e melekëve. I përgatiti në këtë mënyrë, deri sa erdhi beteja tjetër.

Muslimanët u rreshtuan në fushëbetejë, me bindje të plotë, se All-llahu xh.sh., është me ta. Ata kishin bindje të plotë, se do të ngadhënjenin, sado e madhe të ishte ushtria kundërshtarë. Ata, nuk e kishin tani frikën e së kaluarës, por ishin plot iman dhe bindje të plotë. Ata, tani, e dinin mirë domethënien e besimit të tyre dhe detyrimet, se për çfarë ata duhej të luftonin në betejat e ardhshme. Për ta, ligjëroi edhe Kur'ani, dhe ai është Fjala e All-llahut. Ky (ligjërim) nuk do të

zëvendësohet e as nuk do të ndryshohet, deri në Ditën e Kijametit. Ai mbeti në Kur'an dhe do të mbetet, jo vetëm për ata, që e përjetuan betejën e Bedrit, por për të gjithë ata, që nuk e kanë përjetuar. Për t'a kuptuar të gjithë se, All-llahu xh.sh. i mbështet dhe i ndihmon të gjithë besimtarët me melekë, për t'iu dhënë kurajo dhe për t'i bërë ata ngadhnjimtarrë. Kështu, muslimani do t'a ndiejë veten, deri në Ditën e Kijametit, se e ka përkrahjen e All-llahut xh.sh., deri në fitore. Ky shpirt besimtari, i shndërruar në muxhahid, do të bëhet burrë e shkuar burrit, në zemrën e tij, nuk do të ketë vend frika e humbjes nga armiqtë e All-llahut, sado i madh që të jetë numri i armiqve.

MELEKËT DHE BETEJA E BEDRIT

Përderisa, i Lartëmadhëruari ka kërkuar nga njerëzimi që të veprojë sipas dispozitave ligjore, Ai ka sjellë për ta, edhe teoritë, edhe zbatimin e tyre, në të njëjtën kohë. Këto teori, janë të theksuara në Kur'anin Kerim, kurse zbatimi i tyre, është ajo që ndodhi në betejën e Bedrit. Dhënia e kurajos, me anë të melekëve, kishte për qëllim forcimin e besimit. Ky relacion, do të qëndrojë deri në Ditën e Kijametit, kurse përsa u përket të humburve të betejës, këtu aludohet për pabesimtarët, që ishin dhe mbetën pabesimtarë. Në të, shohim harmoninë e plotë, midis ajetit kur'anor, që ka për qëllim besimin në mbështetjen e besimtarëve, dhe qëllimit real. Ai ishte realizimi i asaj, që u tha, në vepër, në kohën e duhur dhe në vendin e duhur, dhe realizimi i qëllimit sekret, që ishte brenda ushtrisë armike, prej atyre që ishin të shtyrë t'i luftonin muslimanët në Bedër, dhe atyre që

do t'a përqafonin Islamin, dhe prej atyre, që do të luftonin në emër të All-llahut dhe do të korrnin fitore për fenë e All-llahut.

Kjo ishte një pasqyrë e shkurtër, sa për t'iu përgjigjur të gjithë atyre që duan t'a njollosin fenë e All-llahut, duke u përpjekur të fusin dyshime në Kur'an. Tani, të shohim dhe të përkujtojmë atë, se çka na mëson i Lartësuar, për mundësitë e Tij të përhershme. Atë, që Ai në mëson neve, duhet t'a kuptojmë si mëshirë prej Tij, për krijesën e vet, sepse ajo na largon nga dënimi dhe na mundëson jetë të ndershme, në këtë planet. Për këtë temë, do të mbaj disa ligjërime rreth sures "Tarik", e cila është një sure, ndër suret e tjera të Kur'an-it. Kjo sure, na përkujton Forcën e All-llahut të Lartëmadhëruar, dhe se nuk ka asgjë në këtë botë, që të mund të dalë jashtë kësaj Force. I Lartësuar All-llah, në këtë sure, thotë:

"Pasha qiellin dhe Tarik-un"²

Me fjalën qiell, kuptojmë çdo gjë që është sipër nesh dhe që bën hije. Sado sipër të ngjitet njeriu, thuhet se ai është në qiell. Dijetarët, që në fillim të emërimit të qiellit, kanë thënë se, qiell është gjithçka që qëndron menjëherë përmbi njeriun. Sa më shumë që All-llahu na shpalos dituritë në qiell, aq më shumë zbulojmë gjëra të reja në ato lartësira, që me një fjalë janë emëruar 'qiell'. U zbulua se shtatë trupa qiellorë rrotulloheshin rreth diellit, dhe atyre iu thanë 'shtatë qiej', pastaj u zbuluan edhe trupa të tjerë dhe komentimet e më hershme u ndërprejnë, sepse sot, numri i tyre, ka arritur në dhjetë.

² Kur'an, 86/1

Në fakt, definicioni shkencor për qiellin është i cekët. Le do të shohim se çfarë na thotë i Lartësuari, rreth krijimit të qiellit:

"Dhe qiellin e ndërtuam me duart (forcën tonë) dhe Ne e zgjerojmë atë"³

Çfarë do të thotë se, Ai i dha cilësinë e zgjerimit ose shtrirjes (seatun) ndërtimit të qiellit? Më herët kishim potencuar, në temën rreth Forcës së All-llahut dhe asaj të njeriut, se dallimi ndërmjet tyre është i pakrahasueshëm, sepse është jashtëzakonisht i madh. Sa herë, që njeriu beson se kjo është Forca e realtë e All-llahut xh.sh., del se kjo forcë është akoma më e madhe. All-llahut xh.sh., nuk i ngjason askush, dhe nëse fillojmë krahasimin me diçka të cilësive së All-llahut xh.sh., do të mbetemi shumë i zhgënjyer, sepse Allahut nuk i ngjason askush. All-llahu xh.sh., ka thënë "dhe Ne e zgjerojmë atë" – gjë që jep të kuptohet se Ai është shumë larg, nuk ka fund, dhe se nuk do të mund të arrihet kurrë nga mendja jonë e kufizuar. Thënia se 'qiellin e përbëjnë planetet dhe yjet, të cilat i shohim' nuk është e vërtetë, sepse All-llahu xh.sh., kur na ka treguar për planetet, ka thënë:

"Vërtet, Ne e stolisëm qiellin e botës me bukuritë e yjeve"⁴

Këto gjëra, të cilat janë skicuar, janë në qiellin e botës, ndërsa më pas, mbi këtë tavan mbrojtës, janë qiejt, ashtu si ka dashur All-llahu i Lartësuar. Fjala 'zgjeruar' kuptohet si pafundësi (infiniti), gjë që, mendja e njeriut, nuk e percepton dot. Përderisa i Lartësuar është betuar në të, detyrimisht ne duhet t'a kuptojmë si një diçka shumë të madhe dhe të mahnitshme. E tërë kjo, qëndron jashtë

³ Kur'an, 51/47

⁴ Kur'an, 37/6

mendjes së çdo individi, pasi ndërtimi dhe mbrojtja e tyre, paraqesin një prej mrekullive të Allahut xh.sh.

Ç'ËSHTË TARIK-U

I lartësuari thotë: "Pasha qiellin dhe Tarik-un"⁵ Ç'kuptim ka fjala 'Tarik' dhe pse duhej të betohej i lartësuari për këtë fjalë? Përgjigja vjen menjëherë, në ajetin tjetër vijues: "E ku e dini ju se ç'është Tarik-u?". Kjo mënyrë pyetjeje, na bën me dije se ne nuk jemi në gjendje t'a përceptojmë atë, dhe se Ai dëshiron të na tregojë për "Tarik-un", pasi në këtë fjalë ka diçka të rëndësishme.

Të përqëndrohemi në këtë pikë, vetëm pak. 'Tarik' është përemër foljor dhe rrjedh prej fjalës 'Tareke', kurse 'tarek'e ka kuptimin – me i ra me forcë - me trokit⁶, e kjo rënie nxjerr zërin, që detyrimisht njeriu e dallon atë. Tarik-u është pra, udhëtuesi në errësirë. Kur nata është e qetë, dëgjohen edhe zërat e hapave, kurse gjatë ditës, në mes të lëvizjeve dhe zhurmave të shumta, ato nuk dëgjohen. Këtu pra, e ngacmon mendjen, që t'a përvetësojë njeriu. Të gjitha këto kuptime, mbliidhen në një vend dhe këto japin një kuptim. Këtu, kemi të bëjmë me një gjë, që i përket shqisave ose materies, ose shpirtit. Na jep të kuptojmë se kjo i ngjason Tarikut - asaj rënieje të fortë, e cila të detyron t'a vështrosh atë, edhe pse nuk e ke pasur fare vëmendjen në të. Kjo vjen

⁵ Kur'an, 86/1

⁶ Tarik, ndryshe e quajnë edhe vizitori natës, ai i cili depërton thellë në brendinë e sekreteve të njeriut

nga jashtë, nuk është në gjendje personaliteti i njeriut t'a ndalojë veten, ajo nuk është e brendshme, por ndikon thellë në shpirt.

Pastaj, i Lartëmadhëruari thotë:

"E ku e dini ju, se ç'është Tarik-u. Ai është Ylli Ndriçues"

Yll ndriçues është ai, i cili e dërgon ndriçimin e tij në errësirë, për t'u udhëzuar nëpërmjet tij. Ai e shpon errësirën, për të treguar rrugën, me anë të ndriçimit të tij. Përderisa i Lartësuari na mundësoi që të udhëtojmë ditën dhe natën, Ai na tregoi, gjithashtu, edhe rrugët e udhëzimit. Gjatë ditës, udhëzues kemi diellin dhe dritën, kurse gjatë natës kemi yjet dhe hënën. Secila kohë, ka udhëzuesin e vet. Kur zgjohesh në mëngjes, sheh se si dita është përplot dritë, e kur të udhëtosh gjatë natës, hëna dhe yjet, të japin drejtimin. Kështu pra, All-llahu xh.sh., kurrësesi nuk të lë vetëm, gjithmonë ke drejtues.

Të vazhdojmë me kapitullin e Kur'ani Kerimit:

"Nuk ka asnjë njeri, që ndaj tij të mos ketë përcjellës"

Cilat janë lidhjet midis qiellit, Tarik-ut, yllit ndriçues dhe kujdesit ndaj vetvetes? Nëse i japim një vështrim horizontal, nuk do të gjejmë asnjë gjë të përbashkët midis tyre, por, në realitet ato kanë lidhje njëra me tjetrën, gjë që do të na bëjë ne, të përkujtojmë Forcën e All-llahut xh.sh. Kështu, i Lartësuari, dëshiroi që ne të kemi vëmendjen tek Forca dhe mundësitë e Tij. Për këtë arsye, edhe u betua për qiellin, që buron nga cilësia e Forcës së Tij, i Cili e ndërtoi qiellin me këtë madhështi. Ai, atë e zgjeroi dhe e ruajti. Secili, që e mëson lëndën e astronautikës, e njeh Forcën e All-llahut

xh.sh. më mirë se çdo kush tjetër, sepse ai i shikon ato hapësira të pafundme që kapin me miliona vit-drite dhe me to, akoma nuk ka arritur në qiellin e parë.

NATËN GJITHASHTU

Shtatë qiejt, e theksuar në Kur'an, ende janë sekret për ne, ato janë në dijeninë e All-llahut të Lartësuar. Forca e All-llahut në planetin tokë dhe përreth nesh, troket në mendjet tona për çdo sekondë. Ngado që të kthehemi, në horizont, shikojmë p.sh.: drunj, lule, kodra, detra, etj. Shikojmë krijaturën e All-llahut, në çdo anë dhe në çdo vend. Në çdo moment, neve na ngacmojnë shikimet mbi krijimet e All-llahut xh.sh., të cilat na e përkujtojnë Atë. E tërë kjo që na rrethon, tregon madhësinë, mundësinë dhe forcën e All-llahut të Lartësuar. Kjo është jeta jonë në tërësi. E gjithë kjo, mund të konsiderohet se është rruga me shenja, e cila na tregon Forcën Hyjnore.

Pastaj i Lartësuari, na përkujton, kur thotë: "Ai është Ylli ndriçues", ndriçimi i të cilit, shpon errësirën. Me këtë, Ai dëshiroi të na tregojë se përveç dritës, posedon edhe forcën. Qoftë në mesin e njerëzve, apo qoftë në një vend më të largët, kur nga të gjitha anët është i rrethuar me errësirë, nata është mbulesa më e mirë e njeriut. Njeriu mendon se askush nuk e sheh, për arsye të errësirës së thellë, ose heshtjes të plotë. Shumica e njerëzve flenë natën, me përjashtim të një pakiceje. Edhe pse jemi në dijeni të këtij fenomeni, ne duhet të jemi të përgatitur, se edhe pas kësaj errësireje apo heshtjeje të plotë, gjenden drita, të cilat depërtojnë nëpër errësirë dhe mësojnë

për sekretet tona. Qoftë edhe sikur të gjithë njerëzit të mos jenë prezent, sikur vetëm ti jesh i zgjuar, kjo nuk të jep të drejtën të mendosh ndryshe, sepse duhet t'a dish se është Forca dhe dituria e All-llahut xh.sh., që të përcjell në çdo çast. Në këtë pjesë të kësaj sureje, i Lartësuar i dëshiroi të na tregojë se, asgjë prej gjëje, në këtë botë, nuk mund t'i fshihet Atij, qoftë ditën ose natën, pa marrë parasysh vendin dhe hapësirën ku gjendemi. Nëse besojmë se gjatë ditës, drita e saj është dëshmitar, përcjellësi ynë dhe lëvizjet e jetës do të na ndalojnë nga të këqiat, që duam t'i bëjmë, për shkak se drita na përcjell. Duhet të kuptojmë se, edhe nata nuk na mbron nga All-llahu xh.sh., pasi duhet t'a kemi parasysh se paska diçka, që e shpon errësirën dhe i sheh të gjitha lëvizjet ose veprat tona, që mund të bëhen gjatë natës.

Mundësitë e All-llahut të Lartësuar janë të pafundme, mendjet tona do ta kuptonin deri diku, madhështinë e qiellit të hapur dhe sekretet e ndërtimit të tij. All-llahu xh.sh. na sheh, si në dritë, ashtu edhe në errësirë, qofshim vetëm, ose në grup. Kjo është Forca, e cila troket në mendjet tona vazhdimisht dhe na përkujton, sa herë që duam të mëkatojmë, se All-llahu xh.sh. na dëgjon, na sheh dhe ne nuk mundemi t'i fshihemi kurrësesi Forcës së Tij.

Kjo na bën të kuptojmë se çfarëdo, që mendojmë të bëjmë, për këto (veprime) nuk është në dijeni vetëm All-llahu xh.sh., sepse veprat tona regjistrohen. Secili njeri e ka kujdestarin e vet dhe çdo gjë është në një regjistër, që ruhet mirë. Asgjë prej gjëje, nuk mbetet pa u regjistruar, qoftë vepër shumë e vogël, apo shumë e madhe. Njeriu, për atë që ka bërë, do të japë llogari.

Secili njeri, në Ditën e Gjykimit, ka për t'u bindur për precizitetin e regjistrimeve, dhe atëherë pabesimtarët do të thonë:

"Dhe kur të sillet libri (i veprave), do t'i shohësh mëkatarët të frikësuar nga shënimet, që janë në të dhe do të thonë:

"Ç'është me këtë libër! Nuk paska lënë as më të voglën (vepër), e as më të madhen, pa e përfshirë! Ata i gjetën, para vetes, veprat e tyre të bëra, dhe Zoti yt nuk e dëmton askënd"⁷.

Forca dhe mundësia e Tij, qëndrojnë të gatshme për çdo moment, ditën qoftë, apo natën. Janë të gatshme të depërtojnë ose të shpojnë çdo pengesë. Dikush, vazhdimisht shkruan për veprat e bëra, si për veten e vet, ashtu edhe për të tjerët. All-llahu xh.sh. do t'i shpërblejë të gjithë ata, sipas veprave të bëra, për secilën fjalë, që nxjerrin nga goja dhe për secilën vepër, që bëjnë. Ai (njeriu), vazhdimisht është në marrëdhënie me All-llahun xh.sh. Dënimi, vjen nga vetja, kurse, Ai, i Lartëmadhëruari do t'a përcaktojë dënimin.

Kështu, vepron edhe me ata, që bëjnë vepra të mira, duke i shpërblyer me të mira. Nëse dikush merr pasuri të paligjshme, All-llahu xh.sh., do t'a dënojë. Kështu do të veprojë për secilën vepër të bërë, sepse njeriu është në marrëdhënie direkte me All-llahun xh.sh. O njeri! Asnjëherë mos të shkojë mendja se mund t'a mashtrosh Atë. Nëse tenton diçka të tillë, do të mashtrohesh shumë keq. Nëse bën një vepër dhe orvatesh t'a fshehësh atë qëllimisht, dije se Forca e All-llahut të Lartëmadhëruar, është ajo që depërton në brendi të sekretit tënd, dhe Ai do të të gjykojë për të.

Ishte dëshira e All-llahut xh.sh., që të jetë i Drejtë, dhe kjo bën që Forca e Tij, të jetë në krahun e më të dobët, kundër të fortit. Është me të dëmtuarin, kundër dëmtuesit dhe nuk e braktis atë, deri kur të barazohen forcat. Ai ka vendosur peshoren për jetërat, në këtë botë. Sikur, All-llahu

⁷ Kur'an, 18/19

xh.sh., të ishte në krah të më të fuqishmit kundër të dobëtve, me dëmtuesit kundër të dëmtuarve, sigurisht, që kishte për t'u prishur bota. Padrejtësia do të përhapej nëpër botë dhe do të kishim, vetëm, zotërinj dhe robër. Forca e të fuqishmëve do të rritej vazhdimisht dhe, me të, edhe padrejtësia. Por ja që, All-llahu xh.sh., i thotë të fuqishmit, nëse provon t'a keqpërdorosh forcën që të kam dhënë, dhe që momentalisht ti e disponon, mbaje mend se Unë jam me të dobët. Unë nuk i duroj reprezaljet dhe tiraninë, prandaj mos tento të bësh trazira dhe ngatërresa në tokë. Fuqia e vetme e vërtetë, është me All-llahun e Lartësuar. Atë nuk ka fuqi që t'a mundë, e Ai është me të dobët, kundër atyre që e keqpërdorin forcën, prandaj ju 'të fortë' kenë kujdes!

Ki kujdes, fshije nga mendja çdo tentativë të keqe, që mund t'a hidhërojë All-llahun e Lartëmadhëruar. Nëse e përkujton Atë, me siguri, që ke për t'u penduar. Do të kthehen shpresat, se do të bëhesh pjesëtar i besimtarëve, pasi në zemrën tënde, të ketë hyrë imani. E kenë vërejtur, se secili njeri që ka pretenduar se ka forcë, dhe se mund të bëjë çfarë të dëshirojë, ka dalë i humbur. O njeri! Përpara ke Forcën, që nuk krahasohet me asnjë forcë njeriu.

Bota është plot shembuj, rreth Mundësive dhe Forcës së All-llahut të Lartësuar. Ndodh që, një njeri të ketë pozitë, të posedojë fuqi maramendëse dhe vetëm për një çast, gjendja e tij mund të ndryshojë plotësisht. Atë mund t'a gjejmë në burg, të paautoritetshëm dhe të pafuqishëm. Ndodh që të kërkojë një gotë ujë nga roja, kurse para pak orësh ishte një njeri, që çdo gjest të tij e përcillnin, mjaftonte të lëvizte gishtin e tij, apo të urdhëronte ndokënd prej qindra rojtarëve të tij. Kjo është jeta! Kështu e ka koordinuar All-llahu xh.sh., për t'ua bërë me dije tiranëve se, All-llahu është me të dobët dhe, fuqinë e tyre, mund t'a përmbysë në çast.

Tek All-llahu xh.sh., nuk ka privilegje. Më i dashur tek Ai, është ai, që i ka veprat më të mira. Ai, gjithashtu, nuk e urren askënd, përveç atyre që shkaktojnë dëme. Me këtë qëndrim, All-llahu xh.sh., e mban drejtësinë midis njerëzve. Por, një gjë është e saktë, se Forca e All-llahut të Lartësuar i troket vazhdimisht mendjes së njeriut, për të na përkujtuar të vërtetën, derisa të bindemi, se duhet të largohemi nga e keqja. T'a kuptojmë se, vetëm All-llahu xh.sh., është Ai që jep. Edhe sikur të gjitha mundësitë e njerëzve, të bëheshin në një anë, do të zhdukeshin, para Forcës së All-llahut. Ai ju jep riskun miliarda njerëzve, iu jep besimtarëve atë, që duan t'a shijojnë. Brenda ditës, shpëton me miliona njerëz nga fatkeqësitë dhe katastrofat, në kriza të ndryshme. Gjithashtu, Mundësitë e Tij, evitojnë nga besimtari, torturat dhe fatkeqësitë që mund t'a godasin. Përfundimisht, secili njeri duhet t'a kuptojë se çdo gjë, është e shkruar, dhe se njeriu do të paraqitet për të dhënë llogari tek All-llahu, në ahiret. Kjo, ishte një thirrje ndaj njerëzve, që bëjnë dëme dhe shndërrohen në tiranë.

ALL-LLAHU NA MBRON

Kuptuam se në krah të qenies njerëzore janë melekët, që janë shumë të vëmendshëm dhe regjistrojnë çdo vepër. Ata kujdesen që besimtarët të mos e pësojnë nga të këqijat, me të cilat dikush orvatet t'i dëmtojë ata. Ndodh që, disa njerëz, nganjëherë të thonë: nuk dimë se si u bë dhe nga erdhëm, por ne shpëtuam, vërtet shpëtuam. Sikur të mos ishte vullneti i All-llahut, ata nuk do të shpëtonin. Ata, përderisa, janë qenie njerëzore, i kanë mundësitë të kufizuara dhe nuk kanë se si t'u shpëtojnë katastrofave. Për këtë arsye, njeriu nuk mundet t'ia atribuojë vetes

shpëtimin. Prandaj, nëse një besimtar ose një grup besimtarësh shpëtojnë, le t'a dinë se mbrojtja prej së keqes, që iu ishte planifikuar atyre, erdhi prej Forcës së All-llahut të Lartëmadhëruar.

Ajeti tjetër kur'anor, i sures Tarik, vazhdon e thotë:

"Le të shikojë njeriu prej çka është krijuar. Ai u krijua nga uji që hidhet fuqishëm, që del nga kurrizi shpinës dhe dërrasa e gjoksit"⁸.

Të jemi preçiz tani, në këtë koment. I Lartësuari, na i tregoi këto, për të qenë ne të vëmendshëm, të mos gabojmë eventualisht dhe të mos mundohemi t'a mashtrojmë Atë. Ai, ia përkujton njeriut: 'O ju njerëz, para se të mburreni ose të mendoni se keni forcë, dhe para se të bëni gabime, duke i mohuar begatitë e Mia, mendoni vetëm pak, vlerësojeni veten mirë dhe dijeni hallin vetes. Ju vlerësuat se jeni zotër të universit, por dijeni se All-llahu ju bëri zotër, dijeni se, Ai urdhëroi që juve t'ju binden të gjitha forcat e tjera të universit. Kjo, u bë me urdhërin Tim të prerë, por dijeni edhe se ju nuk keni dorë që t'i urdhëroni ato'. Ky duhej të ishte falenderimi i parë, dhe ne duhet t'i bien në sexhde për këtë begati, por ja që, mes nesh, mbretëron naiviteti, dashuria dhe adhurimi ndaj vetvetes. Përditshmëria, gjithashtu, e bën njeriun naiv, duke vetëbesuar në veten e tij.

Nëse, kjo të ndodh edhe ty, atëherë ndalo vetëm pak, dhe mendo: cili të krijoi, a është ai prej llojit tënd, a është ai si ti, qenie njerëzore? Kur të fillosh me analiza të tilla të hollësishme, ke për të vërejtur se, ajo që ndodhi, nuk kishte të bënte fare me mundësitë e qenies njerëzore, por me mundësitë e All-llahut xh.sh. Që prej këtij momenti do të kuptohet, fare lehtë, esenca e ndodhive. Të marrim, si shembull, qelizën. Ajo nuk ka kurrfarë mundësie të bëjë diçka, kur është e vetme, si

⁸ Kur'an, 86/7

e tillë, ajo do të zhdukej. Por, kur atë e merr Forca e All-llahut, në emër të Tij, një pjesë e saj shndërrohet në asht, të tjerat në muskuj, në nerva, në tru, në mushkri, në zemër, në sy, në gjuhë, në duar e në këmbë, dhe disa të tjera ngelin brenda, dhe ato zhvillohen pasi njeriu të ketë dalë në këtë botë.

Kështu, shohim se si kjo qelizë, qenka shumë precize. Krijoka miliona gjëra, që e përbëjnë trupin e njeriut, gjakun dhe gjithçka që i nevojitet atij trupi, për të jetuar. Nga një gjë, u krijuan shumë gjëra. Prej ashtit, u bë skeleti, brenda të cilit ka zbrazëtira. Kemi eshtra të rrafshtë dhe eshtra që janë shumë preçize, të tilla që krijojnë një lidhshmëri njëra pas tjetrës, thuajse janë një armatë e plotë, të cilat ndërtojnë një aparaturë të plotë të sistemit nervor dhe të sistemit të tretjes. E gjithë kjo, tregon për një preçizitet të mahnitshëm dhe një Inxhinjeri Hyjnore, e cila është e vetmja mundësi, që mund t'i relizojë këto mrekulli.

I Lartësuar, me këtë sikur na thotë: mos u bë naiv, me atë që njeh rreth krijimit, por nëse dëshiron, kthehu pak prapa, në gjenezë, që t'a njohësh Madhështinë Hyjnore. Krijimi nuk është rezultat i mundësisë së qelizës, por ai është rezultat i mundësisë së All-llahut xh.sh. Ai, në një prej sureve të Tij, thotë:

"Le t'a shikojë njeriu prej çka është krijuar..."

Ky ajet i bën me dije njeriut, që të mos vazhdojë të mburret dhe të mos tregohet naiv. Kemi disa njerëz që pyesin: Ademi a.s. nuk është krijuar në këtë mënyrë, a ka treguar Kur'ani diçka rreth tij? Atyre ju themi: Ka dallim midis përjetimit të krijimit të dëshmuar dhe krijimit sekret të padëshmuar. Ademi a.s., i takon krijimit të përjetuar dhe të dëshmuar, sepse e diti se si u krijua dhe ai e kishte parë All-llahun xh.sh. Këtij (Ademit a.s.) nuk i duhej që t'a përkujtonin, kurse ne

të gjithë, që jemi krijuar nga Ademi, kemi nevojë të dimë se si u krijua ai, sepse nuk e kemi dëshmuar atë. Për këtë arsye, në të shumtën e rasteve, mendjes i mungojnë gjërat dhe ka nevojë për teori, që t'i ketë në formë aksiome. Ai (njeriu), ose i njeh gjërat në këtë formë, ose ia atribuon rastësisë, kur për këtë nuk i mjaftojnë thëniet All-llahut xh.sh., apo i lë anash e të harruara thëniet e Atij, i Cili bëri që nga një qelizë preçize, të formohet një sistem i plotë, i Cili e krijoi qenien njerëzore, pastaj i dha mundësinë e zhvillimit, etapë pas etape, deri në vdekjen e tij.

VËSHTRIM NGA KRIJUESI

Nëse njeriu mburret me forcat dhe mundësitë e tij, atëherë All-llahu gjithësesi, në njërën formë apo në formën tjetër, do t'a paralajmërojë. Atij i përkujton, fillimisht, se si është bërë krijimi tij, duke i thënë: përkujtohu se nga se u krijove, sepse kështu ke për t'i njohur forcat dhe mundësitë e tua, prandaj mos u mburr. Përkujtoje veten, kur ishe një qelizë e vogël dhe preçize, atëherë kur filloi krijimi yt! Ti para atij momenti, ishe një hiç. Këtu do të vërejmë, se sa preçize është thënia e All-llahut xh.sh. në njërën prej sureve të Kur'anit. I Lartëmadhëruari dëshiroi që, me Forcën e Tij, të trokasë vazhdimisht në mendjet tona, në mënyrë që ne të jemi në gjendje gadishmërie të vazhdueshme, që të mos gabojmë. Sa herë që na preokupojnë problemet e botës, dukemi të hutuar dhe duke mos e njohur realitetin, botën që na rrethon, shpeshherë e ndiejmë veten të fuqishëm. Pas kësaj ndienje, natyrshëm, njeriu demonstron fuqinë dhe mburrjen. Në këto çaste kulmore, kur ne e ndiejmë veten të madh, shohim se si Forca e All-llahut xh.sh., do të trokasë në mendjet tona, për të na kujtuar se All-llahu xh.sh. ekziston dhe se dikush, vazhdimisht, i

regjistron veprat tona. Me këtë, na bën që të mos nxitojmë dhe na bën që të planifikojmë më mirë e më gjatë.

Disa njerëz edhe mund të pyesin, cili është raporti midis: yllit ndriçues, melekëve të kujdesshëm që regjistrojnë dhe krijimit të njeriut? Nga pozicioni i njeriut, me një shikim sipërfaqësor, duket se nuk ka kurrfarë lidhshmërie, por në realitet ka lidhshmëri të plotë. Mbase, duket se termat janë krejtësisht të ndryshme dhe ato nuk përputhen mes vete, por kemi edhe të tillë, që pyesin se çfarë lidhje ose marrëdhënie mund të ketë krijimi i njeriut dhe ylli ndriçues? Ne i përgjigjemi se, këtu kemi të bëjmë me përkujtimin e Forcës së All-llahut xh.sh. Ylli ndriçues si përkujtues, tregon se njeriut, nuk mund t'i shpëtojë asgjë, nga dituria e All-llahut. Përkujtimin e krijoi i Lartësuar, nga madhështia e Tij, dhe Forca e Tij vlen për njeriun. Si u bë që, kjo thërmijë kaq e vogël, që nuk e shohin dot sytë e njeriut, të ndërtojë njeriun, i cili do t'a zotërojë gjithësinë!?

Vazhdojmë me ajetin tjetër kur'anor. Pasi na përkujton yllin ndriçues, melekët regjistruar dhe madhësinë e krijimit të njeriut, i Lartësuar All-llah, thotë: "Pa dyshim, Ai edhe për rikthimin ka mundësi"⁹. Nëse i Lartësuar, ishte në gjendje që t'a krijojë njeriun nga hiçi, i dha pamje dhe e përsosi, prej një thërmie të vockël, vallë a nuk është në gjendje që t'a rikthejë atë? Logjika në këtë rast thotë: Po!

Të marrim një shembull për këtë, edhe pse All-llahut i takon shembulli më i lartë. Nëse vjen ustai, për të të riparuar diçka, që të është dëmtuar dhe të cilën ai vetë e ka ndërtuar më parë, vallë a nuk do të jetë ai në gjendje, që t'a riparojë ose t'a ndërtojë atë sërish? Natyrisht se, për të, është më e

⁹ (po aty-sure Tarik)

lehtë, sepse tani ka përvojë më të madhe, se sa herën e parën dhe do t'a rindërtojë atë më shpejt. Nëse kjo vlen për njeriun, i cili ka mundësi të kufizuara, atëherë ç'mund të themi për Mundësitë e All-llahut xh.sh., që janë të pakufizuara? Ai e krijoi njeriun prej hiçit, prej diçkaje që nuk ekzistonte. Kur ai të vdesë dhe të zhbëhet fare, ai edhe më tej do të vazhdojë të jetë dhe nuk do të mund të dalë jashtë mundësisë së fuqisë së All-llahut xh.sh. All-llahu, edhe në këtë gjendje, ka mundësi që t'a rikthejë, sigurisht që tani është (më) lehtë.

Krijimi i parë u bë prej hiçit, krijimi i dytë, nga diçka që ka ekzistuar më parë. Natyrisht, se krijimi nga asgjëja, është më i vështirë se krijimi prej diçkaje. Kjo është vetëm sa për t'a kuptuar më lehtë, është sa për t'ia afruar mendjes së njeriut, sepse në të vërtetë, për All-llahun nuk ekziston shprehja 'e lehtë dhe e rëndë'. Atij, çdo gjë, i nënshtrohet nëpërmjet urdhërit: 'Kun' - 'Bëhu' (dhe ajo bëhet).

Kur i Lartësuari na përkujton ne, se Ai është në gjendje edhe të na rikthejë, kjo nuk do të thotë se Ai ka nevojë për njërin krijim, apo për rikrijimin tjetër. Ai nuk ka nevojë për askënd, është i pasur, dhe Ai nuk pasurohet aspak nëse ne e besojmë Atë, si edhe Atij nuk i mungon asgjë, sikur ne të mos e besojmë Atë. Ne, këtë, duhet t'a kuptojmë si mëshirë për ne, sepse Kur'anë është mëshirë për mbarë njerëzimin. Me madhështinë e krijimit, Ai troket vazhdimisht në kokat tona, për të mos humbur, deri në vetëshkatërrim. Kështu, këto përkujtime, na shërbejnë për t'a na ndriçuar rrugën drejt All-llahut xh.sh dhe për të na ndaluar nga mëkatet. Pra, thënia e All-llahut xh.sh.: "Pa dyshim, Ai, edhe për rikthimin, ka mundësi", do të thotë: mos mendoni se sido që të jeni, të gjallë apo të vdekur, do të mund të dilni jashtë sferës së mbretërimit të All-llahut xh.sh., ose të mendoni se mund të dilni jashtë mundësisë së Fuqisë së Tij. Kudo që të jemi dhe sido që të jemi, ne të

gjithë, jemi nën mbikqyrjen e Tij, për çdo çast. Mrekullia e krijimit të njeriut, e shton imanin tonë, në Forcën e All-llahut të Lartëmadhëruar.

SHPALOSJA E SEKRETEVE

Ajeti në vazhdim, brenda kësaj sureje të bekuar, thotë: "Ditën, kur të fshehurat do të verifikohen". Kuptimi i kësaj, është i njëjtë me kuptimin paraprak, pra ne, nuk mundemi t'i shmangemi (llogarisë së) veprës së bërë. Ne, nuk kemi mundësi t'a manipulojmë, t'a korruptojmë, ose diçka tjetër të ngjashme, të Lartëmadhëruarin. Tek All-llahu, nijeti ose qëllimi është pikënisja e dhënies së llogarisë. Për këtë arsye, i Lartëmadhëruari, thotë : "Ditën, kur të fshehurat do të verifikohen". Nijeti, vendin e vet, e ka në zemër, ai është vendi më i saktë dhe më i pavarur, në të cilin njeriu ka liri të plotë. Askush nuk ka mundësi, ose nuk e ka në dorë, t'a obligojë atë, me diçka, që ajo nuk e dëshiron. Trupi, mund të të tradhëtojë dhe të detyrojë të veprosh ndonjë gjë, pa dëshirën tënde, thjesht, në forma të ndryshme, të persekuton. Gjuha, gjithashtu, mund të të tradhëtojë, të bën që të flasësh nga frika apo tmerri. Gjithashtu, mund të të tradhëtojë edhe lëvizjet e tua, mund të të fusin në burg, ose në një vend, ku ti nuk mund të lëvizësh. Të gjitha pjesët e materies, që posedon njeriu, mund t'a tradhëtojnë atë, me përjashtim të zemrës. Askush nuk mund t'a detyrojë zemrën, që të të tradhëtojë për ato gjëra që nuk i dëshiron, apo të të fusë me forcë në zemër ato ndjenja, të cilat nuk i dëshiron. Sikur, e tërë bota, të mblidhej për t'a verifikuar atë që ke brenda saj, apo për të vendosur në të, një gjë, të cilën ti nuk e dëshiron, nuk kishte për të korrur sukses. I Lartësuari, këtë vend, e ka lënë në liri të plotë, sepse gjykimi do të

bëhet në bazë të saj. Për të qenë gjykimi i drejtë dhe i saktë, duhet të mos ketë ndërhyrje prej fuqive të tjera, me të cilat njeriu nuk pajtohet. Nënshtrimi i njeriut bëhet vetëm në dëshirën e tij të lirë.

Për këtë arsye, i Lartësuari, e ka anuluar gjykimin, ndaj atij që e urren veprimin që ka bërë (pasi ka qenë i detyruar t'a bëjë atë). Këtu, bëhet fjalë, për besimin dhe mosbesimin (kufrin), që janë në vendin kulmor të kësaj jete. All-llahu i Lartëmadhëruar thotë: "...me përjashtim të atij që dhunohet (për të mohuar), e zemra e tij është e mbushur plotësisht me besim..."¹⁰. Këtu hyn edhe urrejtja ndaj prostitucionit. I Lartësuari, nuk na gjykon për ato (vepra për të cilat na detyrojnë). Gjykimi bëhet vetëm për veprat e lira, që i ka pranuar zemra, pasi ndjenjat (tona) i kanë parapëlqyer ato, duke mos pasur kurrfarë presioni dhe kurrfarë urrejtje ndaj tyre. I Lartëmadhëruari, në të njëjtën kohë, na parakujton se: kush mendon se mund t'a mashtrojë, duke thënë se ai 'e urren' (veprimin), por nuk e ka urrejtur, por ka vepruar me dëshirë të plotë (atëherë, ai njeri gabon). Për këtë, i Lartësuari, tha: "Ditën, kur të fshehurat do të verifikohen"¹¹, pra atë ditë, kur do të nxirret e vërteta nga zemra. Sado që të jemi të shkathët apo gjenialë, që me to (shkathhtësinë dhe zotësinë), do të mund të mashtrojmë çdo individ apo një turmë njerëzish, ne, nuk do të arrimim kurrë t'a mashtrojmë All-llahun xh.sh. Në ahiret, veprat tona do të dalin shumë të hapta dhe të qarta, edhe pse njeriu i ka pasur sekret (në veten e tij) në këtë botë. I Lartësuari i di sekretet, dhe ato, do t'i shpalosë në Ditën e Gjykimit. Njeriu, ndonjëherë ndien në vetë, se ka shpëtuar (për ndonjë vepër të keqe që ka bërë), sepse askush nuk ka zbuluar atë, që ai ka bërë.

¹⁰ Kur'an, 16/106

¹¹ Sure - Tarik

Atë, që të tjerët nuk e zbuluan apo nuk e mësuan për të, padyshim se do t'a mësojnë, bile edhe do t'a shohin, pasi të paraqitemi të gjithë tek i Lartësuar, në ahiret. O njeri, nëse ke gjetur mundësi të veprosh diçka fshehurazi në këtë botë, dhe nëse ke arritur t'i manipulosh apo t'i bindësh të tjerët, që të mos e kuptojnë realitetit, dhe nëse ia ke dalë të jesh i pastër nga kjo botë, (atëherë) dije se, llogarisë së All-llahut xh.sh., nuk do t'i ikësh. Ai e di sekretin tend. Nëse, në këtë botë, të ishte dhënë mundësia që të posedoje fuqi, për t'a fshehur veprim (tënd), dhe arrite që të mos zbulohesh, të jesh i bindur, se, në ahiret, nuk do t'a kesh këtë fuqi.

Ajeti tjetër i kësaj sureje, në vazhdim, thotë: "E ai (njeriu) nuk ka as forcë e as ndihmëtarë"¹² Forca kuptohet në dy mënyra: e para, është forca personale që posedon njeriu. Kjo nuk bazohet në ndonjë mjet tjetër, që mund të të mbrojë, përveçse forcës trupore, armës apo çfarëdo (mjeti) tjetër që mund t'a kesh me vete dhe arrin të hakmerresh me të. E dyta është forca, e cila përbëhet nga shoqëria, që të përkrah dhe të ndihmon nga armiku, sikurse (është) ndokush që ka familje të madhe dhe të njohur, trimëritë e të cilëve rrethi (shoqëror) i njeh mirë, apo ndokush, që ka gardën e vet që përbëhet nga bodigardë të armatosur mirë dhe të fuqishëm.

Ajeti kur'anor, na jep të njëjtin kuptim. Më parë, i Lartësuar i përkujtoi njeriut që të mos mburret, e të mos bëhet naiv, për t'a mashtruar vetveten, po ashtu tani i tregon se nuk duhet të mburret me fuqinë që posedon, e as me përkrahësit dhe ndihmëtarët e tij. Në ahiret, nuk do t'a ketë, as këtë fuqi personale, e as shoqërinë që do t'a ndihmojë. Por, shtrohet pyetja, pse i Lartësuar ia përkujton njeriut Fuqinë? Për arsye se, njeriu mendon të bëjë keq dhe të bëjë dëme në shoqëri.

¹² Kur'an 86/10 – sipas përkthimit të Sherif ef. Ahmetit

Gjithmonë të dëmtuarit, në këtë botë, janë të dobëtit. Atyre, i forti, ua merr të drejtën, e duke qenë se ata janë të dobët, nuk kanë mundësi që t'a kthejnë.

Të fuqishmit janë ata, që bëjnë krime dhe tiranizojnë masën, kurse në anën tjetër, i Lartësuari e ka ndaluar krimin dhe tiraninë, dhe u thotë: mos veproni ashtu, sepse (ajo) do t'u kthehet, dhe mos mendoni se (All-llahu) do t'u fali për ato, që vepruat. O njeri! Ti harrove se, melekët janë shumë të kujdesshëm dhe regjistrojnë çdo gjë, dhe ndërkohë vazhdoje të bëje vepra të këqija, duke menduar se askush nuk do t'a kuptonte dhe se do të shpëtoje. Asnjëherë, mos mendo, se fuqia jote e kësaj bote, qoftë ajo personale apo ajo (që ke) në grup, do të mbrojnë tek All-llahu i Lartësuar. Largohu nga ky mendim, sepse në çdo kohë, në kokën tënde troket lajmëtari, që të tregon se mundësitë e All-llahut, janë mbi të gjitha mundësitë, prandaj drejtoju programit (të përcaktuar nga Ai), të cilin All-llahu na e dhuroi (për t'a zbatuar) nga mëshira e Tij.

KTHEN SHIUN

Kur, i Lartëmadhëruari, na përkujton ahiretin, ka për qëllim, që ne të jemi më të sigurtë dhe, njëkohësisht, na bën që t'a përmbajmë veten, për t'u mos u shfrenuar, për të mos e ndier veten plotësisht të lirë, dhe për t'u mos iu dorëzuar epsheve dhe pasioneve tona. Mosbesimtari, ka siguri të plotë në vete, sepse ai mendon se, pas vdekjes nuk ka asgjë. Sikur të mendonte ndryshe, do t'a frenonte veten dhe do të frikësohej prej pasojave.

Ajeti i kësaj sure, në vazhdim, thotë: "Pasha qiellin, që kohë pas kohe kthen shiun"¹³ Fjala rexh'i, do të thotë 'shi'. Me këtë, i Lartësuari dëshiroi të na tregojë për një të vërtetë shkencore, e cila u zbulua disa shekuj, pas zbritjes së Kur'ani Kerimit. I Lartësuari dëshiroi që, edhe njeriu t'a kuptojë shkencërisht, se uji në tërësi avullohet, pastaj avulli ngjitet sipër në retë qiellore, dhe pastaj kthehet përsëri në formën e shiut. Pra, qielli e kthen ujin në tokë dhe kështu (uji) vazhdon të qarkullojë: uji i detërave avullon, (avulli) ngrihet lart në re, pastaj kthehet përsëri (në tokë në formë shiu) në ujë (të detërave dhe oqeanëve). Shikoni se sa preçize janë thëniet e Kur'anit: "Pasha qiellin, që kohë pas kohe kthen shiun". Pra, qielli e bart shiun. Ata, që nuk e njohin shkencërisht procesin e avullimit, kështu e kuptojnë. Nuk ka kurrfarë kundërthënie ose kontradikte me mendjen e njeriut, që do t'a injoronte këtë të vërtetë shkencore. Por, kur ky ajet u kuptua shkencërisht, atëherë ai u kuptua më saktë dhe më gjërë.

Pastaj, ajeti tjetër i kësaj sureje, vazhdon të thotë: "Edhe tokën që çahet për bimë"¹⁴. Pra, edhe toka, çahet që të dalë bima. Dhe kjo, përsëritet në çdo kohë që kryhen mbjelljet. Toka çahet, që prej saj të dalin bimët. Pastaj, vjen koha e mbelljeve të reja, për të mbirë bimë të reja. Çdo gjë, përsëritet. Këto janë rregullat e All-llahut të Lartësuar në tokë. Nëse çdo gjë, paska kthim, atëherë, pse vallë, vetëm njeriu të mos ketë kthim!?

Nëse dëshira e All-llahut, ishte që uji të (ri)kthehet në tokë në formë të shiut, dhe që toka të (ri)japë begatitë e veta gjithnjë të freskëta, atëherë kush e detyron njeriun të fyejë (vetveten) dhe të thotë se ai nuk do të kthehet më, kur (në të vërtetë) edhe jeta e tij ka kthim. Me këto shembuj, i

¹³ Vazhdim i ajeteve të kësaj sure. Marrë nga përkthimi i Sherif ef. Ahmetit

¹⁴ Vazhdim i ajeteve të kësaj sure. Marrë nga përkthimi i Sherif ef. Ahmetit

Lartësuari, dëshiroi që t'ia thjeshtojë sa më shumë mendjes sonë dhe të na japë (të kuptojmë) se si mundet që edhe njeriu të kthehet përsëri. Na solli si shembull, ujin dhe të mbjellat, për të na treguar se, Ai ka mundësi që të na (ri)kthejë edhe neve, shumë herë. Çështja, nuk është e vështirë për t'u kuptuar, pasi rikthimin e kemi vazhdimisht para syve tanë.

Ajeti tjetër, i kësaj sureje, vazhdon e thotë: "Është e vërtetë se ai (Kur'ani) është një fjalë që dallon-gjykon. Ai nuk është i parëndësishëm (lojë e kotë)! ¹⁵

Në këtë ajet, i Lartësuari, na tregon për seriozitetin (e Tij) të thellë. Ai na tërheq vëmendjen, duke na përkujtuar se këto fjalë nuk janë 'shkel e shko', por se duhet t'i kemi kujdes, bile, shumë kujdes. Përse na e tha këtë? Arsyeja është se në ahiret, do të bëhet ndarja. Atje, (askujt) nuk i jepet rast tjetër për t'u penduar, ose për t'u kthyer edhe një herë në këtë botë. Përderisa, kjo ndarje, është përfundimtare, atëherë nuk na pret gjë tjetër, përveç gjyqimit. Prandaj, Ai dëshiroi që fjalët e Tij, t'i marrim me shumë seriozitet, që në ahiret të mos kemi justifikim. Të mos themi pastaj se, kemi menduar se do të mund të ktheheshim përsëri në këtë botë, ose se shpresonim në Mëshirën Tënde, që pasi të të luteshim, do të na përkrahje që të ktheheshim, dhe se do bënim vetëm ato vepra, që do të të kënaqnin Ty. Prandaj tha: "...Është e vërtetë se ai (Kur'ani), është një fjalë që dallon-gjykon..." Është vendim, për të cilin nuk ka kthim. Pastaj, këtë të vërtetë, e ndërlihdh me thënien: "...Nuk është ai i parëndësishëm (lojë e kotë)". Shikoi edhe një herë këto ajete! Ajo, çka do të pësojë mëkatari, nuk është diçka e parëndësishme. Kur'ani Kerim, na tregon edhe për ata njerëz, të cilët thonë: "...neve nuk do të na kapë zjarri, veçse për disa ditë të numëruara..."¹⁶, ose

¹⁵ Vazhdim i ajeteve të kësaj sure. Marrë nga përkthimi i Sherif ef. Ahmetit

¹⁶ Kur'an, 2/80- sipas përkthimit të Sherif Ahmetit

thonë se, ata kanë mendim të mirë ndaj All-llahut (se Ai nuk do t'i dënojë edhe pse ata mëkatojnë), ose flasin duke u tallur, rreth zjarrit dhe dënimit (në Xhehennem). I Lartësuari na tërheq vëmendjen për të gjitha këto, dhe na thotë të mos tallemi dhe të humbim kohën kot. Ajo (Dita e Gjykimit) do të jetë një ditë shumë e rëndësishme, dhe çdo gjë që na është treguar (rreth saj) është Mëshirë për ne, prandaj jetën nuk duhet t'a marrim si lojë. Duhet t'a kuptojmë se mundësisë apo forcës së All-llahut, nuk i ngjason askush. Sa më shumë të kuptohet forca e All-llahu, aq më shumë, në shpirtin e besimtarit, ndiehet respekti ndaj All-llahut dhe frika ndaj Ditës së Kijametit.

EMHILHUM RUVEJDA

Tani, edhe kësaj sure, dalëngadalë po i vjen fundi, me këtë ajet të cituar: "Ata, vërtet, bëjnë kurthe. Po, edhe Unë, përgatis dështimin e kurtheve të tyre! E ti, jobesimtarëve, jepu afat, afatizoi ata pak"¹⁷ Në përfudim të sures, besimtarëve u bëhet një paralajmërim, se ata duhet t'a kenë gjithnjë parasysh, se janë nën kurthet e armiqtë. Këto kurthe ata (pabesimtarët), i bëjnë për t'a luftuar fenë e All-llahut xh.sh. Kur dëgjojmë ose shohim shkrime, që nuk i përshtaten (natyrës së) All-llahut të Lartësuar, si p.sh.: 'Zoti' po bën kurthe, dhe ne i bëjmë kurthe 'Atij', kjo shprehje kuptohet se është shprehje e atyre, që nuk i përfaqësojnë besimtarët. Për t'a argumentuar se All-llahu nuk bën kurthe, por kjo (hakmarrie) është përgjigje ndaj atyre, që mundohen të bëjnë

¹⁷ Kur'an, 86/17- Sipas përkthimit të Sherif Ahmetit

kurthe, marrim thënien e All-llahut xh.sh., në Kur'anin Kerim: "Ndëshkimi i një të keqe, bëhet me një të keqe në të njëjtën masë..."¹⁸

A është padrejtësi kur ne, e ndëshkojmë kryerësin e krimit, me po të njëjtin dënim, si edhe krimi i tij? Jo! Kur ne e ndëshkojmë kryerësin e krimit, për krimin e tij, kjo konsiderohet drejtësi, sepse kështu po ia kthejmë atij, në të njëjtën mënyrë, veprën e shëmtuar, që ai ka kryer. Nëse bën një gabim ose një mëkat, dhe nëse të dënojnë për gabimin që ke bërë, kjo nuk konsiderohet si gabim, por sjellja jote me veprën e bërë, të solli deri aty, sa t'a provosh të njëjtën dhimbje. Kjo dhimbje manifestohet në të njëjtën mënyrë, që ti e ke bërë, por ky (ndëshkim) konsiderohet si shpagim i gabimit apo krimit tënd, ose të bën që atë, mos t'a përsëritësh më asnjëherë.

Shpagimi i së keqes është i dhimbshëm. Ti nuk arrite deri tek qëllimi, të cilin e ëndërroje. Kishe për qëllim të veproje keq, t'a dëmtoje dikënd, ose (të kryeje) ndonjë vepër që e shqetësonte ndonjë njeri, por e keqja nuk u finalizua, dhe atëherë e ndien se çdo gjë, që kishe planifikuar dhe programuar, t'a ka prishur All-llahu xh.sh. Ty, kjo të dhemb, edhe pse ajo se çfarë ngjau, ishte një vepër e mirë. Në rast se do t'i përgjigjeshe të keqes me të keqe, sikur të goditje një njeri të dobët, dhe më pas të vinte një njeri tjetër më i fuqishëm dhe të të godiste, vepra e të dytit duhet të konsidrohet e mirë, sepse qëllimi i tij ishte t'a parandalonte veprën tënde të shëmtuar, ndaj të dobëtit. All-llahu i Lartëmadhëruar, është në gjendje që të të sjell dikënd, që është më i fuqishëm se ti, derisa t'a kuptosh se forca e përdorur e këtij tjetrit, është më e madhe, por e duhur dhe e drejtë. E keqe, quhet vepra e keqe e nismëtarit të së keqes. Nëse, këta që planifikojnë dhe parapërgatiten për të bërë këto vepra të shëmtuara, për t'i shqetësuar muslimanët dhe, me ato

¹⁸ Kur'an, 42/40 – Sipas përkthimit të Sherif ef. Ahmetit

(veprime të dëmshme), e luftojnë fenë e All-llahut xh.sh., atëherë i Lartësuar do t'i shpalosë kurthet e tyre, për t'i penguar ata.

Kur ne shohim disa njerëz, që mundohen t'a shfrytëzojnë shkencën materialiste dhe, me të, mundohen që t'i largojnë besimtarët nga imani (besimi) i tyre, apo (kur lexojmë) veprat e disa orientalistëve, që merren me "hulumtimin" e temave të ndryshme islame, por që, në realitet, mundohen t'a njollosin atë, duke sjellur shembuj që nuk i përkasin Islamit denjësisht, apo kur shohim disa, duke polemizuar rreth krijimit të qiejve dhe tokës, gjë që vazhdon edhe sot, në ditët tona të jetë një temë tërheqëse, në të vërtetë, të gjithë këta "shkencëtarë", janë duke bërë çmos, që t'a njollosin fenë e All-llahut. Ata, të gjithë mundohen të vendosin kurthe. Ata, mundohen t'a zbukurojnë rrugën e shtrembër, duke përdorur të gjitha mjetet e mundshme të kohës.

Para se të përfundojmë fjalën tonë, rreth këtyre njerëzve, duhet t'a kemi parasysh një gjë shumë të vërtetë, se sa më shumë të sulmohet feja e All-llahut xh.sh., aq më shumë ajo forcohet nga sulmet, që ia bëjnë ata, që e luftojnë atë. Nëse vëren se, muslimanët po persekutohen anekënd botës, dije se atje është zgjimi i fesë, nga vetë besimtarët. Ata, duke u sulmuar do të detyrohen të vetëmbrohen dhe orvajtjet e tyre do të japin rezultate të papritura. Çfarëdo armiku t'i paraqitet Islamit, do të vijë forca mbrojtëse (prej All-llahut) për këtë fe, në zemrat e besimtarëve. Disa besimtarë mund të bien pre, e kurtheve të atyre që i veprojnë kundër Islamit. Ata, këtë e bëjnë ose nga frika prej tyre, ose si tentativë, për të mbrojur besimtarët, që ndjekin rrugën e vërtetë, nga goditjet që mund t'i marrin. Këtë mund t'a bëjnë edhe prej mosdijes ose nga labiliteti i besimit të tyre. Kjo (e fundit) do t'i shtyjë ata drejt bashkëpunimit, kundër besimtarëve të singertë, duke i penguar ose (duke u përpjekur për t'i) larguar ata definitivisht nga adhurimi tyre.

Pabesimtarët, kurthet e tyre, i sajojnë në sajë të diturisë së tyre njerëzore, ata mundohen që t'a njollosin Kur'anin, me disa zbulime shkencore të vërteta, p.sh.: komentimin e formës të tokës, që e kemi theksuar në kapitujt e tjerë të mëhershëm, dhe sqaruam se atyre, i Lartësuari, u thotë: "Ndërsa tokën e kemi shtruar"¹⁹ gjë që vërteton se forma e tokës është e rrumbullakët. Ka pasur edhe raste dhe paraqitje të tjera, me të cilat (mosbesimtarët) u munduan të gjejnë 'kundërthënie brenda Kur'ani Kerimit', si p.sh. thënie: "Askush nuk do ta bartë barrën e askujt"²⁰, dhe: "Por ata, me siguri do të bartin barrën e vet, e me atë, edhe barrë të tjera..."²¹.

E vërteta është se personi i parë, për të cilin edhe aludon All-llahu xh.sh., në këtë thënie "Askush nuk do ta bartë barrën e askujt", vlen për atë që e ka bërë mëkatën, dhe secili njeri do të llogaritet sipas mëkatit të tij dhe askush tjetër, nuk do të pyetet për mëkatën e tij. Ndërsa, personi dytë, për të cilin bëhet fjalë në Kur'an: "Por ata, me siguri do të bartin barrën e vet, e me atë, edhe barrë të tjera...", është personi, të cilit nuk i mjaftoi vetëm mëkati i vet, por me të, ai mundohej t'i mashtronte edhe të tjerët për të mëkatuar. Sikurse kemi shembullin e një njeriu, që është duke u falur, ndërsa një tjetër orvatet t'ia prishë namazin, deri sa t'a bëjë atë për vete, që edhe ai të mos falet përfundimisht. Gjithashtu, kemi edhe njerëz, të cilët orvaten, që me lajkat e tyre të mashtrojnë të tjerët, për të mëkatuar. Po ashtu, kemi edhe një lloj tjetër (njerëzish), të cilët mundohen me të gjitha metodat dhe intelektin e tyre, që t'i bindin njerëzit, të largohen nga besimi

¹⁹ Kur'an, 15/19

²⁰ Kur'an, 6/ 164

²¹ Kur'an, 29/ 13

dhe rruga e drejtë. Këta, nuk do të bartin vetëm barrat e tyre, por atyre u takon edhe një përqindje e barrës së atyre që i mashtruan.

Kemi njerëz me oratori të fortë ose (që përdorin) metoda të tjera të ndryshme, që t'i bindin (njerëzit e tjerë) që të largohen nga imani dhe që i shpiejnë ata, në një besim tjetër të gabuar. P.sh., ata i fillojnë bisedat e tyre rreth namazit, duke thënë se ai nuk është asgjë tjetër, pos një 'mençuri' e të parëve tanë, të cilët i kanë nxitur njerëzit për stërvitjen fizike të trupit të tyre. Të tilla fjalë, po i dëgjojmë shumë, edhe këto kohët e fundit.

ALL-LLAHU ËSHTË KURTHUESI (KUNDËRVËNËSI) MË I MIRË

Këtë realitet, e ka theksuar All-llahu në Kur'anin Kerim, ngase kemi njerëz, të cilët vazhdimisht janë munduar, mundohen, dhe do të mundohen t'iu bëjnë kurthe besimtarëve, deri në Ditën e Kijametit. Ai, nuk na e përkujton këtë vetëm për t'a ditur, por për të na bindur se, kur ata planifikojnë kurthe, atëherë ne duhet t'a kemi të qartë, se atyre u pason kurthi i All-llahut të Lartësuar, e Ai është më i Mundshmi dhe më i Fuqishmi. Kur ata (armiqtë) planifikojnë, ne nuk duhet të zhgënjehemi, e as të frikësohemi, sepse All-llahu atyre do t'ua kthejë, ashtu siç e kanë merituar. Habitem me ata njerëz, që planifikojnë dhe mundohen të dalin kundër fesë së All-llahut në tokë! Për çka!? Vetëm e vetëm për t'a ngritur zërin rreth veprës së (tyre të) kotë. Ata, gjatë planifikimit të tyre, gjithësesi, bëjnë parapërgatitjet për të gjitha ato elemente, që kanë për të

sulmuar. Ata, studiojnë secilën pjesë, veç e veç, etapë pas etape dhe nga të gjitha këndet. Le të supozojmë, se ata do të korrin sukses, kur të fillojnë zbatimin e planifikimeve të tyre. Atyre ju themi se, kanë harruar një gjë shumë të rëndësishme, e ajo është: All-llahu ekziston dhe vetëm Ai paracakton. Dallimi, midis jush dhe Atij, është se ju planifikoni sipas kutit tuaj njerëzor, duke mos e ndierë se çfarë mund të përgatisë Ai, për ju. All-llahu i Lartësuar, e ndien dhe e sheh kurthin tuaj, ndërsa ju, nuk e parandieni të Tijin. Ai, në Kur'anin Kerim, thotë:

"(Përkujto o i dërguar) kur ata, që nuk besuan, thurnin kundër teje..."²²

dhe ajeti tjetër

"E ata (çifutët) i kurdisën një dredhi (mbytjen e Isait), All-llahu iu kundërvu dredhisë së tyre, All-llahu është asgjësuesi më i mirë i atyre që bëjnë dredhi".

Pse i Lartëmadhëruari ju tha se, është kurthuesi (kundërvënësi) më i mirë (i atyre që bëjnë dredhi)? (Sepse) Atë që di i Lartëmadhëruari, nuk e di askush tjetër. Përderisa, askush tjetër nuk mund t'a dijë se çfarë dredhirash, shpifjesh apo mashtrimesh, po mundohen të bëjnë kundrejt fesë së All-llahut dhe, përderisa, askush nuk është në gjendje t'i ndalojë ata, ose të kuptojë qëllimet e tyre sekrete, e ata kanë për qëllim të shkatërrojnë fenë e All-llahut, e kjo kuptohet si luftë ndaj të Lartëmadhëruarit, atëherë, Ai i nxjerr në shesh dredhitë e tyre. Atij, askush nuk mundet t'i dredhojë, e as t'a mashtrojë.

²² Kur'an, 8/30- sipas përkthimit të Sherif ef. Ahmetit

Ndërsa, pabesimtarët duhet që t'a kuptojnë mirë e qartë se, Ai e mbron këtë fe. Edhe pse, të gjitha parapërgatitjet e tyre, ishin shumë preçize dhe shumë sekrete, i Lartësuari bëri që ata të dështojnë. Jo vetëm të dështojnë, por, ajo e keqe, iu kthehet atyre vetë, ashtu siç ndodh në të shumtën e rasteve. Ata pyesin: cili ishte shkaku i këtij ndëshkimi!? Shkaku, është i qartë, por ja që njerëzit harrojnë shpesh mundësitë e All-llahut xh.sh.. Atë që e kërkuan, edhe e gjetën, por kuptohet me urdhërin e All-llahut. Çfarë kërkojnë, Ai ua jep, u jep sipas dëshirës së Tij. Le të kuptohet një herë e mirë se, i gjithë universi vepron sipas dëshirës së Tij. Forca e njeriut nuk mund të ndryshojë asgjë prej gjëje, me përjashtim të asaj, që dëshiron i Lartësuari.

E them me shumë ndërgjegje që secili njeri, i cili mundohet të bëjë diçka, dhe nuk e ka në konsideratë mundësinë dhe Forcën e All-llahut xh.sh., nuk do të mund t'a bëjë atë, sepse do t'i dalë një pengesë që do t'a pengojë, ose diçka e kundërt (e asaj që ai dëshiron) do t'i ndodhë atij. Pastaj, varet se çfarë përgatitje ka, por në të shumtën e rasteve atij, nuk i intereson më kjo botë, jeton pa program, i mbushur përplot zemërim dhe frikë, pa bërë asgjë.

I Lartësuari dëshiron që besimtari të ketë zemër të qetë, të frymojë lirshëm dhe t'i zbatojë ajetet kur'anore, ashtu siç janë në suren Tarik. Le t'a kuptojë se Forca e All-llahut xh.sh., troket-viziton vazhdimisht mendjet e tij dhe mos t'i mungojë (frika ndaj) Atij asnjëherë, për asgjë. Në kohën kur mëkaton, le t'a dije se e ka trokitësin, që e përkujton dhe t'i thërrasë mëndjes, për t'a kujtuar se ato janë vepra të shëmtuara, të papëlqyera nga besimtarët, dhe të pëlqyera nga pabesimtarët. Gjithashtu, kijeni parasysh, se pa lejen e Tij, i Lartëmadhëruari nuk ju lë t'a kryenit atë vepër. Ai, i di të gjitha kurthet që parapërgatitin pabesimtarët dhe do t'i shpërblejë ata, sipas veprës së tyre, bile dhe më tepër. Nëse nuk i përkujton këto, ka për të të munguar qetësia, prandaj për të qenë

me zemër të qetë, të lumtur, përkujto Perëndinë. Do të vëresh se do t'a ndiesh veten të fortë, të pa frikësuar nga të tjerët, përveç frikës së All-llahut xh.sh.

Erdhëm në fund të kësaj sureje, të Kur'an Kerimit: "All-llahu është asgjësuesi më i mirë i atyre, që bëjnë dredhi". All-llahu i Lartësuar kërkoi nga i Dërguari Tij, që t'iu caktojë një afat, dhe të presin vendimin e All-llahut xh.sh. Disa njerëz shpejtojnë në shpërblimet nga All-llahu xh.sh., dhe kërkojnë që kriminelët t'i dënojnë shpejt. Shumë të tjerë pyesin veten, pse i Lartësuari, kur i sheh të shëmtuarat dhe tiranët, dhe nuk ndërmerr masa (të menjëhershme), ku është Drejtësia dhe Forca e Tij!?

Ju themi, padyshim se drejtësia e Tij ekziston, Atij nuk i shpëton asgjë, por urtësia e Tij, për mbarë krijesat, do të shfaqet atëherë, kur do t'a marrin të gjithë shpërblimin e tyre, në momentin kur do të vijë koha. All-llahu xh.sh., e ka lënë njeriun të zgjedhë dhe nuk e ka detyruar, dallimi midis njeriut dhe krijesave të tjera është se, ai posedon lirinë e të zgjedhurit, ka alternativë, prandaj (All-llahu) nuk dëshiroi që t'a detyronte njerëzimin për të besuar. Sikur t'a dëshironte këtë, do t'u zbriste (njerëzve) një shenjë, që të gjithë do t'i nënshtroheshin deri në Ditën e Kijametit, e nuk do të ishin të lirë. Liria të jep dy mundësi: t'a bësh (një veprim) ose mos t'a bësh. Duhet të kesh liri të plotë dhe vetëbindje për All-llahun, pa pasur ndonjë presion, që kjo të shndërrohet në dashuri adhurimi, për t'i mundur të gjitha të këqijat, të cilat janë të stolisura me ndjenjën e kënaqësisë momentale.

FUQITË E FSHEHURA NË BOTË

I Lartësuarit kur e krijoi këtë univers, vendosi edhe rregullat e tij. Bëri që ato rregulla të nënshtrohen për atë, që janë krijuar. Njeriu drejtohet nga ligjet njerëzore, të cilat burojnë nga krijimi i tij prej dheu (toke). Exhinët kanë ligjet e tyre, që burojnë nga krijimi i tyre prej zjarri. Ata kanë mundësi të shumta shkatërruese, këtë ua mundëson natyrshmëria e tyre. Ata kanë mundësi t'a ndërrojnë formën e tyre, gjithashtu edhe djajtë kanë rregullat e veta. Melekët janë të krijuara nga drita dhe kanë rregullat e tyre. Këta zbresin nga qielli në tokë dhe ngrihen sipër, vetëm me urdhërin e All-llahut të Lartëmadhëruar.

Ne, kur flasim për shkencën, kërkojmë nga mendja jonë, që ajo të veprojë sipas dëshirës, për të hulumtuar atë çfarë ne dëshirojmë nga elementet e materies. Njeriu me diapazonin që ka, duhet t'a japë mundin e vet, për të hulumtuar rregullat e diellit, tokës, ujit, erërave, florës dhe faunës, dhe nga njeriu, gjithashtu, kërkohet që t'i zbulojë argumentet e All-llahut në univers.

I Lartësuarit, në Kur'anin famëlartë, thotë: "Ne atyre do t'ju tregojmë argumentet Tona në hapësirë (në qiej e tokë), si edhe në vetet tuaja, derisa të qartësohet se ai (Kur'ani) është i vërtetë"²³

I Lartësuarit, me këtë, na tregoi se do t'u japë mundësi pabesimtarëve, t'a vërtetojnë me argumente, se "...ai (Kur'ani) është i vërtetë". Ata të cilët do t'a vërtetojnë do të jenë mohues së fesë së vërtetë edhe pse, më parë ishin besimtarë. Ai (besimtari), nuk ka nevojë që t'ia përkujtojë:

²³ Kur'an, 41/53

"...derisa të qartësohet se ai (Kur'ani) është i vërtetë", sepse besimtari e di se Ai, Kur'ani dhe i dërguari i Tij janë të vërtetë, si dhe, kjo fe me programin e saj dhe paralajmërimin për ahiretin, janë të vërteta. Dëshira e All-llahut xh.sh., ishte që argumentet e Tij t'ua zbulojë pabesimtarëve, për t'ua ndërruar bindjet e tyre, që (ata) të rimendojnë për besimin e tyre, dhe t'a zotërojnë imanin në tokë.

Ata, me vetë dëshirë, po ndikojnë në largimin e tyre nga rruga e All-llahut xh.sh. Shpesh herë, paraqesin teorira dhe ide të ndryshme kotradiktore, me të cilat, vetëm sa e ç'orientojnë njerëzimin kundër asaj, që thuhet në Kur'an dhe vërtetësive të universit. Por, All-llahu xh.sh., bën që këta persona, që merren me hulumtime, t'a kuptojnë realitetin dhe t'i nënshtrohen forcës së imanit.

I Lartësuar, për t'ua vërtetuar atyre besimin në Një Zot, përdori (si shembull) vetë pabesimtarët, që në fillim të revelimit ose zbritjes së Kur'anit, e deri në ditët tona. Ai, që prej fillimit, zbriti një sure, në të cilën thotë:

"Iu thafshin duart Ebu Lehebit, ashtu siç i janë tharë. Atë nuk e ndihmoi pasuria e tij, që kishte fituar. Ai do të futet në zjarrin e ndezur. Ndërsa guaja e tij, është bartësja e thuprave, që në qafën e saj ka një litar të përdredhur".²⁴

Ky ajet, ashtu siç thamë, ka zbritur në pjesën e parë të shpalljes. Kjo ishte thënë sa për të sprovuar imanin e prijësit të mohuesve të fesë së vërtetë. Ebu Lehebi, ishte i lirë t'a mbronte veten kundër sulmit, që atij i bëri Kur'ani, me anën e kësaj kaptine. Ai ishte i lirë, të shprehej qoftë me hipokrizi, apo me shprehje falso (se e pranonte Islamit). Do të mjaftonte, që ai të mund

²⁴ Kur'an, 111/1-5

t'a përgënjeshtrojnë Kur'anin, vetëm sikur të thoshte në prezencën e një turme të madhe të bashkëvendasve të tij se: 'Për mua është thënë në Kur'anin e Muhammedit, i cili pretendon se ky libër do të ekzistojë deri në Ditën e Kijametit, se unë do të vdes si pabesimtar, dhe se do të digjem në zjarrin e xhehennemit, ndërsa unë deklaroj para ju të gjithëve se: "Nuk ka Hyjni tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i dërguari Tij", dhe me këtë po vërtetoj se, Muhamedi është një gënjeshtar. Sikur t'a bënte këtë, Ebu Lehebi do të mund t'a trondiste nga themeli fenë e All-llahut, por edhe këtë liri që e kishte, nuk ia mundësoi vetes. Gjithashtu, e njëjta gjë vlen edhe për çështjen e ndërrimit të Kibles: "Do të thonë disa njerëz mendjelehtë: çfarë i shtyri ata (muslimanët) t'a kthejnë (drejtimin e të falurit) kiblen..."²⁵

I Lartësuar e përdori shprehjen 'do të thonë' (në kohën e ardhme). Kjo tregon se, ata ende nuk kishin thënë, para se të shpallej ky ajet. Ishte e mundur, që ata edhe të mos e thonin, e më pastaj t'ju tregohej njerëzve se Muhammedi, në librin e tij, ka thënë se: "Do të thonë disa njerëz mendjelehtë: çfarë i shtyri ata (muslimanët) t'a kthejnë (drejtimin e të falurit) kiblen...", por, në realitet, askush prej nesh nuk e tha një gjë të tillë. Kjo, vërtet, do t'a rrëronte fenë, por ja që, ata e vërtetuan thënien e Kur'anit, pasi, vërtet, debatuan shumë rreth kësaj ngjarjeje.

Nëse tani kthehemi dhe shikojmë sfidat e kohës së re, do të shohim se i Lartësuar i thotë: "Unë, nuk i kam marrë ata për dëshmitarë gjatë krijimit të qiejve dhe tokës, as disa prej tyre gjatë krijimit të të tjerëve,dhe, Unë, nuk i kam marrë për ndihmës ata që mashtrojnë"²⁶

²⁵ Kur'an, 2/ 142

²⁶ Kur'an, 18/51 bazuar në përkthimin e Hasan I. Nahit

Do të vijnë njerëz, që (me teoritë e tyre) do të ndikojnë në humbjen drejtimit të njerëzve. Përderisa, ne nuk e kemi përjetuar krijimin e qiejve dhe tokës, e as krijimin e njeriut, e as që kemi ndonjë argument dhe askush nuk na sfidon rreth krijimit të qiejve dhe tokës, e as rreth krijimit njerëzor, pse duhet t'i fusim hundët aty, ku nuk na takon, e të themi se njeriu e ka prejardhjen prej majmunit, apo (të sajojmë) teori të tjera, që i përkasin teorisë së evolucionit.

Sikur, askush mos të mos polemizonte për këto çështje, atëherë do të kishim pasur të drejtë të themi se askush nga njerëzimi, nuk u fut në këto polemika, ndërsa, Kur'ani flet për to. Por ja që, disa (njerëz) janë munduar t'ua ndërrojnë drejtimin (të tjerëve) dhe t'i humbin nga rruga e All-llahut xh.sh., që t'a mohojnë Forcën Hyjnore rreth krijimit. Ata, me këtë, (në fakt) vetëm sa i shërbyen besimtarëve për të (kuptuar të) vërtetën. Kështu, do të vijnë vazhdimisht njerëz, që janë pabesimtarë, të cilët janë sfiduar nga Kur'ani, deri në Ditën e Kijametit, të cilët do t'i vërtetojnë thëniet e Kur'anit dhe me të (do të forcojnë) besimin (në vërtetësinë e tyre). Ata, me këto zbulime të reja, po i shërbejnë (vërtetësisë së) thënieve që gjenden në Kur'an, dhe po vërtetojnë se revelata e tij (Kur'ani), është nga i Lartëmadhëruari All-llah.

DISPOZITAT E XHIN-ËVE DHE MELEK-ËVE

Argumentimi i mundësive dhe Forcës Hyjnore ishte një hyrje e domosdoshme. Mendjet njerëzore, që mohojnë ekzistencën e All-llahut xh.sh., mundohen të ndërhyjnë aty, ku nuk kanë qasje, dhe aty ku, prej tyre, nuk kërkohet asgjë. Pse këto koka mohuese, merren edhe me krijesa të

tjera, sikurse janë melekët, ahireti, xhinnët, djajtë, e edhe me disa krijesa të tjera, për të cilat nuk kanë njohuri? Përderisa ne nuk kemi qasje në to, dhe nuk kemi mundësi të drejtëpërdrejtë, t'ua nënshtrojmë analizave tona laboratorike, atëherë pse t'i mohojmë, kur nuk kemi argumente shkencore për mosekzistimin e tyre?

Këtë që po e themi, nuk duhet t'a kuptojmë se jemi kundër eksperimenteve, ose se po e kufizojmë mendjen e njeriut. Mendja e njeriut, ka të drejtë që të hulumtojë, për çdo gjë, por prej saj kërkohet që të jetë konstruktive dhe për të mirën e njerëzimit. Asaj, i kërkohet të paraqesë argumentet e saj dhe pastaj të debatojë.

Kur flitet për dispozitat e xhinnëve dhe melekëve, apo për krijimin e njeriut, (dhe thuhet ajo) që është në kundërshtim me atë, që na mësoi i Lartëmadhëruari, ju themi atyre: cili është argumenti i tyre? Nëse është një supozim ose iluzion, ne nuk do të dalldisemi rreth tyre, por ju themi troç se, ne e refuzojmë dhe nuk e pranojmë si teori. Nëse vërtet kanë prova, argumente shkencore, atëherë, i marrim (në konsideratë) në rend dite, për të polemizuar me ta. Ne e kemi qasjen tonë rreth krijimit. Ajo na është prezantuar nga i Lartësuar, Ai na ka treguar mënyrën e përgjithshme, e jo të hollësishme rreth krijimit të materies organike dhe inorganike, prandaj ne jemi të interesuar të dimë edhe më shumë, rreth hollësirave që mund të na ofrojë shkenca.

Kur njeriu merr guximin të debatojë rreth tyre, ai mundohet që në çdo mënyrë, të sajojë ide, që i kundërshtojnë fjalët e Zotit dhe të hadithve, të të Dërguarit të All-llahut të Lartësuar. Në një hadith, thuhet: "Shejtani qarkullon në trupin e njeriut, ashtu siç qarkullon gjaku". Ata pa sjellë prova, thonë se, kjo thënie nuk ka të bëjë me të vërtetën, dhe se kjo s'është e mundur. Këtyre iu përgjigjemi: A mos vallë i njihni rregullat e shejtanëve? Do të përgjigjen: Jo! Ju themi përsëri: A

nuk është gjaku i përbërë prej rruazave të kuqe dhe të bardha, etj.? A nuk është e mundur, që mikrobet të futen dhe të qarkullojnë nëpër të? Atëherë, pse i mohoni thëniet e Pejgamberit s.a.v.s., kur thotë se ‘shejtani qarkullon brenda në gjak’, përderisa ju nuk keni njohuri dhe as argumentet më të vogla, mbi shejtanët, dhe përderisa të gjithë ne, e dimë se, çdo gjë vepron, sipas rregullave të krijimit të tyre. Rregullat e diellit, nuk vlejnë për tokën, rregullat e materieve inorganike nuk vlejnë për ato organiket. Kjo, na bën të themi se edhe melek-ët i kanë rregullat e tyre, ato veprojnë ashtu siç urdhërohen, gjithashtu edhe xhin-ët, i kanë rregullat e tyre, që janë të ndryshme prej atyre të njerëzve. Prej tyre (xhinëve) kemi besimtarë, që gëzojnë diturinë dhe mëshirën e All-llahut xh.sh. Ata kanë rregullat e tyre të veçanta, dhe kanë mundësi të ndryshme nga ato tonat, në univers.

Ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm, dhe çdo mbrëmje duhet të lexojmë dy kapituj të Kur’anit. Ato janë, suret: Felek dhe Nas. Në suren Felek, ne i drejtohem i Lartëmadhërishmit, duke kërkuar nga Ai ndihmë, prej atyre të cilët, kanë qasjet e tyre ndaj nesh, ndërsa ne jemi të pafuqishëm dhe nuk disponojmë lirinë tonë. Kurse në suren Nas, i drejtohem i All-llahut, duke kërkuar ndihmën e Tij, për ato gjëra që ne kemi qasje ndaj tyre, por që frikësohem i se po e zvogëlojmë imanin. T’a shpjegojmë këtë sure (kaptinë) më gjërësisht.

"Thuaj: i mbështetem Zotit të agimit. Prej dëmit të çdo krijese, që Ai e krijoi, dhe prej errësirës së natës, kur ngryset plotësisht. Dhe prej dëmit të atyre, që lidhin dhe fryejnë njeje, dhe prej dëmit të smirëkeqit, kur sipas smirës vepron"²⁷

²⁷ Kur’an, 113/ 1-5

I kërkojmë ndihmë All-llahut, prej të gjitha këtyre të këqijave. Këto (dëme) vijnë nga jashtë, ato s'i kemi brenda trupit tonë. Ose ndryshe, ato janë jashtë qasjes dhe sferës sonë, ne aty nuk mund t'a shtrijmë ndikimin tonë, që të na lejohet: të veprojmë ose të mos veprojmë. Kur i Lartësuari thotë: "Thuaj: i mbështetem Zotit të agimit...", njeriu këtu kërkon ndihmë dhe mbështetje prej Tij, nga gjërat që e shqetësojnë, ose e kërcënojnë sigurinë dhe qenjësinë njerëzore. Njeriu, nuk ka mundësi të përballet me to, prandaj, ai drejtohet drejt Forcës Hyjnore. Ai është i Vetmi, që ka mundësi të na mbrojë nga të këqijat, prej të cilave nuk mund të na mbrojë asnjë fuqi njerëzore.

I Lartëmadhëruari kërkoj nga ne, që Atij, dhe vetëm Atij, t'i mbështetemi. Kur ne e themi këtë, ne e kemi praktikuar programin Hyjnor. Ai është garantuesi, i Cili u sjell sigurinë atyre që frikësohen. Programi (Hyjnor) është drita dhe udhëzimi i njeriut, në jetën e tij. Agimi është drita, e cila del pas errësirës, ose ajo që agon prej njeriut nga zemra e tij. Pra agimi, edhe sipas kuptimit të parë, edhe të dytë, është prej All-llahut, i cili është Ai, që krijoi dritën në gjithësi, për t'ia lehtësuar jetën atyre, që kërkojnë udhëzim. Prandaj, ky (All-llahu) është Ai, që iu dha dritën në zemër, për t'u udhëzuar drejt imanit të plotë. Është Ai, që krijoi gjithësinë dhe i krijoi këto krijesa, që të jetojnë me dashuri dhe harmoni. Pra, duke shikuar kështu, vërejmë se, të dy këto kuptime, përputhen njëra me tjetrën.

All-llahu i Lartësuar kërkoj nga ne, që Atij t'i mbështetemi: "Prej dëmit të çdo krijese, që Ai e krijoi...". Këtu, të ndalemi pak. Përderisa, Ai tha: "Prej dëmit të çdo krijese, që Ai e krijoi...", do të thotë se kemi dëmtime që na shkaktohen nga krijesa të tjera, të cilat i krijoi i Lartësuari, për njerëzit. Duhet t'a kuptojmë dhe t'a kemi parasysh edhe një gjë se, i Lartësuari çdo gjë që e krijoi, e bëri për dobinë tonë. Njerëzit, shpjeguem më sipër se, orvaten të bëjnë keq, mëkatojnë, merren

me ngatërresa, me kriminalitet dhe shpeshherë janë pjesëmarrës në terror, etj., por, në këtë rast, duam të shtrojmë pyetjen: për cilin dëm, që e ka krijuar, flet i Lartësuari?

Ç'KUPTIM KANË VËRSHIMET DHE TËRMETET

Kemi dy mendime, që duhet t'i shtjellojmë në këtë temë. E para, ka të bëjë me Urtësinë e Krijuesit të Lartëmadhëruar, ndërsa e dyta, ka të bëjë me vetë njeriun.

Ajo, që ka të bëjë me Urtësinë e Krijuesit të Lartëmadhëruar, është se Ai, për ne, krijoi fuqi të mëdha në univers, të cilat e kryejnë obligimin e tyre, për aq sa iu është caktuar në këtë jetë. Këto fuqi i nënshtroi për ne, nga vullneti Tij. Diellin, hënën, tokën, yjet dhe çdo gjë që gjendet në univers, i nënshtroi për njeriun. Pra, të gjitha këto fuqi, i nënshtrohen njeriut, në emër të All-llahut xh.sh. Por ndodh, shpesh herë, që njeriu të harrojë dhe të mburret, duke thënë se, të gjitha këto, i nënshtrohen atij. Kur ai e kuptoi se, ka të bëjë me procese natyrore (që kryhen sipas ligjeve të rregullta të paracaktuara), ai u mundua t'ia atribuojë vetes këto kompetenca, duke shfrytëzuar këto procese, që All-llahu i kishte krijuar për të. Ai, tani mendon se, në këto, që i janë dhënë, është shumë normale, që All-llahu të mos ketë qasje në to. Por ja, që i Lartësuari, me shenjat dhe argumentet e Tij të njëpasnjëshme, ia përkujton krijesës së Tij (njeriut), begatitë që i janë servirur atij. Na përkujton me erëra të forta, që shkatërrojnë gjithçka që gjendet përreth nesh. Na përkujton, pak më rrallë, me tërmete dhe vërshime. Këto janë të rralla, sepse qëllimi i All-llahut, nuk është të shkatërrojë gjithçka. Sikur të dëshironte Ai, bota ose universi, do të shkatërrohej për

një çast. Qëllimi, këtu, është vetëm të përkujtuarit e njeriut. Nëse ti mendon se, çdo gjë të nënshtrohet ty, atëherë përkujto erërat, dhe shih se si sjellin furtuna të ndryshme shkatërrimtare. Kemi edhe rregulla të tjera të tokës dhe të asaj që shtrihet sipër saj, që të sjellin kënaqësi, por që ndoshta bëhen shkaktare që të përkujtojnë se, ti nuk je zotëruesi i tyre. Ti nuk e ke pavarësinë (fuqinë) të veprosht me këto forca, edhe pse ato të nënshtrohen, ose edhe pse t'i këto forca (ndonjëherë) i shfrytëzon. Ato i nënshtrohen vetëm All-llahut xh.sh., dhe në këtë mënyrë e adhurojnë, dhe i bëjnë sexhde Atij.

Shenjat, na paraqiten herë pas herë, dhe në distanca shumë të kufizuara, sa për të na përkujtuar Forcën e All-llahut xh.sh. Ato, na vijnë në forma të ndryshme, dhe kanë për qëllim të na e përkujtojnë këtë forcë. Marrim si shembull kafshët, disa prej të cilave janë shtëpiake dhe na sjellin dobi të drejtëpërdrejta. Kali, p.sh. është më i fuqishëm se një djalosh, por ky djalosh mund t'a kalërojë atë, si të dojë dhe sa të dojë. Trupi, mendja dhe forca e këtij djaloshi, nuk mundin që t'a përvetësojnë kalin deri në nënshtrim, vetëm me vetëdëshirën e tij, pra, me dëshirën e njeriut. Nëse do të ishte e mundur të ndeshej kali me djaloshin, kali do të fitonte për pak sekonda, por ja që këtë kafshë, i Lartësuari e ka urdhëruar që t'i shërbejë njeriut. Ka bërë që kali, t'i përulet Fuqisë së All-llahut, dhe pastaj njeriu të mund t'a shfrytëzojë për qëllimet e veta.

Le të marrim një shembull tjetër, si p.sh. gjarpërin. Shohim se, All-llahu, nuk e krijoi atë, që ai t'i nënshtrohet njeriut, por kjo nuk jep të kuptohet se, ai absolutisht është në dëm të tij. Helmi i tij, në të shumtën e rasteve, është i dobishëm për njeriun, sepse prej tij bëjmë barëra, që ua shpëtojnë jetën mijëra njerëzve, gjithashtu, e shfrytëzojmë edhe lëkurën e tij. Disa popuj, e përdorin edhe për ushqim. Pra, nuk qenka krijuar, absolutisht, për të keqen tonë. Por, nëse e frikësojmë befasisht, atë (gjarpërin) e kaplon frika dhe, në atë moment, mund të jetë edhe

vdekjeprurës për njeriun. Për këtë arsye, kërkojmë mbështetje nga All-llahu xh.sh., prej tij. Pse? Për shkak se, përderisa i Lartësuar nuk na i nënshtroi ne, ai është në gjendje që të na sulmojë dhe të vdesim. Le të ndalemi, tani, tek krijesat e padukshme, sikurse janë shejtanët (djajtë) dhe xhin-ët. Shohim se, edhe këto, nuk janë nën pronësinë tonë, nuk janë të nënshtuara dhe nuk i shërbejnë njeriut. Por, ato mund të ndikojnë në mendjen e njeriut, dhe t'a shqetësojnë, apo bezdisin atë.

Pas gjithë këtyre, mund të themi se, ne nuk kemi forcë që të përballemi me to, sepse ne nuk i shohim, por All-llahu kërkoi nga ne, që t'i kërkojmë ndihmë (Atij, që të na ruajë) prej tyre. Kur ne e bëjmë këtë, dhe kërkojmë mbështetje nga All-llahu i Lartësuar, ndaj dëmeve eventuale të këtyre krijesave, çështja mbetet midis vullnetit të All-llahut dhe midis tyre, aty mund të shfaqet një perde dhe ato janë të padëmshme. Pra, po shohim se ekzistojnë gjëra, që i Lartësuar nuk ia nënshtroi njeriut, qofshin ato forca inorganike ose organike, qofshin ato edhe të njeriut, i cili jeton me to, ose qofshin ato prej fuqive sekrete, tek të cilat ne nuk kemi qasje, e as nuk mundemi që t'i shikojmë. Ato mund t'a dëmtojnë njeriun, sepse forca e njeriut, kundrejt tyre, është më e vogël dhe ai nuk mundet, që me forcën e tij vetjake, t'ju kundërvihet atyre. Përderisa është kështu, i Lartëmadhëruari, na ka urdhëruar që, ne të kërkojmë ndihmë prej Tij.

Ne, kur jemi të sëmurë, mbështetemi tek All-llahun xh.sh., që Fuqia e Tij të jetë prezente (të ndikojë në shërimin e sëmundjes sonë) dhe pastaj marrim barërat, duke shpresuar se ato do të veprojnë gjatë kurimit tonë, duke na pastruar nga mikrobet. Ndodh shpesh që, dy njerëzve me të njëjtën sëmundje, t'u jepet i njëjtë bar mjekues, por njërit i ndihmon, e tjetrit jo, edhe pse sëmundja është e njëjtë. Nëse e pyesim mjekut, ai ka për t'u përgjigjur, se Fuqia e All-llahut ka ndikuar që, tek njëri prej tyre të luftohen mikrobet, e tek tjetri jo. Mikrobet, nuk duhet kuptuar si dëmtuese për njerëzit, ne vetëm sa morrëm shembullin e largimit të sëmundjeve. Ndodh që, prej

tyre, të bëjmë edhe barëra. Ne duhet të jemi me ata, që kërkojnë të kurohen, natyrisht me barëra, por duke u mbështetur tek All-llahu i Lartësuar. Ne duhet t'a njohim Atë, si shëruesin e vërtetë. Ky ishte qëllimi i thënies: "Dhe kur të sëmurem, Ai do të më shërojë"²⁸ Kur njeriu mbështetet tek barërat, ai duhet t'i kuptojë ato, vetëm si shkaktare (ndërmjetëse) të procesit të shërimit, ndërsa e di se, shëruesi i vërtetë është All-llahut xh.sh. I Lartësuari, na ka urdhëruar që të mbështetemi tek barërat, të cilat i ka krijuar i Lartësuari për të ndërmjetësuar tek i sëmuri, dhe pasi t'a kemi respektuar urdhërin e All-llahut, atëherë çështjen e lëmë në vullnetin e All-llahut xh.sh. Nuk ka dyshim se, këtë thënie të cilën po e themi, më së miri e kuptojnë vetë mjekët, të cilët e dëshmojnë këtë lloj mrekullie të përditshme. Ata, gjithnjë presin, pasi t'ia kenë propozuar barin pacientit të tyre, të ndikojë edhe vullneti i All-llahut xh.sh., në shërimin e tyre.

Pra, prej gjithë kësaj sa thamë, kuptohet se çdo e keqe vjen nga njeriu, në qoftëse ai i shpërdoron mjetet, të cilat janë krijuar të nënshtruara për njeriun, si fuqia e mikrobeve, ose gjarpëri, ose edhe çfarëdo lloj krijimi, nga krijimet e All-llahut xh.sh., të cilat kanë të bëjnë me proceset e universit, sikurse fuqia e diellit, hënës, erërave, detërave, ditës, etj ... I Lartësuari, gjithnjë, dëshiron që të na përkujtojë se, gjërat që na rrinë prapa, veprojnë me vullnetin e Tij, e jo me shkathësitë dhe dituritë tona. Na sjell gjëra, që janë të pafuqishme në dukje, kundrejt gjërave, që janë gjigante në univers. Na, jep si për shembull forcën e mikrobeve dhe të diellit. Me këtë, na tregon se është Ai, i cili e nënshtroi këtë forcë gjigante, për ne. Ne, nuk jemi në gjendje t'i largojmë edhe ato gjallesa, që në dukje janë shumë të vogla- mikrobet. Këtë e bëri, që njeriu t'a kuptojë se, si universi, ashtu edhe mikrobet, i janë nënshtruar njeriut, dhe se njeriu nuk ka rrugë tjetër, veçse të kërkojë ndihmë nga

²⁸ Kur'an, 26/80

i Lartësuar. Këto janë shkaktare, që njeriu t'a kujtojë All-llahun xh.sh., për begatitë e Tij. Kur këto, i sjellin atij shumë shqetësime, njeriu e kupton se ka shumë nevojë për Të, bile në çdo minutë. Ajo, që e bën njeriun të mos u frikësohet krijesave, që nuk kanë lidhshmëri me të, është besimi, dhe në të njëjtën kohë, ai bindet për dobësinë dhe mundësitë e tij të kufizuara, kundrejt Krijuesit të vet. Ai e vëren dhe është i bindur se, është i dobët dhe s'ka mundësi që t'i shkatërrojë ato fuqi. Por, kur ai i dorëzohet Fuqisë së All-llahut xh.sh., ka bindjen se ato fuqi, nuk kanë kurrfarë mundësie që t'a dëmtojnë atë.

URTËSIA E KRIJIMIT

Kjo është urtësia e Krijuesit, dhe urtësia e të krijuarit është gjithnjë në komparacion midis krijesave që i nënshtrohen vullnetit tonë, dhe atyre që nuk na nënshtrohen. Ky komparacion është i gjithmonshëm dhe do të vazhdojë përherë kështu. Këto janë shenja të përditshmërisë sonë, për (t'ua tërhequr vëmendjen) gjithë ata (atyre), që mundohen t'a largojnë veten nga imani. Njeriu, që e ka harruar All-llahun, bëhet vulgar, dhe mendon se është mbret i botës dhe i atyre që jetojnë në të. Ai, vazhdon të mendojë kështu, dhe shpesh herë edhe vepron në dëm të të tjerëve, por (papritmas) i Lartësuar i dërgon atij një sëmundje, prej disa gjallesave tepër të vogla, por shumë precize, që ne i quajmë mikrobe. Këto gjallesa tepër të vogla, e bëjnë të mos jetë i aftë të lëvizë, por ndodh që edhe t'ia humbasin aftësinë e të folurit. Kështu, Krijuesi i përkujton krijesës së Vet, urtësinë (dhe fuqinë) e Tij. Mund të jetë mbret, mizor apo tiran, dhe All-llahu, kur të dëshirojë, përnjëherë e poshtëron. Duke u përballur me sëmundjen, atij do t'i kujtohet

Lartëmadhëria e vërtetë, dhe duke ofshëtirë, do të thotë: ‘Subhanallah’. Kështu, i Lartëmadhëruari ua përkujton fuqinë e vërtetë hyjnore, të gjithë atyre, që mundohen t’i harrojnë dhuntitë dhe bukuritë e All-llahut xh.sh.

Më pas, lexojmë thënien e të Lartëmadhëruarit: "dhe prej sherrit të natës, kur e kaplon errësira e thellë"²⁹, ku përdoren fjalët ‘gasik’-‘nata’ dhe ‘idha vekab’-‘errësira e thellë’. Me këtë, i Lartësuar, do të na thotë neve, se: Unë e krijova natën dhe ditën, e bëra ditën të ndriçtshme dhe të sigurtë për të lëvizur lirshëm. Ndërsa, natën e krijova të qetë dhe të errët për të fjetur, për të pushuar, dhe për të qenë të gatshëm për të vepruar ditën e nesërme. Por, nata është e errët dhe kjo jep të kuptohet se, në errësirë gjërat mund të fshihen dhe kjo, jep më shumë mundësira për të kryer vepra të këqia. Në të shumtën e rasteve, krimet bëhen natën. Gjatë ditës, armiku vërehet, atij i shihet forca, dhe shpesh herë ai mburret duke e defiluar forcën e vet. Edhe pse (armiku) ngjall frikë dhe shqetësim, njeriu i zakonshëm e ndien veten të sigurtë, sepse përreth tij ka gjallëri dhe lëvizje njerëzish. Natën, njeriu nuk e ka këtë ndjenjë, e sidomos në errësirën e thellë. Pra, nga kjo kuptojmë se Ai, nuk na dhuroi qetësi dhe begati gjatë natës, sikurse gjatë ditës.

Pra, nga njeriu, kërkohet që, ai të kërkojë ndihmë nga i Lartëmadhëruari, dhe pastaj do t’a ndiejë veten të qetë dhe të sigurtë. I Lartëmadhëruari, sikur na thotë se, ju e dini se Unë jam i Gjallë dhe Mbikqyrës, ju e dini se Mua nuk më merr as kotja, e as gjumi. Ti, o njeri, nëse kërkon mbështetje nga Unë, do të jesh nën mbrojtjen Time. Pasi t’a bësh këtë, ti do të jesh i sigurtë, sepse Unë nuk të harroj për asnjë moment, sepse ti je i bindur, se Unë nuk fle, e as nuk kotem, e as nuk mund të më shpëtojë diçka pa e ditur. Unë nuk fle, prandaj nuk më shpëton asgjë prej gjëje, që ndodh në

²⁹ Kur’an, 113/3-4

botë, si prej atyre veprave, që duken, ashtu edhe prej atyre, që nuk duken. Përkujdesi Im ndaj teje është permanent, askush nuk mund të të lëndojë, qoftë edhe një ushtri e tërë. Kur të të kaplojë terri, ti kërko mbështetje nga Unë dhe fli i qetë dhe i sigurtë, sepse Unë jam i Gjallë dhe Mbikqyrësi yt (truproja jote). Nuk më merr as kotja, e as gjumi, e ti të jesh i bindur se, Unë nuk të spostoj as edhe për një sekondë të vetme, përkundrazi, do të jesh nën mbrojtjen Time gjithmonë dhe me tërë fuqinë Time, saqë askush nuk mund të të dëmtojë aspak.

Në vazhdim, i Lartësuarit thotë: "dhe prej sherrit të falltorëve, që fryjnë në nyje³⁰ (bëjnë magji)". Dijetarët, para këtij ajeti, ndalen për një kohë më të gjatë, se sa në ajetet tjera. Për fjalën 'al-nefatha', shumë prej tyre thonë se janë magjistaret (të gjinisë femërore), por faraonët e Egjiptit të Lashtë kishin magjistarë, prej të cilëve kishte edhe meshkuj edhe femra, dhe dijetarët, duke u bazuar në këtë realitet, kanë dhënë mendime të ndryshme. Pse ndodhin polemika, në raste të tilla? Ngase kjo çështje, nuk i përket mendjes, por është një prej sekreteve (të panjohura nga njerëzit). Nuk është e mundshme, që magjinë t'ua nështrijmë analizave laboratorike.

Përderisa nuk e bëjmë dot këtë, atëherë, ajo nuk mund të përcaktohet dhe të jepen ngjyime (cilësira të saj). Prandaj, këto gjëra, kanë qenë dhe do të mbeten çështje të debatueshme dhe tema shumë polemizuese. Disa njerëz, i refuzojnë ato tërësisht dhe nuk iu besojnë atyre, sepse nuk i shohin. Këtyre iu drejtojmë pyetjen: vallë gjyshërit tanë, i kanë parë mikrobet apo viruset, ashtu siç i shohim ne tani? Përgjigja e tyre do të ishte: jo, sepse ato ishin të panjohura për ata. Një gjë, që është e panjohur për dikënd, nuk do të thotë se nuk ekziston. Tani, kur njerëzimi e zbuloi mikroskopin dhe filloi t'i zmadhojë gjërat për disa herë, apo madje mijëra herë, ne nuk mund të

³⁰ Kur'an, po aty

themi, se këto mikrobe ose bakterie i krijoi mikroskopi. Ajo që realizoi ai, ishte vetëm një zbulim, që shpalosi një prej perdeve (të sekreteve) dhe filloi t'i shikojë gjërat pak më larg, nga se ç'ishin parë më herët.

Kjo, ishte një dhuratë e madhe e All-llahut xh.sh., për ne. I Lartësuar, për çdo ditë, na shpalos gjëra të reja në univers, të cilat më parë ishin të panjohura për ne. Mbase, shumë prej tyre nuk do t'i kishim besuar, edhe sikur të na flitej për to. Por, kur ato filluan të shihen me sy, njerëzit filluan të thonë se, ato nuk kanë qenë për ne sekret dhe të panjohura, por ishte padija dhe mendja jonë injorante (që nuk e pranonte ekzistencën e tyre), sepse vazhdimisht kërkonim që t'i shikonim me sytë tanë. Tani që, çdo gjë u bë realitet dhe transparente, njerëzit filluan të besonin në ekzistimin e tyre. Prandaj, t'a keni më se të qartë se, atë, që nuk e njihni ju tani, nuk do të thotë se, ajo, nuk ekziston në realitet.

Përderisa, i Lartëmadhëruari, na ka përkujtuar magjinë dhe magjistarët, në Kur'anin Kerim, padyshim se magjia dhe magjistarët ekzistojnë. Por, deri tani, shkenca nuk e njeh këtë lëmi. Ne, u themi atyre: mbase, sot, kjo për ne mund të jetë një sekret shkencor, por nesër ose pasnesër, ky sekret mund të zbulohet dhe të na bëhet realitet. Unë jam i bindur në ekzistencën e tyre, përderisa i Lartëmadhëruari, na ka informuar për to.

MAGJIA DHE SYRI NJERËZOR

Vërtet, ç'është magjia? I Lartëmadhëruari, në Kur'an, thotë: "...magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe..."³¹. Magjia është dy llojesh. Njëra, ka të bëjë me fuqinë njerëzore dhe, lloji i dytë, ka të bëjë me ndihmën e një force, që nuk i përket forcës njerëzore.

Lloji i parë, është brenda mundësive njerëzore, ato nuk bëjnë ndonjë ndryshim thelbësor. Ata (magjistarët) kanë mundësi, që t'u paraqesin njerëzve një pamje tjetër, në vend të reales. Ata, i magjepsin sytë e njerëzve dhe, shikimi i tyre, sheh diçka tjetër. Në këtë rast, nuk kemi të bëjmë me ndryshimin e elementit, ose materies. Këtë, na e vërtetoi i Lartëmadhëruari, duke thënë: "...magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe...". Nëse i përcjellim me vëmendje magjitë, prej më të thjeshtave, deri tek ato më të vështirat, që bëhen me ndihmën e një fuqie jashtë njerëzore, do të shohim se të gjitha ato kanë të bëjnë me mashtrimin e shikimit.

Magjistarët e thjeshtë, që merren me lojërat e cirkut, mbështeten në shpejtësinë dhe në shikimet mashtruese, ose, ndryshe, atyre ju thuhet 'dora e fshehur'. Ata bëjnë stërvitje të tepërta dhe i ushtrojnë shumë lëvizjet e duarve. Sa më e madhe të jetë shpejtësia e duarve të tyre, aq më të sukseshëm paraqiten para shikuesve. Njeriu i thjeshtë, mendon se veprimet e tyre janë të mbinatyrshme, por në realitet, ajo çfarë bëjnë ata, është vetëm një shkathësi, me të cilën ata mundohen t'i mashtrojë shikimet e njerëzve. Me të pamurit iluzional, mashtrojnë për gjëra të mëdha. Currilin, e shohim si burim uji. Syrit, shpeshherë, disa lloje të ngjyrave i duken si aeroplanë. Shpejtësinë e madhe, syri njeriut nuk mund t'a përcjellë. Kur e ka pranë ventilatorin

³¹ Kur'an, 7/116 sipas përkthimit të Sherif ef. Ahmetit

elektrik të lëshuar, nga lëvizjet e shpejta të tij, njeriu nuk është në gjendje t'i dallojë fletët e tij. Të pamurit (e njeriut) mashtrohet sepse nuk është në gjendje t'a kuptojë formën, gjatë lëvizjeve të tyre.

Sic po shihet, mashtrimi i të pamurit është një lloj sihri (magjie). Kjo është shumë e qartë dhe, për të, nuk kemi pikë dyshimi. Magjistarët, të cilët merren me 'magji nëpër cirqe, nuk janë gjë tjetër, veçse lëvizës të shpejtë të duarve. Me të, ata i mashtrojnë njerëzit dhe në pamje të jashtme, paraqiten se po realizojnë magjinë.

Ky, është një shembull i thjeshtë, i cili na lë të kuptojmë se magjia, në realitet, nuk e ndryshon gjendjen e realtë të materies, por magjistarët vetëm i magjepsin sytë e njerëzve, dhe ata shohin ato gjëra, të cilat, magjistari, vendos të shihen prej tyre. Pra, nga sa thamë më sipër, kuptuam se magjia është vetëm një defilim i shpejtësisë.

Ndërsa, magjinë që ka për qëllim futjen e sherrit, që krijon bezdi apo neveri, magjistari nuk mund t'a bëjë. Ajo (magjia) realizohet me sukses, vetëm atëherë kur ai (magjistari), së pari, fut tmerrin apo frikën, mbi një grup njerëzish, nëpërmjet defilimeve e sipërpërmendura të mashtrimit të syrit. Do të thotë se magjistari, fillimisht, fut frikën në zemrat e atyre, tek të cilët ka për qëllim të ndikojë magjia e tij. Kur ai e vëren se, i ka trilluar ose mashtruar plotësisht, bën pastaj me ta, çfarë të dojë. Disa prej magjistarëve, ndihmohen ose përdorin zëra të frikshëm, kafka apo eshtra të të vdekurve.

Sidoqoftë, ata, fillimisht, përdorin frikësimin, duke e futur atë në shpirtin e njeriut. Shumë rrallë ndodh, që këta, që e ushtrojnë këtë profesion, të veprojnë gjatë ditës. Ata, pothuaj gjithmonë, këto veprime i bëjnë nëpër dhoma të errëta dhe me ndihmën e zërave, që tingëllojnë frikshëm,

pasi kështu, magjistari do të veprojë më lirshëm me të magjepsurin. Përderisa, magjistari nuk është në gjendje t'a ndryshojë natyrshmërinë ose gjendjen e realtë të matries, ai mundohet të futë frikë, në zemrat e shikuesve. Pastaj, duke përdorur shpejtësinë e lëvizjeve, me anë të duarve të ushtruara dhe mashtrimit bindës, ia paraqet shikuesit, se kinse po sheh para vetes një fuqi mbinatyrore dhe, kështu, ai (njeriu) i nënshtrohet asaj force. Kur magjistarët u përballën me Musën a.s., ata i hodhën litarët dhe shkopinjtë e tyre. Për këtë, i Lartësuari, thotë: "... e kur ata i hodhën litarët dhe shkopinjtë e tyre, atij (Musaut a.s.) nga (ndikimi i) magjisë i dukeshin se, vërtet, po lëviznin (sikur gjarpërinj)"³².

I Lartësuari, këtu përdori fjalën 'i dukeshin'. Kur, i Lartësuari, përdor ndonjë shprehje, ne duhet t'a kemi parasysh këtë dhe të përqëndrojmë vëmendjen tek ajo. Ne, (nga kjo) kuptojmë se magjistarët nuk ndryshuan asgjë në esencë, por gjithçka që ata bënë, ishte se njerëzve iu dukën se litarët dhe shkopinjtë e magjistarëve, ishin shndërruar në gjarpërinj dhe po lëviznin. Përdorimi i fjalës 'i dukeshin', jep të kuptojë se ato (litarët dhe shkopinjtë) nuk e ndryshuan gjendjen e tyre të mëparshme, por atmosfera ishte përplot frikë dhe kësaj atmosfere i kishin ndihmuar magjistarët, me format dhe mashtrimet e tyre. Ata, me anë të përdorimit të mjeshtërisë së tyre dhe lëvizjeve të duarve të tyre, i mashtruan njerëzit dhe i bënë ata, që të mashtrohen duke i parë ato, si gjarpërinj.

Ç'ndodhi pastaj? Musai a.s., e hodhi, gjithashtu, edhe ai shkopin e tij. Por, ai shkop u shndërrua në gjarpër të vërtetë, lëvizi dhe i gëlltiti litarët, që ishin përreth tij. Magjistarët, kur e panë këtë, iu përulën Zotit të Musës a.s., dhe menjëherë e besuan si të Dërguar të Zotit. Pse? Ata ishin njerëz të zanatit, ata e dinin magjinë më mirë se kushdo tjetër. Ata e dinin se si mashtroheshin sytë e

³² Kur'an, 20/66

njerëzve, ata i dinin të gjitha mjeshtëritë e magjisë. Ata e dinin se, natyra e materies nuk ndryshon, por në këtë rast, ata shikuan se, Musai e ndryshoi natyrën e materies. Ata, vërejtën dhe u bindën se ai (shkopi) u shndërrua në një gjarpër të vërtetë. Kjo e vërtetë, nuk ishte nga mjeshtëritë e magjistareve, por ata e kuptuan se, ishte nga Fuqia e All-llahut të Lartësuar, prandaj, ata ishin të parët që i ranë në sexhde, dhe iu përulën Zotit të Musait. Ata ishin të bindur se, Musai ishte i Dërguar i vërtetë, nga Zoti i tij.

EKSPERIMENTI DHE USHTRIMET

Musai kishte hyrë në këtë sprovë, pasi, All-llahu i Lartëmadhëruar e kishte ushtruar atë. Ai, duhej t'a kuptonte dallimin midis magjisë dhe mrekullisë. Duhej t'a njohte magjinë, që mos të magjepsej dhe të mos frikësohej. Atij, i Lartësuar, i kishte thënë: "Ç'është ajo, që ke në dorën e djathtë, o Musa? I tha: ky është shkopi im, me të mbahem dhe (ndodh) t'u shkundi gjethe kopesë sime, gjithashtu, prej tij kam edhe dobi të tjera. (All-llahu) I tha: hidhe atë, o Musa! E hodhi atë dhe ai (përnjëherë) u shndërrua në gjarpër (të vërtetë) që po zvarritej"³³

Pasi ndodhi kjo e papritur, Musai u frikësua dhe u rrëngeth. Atëherë, pas kësaj ndodhie, i Lartësuar, i tha përsëri: "(All-llahu) I tha: merre atë, dhe mos u frikëso, sepse do t'a rikthejmë atë, në gjendjen e mëparshme"

³³ Kur'an, 20/ 17-20

Vërtet, ai u kthye në gjendjen e tij të mëparshme.

Pse vallë e bëri, i Lartësuar, këtë me Musain a.s.? Duhet t'a kemi parasysh, se çdo gjë, që ndodh, ka urtësinë e vet, asgjë nuk vjen, nga All-llahu xh.sh., ashtu shkel e shko, ose pa ndonjë qëllim. Kjo mrekulli, nuk kishte për qëllim vetëm shndërrimin e shklopit në gjarpër, por vetë, ajo që ndodhi, ishte fantastike. All-llahu, me dijen e Tij absolute, e dinte se Faraoni do të mundohej, me magjistarët e tij, t'a shkatërronte mesazhin e Musait a.s. Ata, do të përpiqeshin që t'i mashtronin njerëzit, duke ju bërë magji. Për këtë, i Lartësuar, e ushtroi Musain a.s., për ndryshimin e natyrshmërisë së sendeve, në mënyrë që t'a kuptonte dallimin midis magjisë dhe mrekullisë. Sikur i Lartësuar t'a kishte bërë provën e Tij, në ditën e garimit midis tij (Musait) dhe magjistarëve, pa e ushtruar atë fare, ai gjatë asaj sprove do të ishte frikësuar dhe, ndoshta, kishte për të bërë edhe lëvizje të papëlqyeshme, që do të kishin pasur efekt të kundërt.

Jo vetëm kaq, por sigurisht, që do të kishte futur dyshimin edhe tek ata, që e kishin besuar, ose atyre që do t'a besonin. Ata do të thonin, se përderisa ai vetë u frikësua, ne nuk kemi se si t'i besojmë, dhe, padyshim, se magjistarët do të kishin epërsi, gjatë garimit të tyre. Për këtë arsye i Lartësuar, së pari, e kishte ushtruar të Dërguarin e tij, duke ia larguar kështu frikën, dhe më pas ia kish mësuar dallimin midis gjarpërit të madh, që shndërrohej nga (shkopi i) Musait dhe midis atyre (gjarpërinjve) që do të bënin magjistarët. Kur ai u përball me magjistarët, kishte besim të plotë, por, megjithatë: "...dhe Musai, në vete, ndjeu frikë"³⁴

³⁴ Kur'an, 20/67

Pastaj, i Lartësuar i thotë: "Ne i thamë atij: mos u frikëso, padyshim ti je mbi ata (do të ngadhënjesh). Tani (mos u hamend), hidhe atë, që ke në dorën e djathtë (shkopin), që t'i gëlltisë ata (litarët) që ata i shndërroan, sepse ajo që bënë ata (nuk është asgjë prej gjëje, ajo) është një lloj mashtrimi magjistarësh, ndërsa magjistarët, kudo që të jenë, nuk do të kenë sukses"³⁵.

Kështu All-llahu xh.sh., e përkrahu dhe e mbështeti të Dërguarin e Tij. Këtë (mbështetje) e bëri për t'a përforcuar dy herë, herën e parë, ia shndërroi shkopin në gjarpër të vërtetë, dhe herën e dytë e mbështeti, atëherë, kur ai u frikësua në vete, prej magjive të magjistarëve.

Këtu, vlen për t'u përmendur dhe për t'u vlerësuar shumë, edhe imani (besimi) i magjistarëve, tek Zoti e tyre. Magjistarët, pak orë para se të vriteshin (gjymtoheshin) nga faraoni, e besuan All-llahun e Lartëmadhëruar. Vendimi tyre, për atë veprim, ju solli xhennetin. Ky është një realitet. All-llahut xh.sh., kërkon prej njerëzve që, asnjëherë të mos i humbasin shpresat tek mëshira e Tij. Ata (magjistarët), gjatë tërë jetës së tyre, kishin jetuar në mosbesim dhe, pak para se të mbyteshin, kishin shkuar me magjitë e tyre, për t'a luftuar fenë e All-llahut. Por, kur këta vërejtën mrekullinë, besuan në të, dhe përderisa ishin të mbushur me iman pak para dhënjes së shpirtit, ata fituan, pasi i Lartëmadhëruari i fali dhe i mëshiroi.

³⁵ Kur'an, 20/68,69

DISPOZITAT E JO NJERËZORËVE

I Lartësuarit, na ka shpjeguar duke na argumentuar se magjia, mbështetet tek mashtrimi i syve, futja e frikës dhe (bërja e) dredhive tek njerëzit. Këto tri elemente, bëjnë që të magjepsurit t'i dorëzohen magjistarit, duke supozuar se, ata munden t'a ndryshojnë natyrshmërinë e gjësendeve, duke sajuar mrekullitë e tyre. All-llahu i Lartëmadhëruar, na ka urdhëruar të mos u frikësohemi këtyre llojeve të magjive. Kur, dikush mundohet të fusë frikë në zemrat tona, me këto lloje magjish, ne duhet të kërkojmë mbrojtjen e All-llahut xh.sh., dhe atëherë, ata, nuk do të munden të ndikojnë brenda nesh.

Kemi edhe një lloj tjetër magjie, ajo që mbështetet në një forcë të huaj dhe që nuk i përket fuqisë njerëzore. Këtë, më së miri, na e sqarojnë ajetet e All-llahut, që janë dhënë në suren al-Neml. All-llahu xh.sh., na tregon tregimin e mbretëreshës së Sebe-es. Sulejmani a.s., kishte kërkuar që dikush nga radhët e tij, t'ia sillte atij fronin e mbretëreshës, prej Jemenit, në Kuds³⁶: " (Sulejmani tha): O parësi, kush nga ju do të ma sjellë fronin e saj, para se të vijnë ata (tek unë) të dorëzuar?"³⁷

Sulejmani kishte pushtet ndaj xhinnëve, njerëzve dhe djajve. Ai nuk kishte caktuar askënd prej tyre, që t'ia sillte fronin e mbretëreshës, nga populli i Sebe-es. Ai e dinte fare mirë, se kërkesa e tij, ishte mbi natyrën e qenies njerëzore. Por, ajo nuk ishte e vështirë për natyrën e xhinëve ose krijesave të tjera, për të cilat ne nuk dimë asgjë. Ai, një gjë, e dinte fare mirë, se ai kishte nën pushtet, krijesa që nuk ishin qenie njerëzore dhe që kishin natyrë, ligje dhe veçori të tjera, të

³⁶ (distancë mbi tre mijë km - shën. i përkth.)

³⁷Kur'an, 27/38

dhuruara nga All-llahu xh.sh., prandaj kishte besim se, dikush prej tyre, do t'a zbatonte kërkesën e tij.

Çfarë kuptohet prej kërkesës së Sulejmanit a.s., kur ai kërkoi që dikush t'a kryente këtë detyrë: "...kush nga ju do të ma sjellë fronin e saj, para se të vijnë ata (tek unë) të dorëzuar". Kjo jep të kuptohet se, Belkiza³⁸ e kishte lëshuar Jemenin dhe ishin nisur për tek ai. Ai kërkoi që dikush, prej ushtrisë së tij, të shkonte në Jemen dhe t'ia sillte fronin e saj. Derisa Belkiza, dhe ata që ishin me të, ishin në rrugë e sipër, dikush prej ushtrisë së tij, duhej t'ia sillte fronin mbretëror, para se ajo të vinte. Do të thotë se shpejtësia, duhej të ishte disa herë më e madhe, se shpejtësia e ushtrisë së mbretëreshës Belkizë.

Kjo duket një gjë shumë interesante. Kush do të fliste në këtë rast? Mos vallë, këtë kërkesë do të mund t'a plotësonte ndonjë njeri, si njerëzit e zakonshëm? Mos kishte dikush prej tyre, guxim të thoshte se unë do t'a sjelli atë? Jo! Asnjë njeri nuk iu përgjigj, sepse ajo ishte mbi mundësitë e qenies njerëzore. A mos u zotua, ndonjë prej xhinëve të rëndomtë?

Jo! Askush prej tyre nuk foli, por ai, që u zotua, ishte njëri prej xhinëve më të fuqishëm. Për këtë, i Lartësuar, thotë: "Tha: Ifriti, njëri prej xhinëve"³⁹. Ai, që foli, nuk ishte një xhin i rëndomtë, por ishte më i fuqishmi i të gjithë xhinëve. Ai u zotua se do t'a zbatojë këtë detyrë, që ishte e rëndë për të tjerët. Në kohën kur foli, ai (më i fuqishmi i të gjithë xhinëve) e kishte parasysh se, koha dhe distanca, përshtateshin me mundësitë e tij. Kjo mundësi, atij i ishte mundësuar nga i

³⁸ (Belkiza, emir i mbretëreshës që sundoi popullin e Sebe'es -shën. i përkth.)

³⁹ Kur'an, 27/39

Lartëmadhëruari All-llah, dhe ai (xhini) tha: "...unë do t'a sjell atë, para se të ngrihesh nga vendi yt..."⁴⁰

Do të thotë se ai, do t'i mundësonte Sulejmanit, që t'a kishte përpara fronin që kërkonte, para se të mbaronte mbledhja, apo, aq sa mund të vazhdonte ai tubim. Një orë, dy ose tri orë. Ajo, çka është me rëndësi, është se ai i caktoi vetes një kohë, për t'a sjellë fronin mbretëror të Belkizës.

Këtu, kemi të bëjmë me një qenie, që kishte njohuri prej Librit. A thua, si? Sipas gjitha normave, ai, të cilit All-llahu i Lartësuar i kishte dhuruar dituri nga Libri, do t'a shfrytëzonte forcën dhe mundësinë e ligjeve të xhinëve, që ishin të panjohura për xhinët e tjerë.

"Ai, që ishte i pajisur me dijen e Librit, tha: unë do t'a sjell atë, sa hap e mbyll sytë"⁴¹.

Këtu, duket një urtësi e madhe. Secila krijesë, që ishte në shërbim të Sulejmanit, prezentohej me ligjet e veta, të dhuruara nga All-llahu xh.sh. Njeriu është prej dheu, prej materies së ngurtë. I Lartësuar i ka dhuruar atij ligjet, që i përshtaten natyrës së krijimit të tij. Për këtë arsye, kur kërkoi t'ia sillnin fronin, nuk u paraqit asnjë vullnetar nga qeniet njerëzore. Askush prej tyre, nuk tha se, unë do të t'a sjell atë, sikur të më japësh një numër të zgjedhur ushtarësh, apo të kërkonte (si ndihmë edhe) diçka tjetër. Por qeniet njerëzore heshtën fare, sepse ligjet e tyre e pengonin marrjen përsipër, të realizimit të kësaj kërke.

⁴⁰ Kur'an, 27/39

⁴¹ Kur'an, 27/40

Gjithashtu, nuk u paraqitën as xhinët e rëndomtë, sepse edhe ata nuk ishin në gjendje t'a kryenin këtë vepër, edhe pse ligjet e tyre ishin më të favorshme se të qenieve njerëzore. Ligjet e xhin-ëve janë më të fuqishme nga ato të njerëzve. Ata, munden që t'a kalojnë një distancë më shpejt se njerëzit dhe, gjithashtu, ata kanë mundësi të shndërrohen në materie (të dukshme). Kjo është natyrshmëria e tyre, ata janë të krijuar nga zjarri. Zjarri, nuk i disponon ligjet e baltës. Edhe pse, ata ishin më të fuqishëm se njeriu, kësaj kërkesë i heshtën. Ata kishin frikë, se mos nuk po arrinin t'a kryenin punën si duhet. Iu dëgjua zëri vetëm Ifritit, njërit prej xhinëve më të fuqishëm prej tyre. Ky kishte dituri nga Libri dhe, nga kjo, atij i ishte mundësuar që t'i kapërcente të gjitha ligjet e tyre, vetëm e vetëm për t'a sjellë fronin e mbretëreshës së Sebe-es, në një çast të vetëm, ose si të thuash, përafërsisht, për një kohë të pakohë, ngase ai kishte dituri nga Libri. Kjo ishte dhunti e All-llahu xh.sh., ndaj tij. Pra, të gjithë i parashtruan ligjet (mundësitë) e tyre, të dhuruara nga i Lartësuari dhe (kur Ifriti, premtoi t'a zbatojë) Sulejmani a.s. filloi të shpresojë.

Po e përsëris, secila krijesë ka ligjet dhe rregullat e veta, dhe asnjëra prej tyre nuk mund t'i tejkalojë ato kompetenca. Gjithashtu, asnjëri nuk mundet t'ia marrë tjetrit ato kompetenca, por ai, të cilit i është dhënë dituri e veçantë nga Libri, bën përjashtim dhe mund t'i shkatërrojë të gjitha ligjet dhe rregullat. Ky është një mësim për të gjithë ne, për të kuptuar se i Lartësuari mundet, dhe është i Vetmi që disponon mundësi të shumta, të panumërta për shkatërrimin e ligjeve dhe rregullave. Atyre, që janë poshtë, ua jep forcën, ndërsa atyre, që janë sipër, ua merr atë. Ai i mundësoi Sulejmanit që t'ia sjellnin fronin e mbretëreshës për një moment (kohë), që mund të quhet 'jo-kohë'.

Disa njerëzve, u jep ndihmë me 'magji' shumë më të forta, që i tejkalojnë të gjitha ligjet njerëzore, dhe ata i ndihmon me xhinë dhe djaj.

URTËSIA TEK HARUTI DHE MARUTI

Tani, do të shkoqisim tregimin e Harutit dhe Marutit. Para se të fillojmë shkoqitjen e këtij tregimi, mendoj se duhet të theksoj se, ne duhet të dimë se, i Lartësuar i krijoi universin mbi bazat e reciprocitetit. Secili njeri, në jetën e tij, disponon të njëjtat mundësi, sikurse çdo njeri tjetër. Nëse një njeri, ndihmohet nga fuqi, që nuk i përket fuqisë njerëzore, dhe ai person e përdor (këtë fuqi) ndaj një njeriu tjetër, ai ka përdorur një mundësi (fuqi), që nuk është e barabartë me atë, të qenies së tij njerëzore. Nëse, një njeri, përdor këtë forcë (që nuk i përket fuqisë njerëzore), ai i gënjen të tjerët nëse u thotë se, atë e përdor për të mirën e përgjithshme njerëzore. Fuqia, që ai disponon, e bën atë, që t'a keqpërdorë. Kur atij i kundërpërgjigjet dikush, me ndihmën e All-llahut, me të njëjtën forcë, ai ose do të vdesë, ose do të çmendet, ose do të përfundojë në një varfëri të tejshkajshme. Ajo, çka është me rëndësi, është se përfundimi i tij, do të jetë shumë i keq. Këtë, e vërteton ajeti kur'anor: "E disa njerëz, kanë kërkuar strehim tek disa xhin, e kjo vetëm sa ua shtoi tërbimin"⁴²

Ky ishte një përshkrim i shkurtër, tani, do të përpiqem të jem më i qartë.

I Lartësuar, rreth tregimit të Harutit dhe Marutit, na tregon:

⁴² Kur'an, 72/6

"(Jehuditë e braktisën Teuratin) dhe shkonin pas shpifjeve që bënin djajtë, kundër mbretërisë së Sulejmanit. E Sulejmani, nuk ishte mohues, por ishin djajtë ata, që mohonin e që u mësonin njerëzve magjinë..."⁴³

Rreth këtij tregimi, transmetohet: (në kohën) kur Sulejmanit iu dhurua mbretëria, djajtë ishin ata, që përdornin magjinë për t'a ç'rregulluar botën. Sulejmani kishte marrë të gjitha hajmalitë e tyre dhe i kishte groposur në tokë. Kur Sulejmani vdiq, djajtë kishin shpërndanë fjalë, duke shpifur se ai kishte sunduar me forcën e magjive. Ata i treguan popullit se në ç'vend i kishte groposur hajmalitë, dhe në praninë e tyre, kërkuan që ato të nxirren. T'i kthehem, sërish, ajetit: "(Jehuditë e braktisën Teuratin) dhe shkonin pas shpifjeve që bënin djajtë, kundër mbretërisë së Sulejmanit..."

Pra, djajtë ishin përpjekur që t'i mashtrojnë ata, se kinse Sulejmani e kishte mbajtur pushtetin me ndihmën e magjive, e jo siç kish pretenduar ai, se ishte i dërguari i All-llahut të Lartësuar: "...E Sulejmani nuk ishte mohues,..." Këtu, shohim se All-llahu i doli në mbrojtje, duke e shfajësuar nga kjo akuzë, duke thënë se Sulejmani nuk kishte mohuar, por ai ishte njeri i drejtë dhe kishte me vete Revelatën Hyjnore. Nëse Sulejmani nuk kishte mashtruar, atëherë është e kuptueshme se djajtë ishin ata që kishin mohuar, sepse shpifnin mbi të vërtetën e Sulejmanit a.s.

Ajeti Kur'anor, vazhdon: "që u mësonin njerëzve magjinë...". Nëse ndalojmë pak, në këtë ajet, do të gjejmë fjalën "u mësonin" dijen, e cila nuk i përket qenies njerëzore, siç theksuam në temat tjera, pra ata që i mashtrojnë sytë e njerëzve dhe që ndihmohen nga lloji tjetër i dajve, i atyre që e disponojnë këtë lloj diturie të magjisë. Ata janë mohues ose të refuzuar, mëkatarë ndaj All-llahut

⁴³ Kur'an, 2/ 102

xh.sh. Djajtë kanë mundësi t'a ndërrojnë formën, ata shndërrohen në forma të ndryshme. Ata, mund t'i shohësh herë si kafshë, herë si njerëz, e herë edhe në forma të tjera. Në momentet kur ata ndyshojnë formën, ata veprojnë sipas ligjeve të asaj forme. Ishte mëshirë prej All-llahut xh.sh., që edhe pse atyre (xhinëve dhe djajve) u është mundësuar formësimi në figura të ndryshme, ata të gjykohen në formën sipas së cilës janë formësuar (prandaj ata i shmangen kësaj, pasi për ndryshe), jeta e njeriut do të ishte e pajetueshme, apo do të ishte shumë e vështirë.

Njerëzimi do të sundohej nga djajtë dhe kështu do të ishte, gjithnjë, i përbuzur e i robëruar. Por, djajtë veprojnë dhe gjykohen sipas llojit të formësimit, në të cilin janë shndërruar dhe, ata, frikësohen të qëndrojnë gjatë në atë formë, se mos po goditen (dëmtohen) në formën, në të cilën janë. Kur djalli shndërrohet në formë njeriu, majmuni ose gomari, dhe goditet me plumb ose thikë, ai do të mbytet. Ai këtë e di fare mirë, prandaj ai nuk dëshiron të qëndrojë gjatë, në këto lloj formash, sepse është në rrezik permanent nga njeriu. Ai qëndron në ato forma, vetëm sa të ndikojë në mashtrimin e njeriut. Ndodh që djajtë të shndërrohen në forma shumë të shëmtuara, ata përpiqen të gjenden mes distancës së burrit dhe gruas. Qëllimi i tyre është që të krijojnë efekte negative midis burrit dhe gruas. Kur burri e shikon 'gruan', ajo do t'i duket atij se është e shëmtuar dhe kështu do të fillojë të mbillet urrejtja midis tyre.

Ajeti i sipërshënuar, vazhdon:

"...dhe diturinë, që ju ishte dërguar dy melekëve në Babiloni – Harutit dhe Marutit. (Këto dy melekë) askujt nuk ua mësonin magjinë, pa iu thënë: ne jemi sprovë, e ju mos u bëni mohues. Mësoi (njerëzimi) prej tyre, se si t'i ndajnë bashkëshortët. Ata (magjistarët) nuk janë në gjendje askujt t'i bëjnë dëm, pa lejen e All-llahut, ata vetëm sa ju mësojnë atyre se si t'ju bëjnë dëm, ata

nuk bëjnë kurrfarë dobie. Ndërsa ata, të cilët e ushtrojnë këtë mjeshtri, e dinë se nuk kanë kurrfarë të mire, në botën tjetër (ahiret)”⁴⁴.

RASTI DHE LLOGARIA

Nga ky ajet, do të nxjerrim, disa të dhëna.

E para: Magjia e këtij lloji, e fsheh realitetin, duke i përdorur ato ligje që u përkasin rregullave të xhinëve ose djajve, kurse njeriu nuk e zotëron artin e magjisë, me përjashtim (të magjive me anë) të mashtrimeve në shikim.

E dyta: Magjia e llojit të dytë iu revelua dy melekëve, që quheshin Harut dhe Marut.

Të gjithë ata që kishin rast të takoheshim me këta dy melekë, dëgjonin prej tyre se, ata ishin sprovë dhe se nuk duhej t’a mësonin magjinë prej atyre. Nga kjo kuptojmë se, ata ishin sprovë për njerëzimin. A thua pse? Kjo lloj magjie, jepte mundësira të mëdha, që njeriu të dispononte fuqi, që nuk ishin të llojit njerëzor. Nëse dikush e dispononte këtë lloj mjeshtërie, ai do të ishte në gjendje të sundonte një numër të madh qeniesh njerëzore. Kjo situatë, me kalimin e kohës, do të rritej (eskalonte) edhe më shumë, dhe ai do të ushtronte dhunë dhe terror mbi njerëzimin, derisa ata t’a mohonin All-llahun xh.sh.

⁴⁴ Kur’an, 2/102

T'a sqarojmë këtë, pak më shtruar. Të supozojmë se, jemi duke jetuar në një fshat të vogël dhe se dikujt prej fshatarëve i është dhënë mundësia të posedojë një pushkë, ose ndonjë armë zjarri. Kur një njeri i vetëm në fshat, e ka në duart e veta këtë armë, ai, fillimisht, do të thoshte: këtë armë do t'a përdor, për t'a mbrojtur veten dhe familjen time nga ndonjë e keqe. Pastaj, dalngadalë, me kalimin e kohës, do të fitonte përshtypjen se atij, po i nënshtrohen (frikësohen) të gjithë fshatarët. Kjo ndienjë, do t'a bënte atë, të fillonte t'i terrorizonte dhe t'i pushtonte ata (fshatarët). Posedimi i një mjeti, që nuk është ekuivalent ose i përafërt me (ato që posedojnë) të tjerët, hap shtigjet e pushtimeve të tjera, me përmasa akoma më të mëdha.

Shtrohet pyetja, pse atëherë i Lartësuar i zbriti këtë sprovë? Të gjitha spovat, nuk janë gjë tjetër përveçse, provim i imanit ose i besimit njerëzor. Pasuria, fëmijët, pushteti, etj., të gjitha këto janë sprova. Të gjitha këto sprova, janë dërguar nga All-llahu i Lartësuar, në mbarë gjithësinë për t'a sprovuar njeriun. Këtë, e themi duke u mbështetur në thënien e All-llahut xh.sh., në Kur'anin Kerim: "A mos menduat se do të hyni në xhennete, e All-llahu të mos ju tregojë për ata, të cilët kishin luftuar dhe për ata që kishin duruar" ⁴⁵

Pra, sprovat janë të shumta, të ndryshme dhe të shtrira në gjithësi. Njeriu kërkon nga All-llahu xh.sh., që t'i japë risk dhe pasuri, për të dhënë sadaka, duke pretenduar se do të bëjë mirë. Kur All-llahu e furnizon me risk dhe pasuri, e sprovon atë. Ndodh që ai, jo vetëm që nuk e jep atë që premtoi, por, ndodh ajo më e papëlqyera, ai fillon t'ua marrë hakun jetimëve dhe skamnorëve.

⁴⁵ Kur'an, 3/ 142

Dikush e lut All-llahun t'i falë një djalë apo një fëmijë, që të bëhen krenaria e tij. Por, kur All-llahu ia fal atë, ai fillon t'a keqpërdorë dhe i mëson se si t'a mbrojnë pasurinë e vet, duke dhunuar dhe terrorizuar njerëzit e tjerë. Kështu, të gjitha këto hyjnë në termin 'amanet', All-llahu xh.sh. ia ngarkoi njeriut këtë amanet. Kjo nënkupton se ai është i ngarkuar, dhe është borxhli ndaj Tij. Ajo që është me rëndësi, është se njeriut do t'i afrohet afati i fundit, dhe ai do të kthehet dhe do t'a shlyejë borxhin për amanetin. Nëse këtë do t'a zbërthenim edhe më gjërë, do të thoshim se All-llahu xh.sh., ia ka paraqitur amanetin qenies njerëzore, ose zgjedhjen (alternativën) e lirë: 'vepro' apo 'mos vepro'. (Për lirinë e dhuruar) Njeriu duhet t'i drejtohet Lartëmadhërisë së Tij, duke i thënë: O Zoti im, unë të jam mirënjohës për atë liri që më dhurove, dhe do të të adhuroj me bindje të plotë. Por, shohim se njeriu në vend të sjelljeve të mira të tij, shkakton trazira dhe bën ngatërresa në tokë.

Më pas, do të vijë koha e kthimit të amanetit, që ne e njohim si koha e agonisë së vdekjes. Sikur (njeriu) t'ia paraqiste llogaritë Krijuesit të vet, sipas premtimeve të bëra, çdo gjë do të ishte në regull, por kur ai e vëren se, vërtet, i erdhi koha e dorëzimit të amanetit (dhe ai nuk i përmbushur ato që ka premtuar), ai mundohet të përmirësohet, por kjo kohë nuk i premton atij të përmirësohet, sepse nuk do të ketë mundësi t'a bëjë atë. Njeriu mashtrohet, kur kërkon nga All-llahu xh.sh., që t'i japë pushtet, me qëllim që të nënshtrojë të fuqishmit (që dhunojnë njerëzit e tjerë), me anë të fuqive mbinatyrore. Ai mashtrohet kur i thotë, All-llahut xh.sh.: O Zoti im, (nëse më jep pushtet) do t'a përdori vetëm në të mirë të njerëzimit, pasi, në të vërtetë, ai vepron krejt ndryshe.

Ai e përdor atë (pushtet), për të bërë ngatërresa dhe për t'i shqetësuar njerëzit. Kur atij t'i afrohet koha e dhënies së llogarisë, ai bindet se nuk e ka zbatuar atë që ka premtuar, dhe se nuk e ka

përfillur amanetin. Çdo gjë që i ndodh njeriut, është rezultat i sprovës. Ajo (sprova) është eksperiencia e imanit. Njeriu kërkon, dhe All-llahu ia plotëson dëshirën, duke ia provuar atij imanin. Kjo, nuk nënkupton se All-llahu nuk e di se çfarë imani ka ai (person), por atë e bën për të dëshmuar ai vetëveten e tij. Atij i jepet mundësia të debatojë me vetveten, duke thënë: sikur t'a disponoja këtë apo atë, do t'a përdorja vetëm për vepra të mira, por, kur atij i jepet mundësia që t'i përdorë ato, ai e përdor për veprime të këqia. (Zoti ka për qëllim që) Me këtë veprim, njeriu të dëshmojë vetë. Njeri i mençur është ai, i cili u largohet këtyre sprovave. Ai, do të thoshte: O Zoti im, unë nuk jam i sigurtë në vetveten time, frikësohem se mos po sprovohem në besimin tim dhe nuk dua asgjë, që nuk do të mund t'a zbatoj dot.

Ky lloj njeriu, është larg sprovave. Ky njeri, i pranon pikat e dobëta tek vetvetja, ose tek qenia e dobët njerëzore. Ai refuzon t'a bartë amanetin, që nuk mundet t'a mbajë, sepse nuk do të arrijë t'a zbatojë atë, pasi All-llahu i Lartëmadhëruar i ka mundësuar të bartë vetëm atë barrë, që mundet t'a mbajë. Atij, i mjafton t'a mbajë ekuilibrin e lirisë së tij, duke përdorur shprehjet: 'po' ose 'jo', 'e bëj' ose 'nuk e bëj'. Në të shumtën e rasteve, ky lloj personi, nuk ka kokëçarje dhe bën një jetë të qetë e të mirë. Cilët janë ata (njerëz), që kanë pengesa (telashe) në këtë botë? Ata pra, janë ata, të cilët i kërkojnë sprovat, dhe nuk arrijnë t'i përballojnë ato me sukses, dhe kështu rrëzohen. Sprovat janë provimet e njerëzve dhe ato janë të rënda.

E MIRA PËRFUNDON KËTU

T'i kthehemi sërish ajetit kur'anor, i cili lë të kuptohet se magjia, ndërmjet njerëzve, është nënshtrim (i të tjerëve) nëpërmjet një force njerëzore të fuqishme, i cili ndihmohet me forca jonjerëzore. Kjo forcë vepron me ligje jonjerëzore. Këta janë në gjendje të kalojnë distanca të largëta për një kohë të papërshtatshme, gjithashtu mund të shndërrohen në forma të ndryshme. Pra, këta kanë mundësi që t'i sjellin gjërat pranë, për një kohë shumë të shkurtër, ose të shndërrohen në forma të ndryshme, sipas dëshirës së njeriut, të cilit ata i janë nënshtruar.

Nëse kjo lloj magjie është në dispozicion të xhinëve dhe djajve, atëherë çfarë dëmsh mund t'i shkaktojnë njeriut? Cili është raporti ndaj tyre, dhe në çfarë mënyre, njerëzit mund të mbrohen ndaj tyre? Këtyre pyetjeve, iu përgjigj i Lartësuar, i Cili, gjithashtu, na mësoi se çfarë janë në gjendje të bëjnë ata (magjistarët). All-llahu xh.sh., në Kur'anin Kerim, thotë: "Mësoi (njerëzimi) prej tyre se si t'i ndajnë bashkëshortët. Ata (magjistarët) nuk janë në gjendje askujt t'i bëjnë dëm pa lejen e All-llahut, ata vetëm sa ju mësojnë atyre se si t'ju bëjnë dëm, ato nuk bëjnë kurrfarë dobie⁴⁶.

Pra, e mira këtu stagon (përfundon). I Lartësuar e ka përcaktuar fuqinë e kësaj magjie, dhe atë se çfarë mund të bëjë ajo. Ata (magjistarët), i shfrytëzojnë magjitë e tyre, për të ndikuar në ndarjen e shokëve, apo në shkurorizimin e bashkëshortëve, ose të paktën të ngjallin urrejte midis tyre dhe familjes, apo ndikojnë në kryerjen e krimit apo vjedhjeve. Ç'është me rëndësi, magjistarët i përdorin magjitë e tyre për vepra të liga kundër njerëzimit, e asesi në dobi të njeriut.

⁴⁶ Kur'an, 2/102

Bërja e magjisë dëmton dy individë. Si ai, i cili e ushtron magjinë, ashtu edhe ai, i cili e përdor atë kundër të tjerëve, janë të njëjtë. All-llahu, ka ndaluar që magjia të luftohet me magji. All-llahu kërkoi nga njeriu, që të mbështetet dhe të kërkojë mbrojtje prej saj (magjisë) tek Ai, duke na mësuar të themi: "Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit. Prej dëmit të çdo krijese, që Ai e krijoi dhe prej errësirës së natës, kur ngryset plotësisht. Dhe prej dëmit të atyre, që lidhin dhe fryjnë nyja dhe prej dëmit të smirëkeqit, kur sipas smirës vepron"⁴⁷

Kështu All-llahu xh.sh., ua tregoi besimtarëve edhe mjetin mbrojtës, u tregoi se si të kërkojnë mbrojtje kundër magjive, dhe se në cilin kapitull të Kur'ani Kerimit, duhen të drejtohen për t'a lexuar. All-llahu xh.sh., na tregoi se kaptina Felek është mbrojtja më e mirë, posaçërisht për këto raste. Ata të cilët veprojnë me bindje, në këtë mënyrë, nuk preken dhe nuk dëmtohen nga këto raste.

Thënia e All-llahut xh.sh "..."ata vetëm sa ju mësojnë atyre, se si t'ju bëjnë dëm, ato nuk bëjnë kurrfarë dobie...", na lë të kuptojmë se, ata të cilët i mësojnë këto gjëra, do të dëmtohen vetë. Ata janë marrë (me magji), i kanë shfytëzuar ato, dhe kanë qenë të pabarabartë me të tjerët, ndaj do të dëmtohen vetë. Ata, të cilët e kërkojnë këtë ndihmë, me këtë lloj fuqie, shohim se, riskun e vet, e kanë kaluar në duart e atyre, që janë poshtë tyre. Kjo do të thotë se, All-llahu i Lartësuar, ua jep riskun prej duarve të atyre që janë më të cekët në dituri, për shkak se mbështeten tek ata, që i disponojnë këto ligje.

⁴⁷ Kur'an, 113/1-5

Kjo është njëra anë, ndërsa ana tjetër është se All-llahu xh.sh., do t'ua sjellë punët atyre, që mbështetet tek xhinët, në atë mënyrë, që atyre do t'u ndodhin fatkeqësira, katastrofa në familje dhe tek fëmijët e tyre. Ata, nuk do të mund t'i përballojnë (këto fatkeqësi) dhe përfundimi tyre do të jetë i mjerueshëm. Gjithsesi, ata do të vdesin të varfër, në mjerim dhe me shumë spova të dhembshme. Vdekja, ata do t'i gjejë si mohues të All-llahut, pra si qafirë.

Këtë e vërteton thënia e All-llahut: "E disa njerëz kanë kërkuar strehim tek disa xhin, e kjo vetëm sa ua shtoi tërbimin"⁴⁸

Ata, të cilët mbështeten në këto forca jonjerëzore, nuk u shtohen aspak të mirat. Përkundrazi, atyre iu shtohen fatkeqësitë dhe vuajtjet. Ata, padyshim, që do të arrijnë deri në atë shkallë, sa që do t'a mohojnë edhe All-llahun (larg qoftë prej nesh). Kështu, atyre veçse iu shtohet një ngarkesë (barrë) e tepërt dhe e padobishme. Ata jetojnë në vuajtje, të frikësuar dhe kështu e përfundojnë jetën e tyre si mohues (qafir) të All-llahut.

Magjitë, qofshin prej llojit që, veprimet e tyre i mbështetin në ligjet njerëzore, apo në ligjet jonjerëzore, nuk i ndryshojnë natyrat e sendeve. Kemi thënë se magjia e bazuar në ligjet njerëzore, mashtron vetëm të pamurit dhe i frikëson njerëzit. Ndërsa, magjitë e mbështetura në ligjet jonjerëzore, janë të ndihmuara nga krijesa të tjera dhe magjia e tyre ka për qëllim t'i nënshtrojë njerëzit, që e ndiejnë veten më të dobët se ata. Ata, duke paraqitur skena të ndryshme, shndërrohen nga një formë në formë tjetër, por ashtu siç thamë, ata nuk e ndryshojnë esencën e sendeve, por vetëm sa mashtrojnë të pamurit e prezentuesve.

⁴⁸ Kur'an, 72/6

Në të dyja rastet, është përdorur mashtrimi, njëri (duke vepruar) me ligjet njerëzore, ndërsa, tjetri me ligje jonjerëzore. Ata i frikësojnë njerëzit, i ngatërrojnë dhe i magjepsin sytë e tyre, dhe mjerisht ka të tillë që iu nënshtrohen atyre. Thënë realisht, magjia është një iluzion, që e kaplon individin, qoftë me ligje të njëjta njerëzore, qoftë me ndihmën e ndonjë force tjetër. Përderisa, magjia është një lloj iluzioni, ndodh që njeriu të ndikohet prej saj, dhe kur ai bie pre e saj, thuhet se ai njeri është nën ndikimin e magjisë.

E tërë kjo, që thamë më sipër, nuk ndikon tek njeriu besimtar, sepse imani e bën atë të sigurtë t'a njohë realitetin dhe të kuptojë se nuk ka kurrfarë force, që mund t'a ndryshojë natyrshmërinë e materies. Njeriu besimtar, i cili kërkon ndihmën e All-llahut xh.sh., nuk mund t'a kapë mashtrimi i magjistarit, sado që ai të mundohet. Ai është nën mbrojtjen e All-llahut xh.sh. dhe nuk dëmtohet, përkundrazi, ata, që mundohen t'iu bëjnë atyre ndonjë dëm, ata e pësojnë vetë atë.

Mbrojtje, prej këtyre sulmeve, kemi mbështetjen e All-llahut xh.sh., i Cili thotë: "...por dredhia e keqe, nuk godit tjetër, vetëm ata, që e kurdisën..."⁴⁹. Pastaj i Lartëmadhëruari, për ata, që merren me magji për t'i mashtruar dhe frikësuar njerëzit, thotë: "...Ndërsa ata, të cilët e ushtrojnë këtë mjeshtëri, e dinë se nuk kanë kurrfarë të mire në botën tjetër (ahiret)"⁵⁰.

Ata, të cilët paraqiten si besimtarë, por në realitet e kanë shitur imanin e tyre, dhe i mashtrojnë dhe i frikësojnë njerëzit, nuk kanë kurrfarë shpërblimi në ahiret. Përkundrazi, ata do të dënohen dhembshëm, sepse e kanë shitur (këmbyer) imanin me kufrin (besimin me mosbesimin). I

⁴⁹ Kur'an, 35/43- sipas përkth. të Sherif Ahmetit,

⁵⁰ Kur'an, 2/102

Lartësuari, nuk i jep pushtet, pabesimtarit ndaj besimtarit. Ai, i cili mendon se do të shpëtojë, dhe merret me mashtrim dhe përdor magjitë, mashtrohet keq! Do të vijë koha, kur ata do të pyeten dhe do t'u thuhet: jeni marrë me ngatërresa, keni gjetur personat, që e dëshironin këtë sherr, dhe ju vetë dëshmuat se ajo, iu kthye bumerang atyre, që u morrën me këtë të keqe (magji) në këtë botë. Mjerimi dhe dënimi nuk do të mjaftojë (zgjasë) për ta, vetëm në këtë botë, por ai do të vazhdojë për ta, edhe në ahiret, sepse ata e mohuan Krijuesin e tyre.

Na ka ngelur tani, edhe ajeti fundit për zilinë. I Lartësuari thotë: "dhe nga sherri i ziliqarit, kur shfaq zilinë"⁵¹. Çfarë është zilia? Zili kemi atëherë, kur njeriu mundohet për t'a larguar apo penguar dikënd nga begatitë, ose ndryshe kur dikush e sheh një njeri, që është i lumtur dhe mundohet t'a largoj prej saj, apo përpiqet t'i japë fund asaj lumturie. A ka të bëjë zilia me shikimin e syve dhe a ka ajo lidhje me botën materiale? Ose, p.sh. a mundet i verbëri të mos ketë zili? Kjo formë e të menduarit rreth zilisë, është një gabim i madh. Si i verbëri, ashtu edhe ai që nuk është i verbër, kanë zilitë e tyre. Zilia, ndërlidhet me vullnetin e ziliqarit, e jo me të pamurit. Njeriu, i cili ka zili, atë e bën me vullnetin e tij. Vendi i zilisë nuk është syri, por zemra.

Ai që ka zili, nuk e kupton fjalën begati. Ajo, rrjedh nga All-llahu xh.sh. Është dhuratë nga i Lartëmadhëruari për ata, të cilëve iu hapen dyert e begatisë. Ndërsa, ai që e dëshiron me çdo kusht begatinë, atij i vështirësohet, ose i bëhet e pamundur të arrijë deri tek ajo, pa vullnetin e All-llahut xh.sh. Këtë realitet, duhet t'a kuptojmë një herë e mirë. Begatia është nga All-llahu xh.sh.

⁵¹ Kur'an, 113/5

Për të pasur begati të qëndrueshme, duhet të kuptojmë ajetin e All-llahut xh.sh., i cili thotë: "(Ma shae All-llah) ashtu si ka dëshiruar All-llahu, nuk ka fuqi përveç asaj të All-llahut"⁵²

Pra, begatinë duhet t'a kuptojmë në këtë mënyrë: ajo transferohet nga Dhuruesi i Vërtetë (All-llahu) në duart e pranuesit, dhe kështu shkatërrohet çdo zili.

Edhe një herë të përkujtojmë se, All-llahu xh.sh. ka vendosur barazpeshën në gjithësi. Kjo, nuk do të thotë se arritja e saj, është e lehtë, qoftë në risk, qoftë në pushtet. Kemi disa, që kanë pasuri, por nuk mund t'a shfrytëzojnë atë. Ndodh që dikush, e shtron sofrën e vet me gjithë të mirat, por nuk mund të hajë më shumë se një kafshatë. Edhe pse ka pasuri, atij i është ndaluar të hajë, për shkak të sëmundjes. Ndodh, që të ketë rezidencë prej më luksozeve në botë, por, megjithatë, të jetojë në vetmi i mërëzitur dhe në bezdi të tmerrshme. Nuk i ndien dhe nuk i shijon bukuritë që i ka pranë, edhe pse jeton në saraj të vërtetë. Atë bukuri, më shumë e ndien rojtari i tij, sesa vetë pronari. Shembuj të tillë, kemi shumë në jetën e përditshme. I Lartësuar, e bën njeriun të ketë nevojë për një njeri tjetër, që është shumë më i dobët se ai materialisht, edhe pse ai vetë posedon pasuri për të sunduar botën. Mund të ndodhë që nevoja për të, t'ia shpëtojë jetën...

Baraspeshat (e begative) shpeshherë janë të padukshme, ato shpesh janë të padukshme për ata, që hulumtojmë (vetëm) pasurinë ose diçka tjetër. Ne duhet t'a kemi parasysh se i Lartësuar, dikujt i jep begati dhe pasuri, dikujt i jep shëndet, dikujt tjetër bereqet, ndërsa dikujt tjetër ia lehtëson riskun. Nëse dikush mendon se ka humbur diçka të shtrenjtë, All-llahu do t'ia plotësojë atij, në një formë tjetër. Për secilën paaftësi (hendikep), All-llahu të jep (t'a kompeson me) forcë dhe

⁵² Kur'an, 18/39

shkathtësi të tjera. Nëse dikush është i verbër, i Lartësuar i ia zëvendëson (mungesën e) të pamurit me dëgjim të fortë. Atij që s'ka aftësi të lëvizë, All-llahu i jep shkathtësi dhe zgjuarsia mendore.

Mençuria e tij mahnit shumëkënd për sukseset që ka mundur t'i arrijë, rezultate, të cilat shumëkush prej njerëzve pa të meta, nuk e arrijnë dot. Gjërat janë në baraspeshë dhe të përcaktuara. Ndonjëherë, njeriu mendon se forcat janë të paqëndrueshme (labile), të pabaraspeshuara. Edhe pse, në pamje të jashtme, nuk janë të dukshme, kjo nuk jep të kuptohet se, në global, nuk ka baraspeshë. Ka raste të tilla, që dikush duhet të kujdeset për dikënd, për një kohë shumë të gjatë, megjithatë jeta e tij është shumë më e mirë, se shumë të tjerëve në botë.

ZILIA - SMIRA

Ç'është zilia? Thamë se zili kemi atëherë, kur njeriu mudohet për t'ia larguar apo penguar dikujt begatitë, ose, ndryshe, kur dikush e sheh një njeri, që është i lumtur dhe mundohet t'a largojë prej saj, apo përpiqet t'i japë fund asaj lumturie. Këtë e realizon, duke vënë pengesa, apo duke dëmtuar ato punë, që rezultojnë suksese. Kemi njerëz, të cilët shprehin zili, kur shohin se si një arë është pjellore dhe jep shumë rendimente. Nga zilia që kanë, shkojnë dhe e shkatërrojnë atë. Dikush, mund të ketë shtëpi apo makinë të mirë, dhe (të tjerët) ua vënë flakën (nga zilia). Dikush e shpreh zilinë, duke bërë dua kundër tij, pa ndërmarrë ndonjë veprim konkret, ndërsa dikush e ndien shumë thellë zemërimin dhe ndodh që (ky zemërim) të ndikojë tek ai. Kemi edhe të atillë që, shpirtërisht, e kanë zili dikënd, dhe e shqetësojnë atë psikikisht dhe ia destabilizojnë jetën. I

tilli, mundohet vazhdimisht të punojë kundër tij, duke ia marrë mendja se, kështu do të arrijë t'ia largojë atij begatitë.

Zilia është shumë llojesh, ashtu sikurse ishte edhe magjia. I Lartësuari na ka informuar për to, dhe përderisa i Lartësuari na ka informuar për to, ato ekzistojnë dhe janë prezente në botë. Askush nuk mund t'i ndalojë këto veprime, ato nuk janë substanca (materie) dhe nuk mund të futen në laboratore, që të mund të nxjerrim diagnozat e tyre shkencore. Ajo, çka s'është lëndë materiale dhe që syri nuk e sheh, ajo mund të ekzistojnë në univers dhe askush nuk mund t'a zhdukë atë, nëse ajo ekziston. Pak më lartë, theksuam se, shumë gjëra, vetëm pak kohë para nesh, ishin inekzistente për ne, por në fakt, tani, ato janë në mesin tonë.

Ato, më parë, nuk shikoheshin me sy, por, tani i njohim mirë. Disa gjëra, para njëqind vjetësh, ishin "inekzistente", mendja as që i parafytyronte, e as që besonte se ishte e mundshme ekzisteca e tyre, por, tani, jo vetëm që i besojmë, por edhe i prekim. Pa marrë parasysh, nëse njeriu, merret me magji ose ka zili, ai konsiderohet mëkatar, tek All-llahu xh.sh. Ai që merret me magji, me siguri synon kënaqësitë dhe interesat e veta, por ai, padyshim, se do të përfundojë në ngulfatjen e tij, sepse përreth tij janë plot vepra të këqia. Atij, i ndalohet çdo mirësi.

Ndërsa, ziliqari përpiqet, apo shpreson, t'ia largojë njeriut begatitë e tij. Gjendja (sjellja) e tij është e çuditshme, sepse ai nuk përfiton asgjë. Sikur të shkatërronte një arë, apo të ndizte shtëpinë e dikujt, apo të bënte diçka tjetër të dëmshme, ai nuk do të përfitonte asgjë, sepse ajo nuk do të bëhej pronë e tij. Shikuar realisht, ai është dëmtues i vetes, sepse veprimet e tij, nuk e pasurojnë atë, qoftë edhe me ndonjë përfitim të shpejtë e të vogël. Ky person, në momentin e shprehjes së zilisë, ka dëmtuar veten, sepse ka shkaktuar mëkat dhe armiqësi, në këtë botë dhe në ahiret. Sikur

të mos të ishte i mbushur me zili, ai do t'a kuptonte se ajo ishte dhuratë prej begative të All-llahut të Lartësuar, dhe Atij, ato nuk i shterren kurrë. Ai, ka mundësi, t'u japë të dy palëve, sa të duan. Atij, nuk mungon asgjë prej pasurisë së Tij.

Do të ishte më mirë, shumë më mirë, që ziliqari t'i drejtohej me kërkesë All-llahut xh.sh., për diçka, por fatkeqësisht ai, dëshiron shkatërrimin e dikujt, vetëm e vetëm, që ai të mos e gëzojë atë begati. Sikur kjo të ishte pasuri, apo pushtet, ose shëndet, dhe ai do t'a përfitonte pas shfaqjes së zilisë së tij, do të thonim se, të paktën, ka fituar diçka. Fatkeqësisht, ziliqari e di fare mirë se, ai nuk përfiton asgjë prej atij veprimi, por e bën atë së koti. Me këtë veprim, ai dëmton veten dhe sigurisht edhe pasurinë e tij personale.

Sikur të ishte besimtar i vërtetë, do të trashëgonte begati nga Krijuesi i tyre, dhe do t'a kuptonte se, ato janë dhuratë e All-llahut xh.sh., i Cili ai jep kujt të dëshirojë. Si duket, ziliqari e kundërshton vullnetin e All-llahut të Lartëmadhëruar, i Cili i jep atij, që Ai dëshiron. Kundërshtimi i vullnetit të All-llahut, këtu, lë të kuptohet se është një lloj kufri (mohim i All-llahut). Ai, jo vetëm që e mohon furnizimin e All-llahut xh.sh., por edhe e kundërshton vullnetin e dhurimeve të furnizimit.

Thënë realisht, zilia rrjedh nga begatia (që kanë të tjerët), prej së cilës nuk ndikohet askush, përveç ziliqarit me smirën e tij. Por atij, që i është dhuruar begati dhe që kërkon mbrojtje nga i Lartësuari, atij nuk i ndodh asgjë. Por, nëse nuk bën zili, por thotë: "... këtë që e posedoj (nga pasuria) është rezultat i diturisë sime..."⁵³, dhe vazhdon të merret me ngatërresa ndër njerëz, kjo

⁵³ Kur'an, 28/78

begati do t'i merret ose do t'i ikë atij. Një njeri, që mburret vazhdimisht, dhe kudo që shkon thotë, se: kjo vepër u bë në sajë të shkathësisë sime, atij personi, i Lartësuar, do t'i thotë: ti hyre në hisen time dhe m'u bëre ortak. O ti njeri, Unë të dhashë inteligjencën, por dije se Unë jam më i Pasuri nga të gjithë dhe atë, që Mua më shoqëron me dikënd tjetër, Unë do t'a lë pa mbështetjen Time. Kur ky njeri, nuk do t'a ketë mbështetjen e All-llahut, ai do t'a humbë begatinë, sepse, nga vetja, nuk mund të realizojë gjë prej gjëje. Secili, që mund të arrijë diçka, do t'a bëjë në sajë të vullnetit të Tij, sepse ai është dhuruesi. Ai ia ndriçon rrugën dhe ia lehtëson rrugëtimin, për të arritur deri tek ajo begati. Ato begati, që dikujt i ikin prej duarve, le t'a kuptojë se ato nuk ishin për dobinë e tij. Sikur të ikte begatia e shëndetit, prej All-llahu xh.sh., atij do t'i shfaqej përnjëherë sëmundja. E njëjta gjë, vlen këtu edhe për riskun. Sikur të mos ishte vullneti All-llahut për t'i furnizuar njerëzit, puna do të sillej në atë mënyrë, që rezultatet sipas proceseve natyrore do të stagnonin dhe nuk do të dhuronin asgjë, edhe pse njeriu do të mendohej dhe do të sakrifikonte shumë nga vetja.

NJERËZIT JANË DY LLOJESH

Duhet t'a kemi parasysh se njerëzit janë dy llojesh. Njëri lloj i njerëzve, mbështetet tek All-llahu xh.sh. dhe çdo gjë ia atribuon Atij, duke e falenderuar Atë. Këta persona, nuk i dëmton magjia, e as që u shkatërrohet pasuria nga ziliqarët. Këta individë, janë të rrethuar, nga të mirat e All-llahut të Lartësuar. Ndërsa lloji tjetër i njerëzve, çdo gjë, ia atribuon vetvetes. Këtyre njerëzve, mund t'iu

ndodhë që të kenë probleme në jetë dhe t'iu humbasë pasuria, sepse (mbështetjen në) fuqinë dhe mundësitë e All-llahut i kanë kaluar (në mbështetjen) tek forca njerëzore.

I Lartësuari, kërkon prej nesh që, gjithmonë, të mbështetemi tek Ai. Përderisa, i Lartësuari, kërkon prej nesh që të mbështetemi tek Ai, Ai e di se ne nuk jemi në gjendje të përballemi me ato probleme, sepse ne nuk mundemi t'a njohim zanafillën e rregullave. Djajtë dhe xhinët i shohin njerëzit, ndërsa, ne nuk e shohim ata. Mosnjohja e ligjeve dhe e rregullave të tyre, ose e krijesave të tjera dhe, njëkohësisht, pamundësia për t'i parë ata, na bëjnë të paaftë që t'iu bëjmë ballë atyre, qoftë sikur t'i kemi me vete të gjitha forcat e botës. Duke qenë se pozicioni ynë është ky që është, i Lartësuari, kërkoi nga ne, që ne t'i mbështetemi vetëm Atij, pasi vetëm Ai mund t'i pengojë të gjitha ato forca, që janë të panjohura për ne.

Magjia realizohet nëpërmjet mashtrimit të syve dhe ushtrimit të frikës psikike. Ato kryhen, ose sipas rregullave tokësore, ose duke përdorur magjitë me kafka, me zëra të frikshëm, me mashtrime të ndryshme, me lëvizje të shpejta të dorës, me përdorimin e rregullave jonjerëzore, sikurse janë rregullat e xhinëve, por (realizimi i këtyre mashtrimeve) nuk e ndryshon esencën e gjësendeve. I Lartësuari, kërkoi nga ne, që t'i mbështetemi Atij, (për mbrojtje) nga të gjitha këto dëme, pastaj çështjen t'ia kalojmë plotësisht mundësive të fuqisë së All-llahut xh.sh. Kjo argumenton se Ai, është mbi çdo mundësi të diturisë njerëzore. Këtu nuk kemi pse të debatojmë, sepse kjo nuk argumentohet shkencërisht.

Nuk ekzistojnë laboratore materialiste që të mund t'a evidentojnë këtë gjë. Për, këto fakte ne bazohemi në informacionet e All-llahut xh.sh., i Cili na tregoi rreth tyre, duke na mësuar se, ato janë krijesa të padukshme për ne. Njeriu, nga vetë natyra e tij për të hulumtuar vazhdimisht të

panjohurën, vazhdon t'i kërkojë përgjigjet (faktet) për këto krijesa. Atij i lejohet ky hulumtim, por sygjerohet që atë t'a bëjë duke u mbështetur tek All-llahu xh.sh. Këto na lejohen, sepse ato (krijesat e padukshme) kanë të bëjë edhe me ne, por ne duhet t'a dimë dhe t'a kuptojmë mundësinë tonë, dhe të mbështetemi tek Zoti, për arsye se vetëm Ai, mund t'i pengojë (dëmet që bëhen nga) ato.

Tani jemi tek momentet e fundit. Dëmet, të cilat vijnë nga individët që i përkasin qenies njerëzore, janë vetëm vesvese, ose ndryshe njihen si 'të dëgjuarit e joshjeve të shejtanit (djallit)' dhe 'urisë për sherr'. Informacioni që, nëpërmjet All-llahut, kemi për to, nuk duhet të na bëjë që t'iu frikësohemi atyre, por ky informacion duhet kuptuar si një qetësim i plotë, sepse fuqia e All-llahut xh.sh., është me ne, dhe përderisa ne i mbështetemi Atij, jemi plotësisht të sigurtë.

I Lartësuari, pa dyshim, se do të na mbrojë dhe kjo duhet të jetë e qartë për ne. Nëse, eventualisht, frika hyn tek ne, Ai është me ne, dhe do t'a shfaqë Fuqinë e Tij, dhe kështu do të qetësohemi, sepse mëshira e Tij, do të ndikojë përnjëherë kur ne kërkojmë ndihmë nga Ai, për frikën që na kaploi. Këtë dituri, që na e reveloi i Lartësuari, duhet t'a kuptojmë si siguri dhe qetësim prej të këqijave që na rrethojnë, dhe jo vetëm kaq, por, Ai edhe i largon ato të këqija prej nesh. Gjithashtu, këto na japin forcë, veçanërisht, kur i njohim edhe cilësitë e Dexhallit dhe të ugurzinjëve, të cilët shtiren se janë në gjendje të na bezdisin dhe të na lëndojnë kur 'të dëshirojnë ata', pasi ne jemi nën harmoninë e Fuqisë dhe mundësive të All-llahut xh.sh. Vepruesit e këtyre të këqijave, diturinë e kanë marrë nga melekët, të cilët i kanë sygjeruar secilit që ka shprehur dëshirën për t'i mësuar, se ato janë në dëm të tyre. Jeta e tyre është tepër brengosëse dhe përfundimi tyre do të jetë i dhembshëm.

Disa njerëz, proceset i ndërlidhin me shkaktarin e parë. Ata besojnë se i Lartësuar i krijoi universin, e përsosi atë duke ia vendosur rregullat dhe ligjet mbi të, dhe pastaj e braktisi atë përfundimisht. Këto supozime nuk janë të vërteta. I Lartësuar i është Mbikqyrësi, i Cili i mbikëqyr të gjitha krijesat, deri në Ditën e Kiametit. Ai e shfaq Forcën e Vet, vetëm atëherë kur paraqitet nevoja. Kjo temë, do të jetë biseda jonë e ardhshme, në kapitullin vijues.

SHFAQJA E FUQISË NË UNIVER

Pa dyshim se, All-llahu i Lartësuar, krijoi çdo gjë që ekziston në univers. Gjithashtu, Ai, është Krijuesi i proceseve natyrore, të cilat veprojnë në të. Këtu përfshihen edhe ligjet me rregullat e tyre. Në momentin kur, i Lartësuar, thotë: 'Bëhu', në atë çast bëhet ajo që Ai dëshiron. Pastaj, në qiej dhe në tokë, vepruan proceset e parapara, të cilat e zbatuan atë urdhër, për gjashtë ditë. Këto janë gjashtë ditë, prej ditëve që njihen prej njerëzve, sepse vetë i Lartësuar i ka komunikuar (këtë gjë) qenies njerëzore. Që tani e tutje, duhet t'a kemi parasysh, se për çdo gjë që flitet, kemi të bëjmë me parametrat dhe logjikën njerëzore. Qoftë, kur ne flasim për kohën e tashme apo të ardhmen, qoftë për gjërat që tani për tani, neve nuk na janë të njohura.

Ligjet dhe rregullat, nuk duhet të kuptohen se janë bazament i të gjitha prodhimeve ose shfaqjeve të Fuqisë. Sikur, All-llahu xh.sh., t'i kishte paracaktuar proceset në tokë të ishin të vetëpërmbytura, njerëzimi kishte për t'iu besuar proceseve. Sikur proceset të ishin të kësaj kategorie, atëherë (njerëzit) do t'a kishin harruar, Krijuesin e proceseve, përfundimisht. Për këtë

arsye, shpeshherë kemi ndërhyrje, në prishjen e proceseve natyrore, drejtëpërdrejtë nga ana e All-lahut xh.sh. Kjo bëhet, sa për t'ia bërë me dije njerëzimit, për ekzistimin e Fuqisë më të madhe, se sa proceset. Kjo Fuqi është mbinatyrore, dhe ajo nuk i përfill rregullat e parapara në këtë univers. All-llahu, ato, i paraqet kur të dëshirojë, si të dëshirojë dhe sa të dëshirojë. Këto janë arsyet, pse njeriu merret me mashtrime dhe e mundon veten aq shumë, dhe prapëseprapë, kemi shumë prej tyre, që jetojnë në skamje të tejskajshme. Gjithashtu, kemi edhe të tjerë, të cilët mundohen shumë pak, por janë të pasur.

Njeriu i pafuqishëm ngadhënjën (vetëm) me Fuqinë e All-llahut xh.sh., kundrejt një njeriu të fuqishëm, mizor dhe shkatërrues. Realizimi i kësaj (pa ndihmën e All-llahut), nuk është diçka e natyrshme, por, shfaqja e Fuqisë së Zotit vjen në atë mënyrë, që ajo të vështrohet prej njerëzve dhe ata t'a kuptojnë se ishte Forca e All-llahut xh.sh., dhe mundësia e Tij e pakufishme (që bëri të mundur realizimin e saj).

Kjo që unë po them, shumë njerëzve, nuk ju pëlqen, e në veçanti nuk dakordohen me mua materialistët, të cilëve iu pengojnë shumë këto thënie, sepse ata supozojnë se Islami është fe e prapambetur, për shkak të besimit të shumtë, në shfaqjen e Fuqisë Hyjnore. Ata e refuzojnë thënien e All-llahut xh.sh., e cila është e shkruar në Kur'ani Kerimin: "...All-llahu i furnizon ata, që dëshiron, pa masë (llogari)..."⁵⁴. Kjo thënie (sipas tyre) është regresive, pasi ajo e pengon njeriun të vrapojë në gjetjen e riskut. Atëherë, pse njeriu të vrapojë pas riskut, pse të lodhet, të mundohet apo të vuajë, përderisa e ka të trashëguar atë? Para se t'i përgjigjemi kësaj pyetje, do të kisha sjellë një shembull të kohës sonë, që mendoj se është shumë i rëndësishëm. Shohim se, këta

⁵⁴ Kur'an, 2/212

njerëz, me të drejtë dhe shumë mirë e kanë kuptuar thënien e All-llahut xh.sh., në Kur'an: "...All-llahu i furnizon ata që dëshiron pa masë (llogari)...".

Ata, të cilën mundohen të shpifin për fe islame, apo për këtë ajet, padyshim janë prej atyre, që u besojnë proceseve natyrore. Këto, për ta, janë sikur Zotëra. (Sipas tyre) Çdo risk është ekuivalent me punën e kryer. Nëse dikush punon ditë e natë do t'a shtojë riskun, ndërsa nëse punon disa orë në ditë, do të ketë riskun më të kufizuar. Ky (sipas tyre) është një rregull, që përcjell jetën e secilit, që jeton në këtë botë. Këta, janë mësuar të mendojnë se, risku është ekuivalent me përmasën e punës që bëhet.

Këtyre iu përgjigjemi, se ky mund të jetë një rregull i përgjithshëm, ashtu siç po kuptojnë edhe ata vetë, por ky shpjegim nuk e mohon, këtë thënie të Kur'anit: "...All-llahu i furnizon ata, që dëshiron, pa masë (llogari)...". Ne do të përqëndrohemi tek thënia "...ata, që dëshiron...". I Lartësuar nuk thotë 'të gjithë ata', por 'ata, që dëshiron'. Secili risk që posedohet prej nesh, edhe pse është fituar me mund dhe sakrifica të mëdha, është arritur sipas vullnetit të Tij. Është arritur sipas shfaqjes së Fuqisë së All-llahut xh.sh., i Cili jep pa masë, ose pa ndonjë shkak.

Nëse vështrojmë shtetet që janë të pasura me naftë, shohim se ato janë shtetet, të cilat posedojnë forcën e vërtetë të pasurisë, apo të riskut në mbarë botën. Nëse i vërejmë ato, do të konstatojmë se janë më me shumë risk dhe më të pasura, se ato (shtete), të cilat janë pasuruar me mund të madh dhe me ndihmën e dijeve. Ndoshta, disa prej tyre janë bërë për lëmoshë, sepse kanë nevojë imediate për ta. Konstatojmë se Amerika dhe Evropa perëndimore janë vendet më të përparuara dhe më të ditura. Megjithatë, ekonomia e tyre i ka drejtuar sytë nga shtetet e petrolit, që tani kanë biliarda dollarë të stivosura. Perëndimorët orvaten për t'a tërhequr pasurinë e këtyre shteteve,

drejt bankave të tyre. Nuk është për t'u habitur që shtetet naftëmbajtëse sot janë në gjendje të shkaktojnë inflacion, apo të falimentojnë shtetet më të mëdha në botë, siç janë: Amerika, Gjermania, Japonia etj., nëse e tërheqin ndihmën ekonomike dhe ua ndalojnë atyre blerjen (e naftës).

Atëherë, cilët qenkan gjigantët e vërtetë ekonomikë, në botë? Realisht, ato janë shtetet e petrolit. Ata, janë bosët e pasurisë dhe riskut. Këta janë ata, të cilët mund të veprojnë si të dëshirojnë, jo vetëm me riskun, por edhe me ekonominë botërore. Kjo vlen (si përgjigje) për të gjithë ata, që pohojnë (dhe mbrojnë) materializmin dhe mosbesimin në botë.

I JEP RISKUN ATIJ QË DO

Na ka ngelur pa sqaruar, pjesa tjetër e pyetjes. Nëse pra, shtetet e naftës kanë arritur në këtë shkallë, sa të mund të udhëheqin ekonominë botërore, padyshim se, sipas teorisë materialiste, e kanë arritur këtë standart nga dituria dhe puna e atyre, që do të ishin nga më të përparuarat dhe më të njohurat në botë. Kjo, në fakt, nuk është e vërtetë, sepse këto shtete nuk kanë përparuar në shkencë dhe punë, që prejse kur u zbulua nafta. Tani, ata që e zbuluan këtë lëndë, varen ekonomikisht nga shtetet që e posedojnë atë, ose prej atyre që punojnë më pak ...sikurse e theksuam më lartë. Ato (shtetet naftëmbajtëse), me ndërmjetësimin e specialistëve bënë hulumtime, sollën makineri dhe importuan mjetet elektronike prej shteteve të tjera.

Si do të realizohej e gjithë kjo, sikur të mos ishte thënia e All-llahut të Lartësuar: "...All-llahu i furnizon ata, që dëshiron, pa masë (llogari)...". Si mund të spjegohet e tërë kjo, vërtet, si ndodhi?! Sikur të mbretëronin rregullat e proceseve natyrore, sipas të cilave do të vinte risku, kjo nuk do të ndodhte. Gjithashtu, shtetet e petrolit, nuk do të ishin forca kryesore ekonomike në botë, dhe kjo (nuk do të mund të arrihej) për një kohë shumë të shkurtër. Puna dhe shkenca, nuk do të mund të arrinin, që për një kohë kaq të shkurtër, të bënin një hop kaq të madh. Për t'i kaluar disa shtete, nga më të përparuarat në botë, do të duhej një kohë shumë e gjatë, dhe (do të duhej të posedoje) shkathtësi të veçanta. Këtu, as faktori kohë, as faktori shkencë, e as faktori punë, nuk është ekuivalent me riskun. Atëherë, pyesim, kush pra, ishte ai, i cili ua dha këtë risk? Padyshim, ai ishte All-llahu xh.sh., thënien e të Cilit ne besojmë: "...All-llahu i furnizon ata, që dëshiron, pa masë (llogari)...".

Me këtë, kisha për qëllim të thoja, se vizionet e perëndimorëve këtu duhet të ndalen pak, e mos t'i shikojnë, shkaqet, si çdo gjë në jetë. Duke qenë se shikojnë nga një këndvështrim tjetër, ata shpifin dhe mundohen t'i ndryshojnë thëniet e All-llahut xh.sh.: "...All-llahu i furnizon ata, që dëshiron, pa masë (llogari)...". Ata, mendojnë se kjo, nuk mund të vlejë tani në kohën e përparimit, shkencës dhe ardhmërisë. Para se të nxitojnë në akuzat e tyre, ju themi atyre: shpresoni dhe vështroini në univers, sepse aty do të gjeni, në çdo cep, riskun e All-llahut xh.sh., i Cili, i jep pa masë, atij që dëshiron. Ky risk, vjen për një arsye shumë më të thellë, vjen për arsye që t'i tregojë njerëzimit se, duhet të shfaqet Fuqia dhe t'i informojë se, All-llahu vepron çka të dëshirojë.

Përderisa, shkaqet ekzistojnë dhe janë prezente, edhe shfaqje e Fuqisë Hyjnore duhet të jetë prezente në univers. Mendoj se, askush nuk mund t'a demantojë këtë pikë. Megjithatë më vjen

keq, që disa parafrazojnë, mbjellin urrejtje dhe neveri kundër ajetit të All-llahut xh.sh.: "...All-llahu i furnizon ata, që dëshiron, pa masë (llogari)..." , duke thënë se ky ajet nuk ka të bëjë me realitetin. Përkundrazi, kjo është prezente, që prej kohës kur Zoti e krijoi tokën. Kjo do të vazhdojë të ekzistojë kështu, deri në Ditën e Kijametit, ndërsa, secili që mendon ndryshe, le të paraqesë argumentin e tij.

Pas kësaj pasqyreje, t'i kthehemi shfaqjes së Fuqisë. Pse, i Lartësuari, e mbajti për vete këtë shfaqje të Fuqisë, dhe pse nuk i la të lirë universin, që të veprojnë vetëm sipas proceseve të veta?. Materialistët, rreth proceseve dhe shpagimeve, janë shumë të avancuar, ata kanë një administratë të shkëlqyer dhe janë shumë të disiplinuar. Megjithatë, sikur shkaqet të vetësundonin, pa prezencën e All-llahut xh.sh., do të mbisudonte anarkia. All-llahu, i jep pushtet kujt të dojë prej krijesave të Tij, dhe këtë e bën me qëllim që bota të ketë rrjedhshmëri.

Dikujt ia bën të mundur të bëhet kryetar shteti, dhe ia lehtëson shkaqet që të ketë pushtet mes njerëzve. Dikujt tjetër, ia lehtëson arritjen e pasurisë, e shumë gjëra të tjera, që i shohim në jetën e përditshme, në këtë botë. I Lartësuari, këto, i bëri me qëllim që jeta të vazhdojë në univers, me shfaqje të qarta. Por, çfarë ka ndodhur tani? Në botë, u shfaqën materialistët, të cilët në çdo mënyrë mundohen t'ia atribuojnë vetvetes rezultatet. Këta, po t'a kenë pasurinë, e eliminojnë cilin të dëshirojnë. Po t'a kenë edhe pushtetin, kuptohet se këta do t'u japin të tjerëve, aq sa dëshirojnë, prej punës që ata do të bëjnë. A nuk është ky, realiteti jetësor i tanishëm, në botë?

Të supozojmë se ata, që nuk i frikësohen All-llahut xh.sh., një ditë do të kërkojnë nga unë, që të bëj një shërbim për ta, për të cilën ata do të më shpërblejnë, por, ajo, është një punë, që do t'a hidhërojë All-llahu xh.sh. Cili do të ishte qëndrimi im, sikur të isha prej atyre, që u besojnë

shkaqeve, dhe t'a zbatoja atë, që do të më kërkohet, për përfitimet e mia personale? Sikur, pronari im, apo ai që posedon pasurinë dhe pushtetin, të më thoshte, në fund, të mbysja një njeri, sepse do të më jepnin këtë apo atë, unë do t'a bëja pa kurrfarë mëdyshje, sepse ndienjat e mia më japin sinjale, se ai është i vetmi, që jep urdhëra dhe ka pushtet. Mëkatet (e nxitura nga ana) e tij do të më shpienin deri në shkatërrim, dhe kështu do të më ndalonin një ditë nga jetësimi i jetës sime. Respektimi im ndaj tij, do të bënte që unë të jetoja një jetë që e kam ëndërruar t'a jetoja, pa menduar fare, se çfarë më mëson All-llahu xh.sh., mbi lirinë time, për të vepruar ose jo.

Kështu, unë do t'i realizoja pasionet dhe epsheet e mia, së bashku me atë, që posedon pasuri dhe pushtet, edhe pse do t'a hidhëroja All-llahun xh.sh. Ajo çka unë do të bëja, s'do të ishte gjë tjetër veçse adhurim, por dallimi është se këtu do të adhuroja individin. Kështu do të rridhnin punët nëse, pasioni dhe arritja e qëllimit njerëzor, do të bëhej element bazik, në këtë jetë. Pa dyshim, se me këtë formë të të jetuarit, do të ç'rregullohej i tërë universi, sepse njerëzimi nuk do të jetonte sipas programit të All-llahut xh.sh., i Cili e mbron të dobëtin nga vuajtjet e mizorit, të shtypurin prej shtypësve. Jeta, do të jetohej, sipas pasioneve dhe epsheve njerëzore, e jo sipas fesë së All-llahut.

Kjo mënyrë e të jetuarit, është në kundërshtim të plotë (me llogjikën e shëndoshë), sepse do të ç'ekuilibrohej drejtësia në univers, do të shtohet urrejtja, eksploatimi dhe ngatërresat në botë. Në një shoqëri të tillë, ku do të adhurohej individi, do të përhapej tirania dhe terrorizmi. Drejtësia do të zhdukej, dhe njeriu do të kërkonte të bëhej i adhuruar. Pë të vërtetuar këtë që po them, le të marrim si shembull, kryetarin e ndonjë shteti, i cili presupozon se është hyjni (Zot) dhe banorët e atij shteti, të cilët nuk i besojnë All-llahut xh.sh.

Qysh prej, kur historia ka filluar të shkruhet, faraonët kanë qenë ata, që kanë pretenduar se janë Hyjni. Prej asaj kohe, e deri në ditët e sotme, i Lartësuari ka sqaruar se të gjithë ata (njerëz), që i përkrahin ata (faraonët), do të dënohen më shumë se të tjerët. Do të dënohen, sepse me veprimet e tyre, i kanë mbështetur pasionet e tyre dhe kështu e kanë hidhëruar të Lartësuarin. Po e veçojmë familjen e faraonëve, sepse që kur ka filluar jeta e tyre në varreza, dënimi do t'u vazhdojë (atyre) edhe ditën, edhe natën, deri në Ditën e Ringjalljes. I Lartësuari thotë: "Ata do të (dënohen) paraqiten para zjarrit, çdo mëngjes dhe mbrëmje, e kur të vijë çasti (Dita e Kijametit, ju thuhet): Ithtarët e Faraonit futini në dënimin më të rëndë"⁵⁵

Këta ithtarë, nuk do të dënohen si gjithë të tjerët, në Ditën e Kijametit, por atyre do t'ju shtohet dënimi me zjarr, mëngjes e mbrëmje, deri në ditën kur do të ringjallemi. Dënimi, për këta ithtarë, do të jetë më i madh, sepse mëkati i tyre ka qenë tepër i madh. Adhurimi i individit është ekspozim i pasioneve, shprehje haptazi e përkrahjes së përhapjes së tiranisë, kriminalitetit, perversitetit dhe ngatërresave në botë.

SHKAQET NË VETE, JO

Paraqitja në univers e shkaqeve në vetvete, sjell adhurimin e individit, shtrirjen e terrorizmit, tiranisë e kështu me radhë, deri në adhurimin e plotë të proceseve shkaktuese. Ai, që do t'a kishte

⁵⁵ Kur'an, 40/ 46

pushtetin në dorë, do të kërkonte nënshtrimin dhe pasurinë e të tjerëve. Një pushtet i tillë, do t'a shpinte njerëzimin në harresën totale, të sundimit absolut të universit, nga ana e All-llahut xh.sh. Pse do t'a bënin këtë? Shkaqet në vetvete, që në fillim, japin shenja të adhurimit nga njerëzit. Ato pra, duken se japin dhe marrin. Për këtë arsye, ishte e domosdoshme shfaqja e Fuqisë së All-llahut, për t'a përmirësuar këtë mentalitet, sepse në të kundërtën, njerëzimi do t'a kishte humbur rrugën. Mbarë njerëzit, duke e ditur se All-llahu është i vetmi Ai, i cili i jep shkaqet dhe i merr ato, gjithashtu, duke e ditur se ata janë vetëm robërit e Tij, e kuptojnë më lehtë se ai, i cili e lë anash Krijuesin e shkaqeve, dhe adhuron vetëm shkaqet në vetvete, do të jetë i humbur dhe i harruar nga All-llahu xh.sh.

Ne habitemi me njeriun, i cili zotëron shumë gjëra në botë. Posedon pasuri, pozitë dhe pushtet, por nuk ndalet me kaq, sepse përpiqet t'ia marrë pronën dhe pasurinë një personi tjetër, që është më i dobët dhe pa pushtet. Habitemi se, si një njeri i tillë e ul veten, në atë nivel poshtërimi. Atij i nënshtrohen shumë gjëra, ai disponon gjithçka, gëzon pozitë dhe pushtet. Gëzon respekt nga shumë të tjerë dhe nuk i mungon asgjë, që të ishte i afërt dhe i drejtë, me të gjithë.

Ne jemi dëshmitarë të përditshëm, të atyre personave që disponojnë fuqi në mbarë botën. Jemi dëshmitarë të mbretërve që vijnë e shkojnë, të atyre që disponojnë pushtet dhe pasuri. Gjithashtu, jemi dëshmitarë se si, këta që sipër përmendëm, bëhen në pak çaste të varfër apo të poshtëruar, me anën e puçeve, ose në forma të tjera. Këtu, nuk përjashtohen edhe portofolet ministrore, pasi shpesh, shohim se si ata (ministrat), për pak çaste humbin gjithçka dhe përfundojnë duarlidhur nëpër burgje. Kjo ndodh para nesh, në prezencën tonë. Kjo bëhet sa për të na kujtuar paraqitjen e Fuqisë dhe Forcën absolute. Të na përkujtojnë dhe të bindemi se, shkaqet të cilat i japin njeriut

pozitën e mbretit, ose cilindo pozitë në pushtet, janë vetëm dhuratë e All-llahut të Lartësuar, e kurrësesi rezultat i mundit dhe punës së tij personale.

Sikur të dëshironte All-llahu xh.sh., do t'ia largonte ato shkaqe, që kur e kish filluar karrierën. Sikur të ishin vetshkaqe, të krijuara rastësisht nga vetvetja, pra t'a kishin krijuar prej një burimi njerëzor, ato do t'i atribuoheshin atij vetë dhe atij askush nuk do të mund t'ia merrte. Por, përderisa, ato i dalin nga dora, i ikin për një çast dhe shumë lehtë, ky është argument se All-llahu xh.sh., është krijues i tyre dhe vetëm, Ai, ua jep dhe ua merr atyre këto shkaqe.

Shkaqet, nuk duhet kurrësesi, që t'i ngrejmë në pedestalin më të lartë, në botë. Ato janë relative, nga më të thjeshtat deri tek më të ndërlikuarat, ato nuk i mundësohen vetëm një njeriu (apo një shoqërie), e një tjetri jo. Ato i takojnë të gjithëve. Secili prej nesh, është zotëri një ditë prej dite (ndoshta i madh), ose ndoshta edhe është, (Zoti yt nuk të neglizhon dhe nuk të merr për të keq), ndikimi i Tij ndërhyr në ndihmë të të okupuarit të pafuqishëm dhe të pashpresë, kundër okupatorit të fuqishëm dhe të bindur në fuqinë e tij. Ndikon tek njeriu, i cili ka bërë një krim, dhe mendon se do të shpëtojë nga dënimi. Ndikon (tek njeriu) kur mendon se e drejta ka humbur, dhe nuk do të ekzistojë më ndër njerëz, asnjëherë.

I largon pushtetarët okupues, sepse kishin filluar t'a tepronin, duke i përçmuar njerëzit. Këta pushtetarë, i bën një ditë të paaftë, saqë nuk janë në gjendje të shpëtojnë, as veten. Të gjitha këto ndodhi, ose ngjarje të mundshme, gjenden brenda shprehjes 'O Zot', e cila del me ofshamë nga zemra e të shtypurit, i cili e ka humbur shpresën dhe nuk ka as forcë, e as mundësi, t'a largojë të keqen. Kur të tillët kanë ngelur në udhëkryq, dhe nuk dinë si t'ia bëjnë, ndërhyr (ndihma nga)

qielli. (Kjo ndihmë) Është efektive sa për t'a larguar tiraninë, dhe për t'i dhënë hapësirë drejtësisë, për të vepruar. Kjo, bëhet për të ekzistuar barazpesha, në tokë.

Përderisa shfaqja e Fuqisë është prezente dhe vepron në univers, ajo paraqitet mes njerëzve, sa për t'ua përkujtuar atyre prezencën e All-llahun të Lartësuar. Kur okupatori paralajmëron se do të ndëshkojë (të okupuarin) me marrjen e pasurisë, s'do mend se ajo që okupatori kërkon nga i okupuari është një vepër e shëmtuar dhe irrituese, dhe shkakton hidhërimin e All-llahut xh.sh. Nëse në këtë rast, (të okupuarit) i kujtohet prezenca e Fuqisë së All-llahut xh.sh., dhe e di se Ai, është i Vetmi, i cili i jep riskun pa masë, atij që do, dhe situata do të ndryshojë. Njeriut i jepet, vazhdimisht, mundësia që të gjykojë. I jepet mundësia t'a mallkojë armikun dhe t'i mbështetet All-llahut xh.sh., i Cili i jep riskun, dhe i Cili nuk ka kurrfarë pengese për realizimin e atyre (që Ai dëshiron). (O njeri!) Dije se për ty do të hapen ato dyer, të cilat nuk i ke paramenduar dhe nuk i ke ditur ndonjëherë. Dije se do të realizohen për ty, ato ëndrra që dikur i ëndërroje.

Nëse vazhdosh t'i bindesh okupatorit, apo atij që është sipër teje me pozitë apo me pushtet, dhe nëse do të vazhdosh të veprosh sipas dëshirave të tij, vepër me të cilën, do t'a hidhëroje All-llahun xh.sh., përsëri do të shfaqej Fuqia e All-llahut të Lartësuar, sa për t'a përkujtuar prezencën e Tij. Sikur t'a respektoje All-llahun, Ai, mbase, një ditë do të t'a jepte atë pozitë, ose një më të mirë se ajo⁵⁶.

⁵⁶ Shembij më të mirë për ne në ditët tona do të ishin biografitë e Adem Demaçit, Mandelës dhe Millosheviqit shën. i përkthyesit

Nëse ky njeri ka mjete, me të cilat të frikëson për të mos arritur aty ku shpreson, dije se All-llahu i Lartësuar zotëron shumë më shumë se okupatori, vetëm duke e shfaqur Fuqinë, dhe të dhuron mirësi të pamatë. Duhet kuptuar se okupuesi të mashtron, me pasuri ose me pushtet dhe që të dyja ato janë kalimtare, ndërsa shfaqja e Fuqisë së All-llahut, nuk ndikohet prej tyre, dhe as që pengohet nga ndokush, dhe nuk ka forcë që e kushtëzon Atë.

ALL-LLAHU NA PËRKUJTON FUQINË E TIJ

I Lartësuari, nuk e fshehu nga ne, shfaqjen e Fuqisë së Tij. Ai na mundësoi që ne t'a njohim dhe t'a kuptojmë Atë, dhe na e përkujton këtë në shumë vende të Kur'ani Kerimit. Në secilën kapitull të Kur'anit, ka dhënë shenjat e shfaqjes të kësaj Fuqie. Nëse lexojmë thëniet e Tij në Kur'an, do të vërejmë se Ai, thotë: "...e All-llahu, mëshirën e vet ia jep atij, që dëshiron..."⁵⁷, "...e dënon atë, që dëshiron..."⁵⁸, "...e fal atë, që dëshiron..."⁵⁹, "...e udhëzon atë që dëshiron..."⁶⁰, "...e humb atë, që dëshiron..."⁶¹, "...e ngre (i jep pushtet) atë, që dëshiron..."⁶², "...e përul (ia merr pushtetin) atë, që

⁵⁷ Kur'an, 2/ 105

⁵⁸ Kur'an, 29/ 21

⁵⁹ Kur'an, 48/ 14

⁶⁰ Kur'an, 35/ 14

⁶¹ Kur'an, 13/ 27

⁶² Kur'an, 3/ 26

dëshiron..."⁶³, "...ia jep sundimin atij, që dëshiron..."⁶⁴, "...ia merr sundimin atij, që dëshiron..."⁶⁵, "... vërtet, All-llahu është i Plotëfuqishëm për gjithçka..."⁶⁶.

Pra, siç po shohim, i Lartësuari, na ka dhënë mundësi që në këto ajete, dhe me dhjetra ajete të tjera, në Kur'anin Kerim, t'a shohim shfaqjen e Fuqisë së Tij. Sikur t'a lexojmë Kur'anin, do të gjenim shumë e shumë ajete, të cilat na tërheqin vëmendjen në këtë Plotëfuqishmëri, prandaj themi se, i Lartësuari, nuk e fshehu shfaqjen e Fuqisë së Tij ndaj robërve të vet, por përkundrazi, Ai e shfaqti haptazi prezencën e kësaj Fuqie. Ndoshta, thënia e Tij, e shprehur në Kur'anin Kerim: "Vërtet, kur Ai dëshiron të bëjë diçka (mjafton) vetëm të thotë: 'Bëhu' dhe ajo bëhet"⁶⁷ është piedestali i paraqitjes së Fuqisë së Tij absolute.

Të gjitha këto ajete, na përkujtojnë ose na tërheqin vërejtjen, se për All-llahun, nuk ekzistojnë pengesa, që të mund të shkaktojnë mossuksesin e Tij. Ai është krijuesi i shkaqeve dhe ato i krijoi të tilla, që jeta në univers të ketë barazpeshë. Por, kjo barazpeshë e vendosur prej Tij, nuk vlen për Të. Sikur Ai të kushtëzohej, do të na thoshte neve, se kjo punë është jashtë mundësive të Tij për t'a kryer, edhe pse Ai do të dëshironte t'a kryejë, pasi e pengojnë shkaqet e krijuara prej Tij. Duke pasur parasysh këtë, shprehja 'Bëhu dhe ajo bëhet', nuk do të kishte kuptim. Por, realisht, Ai krijoi qiejt dhe tokën dhe ç'ka në të, vetëm me fjalën 'Bëhu'. Gjithashtu edhe krijimi njeriut u

⁶³ Kur'an, 3/ 26

⁶⁴ Kur'an, 2/ 247

⁶⁵ Kur'an, 3/ 26

⁶⁶ Kur'an, 65/ 12

⁶⁷ Kur'an, 36/ 32

bë fjalën 'Bëhu'. I Lartësuar, në Kur'anin Kerim, thotë: "...i jep kujt të dëshirojë vajza dhe, kujt të dëshirojë, i jep meshkuj..."⁶⁸ dhe gjithashtu thotë: "...dhe cilindo, e le steril..."⁶⁹. Urtësia e këtyre thënieve, qëndron pikërisht në ndërhyrjen e pengesave të proceseve natyrore dhe të shkaqeve të tyre. Pra, Ai nëse dëshiron që dikush të ketë pasardhës, e realizon atë përmes bashkimit të mashkullit edhe femrës. Ndërsa, po të dëshirojë t'i pengojë, mjafton që të shfaqet Fuqia e Tij Absolute dhe t'i eliminojë shkaktarët, dhe kë dëshiron e lë steril, pa marrë parasysh bashkimin e mashkullit dhe femrës. Në këtë rast, të gjitha proceset natyrore, stagnojnë sipas dëshirës së Krijuesit.

Kështu, tha i Lartësuar, në Kur'anin Kerim. Nëse ne i kthehemi praktikës, do të shohim se shfaqja e Fuqisë është e qartë. Ai dërgoi peigamberë (paqa dhe mëshira e All-llahut, qoftë mbi të gjithë ata) dhe të gjitha mrekullitë e tyre, kanë ardhur në sajë të shfaqjes së Fuqisë së All-llahut xh.sh., e jo prej shkaqeve të proceseve natyrore. Nuhu a.s., e luti All-llahun xh.sh., për shkatërrimin e pabesimtarëve, dhe uji vërshoi nga poshtë dhe nga sipër, dhe u bë përmytja (vërshimi madh). Ky vërshim, nuk ndodhi nga shkaku i kushteve klimatike dhe proceseve natyrore, por ai ndodhi si pasojë e shfaqjes së Fuqisë së All-llahut xh.sh.

Ibrahimi a.s., u hodh në zjarr, dhe cilësia e zjarrit, sipas proceseve natyrore është djegia, por thënia e All-llahut të Lartësuar: "...O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtues për Ibrahimin..."⁷⁰, bëri që,

⁶⁸ Kur'an, 42/ 49

⁶⁹ Kur'an, 42/ 50

⁷⁰ Kur'an, 21/ 69

në këtë moment, cilësia e djegies së zjarrit të pengohej dhe zjarri iu bind urdhërit të All-llahut xh.sh. Këtu, gjithashtu, kemi të bëjmë me shfaqjen e Fuqisë së Tij.

Kështu ishte edhe me Musain a.s., i cili gjatë gjithë jetës së tij peygamberike jetoi me shfaqjen e Fuqisë, ngase kishte të bënte me gabimet dhe mëkatet e vazhdueshme (permanente) të çifutëve. I Lartësuar, i tha: "...mëshoi me shkopin tënd detit..."⁷¹ dhe deti u nda. Para tyre doli dheu, dhe ujërat i ndërruan veçoritë, një prej veçorive të së cilit është fundosja. Musai a.s., qëndroi i qetë dhe larg nga toka, dhe kjo u bë me Fuqinë e All-llahut të Lartëmadhëruar. Kështu, Musait dhe popullit të tij, iu mundësua të kalonin përtej detit. Kur personi i fundit, nga populli i Musait a.s., kaloi andej, deti u mbyll dhe Faraoni që ishte në atë rrugëtim, për të kaluar detin, u fundos së bashku me ushtrinë e tij. Më pas, vijojnë kërkesat e tjera të Musait a.s. Njëra pre tyre ishte kërkesa për ujë të pijshëm. Atij, i mjaftoi që t'i mëshojë shkëmbit, me shkopin e tij, dhe prej tij të rrodhën dymbëdhjetë burime uji. Kjo ndodhi, vetëm në sajë të të mëshuarit me shkop. Prej atij shkëmbi, nuk rrodhi vetëm një burim uji, por, për secilën familje rrodhi nga një burim, e ata ishin dymbëdhjetë. Gjithashtu, kemi edhe ngritjen e kodrës, edhe rastin e lopës, që me anën e një pjese të mishit të saj, i ranë kufomës së një të vdekuri dhe i vdekuri u ngjall, sa për të treguar se cili ishte vrasësi i tij i vërtetë.

⁷¹ Kur'an, 26/ 63

AJO PËR MUA ËSHTË E LEHTË

Për të gjitha këto mrekulli, nuk mund të thuhet, se kemi të bëjmë me shkaktuesit e proceseve natyrore. Padyshim, ato kishin të bënin me shfaqjen e Fuqisë, pasi kur Ai, thotë: 'Bëhu', ajo bëhet. Gjithashtu, kemi rastin e shfaqjes së Fuqisë, tek Zekerijau dhe tek Merjemja (All-llahu qoftë i kënaqur me këta dy). Zekerijau e luti All-llahun t'i falte një djalë.

"E thirrën atë melekët, kur ai po qëndronte duke u lutur në këmbë, në Mihrab⁷² (e i thanë): All-llahu po të përgëzon me (një djalë) Jahjanë..."⁷³.

Gjithashtu, kemi edhe thënien tjetër, që e vërteton këtë:

"O Zekerija, Ne të përgëzojmë me një djalë që do të mbajë emrin Jahja, ndërsa Ne, më parë, nuk kemi emëruar me këtë emër"⁷⁴.

Në momentin, kur Zekerijau e mori përgjigjen prej shfaqjes së Fuqisë, ai u rrëqeth. I hutuar e pyeti All-llahun, se si mund të ndodhte kjo, kur ai ishte i shtyrë në moshë dhe gruaja e tij ishte shterpë. Nëse, do t'iu përmbaheshim rregullave të shkaqeve të proceseve natyrore, ai nuk mund të kishte fëmijë. Duke u ditur fare mirë moshën dhe gjendjen e gruas së tij, atij i kthehet përgjigja nga i Lartësuari: "...kjo për Mua është e lehtë, të kisha krijuar më parë edhe ty, kur ti nuk ishe

⁷² Mihrab - vend i veçantë në xhami

⁷³ Kur'an, 3/ 39

⁷⁴ Kur'an, 19/ 7

asgjë"⁷⁵. I Lartësuar i ia përkujtoi Zekerijasë Fuqinë e Tij, se për Të, asgjë nuk është e vështirë. Tek Ai, nuk ndikon asnjë rregull prej proceseve natyrore. Atë, që Ai dëshiron t'a bëjë, e bën pa futur në llogari shkaqet. Nëse, pra kjo, për ty o Zekerija, është e vështirë për t'a kuptuar, atëherë, përkujto disa çaste të krijimit tënd: "...të kisha krijuar më parë edhe ty, kur ti nuk ishe asgjë". Nëse, Unë kam pasur mundësi që të krijoj prej hiçit, vallë, a nuk mund të krijoj pa ndonjë shkak, prej diçkaje?!

Kur Zekrijau hynte në faltoren e Merjemes, në veçanti, kur shkonte në Mihrab, aty gjente risk të ndryshëm, bile gjente edhe fruta, që nuk ishin të stinës, ose nuk i kishte parë fare gjatë jetës së tij. Ai, e pyeste Merjemen: "...prej nga këto, tek ti (oj Merjeme)..."⁷⁶, kush po t'i sjell këto ushqime ose këto fruta? Përgjigja e saj: "...këto janë prej All-llahut, vërtet, All-llahu i furnizon kënd të dëshirojë pa masë (pa llogari)", i jepte shenjë shfaqjes së Fuqisë tek ajo, Fuqi e cila nuk parandalohej në asnjë mënyrë.

Gjithashtu, krijimi Ademit a.s., është bërë nga paraqitja e kësaj Fuqie. I Lartësuar i, e krijoi atë prej asgjëje, ndërsa Havanë e krijoi prej Ademit a.s. Krijoi femrën prej mashkullit pa femër, krijoi njerëzit me bashkimin e mashkullit dhe të femrës. Për t'u rrumbullaksuar etapat e krijimit, kishte ngelur edhe krijimi i mashkullit nga femra, pa prezencën e mashkullit. Ky krijim, u plotësua, me rastin e lindjes së Isaut a.s., birit të Merjemes.

⁷⁵ Kur'an, 19/ 9

⁷⁶ Kur'an, 3/ 37

Nëse transferohemi tek ndodhitë e Isra-së dhe Miraxh-it, do të shohim shumë e shumë mrekullira të mëdha, që kanë për qëllim të tregojnë se si shfaqet Fuqia. Muhammedi a.s.v.s., kishte udhëtuar nga Mekka deri në Kuds⁷⁷, atje u fali namazin dhe u bë imam i peygamberëve.

Është prezantim i Fuqisë së All-llahut që, i gjalli t'ua falë namazin, të gjithë peygamberëve, që kishin ndërruar jetë, që prej disa shekujsh. Ishte shfaqja e Fuqisë, kur ai shpërtheu orbitat, kaloi sferën e tokës drejt qiellit të shtatë, pra, deri në Sidretul al Munteha. Të gjitha këto, ishin prezantime, të cilat i ndryshonin proceset natyrore, që i Dërguari i All-llahut s.a.v.s., të mundej të falej në Sidretu al Munteha.

Kjo dhe shumë të tjera, sikurse edhe vetë revelata, janë shfaqje e Fuqisë së All-llahut të Lartëmadhëruar. Ai, i Lartësuar nuk na i prezantoi të gjitha këto Fuqi, pa na treguar edhe shembujt, se si ato duheshin të praktikohen. Atë, e bëri duke na dërguar peygamberët e Tij. Ata i mbështeste, duke u ofruar mundësinë e veprimit me këtë Fuqi. Këta peygamberë, duke treguar mrekullitë e tyre, i afronin besimtarët.

Shfaqja e Fuqisë së All-llahut xh.sh., nuk është reveluar vetëm tek peygamberët, ajo është prezente vazhdimisht, dhe është me ne, gjatë gjithë jetës sonë të përditshme. Nëse duam t'a shikojmë shfaqjen e Fuqisë, në një prej vendeve ose krijesave të botës, do të kishim marrë, si shembull, thënien e All-llahut xh.sh., në Kur'anin Kerim: "Vërtet, All-llahu nuk turpërohet të sjellë shembull mushkonjën, ose diçka mbi të (më të vogël se ajo). Ata të cilët besojnë, e dinë se ajo e vërtetë është prej Zotit të tyre, ndërsa ata, të cilët nuk besojnë do të thonë: cili ishte qëllimi i All-llahut

⁷⁷ Kuds i thonë arabët qytetit që evrpianët dhe çifutët e quajnë Jerusalem

(që na solli) me këtë shembull, (Ai) me këtë po e devijon shumëkënd, gjithashtu, po e udhëzon shumëkënd, por Ai nuk e devijon, me të, askënd (nga rruga e drejtë), përveç ngatërrestarëve (pabesimtarëve të pabindur)."⁷⁸

Nëse ndalemi vetëm pak, në këtë ajet, do të shohim se All-llahu i Lartëmadhëruar, ka sjellë për ne, si shembull, mushkonjën. Ky shembull këtu, i gjason të gjithë shembujve të tjerë të Kur'anit Kerim. Ato nuk janë sjellë së koti, por secili shembull, ka në vetvete, një urtësi shumë të madhe. Kur Ai solli këtë shembull, pabesimtarët patën thënë: Cili ishte qëllimi i këtij shembulli!? Ne, asgjë, nuk po kuptojmë. Në këtë rast, i Lartësuari, dëshiroi të na sjellë, si shembull, këtë krijesë të vogël, por, shumë precize. Përmendja e krijimit të mushkonjës bazohet në imtësinë e saj, por (edhe pse, një krijesë aq e vogël) ajo kryen punë shumë të rëndësishme, gjatë jetës së saj. Vetë preciziteti i krijimit të saj jep përgjigjen e Krijuesit, se vërtet, Ai është Krijues. Mushkonja është shumë e vogël në trup, por ajo disponon të gjitha elementet që janë të domosdoshme për jetë, bile, kemi krijesa edhe më të vogla se ajo. Ato, janë më të vogla, dhe më precize në krijim, se sa vetë mushkonja. Ai, i Lartësuari, ua plotësoi të gjitha kushtet, për t'a vazhduar jetën e tyre, të paraparë prej Tij.

Mos e neglizhoni Krijuesin

Edhe këtu, gjithashtu kemi urtësi të madhe. I Lartësuari dëshiroi të na informojë, që mos t'i neglizhojmë krijesat precize, edhe pse janë të vogla nga pamja. Sa më i madh të jetë preciziteti i krijimit të krijesave të imta, aq më e madhe është rëndësia e veprimeve të tyre. Formimi i

⁷⁸ Kur'an, 2/ 26

krijesave, me përmasa më të mëdha, nuk do të thotë se ato janë edhe të fuqishme. Nëse përqëndrohemi në këtë teori, le të kthehemi tek fillimi i krijimit. Historia na ka mësuar se, miliona e miliona vjet më parë, kanë jetuar disa kafshë gjigante, që quheshin dinosaurë, të cilët nuk qenë në gjendje t'i bëjnë ballë epokës së akullnajave, atëherë kur ajo e kish kapluar tërë rruzullin tokësor. Këto gjallesa gjigante, të cilat e dridhnin tokën, nuk ishin në gjendje t'u bënin ballë ndryshimeve klimatike. Ndërsa, pleshti dhe mushkonja, i mbijetuan ato kohëra, deri në ditët e sotme. Duke i komentuar këto dukuri, shkencëtarët kanë vënë në pah se, krijesat gjigante ishin mendjelehta, nuk ishin në gjendje të parapërgatiteshin për ndryshimet e ambientit, dhe për këtë arsye u zhdukën. Ky është komentimi shkencor, ndërsa komentimi imanor thotë: All-llahu xh.sh. dëshiroi të na informojë se, madhësia ose forca nuk është elementi kryesor i qëndrueshmërisë, por ajo që e bën të fuqishëm është mundësia e të bërit të fuqishëm.

Edhe pse, në këto kohëra, kemi superfuqi gjigante, që mendojnë se toka do të sundohet prej tyre, dhe gjithçka do të marrë fund përgjithmonë, shohim se shfaqet Fuqia e All-llahut xh.sh dhe i shkatërron ato. Shikojmë të kundërtën e kësaj superfuqie gjigante, e cila, në shikim të parë, të jep ndienjën e dobësisë, sepse është e vogël dhe, të cilën, nuk e sheh as syri, si p.sh. virusin. Ato (viruset), edhe sot, askush nuk mund t'i shohë për nga madhësia, por ato janë shumë preçize dhe janë shumë më të fuqishme se elefantët, luanët, mendja njerëzore, mbase, edhe se mbarë krijesat e botës. Ato, i sfidojnë të gjithë këta që përmendëm më lart, pasi deri më tani, të gjitha ato janë të paafta t'iu bëjnë ballë atyre. Ato jetojnë prej miliona e miliona vjetësh, edhe pse janë me një madhësi aq të vogël, sa thuajse nuk duken se ekzistojnë fare. Këta virusë, janë në gjendje, që shumë shpejt, të shkatërrojnë një popull të tërë. Kemi shoqëri, që pretendojnë se kanë potencial të fortë njerëzor, por nëse, i Lartësuar i jep fuqi këtyre virusëve, që nuk vërehen, të përhapen në

forma të epidemive të ndryshme midis njerëzve të asaj shoqërie, do të shohim se të ‘fuqishmit’ s’do të rezistojnë aspak. Këtu All-llahu xh.sh. e prezanton Fuqinë e Tij, me anë të këtyre krijesave, të cilat janë aq të vogla, thujase inekzistente, por që posedojnë fuqi aq të madhe, sa të shkatërrojnë më të fuqishmit në botë, duke mos u dhënë mundësi të ‘fuqishmëve’ të rezistojnë aspak. Pas kësaj, mendoj se duhet do të besojmë se, Fuqia është vetëm e All-llahut të Lartëmadhëruar.

Ajo, nuk mund të krahasohet me fuqinë tonë, edhe pse ne mendojmë se nuk ka forcë në botë, që mund të na mposhtë. Ja pra, disa krijesa të All-llahut, që janë shumë të vogla dhe preçize, kanë fuqi shkatërruese që ta na asgjësojnë për disa orë. Por, për këtë, nevojitet caktimi i All-llahut xh.sh., sepse njerëzit herë pas here mashtrohen, dhe atyre iu duhet përforcuar imani (për të kuptuar) se pa Fuqinë e All-llahut xh.sh., dhe mbështetjen e Tij, nuk vlejme asgjë.

Të gjitha këto të dhëna, nga i Lartësuari, janë përkujtim për ne dhe secila në vetvete ka urtësi të lartë. Ai na tregoi (me qëllim) që ne t’a ngrejme nivelin e njohjes së shfaqjes së Fuqisë, në mënyrë shkencore. T’a njohim atë në praktikë, në të folur dhe në vepra, derisa imani ynë të mbushet përplot besim, tek ata individë që besojnë bindshëm në Fuqinë e All-llahut, dhe që nuk i frikësohen, e as nuk ç’orientohen, kur ju paraqiten shkaqet shkatërrimtare.

Pika e parë e urtësisë së lartë, është shfaqja e Fuqisë. Ky është besimi në ekzistencën e All-llahut xh.sh., sepse shkaqet, me të besuar në ekzistencën e Tij, përfundojnë. Ky iman është ai, i cili e bën njeriun besimtar, e bën të qetë, dhe nuk e lë të hamendet, sepse i Lartësuari do t’i largojë prej tij mëdyshjet në momentet më kritike të jetës së tij. Shtetet materialiste, thuajse ateiste, që nuk i pranojnë në mesin e tyre besimtarët, janë të kalbura. Tek ata është përhapur fobiomania dhe dëshprimi në jetë. Ata, jetën administrative e kanë rregulluar mirë, kanë përparime të dukshme,

por e kanë humbur besimin kolektiv. Çdo individ, jeton në dëshpërim të dukshëm, dhe shpesh ndodhin vetëvrasje. Përse ndodh, e gjithë kjo? Kjo vjen për arsye se secili materialist, beson tek shkaqet, pa shkaktarin. Këta besojnë në fuqinë njerëzore, duke mos e njohur Fuqinë Absolute të All-llahut xh.sh. Kur dikujt i ndodh që t'a largojnë nga puna, ai nuk mendon se, nëse iu mbyll një derë, All-llahu do t'i hapë atij, disa dyer të tjera. Atij, nuk i shkon mendja të thotë se, ky ishte një provim për të, dhe se pas çdo vështirësie ka lehtësim. Gjithashtu, ai nuk mendon të thotë, se Ai, të cilit i besoj dhe se Ai, që e adhuroj, nuk do të më lerë kurrë vetëm. Kështu duhet të jetë logjika e besimtarit. Ndërsa logjika e materialistit fillon duke fyer dhe duke e parë botën të errët. Atij i duket se i janë mbyllur të gjitha dyert, para tij nuk gjenden opsionet e hapjes së dyerve të reja. Atij i duket se çdo gjë përfundoi. Ai, duke qenë se e ka kapluar pesimizmi, i humb shpresat në mëshirën e All-llahut dhe përfundimet, në të shumtën e rasteve, i gjejnë në vetvrasje ose çmenden. Pse? Ai këtë e bën sepse beson se njeriu është ai, i cili ia mbylli derën dhe ai është çelsi i hapjes së dyerve të reja. Përderisa ai ia mbylli të gjitha ato dyer, atij nuk mbetet shpresë tjetër sepse, i Lartësuar, për të, është “kot fare”.

Nëse, materialisti sëmuret nga një sëmundje e pashërueshme, ai i humb të gjitha shpresat për të ardhmen, dhe nuk beson në stagnimin e shkaqeve dhe në mëshirën e All-llahut, i cili nuk e lë vetëm. Ai nuk mendon se Ai, do t'a shërojë, ose të thotë se All-llahu xh.sh., ka mundësi që t'a shërojë, qoftë edhe nëse të gjitha shkaqet janë kundër tij. Fatkeqësisht, përderisa nuk beson në ndërhyrjen hyjnore, ai, ato ditë, të cilat i kanë ngelur, i sheh të mjerueshme dhe të errëta.

Shpëtim për besimtarët

I Lartësuar, dëshiron që besimtari të shpëtojë nga kjo jetë e mundimshme dhe të kalojë në jetën (tjetër) më të mirë. Jeta tjetër, nuk ka mundime, atje njerëzit nuk lodhen nga obligimet e tyre materiale. Në të, është mëshira e All-llahut xh.sh., sikurse mëshira që iu dhurua Ismailit a.s., kur ai ishte foshnje. Kur, ai i mëshoi tokës me thembrën e tij të vogël, buroi uji i Zem-zem-it. Kjo ndodhi pasi që, e ëma e tij kishte vrapuar shtatë herë, nga kodrina Safa deri në kodrinën Merva. Ajo përpiquej të gjente ndonjë burim uji ose vetëm ujë. Kur ajo i humbi shpresat, në këtë moment, u shfaq Mëshira e All-llahut xh.sh., dhe nga një e mëshuar e tokës, nga këmba e vogël e foshnjes, shkëmbi u ça dhe buroi uji.

Ishte kjo, një prej muxhizeve (mrekullive), prej së cilës, i Lartëmadhëruari, dëshiroi që edhe ne, sot, t'a shohim dhe t'a përjetojmë. Nëse ndalemi para proceseve natyrore dhe kësaj ndodhie të madhe, habitemi! Për këtë arsye, i Lartësuar, në një prej ajeteve të Tij, në Kur'anin Kerim, na thotë: “Kush tjetër i përgjigjet thirrësit të detyruar, kur ai bën lutje...”⁷⁹ Nëse mbështetetmi në këtë ajet, do të shohim se i Lartësuar e ka përdorur fjalën ‘i detyruar’. I detyruar, është ai, i cili ka ngelur në mes të rrugës, dhe nuk di nga t’ia mbajë, për shkak se, për të, të gjitha rrugët e proceseve natyrore, që ai kërkon, i janë mbyllur, pra kur atij nuk i funksionon asnjë prej proceseve natyrore. I Lartësuar, na përkujton duke na thënë se, edhe në këso rastesh, mos i humbni shpresat në mëshirën e All-llahut xh.sh., mos mendoni se çdo gjë mori fund. Por, ajo që duhet të bëni është të ngrini duart drejt qiellit dhe, nga thellësia e shpirtit, të thoni: ‘O Zot’. Në ato momente do t’iu hapen dyert e qiellit dhe do të ndërhyjë Fuqia, për t’iu realizuar ato që dëshironi.

⁷⁹ Kur'an, 27/62

Kjo nuk është diçka e panjohur për ne, në jetën tonë të përditshme. Asnjë fjalë, nuk nxirret ashtu së koti, patjetër se kemi pasur ndodhira të këti lloji në jetë. Nëse e kthejmë shiritin e jetës sonë të kaluar, secili prej nesh, do të gjejë se edhe tek ai është shfaqur Forca. Sa prej nesh, kemi mbetur pa zgjidhje, ose rrugëdalje në jetën tonë. Ndoshta, dikujt prej nesh i ka ndodhur të mos flejë me netë të tëra, i hutuar dhe i preokupuar. Sa herë është rrotulluar në shtrat, duke i ndërruar planet, por përsëri nuk ka pasur rezultat. Pas një kohe relativisht të shkurtër, papritmas, befasohet, përnjëherë i ndryshon fytyra. Çdo gjë, tek ai, ka ndryshuar sepse i është hapur një derë apo një deriçkë, prej nga se ka pritur fare. E gjen zgjidhjen përnjëherë, dhe thotë me vete, se sa e lehtë paska qenë. As që e kishte menduar ndonjëherë, se zgjidhja mund t'i vinte në atë formë. Besoj, se secili prej nesh ka kaluar nëpër këtë përvojë.

Secili prej nesh, e ka parë shumë herë dhe e ka përjetuar shfaqjen e Fuqisë së All-llahut xh.sh. Na është larguar e keqja, që ne nuk kemi pasur kurrëfarë shanse për t'a larguar atë vetë, me mundësitë tona, ose kemi zgjidhur ndonjë problem, që logjika jonë na thoshte se ishte i pamundur. Kjo shfaqje e Fuqisë, na ka sjellë diçka, që kurrë se kemi ëndërruar. Pa dyshim, se të gjithë ne, kemi përjetuar të tilla gjëra.

Me këtë, i Lartësuari, dëshiroi që t'ia i mbushë zemrën, me Rahmetin e tij, atij që ka pak iman në zemër, duke e liruar nga vështirësitë e jetës. Kjo sasi e pakët imani, është shpresa e lidhjes midis robit dhe All-llahut xh.sh. është shpresa, e cila nuk duhet të fiket asnjëherë. Në raste të tilla, besimtari e ndien veten se të gjitha vështirësitë, që mund t'i dalin, mund t'ju bëjë ballë dhe mendon se, nuk kanë se çfarë mund t'i bëjnë. Atë, nuk e mbron asnjë sigurim, e as ndonjë garanci njerëzore. Pse? Sepse ai, përkujton thënien e All-llahut të lartësuar "...kjo për mua është e lehtë...".

Vështirësitë, sado të mëdha qofshin ato, për All-llahun xh.sh., janë të lehta. Ato, i nënshrohen All-llahut të Lartësuar, prandaj besimtari nuk ndien në shpirtin e tij demoralizim, e as nuk e shkatërron jetën e tij deri në çmenduri, ose vetëvrasje. Mbase, argumenti më i mirë për njerëzimin, është rasti i çmendurive dhe vetëvrasjeve në shtetet materialiste. Kjo, tek ta, fatkeqësisht është në rritje, ndërsa në shtetet fetare, ka rënie të vazhdueshme. Kjo dukuri, tek besimtarët, vjen si rezultat i jetës së mirë, që All-llahu u ka dhuruar robërve të Tij.

Pika e dytë, e shfaqjes e Forcës, do të na shpjegojë neve se, cilat janë ndodhitë e gjësendeve në univers, që nuk i pranon ligji i proceseve natyrore. Ne e jetojmë një jetë, të cilën e administrojnë, përveç proceseve natyrore, edhe ligjet e shfaqjes së Fuqisë. Shohim se si, ndonjëherë, njeriu posedon shumë prej arsenalit të forcës, gjë që ia ka mundësuar jeta e ligjeve të proceseve natyrore. Ndodh që ai të ketë ushtri, polici, mbase edhe aparatin shtetëror, ndërsa në anën tjetër, kemi njeriun e rëndomtë dhe të dobët. Kur këta dy, përballen njëri me tjetrin, befasonemi kur e shohim se, ai i forti spostohet nga vendi, dhe vendin e tij e zë ai i dobëti. Kjo ndodh edhe në jetën tonë të përditshme. Sikur të ishin vetëm proceset natyrore, ato që do t'a administronin botën, atëherë kjo nuk do të mund të ndodhte. Por ja që, proceset natyrore janë rregulla më vete, ndërsa shfaqja e Fuqisë është diçka krejtësisht tjetër.

Nëse, tani, kthejmë vështrimin tek popujt e vetëshpallur pabesimtarë, p.sh. sikurse ata të Bashkimit Sovjetik,⁸⁰ do të vërejmë se si, ata, dalëngadalë janë duke u shkatërruar. Ndodh që, në një vend, të kemi shkatërime marramendëse brenda njëzet e katër orëve, por ndodh, nganjëherë, që ato të ndodhin për një periudhë më të gjatë. Bashkimi Sovjetik, më parë, ishte hambari i

⁸⁰ (libri është botuar në origjinal në vitin 1985 shën. i përkth.)

drithrave në botë. Vetëm Ukraina do t'i mjaftonte Bashkimit Sovjetik, bile edhe i tepronte shumëfish. Por, fatkeqësisht, tani bereqeti tyre ka pësuar një rënie të tmerrshme, deri në atë masë sa, Bashkimi Sovjetik ka filluar të importojë sasira të mëdha drithërash, nga jashtë. Atje, tani, nuk e gjen as edhe një copë buke të hedhur. Të këtij niveli të njëjtë, janë të gjitha vendet ateiste, ato janë plot mjerim dhe katastrofa. Ata nuk kanë kurrfarë sigurie, e as garancie. Iu është ngushtuar edhe risku. Për ta, bollëku, është një ëndërr e dikurshme, ai tani është inekzistent. Ata, tani i ka kapluar stërmundimi, dhe po e mallkojnë kohën, në të cilën jetojnë. E gjithë kjo ndodh, nga mosnjohja e shfaqjes së Forcës, pa ndonjë shkak të proceseve natyrore. Ka pasur raste kur, në këto vende, kanë ndodhur reaksione të kundërta. Këto shtete (popuj) projektonin, sikurse edhe të tjerët, projekte të ndryshme për të ardhmen. Sipas tyre, ata jepnin shifra shumë të mëdha për rendimentet që do t'i prodhonin, por ndodhte e kundërta e planifikimeve të tyre. E gjithë puna fizike dhe mundi projektues, ju shkonte bosh. Atyre, u ngelej, vetëm sa për kafshatën e gojës. 'Aty ku thonë se ka dredhëza, mere me vete shportën e vogël'.

Pas gjithë kësaj që thamë, mendojmë se, shfaqja e Fuqisë së All-llahut xh.sh. mbetet e vetmja garanci e vërtetë. Ajo bën që, çdo gjë përreth saj të ndryshojë; shtetet e mëdha që nuk ju perëndon dielli, të humbin fare, bile disa shteteve t'u fshihen edhe emrat nga hartat gjeografike të botës. Popujt mbetin ashtu, ato nuk ndryshojnë, gjithashtu forcat mbeten në vend, ato nuk ndryshojnë, i vetmi që i bën të ndryshojnë është i Lartësuari All-llah.

Çdo gjë ka lindjen e vet

Çdo gjë që ekziston në univers ka lindjen e vet. Kjo është pika e tretë, që ka të bëjë, gjithashtu, me shfaqjen e Fuqisë së All-llahut xh.sh. I Lartësuari, secilës gjeneratë, i zbulon disa prej

sekreteve, që nuk ua kishte zbuluar gjeneratave të mëhershme. All-llahu xh.sh., secilës gjeneratë, gjithnjë ia jep mundësinë të zbulojë gjëra të reja. Nëse e shtjellojmë këtë pikë më shtruar, do të themi se, shumë prej njerëzve, nuk janë në gjendje t'a kuptojnë komentimin e ajetit të madhërueshëm: “ ...e kur të sëmurem, Ai më shëron...”⁸¹. Disa njerëz, qëllimisht, nuk shkojnë tek mjeku, sepse duan t'a praktikojnë këtë ajet kur'anor. Ndërsa, shumë të tjerë, mendojnë se shërimi vjen prej duarve të mjekut. Por, një gjë duhet të dihet mirë, se secili shërim ka exhelin⁸² e vet. Kur të vijë exheli ose koha e caktuar, mjeku i mundësohet t'a zbulojë sëmundjen e pacientit të tij. Kur atij i vjen koha e shërimit, mjeku i cakton pacientit të tij ilaçin e duhur dhe sëmundja shërohet. Sipas traditës sonë, njeriu, zakonisht preferon të vizitohet tek mjeku specialist, mundësisht tek më i miri se të tjerët, dhe që, normalisht, duhet të ketë edhe famë të lartë në shoqëri. Ndodh, shpeshherë, që mjeku të mos ketë sukses me pacientët e tij. Ndodh që i njëjti pacient, të shkojë te një mjek i ri dhe pa përvojë të madhe, ose ndryshe, tek një mjek fillestar, por, barërat që ia cakton ai, qëllojnë që t'a shërojnë atë. Kur vërtetohet se, ai pacient u shërua nga ky mjek, habitemi. Kjo ndodh se, kanë ndryshuar shkaqet. Do të ishte normale dhe në rregull sikur, pacienti t'a gjente shërimin nga mjeku specialist dhe me përvojë, dhe jo nga mjeku fillestar ose nxënësi i profesorit, që nuk arriti t'ia gjejë sëmundjen. Këto janë proceset tokësore, por realiteti, ose ajo se çfarë ndodhi, çfarë ne dëshmojmë, çfarë ne njohin që të gjithë, është e kundërta e saj. Është logjike se, dituria dhe përvoja e nxënësit nuk mund të jetë më e madhe se e profesorit të tij, por ajo se çfarë ndodhi ishte 'koha e shërimit'. Atij i ishte afuar koha, dhe All-llahu ia lehtësoi atij sëmundjen me mjekun, që diti t'ia japë ilaçin në atë kohë. Por, ndodh që ai të shërohet, edhe sikur të mos

⁸¹ Kur'an, 26/80

⁸² Exhel - kohen e caktuar

shkonte fare te mjeku. Njerëzimi, këtë e quan “rastësi”. Mund të ndodhë që, i sëmuri të takohet me mjekun, që do të bëhet shkaktar i shërimit të tij, në një vend, ku nuk është spital, p.sh. në ndonjë gosti, tren, etj. dhe aty të hapet tema e sëmundjeve të ndryshme, dhe mjeku tregon se është mjek (me profesion) dhe, fare qartë dhe pamund, ai ia jep diagnozën të sëmurit, si edhe ilaçin me të cilin do të shërohej.

Me këtë, All-llahu xh.sh., dëshiroi të na bindë ne, si krijesa, se çdo zbulim e ka lindjen e vet tek All-llahu xh.sh., dhe gjendet në Dijen e Tij. Kur të vijë koha e zbulimit së diçkaje, ajo ose do të ndeshet ‘rastësisht’, ose për atë zbulim bëhen mundime dhe sakrifica të mëdha, ose në forma të tjera, të cilat i shpalos, apo i zbulon për ne, All-llahu xh.sh. Nëse nuk rastisin t’ua zbulojnë atëherë, i Lartësuar, do t’ua zbulojë atyre, edhe në rastet, kur ata janë duke hulumtuar diçka krejtësisht tjetër. Prej këtyre rasteve kemi shumë. Ndodh që dikush është duke hulumtuar diçka, por krejt rastësisht zbulon diçka tjetër, të papritur dhe papasur kurrëfarë njohurie për të.

Në botë, ndodhin edhe zbulime që as nuk ishin imagjinuar. Ato ndodhin në forma që ne i quajmë ‘të rastësishme’. Sikur të kishim regjistruar zbulimet shkencore dhe çfarë ka ndodhur me to, do të kishim konstatuar se shumica e zbulimeve janë rezultat i ‘rastësive’, sepse, në realitet, ato zbulime nuk kanë qenë ‘caku i hulumtimeve’.

Zbulimet, shpeshherë kanë ndodhur në këtë mënyrë. Kur afrohet koha e zbulimit së një diçkaje, All-llahu xh.sh. ia jep këtë zbulim dikujt, si shenjë dhurate, por në formë indirekte. Ndonjëherë, Ai, e bën këtë përmes shkaqeve të proceseve natyrore. Ndonjëherë, (ky zbulim) i teket mendjes njerëzore “rastësisht”, ose për një moment, ose në forma të ndryshme, quajini si të doni.

Pika e katërt, e shfaqjes së Fuqisë është imani, i cili është baza dhe themeli i besimit dhe ndihmës. Ai, i cili nuk beson në shfaqjen e Fuqisë, ai nuk mund të besojë edhe në sekretet. Njeriu pabesimtar, ose ai i cili refuzon ekzistencën e All-llahut xh.sh., përqëndrohet vetëm në shkaqet e proceseve natyrore. Ai beson vetëm atë çfarë sheh para vetes, ndërsa atë që nuk e sheh para vetes, ai e përgënjeshtroi. Kur flitet për xhennetin dhe xhehennemin, për shpërblimin dhe dënimin, ose për ato gjëra që ju janë premtuar besimtarëve, ai tallet. Ndërsa, ai, i cili është besimtar dhe beson në shfaqjen e Fuqisë së All-llahut xh.sh., e beson dhe e kupton se në xhennet ekzistojnë gjëra që syri nuk i ka parë, veshi nuk i ka dëgjuar, e as që është drithëruar zemra e njeriut. Që të besojmë ahiretin, Fuqinë e All-llahut xh.sh., ringjalljen e të vdekurve dhe që të besojmë në ato gjëra, për të cilat kemi informacione nga All-llahu xh.sh., që kanë të bëjnë me jetën e përtejme, duhet të besojmë dhe t'a dimë se All-llahu xh.sh., nuk ka kufij, e as rregulla që mund t'a kufizojnë, apo t'a pengojnë Atë.

Ne, Atij, kurrësesi nuk mundemi t'a parashtrojmë pyetjet: A mundet? E pamundur?! Përderisa na ka premtuar, dhe premtimi i Tij është i vërtetë, ajo do të realizohet, e Ai, vërtet, është në gjendje të na sjellë përpara, ato gjëra që syri nuk i ka parë dhe veshi nuk i ka dëgjuar. Ai, është në gjendje që njeriut t'i japë mirësi të amshueshme dhe, gjithashtu, mundime të amshueshme. Ai, është në gjendje t'i regjistrojë të gjitha veprimet e njerëzimit dhe ato t'ua paraqesë atyre, Ditën e Gjykimit. Të gjitha këto, nuk i nënshtrohen rregullave dhe shkaqeve të proceseve natyrore, por i nënshtrohen shfaqjes së Fuqisë, që është në kujdesin e All-llahut xh.sh., dhe që Ai na e argumenton atë, me fjalë dhe me vepra. Këtë realitet, e ka futur në përditshmërinë tonë. Ne jetojmë në sajë të shfaqjes së Fuqisë, për arsye se me të, Ai, na bën që imani ynë të shtohet. Kjo ndodh për shkak se, Ai na mëson sekretet e botës dhe ato që na fshihen. Kur ne gjendemi para

një fakti të kryer, në të cilën ishte prezent shfaqja e Fuqisë, por që këtë ndodhi, logjika e shëndoshë nuk e kupton se si u krye, atëherë, në këto raste, neve na shtohet imani tek All-llahun xh.sh., i Cili qëndron mbi të gjitha fuqitë mendore.

Themeli i Imanit

Ky është një realitet, me të cilën duhet të kemi shumë kujdes. Shfaqja e Fuqisë, është bazë shumë e fortë e besimit. All-llahu i Lartësuar, na ka informuar për gjithçka rreth saj, edhe pse është një prej gjërave të fshehta, dhe ato po na zbulohen, gjeneratë pas gjenerate. Kjo formë, ndikon thellë në shtimin e bindjes në Fuqinë e All-llahut dhe, me të, na shtohet respekti dhe respekt-nënshtimi ndaj Tij. Çdo ditë e më shumë, po rritet njohuria e “sekreteve”, që kanë ekzistuar në univers, por që ne nuk kemi ditur agjë, më parë, për to. Këto gjëra, na japim të kuptojmë se, në të shumtën e rasteve, ishin mendime të gabuara që ekzistonin ndër ne, se ishin shkenca tokësore.

Sikur ne të zbërthenim ato, që na u zbuluan nga All-llahu xh.sh., prej sekreteve të gjithësisë, do t’a kishim gjetur këtë gjeneratë më me shumë besim dhe drotje në All-llahun xh.sh., se gjeneratat e kaluara. Këto kanë arritur të kenë pranë vetes më shumë sekrete dhe kështu do t’a kishin njohur më mirë Fuqinë e Krijuesit dhe Mundësitë e Tij. I Lartësuari për këtë thotë: “...derisa toka t’a merr bukurinë e saj dhe të zbukurohet mirë, ndërsa banorët e saj mendojnë se janë zotëruesit e saj, (atëherë) ju vjen urdhëri Ynë, natën ose ditën...”⁸³

Kuptimi i këtij ajeti fisnik ishte paralajmërues se, All-llahu xh.sh do t’ia zbulojë sekretet qenies njerëzore, për t’ua bërë me dije precizitetin e Krijimit të Tij dhe mënyrën si do t’i gjykojë krijesat e

⁸³ Kur’an, 10/24

Tij. Por, njerëzit nuk i morën këto shpjegime në këtë formë. Ata u vetëmashtruan, duke pretenduar se ata ishin shpikësit e atyre zbulimeve. Ky mashtrim bëri që ata të mendojnë se kanë arritur dituritë, me të cilat kishin tanimë forcën për të sunduar çdo gjë në tokë. Në këso rastesh, arrin gjykimi i All-llahut dhe do të ndodhë kataklizma. I Lartësuari e ka përdorur shprehjen ‘supozojnë-mendojnë’ për një urtësi të lartë. Kjo është se, i Lartësuari ishte Ai, i Cili e nënshtroi çdo gjë, që ka në univers për njeriun, dhe ishte Ai që ia zbuloi krijaturës së Vet këtë gjithësi.

Por është habitëse, se njeriut në vend që t’i shtohet besimi dhe të bëhet falenderues, ai ia atribuon vetes lëvdatat. Kjo nuk është e vërtetë, por shprehja ‘supozuan’, nënkupton se sa më shumë njeriu të përparojë, aq më shumë ai do të besojë se kjo ishte dhunti prej diturisë personale, dhe do të supozojë se vetë personaliteti i tij ka arritur, që ato t’i nënshtrohen atij. Ky supozim, e dërgon këtë njeri deri në atë ekstrem, sa të mendojë se është sunduesi i botës. Tani, e ndien veten se është në formë dhe i gatshëm të përballet me çfarëdo fuqie tjetër. Në kohën kur ai do të mendojë kështu, do të bëhet kataklizma, do të ndërpriten të gjitha ligjet. Atëherë, njeriu do t’a kuptojë se, të arriturat e tij ishin prej Mirësisë së All-llahut xh.sh. Përderisa na krijoi, Ai i urdhëroi edhe shkaqet që të na nënshtrohen, dhe nuk duhej që ne, të mashtrohemi me to dhe t’a harronim shfaqjen e Fuqisë.

Gjithashtu, i Lartësuari na ka thënë, në Kur’anin Kerim: “Do t’ju tregojmë atyre argumentet tona në hapësirë dhe në vetet e tyre derisa të binden ata se Ai është Krijuesi i vërtetë”⁸⁴

⁸⁴ Kur’an, 41/53

Kur'ani është libër adhurimi, ai nuk ndryshon deri në Ditën e Gjykimit. Për këtë arsye, secila gjeneratë do t'a lexojë atë "Do t'ju tregojmë atyre..." Thënia: 'do të', paralajmëron të ardhmen. Kjo jep të kuptohet se, secila gjeneratë do të shohë atë që, gjenerata e shkuar nuk ka pasur rastin t'a shohë. Jo vetëm argumentet tokësore, por edhe ato qiellore. Këto, gjithashtu, janë edhe në vetë qenien njerëzore.

Tani po përjetojmë një përparim shkencor (drejt zbulimeve të sekreteve) në hapësirë, si dhe (në zbulimin e sekreteve) të trupit të qenies njerëzore, të cilat e vërtetojnë këtë thënie kur'anore. Kjo që u paralajmërua nga All-llahu xh.sh., nuk kuptohet ndryshe veçse si dhuratë e All-llahut të Lartëmadhëruar për ne, sepse asnjë shkencë, sado e përparuar që të ishte, nuk do të kishte mundësi të paralajmëronte për gjëra, të cilat do të ndodhnin në të ardhmen, bile pas shumë e shumë gjeneratave. Por, duhet të kemi parasysh, se Ai, që na tregoi ose informoi (për to) është All-llahu xh.sh. Ai është veprues. Përderisa i jemi bindur Atij, Ai është i vetmi në gjendje, të na japë një pasqyrë reale për të ardhmen e afërt, ose të largët.

Kur njeriu pasionohet pas shkaqeve të proceseve natyrore, ai i atribuon vetes forcat, të cilat nuk janë të tijat. Kur i Lartësuarit e shikon robin e Tij, duke u bazuar në shkaqet e proceseve natyrore, e lë atë t'a vazhdojë rrugën e tij, për aq sa ai do të vazhdojë të besojë në to. Kur të arrijë ai në këtë shkallë, në këto momente, tek ai do të shfaqet shkaktari i vërtetë dhe prej tij do të largohen begatitë (mirësitë). Sikur njeriu të bazohej në shkaktarin e vërtetë, i Cili jep gjithmonë, atij nuk do t'i iknin shkaqet, gjithashtu edhe dhurimi. Për këtë, i Lartësuarit, na dha një shembull në Kur'anin

Kerim, ku Karuni,⁸⁵ thotë: “...por unë, e arrita këtë nga dituria ime...”⁸⁶, gjithashtu edhe pronari i dy kopshteve “...nuk mendoj se do të shkatërrohet ndonjëherë...”⁸⁷, gjithashtu edhe ata që deshën t’i vjelin frutat herët në mëngjes, për t’u ikur të varfërve “Mos të lejojmë të hyjë sot (në kopshtin tonë) asnjë i varfër...”⁸⁸, por tek të gjithë këta, pasoi dënimi me shkatërrim total. Karunin e përpiu toka me gjithë pasurinë e tij, pronarëve të dy kopshteve iu shkatërruan plotësisht kopshtet, i gjithë prodhimi iu asgjësua, si pasojë nuk patën fare bereqet. Këtyre, e gjithë kjo u ndodhi për shkak se kishin lënë anash dhe kishin sfiduar shfaqjen e Fuqisë së All-llahut xh.sh. Ata kishin menduar se ishit pronarët e vërtetë.

Shfaqje e Fuqisë do të thotë se, All-llahu është Një i Vetëm dhe i Pashoq. Thënja ‘All-llahu është i Vetëm’, jep të kuptohet se (All-llahu) në vetvete përmban cilësi, të cilat nuk mund të përmbahen tek njeriu dhe tek krijesat, por vetëm tek Krijuesi i Lartëmadhëruar. Ai është i Vetmi, që e posedon këtë shfaqje të Fuqisë, mjafton t’i thotë diçkaje: ‘Bëhu’, e ajo bëhet pa iu drejtuar shkaqeve. Të gjithë ne kemi fat në dituri, por i Lartësuarit është i Dituri Absolut, dituria Atij nuk i është mësuar nga ndokush, por Ai, Diturinë e ka nga Vetja dhe Ai, di atë që ne nuk e dimë.

Thënia jonë ‘i Vetëm’ është thënie që (tregon se) askush (tjetër) nuk e posedon, kjo (thënie) i përshtatet vetëm All-llahut xh.sh., sepse akush nuk mund t’i ngjasojë Atij. Thënja ‘një’ mund të

⁸⁵ Karuni- nje prej pasanikeve me te medhenj boteror. Ishte prej popullit te Musait a.s., per me shume lexo Kur’anin ne vijim

⁸⁶ Kur’an, 28/78

⁸⁷ Kur’an, 18/35

⁸⁸ Kur’an, 68/24

ketë ngjasues. Thënia ose shprehja ‘një’ pranon në vete të ketë shumë gjëra, që janë një. Mund t’u themi shumë individëve se, ishin të gjithë të një zëri. Secili prej tyre, përsërit shprehjen që ka përsëritur shoku i tij. Ndërsa thënia: ‘i Vetëm’, (tregon diçka që) iu mohohet të tjerëve. Nëse i thua një objekti: ‘një’, kjo nënkupton se ai është i përbërë prej disa gjërave, p.sh. karrigia, kjo është formuar prej drurit, gozhdave dhe lëkurës, por është një, është karrige. I Lartësuar, nuk duhet të kuptohet në këtë mënyrë. Ai nuk është i përbërë prej shumë elementeve. I Madhëruar, Ti je i Lartëmadhëreshëm dhe i Pashembullt. (Pasi në të kundërtën) Kush pra, do të ishte i pari prej të tre elementeve që krijoi tjetrin?! Kush pra, ishte i pari? Nëse, i Lartësuar, do të ishte i pari, atëherë pjesët e tjera do të mbeteshin të ishin prej krijimit të Tij, e jo pjesë të Tij. Prandaj, çdo gjë që ekziston, është prej Krijimit të Tij. Kjo e mohon (thënie) se All-llahu është i përbërë. Thënia se All-llahu është ‘një’ është thënie jo e përshtatshme, sepse (kjo thënie) pranon përbërje, ndërsa thënia e vërtetë për të, është ‘i Vetëm’, Atij nuk i ngjason askush, e as që ka nevojë për (ndihmën e) asnjë krijese që Krijoi, por Ai është ‘i Vetëm’ që nuk ka shok, dhe askush nuk e robëron Atë, sado i fuqishëm dhe madhështor qoftë ai.

All-llahu Samed

All-llahu është ‘Samed’ - ‘Atij, që çdo krijesë i drejtohet (mbështetet) për çdo nevojë’. Cila forcë pretendon të ketë fuqi? I Vetmi është i Lartësuar, që nuk i ngjason askujt. ‘Samed’ nënkupton se çdo gjë ka nevojë (për ndihmën e Allahut, kurse Ai nuk ka nevojë për asgjë). Ne i drejtohem Atij, kur na shfaqet nevoja për diçka që është e pakapërcyeshme për ne. Atij i drejtohem ose sepse jemi i detyruar, ose nga vullneti ynë i lirë. I Lartësuar ka krijuar krijesa, që nuk e kanë lirinë e të shprehurit, p.sh. të tillë janë melekët, që: “...nuk e kundërshtojnë (urdhërin) All-llahun, por ata

veprojnë vetëm çka urdhërohen...”⁸⁹. Ata nuk kanë liri, ata janë të detyruar. Ata janë krijuar për këtë gjë. Kështu edhe dielli, hëna dhe çdo gjë që e nënshtroi All-llahu xh.sh., janë të krijuara për këtë respekt-nënshttrim. Dielli nuk guxon të mos lindë një ditë, e të lindë kur ai dëshiron. Toka nuk mund t’a ndaloj rotacionin e saj ndonjë ditë të caktuar. Kështu është edhe me yjet, me hënën, me kodrat dhe detërat. Çdo gjë, që është krijuar dhe është e nënshttruar, nuk ka forcë të jetë e lirë. Prandaj, ata i janë drejtuar All-llahut xh.sh., i Cili e vazhdon qarkullimin e tyre, sipas krijimit për të cilën ata janë krijuar.

Tani të shohim njeriun, të cilit, i Lartësuari ia dhe lirinë e veprimit. Atij i mundësoi lirshëm, që të veprojë ose që të mos veprojë. T’i drejtohet Atij ose jo, t’a mohojë apo t’a pohojë ekzistimin e Tij. Kjo gjendje, ose ky status i tij skadon, ose është i vlefshëm vetëm sa është në këtë jetë, që po e jetojmë tani.

Pra, thënia e All-llahut të Lartësuar “All-llahu – Samed”, na ka vendosur para një pamje të vërtetë për besimin-akiden. Përderisa All-llahu është i Vetëm, nuk ka shok, dhe përderisa është Samed, që ka për qëllim nevojtarët, Atë nuk mund t’a zëvendësojë askush. Nuk ka ekzistencë tjetër përveç ekzistimit të Tij. Nuk ka veprues tjetër, përveç veprimit të Tij. All-llahut xh.sh., nuk i mungon asgjë prej gjëje në sundimin e Tij, që t’i japë secilit njeri atë që ai dëshiron. Sikur i gjithë njerëzimi t’a mohonte Atë, Të Lartësuarit nuk do t’i mungonte asgjë. Ai është në gjendje të japë dhe të marrë, t’a bëjë të dobëtin të fortë. Ky është dallimi i dhurimit të All-llahut dhe dhurimeve të njeriut. Dallim tjetër është se, kur njeriut i japësh diçka, nuk mundesh t’a kthesh atë, nëse ia kërkon.

⁸⁹ Kur’an, 66/6

Nëse ti i jep dikujt para (borxh) dhe ai refuzon që të t'i kthejë ato, ti nuk je në gjendje t'ia marrësh atij, sepse ajo bëhet pronë, nën sundimin e tij. Nëse je mjek dhe pasi t'ia japësh barërat pacientit për t'a shëruar, por më pas, ai refuzon të t'a paguajë mundimin tënd, ti nuk je në gjendje t'ia marrësh shërimin atij. Ndërsa All-llahu i Lartësuar, mundet të japë e të marrë. Nëse Ai të jep begati dhe njeriu e mohon Atë, Ai mundet që pasanikun t'a shndërrojë në të varfër, ose ta bëjë të shëndoshin të sëmurë. Por, nëse njeriu i pranon ato me falenderim, Ai ia shton Atij të mirat.

All-llahu i Lartëmadhëruar, nëse i mundëson dikujt të sundojë në tokë dhe ai e keqpërdor atë, duke ndërrmarë ofensiva të ndryshme tiranizuese, atëherë atij i dërgon një (sundues) tjetër, më shkatërrimtar se ai, dhe kështu i hakmerret atij. All-llahu xh.sh., nuk e dërgon tek shkatërruesi njeriun e mirë dhe besimtar, sepse (ky njeri) është i butë dhe mëshiron. Ai (njeriu besimtar) mundohet që të keqen t'a kthejë me të mirë, sepse e mira e mund të keqen. Kjo është ajo, që e ka urdhëruar All-llahu. All-llahu, atij i dërgon një tiran më të fuqishëm se ai, derisa të bëhet hakmarrja ekuivalente me të. All-llahu i dërgon atij, një shkatërrimtar, andej nga ai se kujton fare.

Shfaqja e Fuqisë prej All-llahut, nuk është për t'u hakmarrë ndaj krijesave të Tij, por ajo është begati. Ai, nuk ka pasione, që të gjithë ne jemi robërit e Tij. Nuk ka përparësi arabi ndaj jo arabit, përveç atij që është më i devotshmi. Shfaqja e Fuqisë është për t'a mbajtur barazpeshën në univers. I Lartësuari, gjithnjë, është në anën e të dobët kundër të fuqishmit, është me të pamundurin, kundër të mundësit. Sikur të mos ishte kjo shfaqje e Fuqisë dhe kjo të lihej në kompetencat e shkaqeve të proceseve natyrore, toka do të ishte mbushur plot probleme dhe ngatërresa. Sepse, nëse do të bazoheshin vetëm në shkaqet, do të mbushej bota plot mashtrime me fuqitë kundrejt krijesave të All-llahut. Do t'a merrnin të drejtën në dorë ata, që nuk e meritojnë. Njerëzit do të grumbullonin aq shumë pasuri, sa që nuk do të ishin në gjendje t'a

shpenzonin atë, gjatë tërë jetës së tyre njerëzore. Të bazuar në këtë logjikë, bota nuk do të kishte kuptim, sepse vetvetiu do të shkatërrohej. Për këtë arsye, i Lartëmadhëruari i mënjanon shkaqet dhe e bën të fortin të dobët, të pasurin e varfëron dhe mendjemadhin e poshtëron.

Pra, All-llahu krijoi universin dhe secilit që jeton në këtë jetë, në mbarë universin, ia ka caktuar riskun dhe dhurimin, pa marrë parasysh nëse është besimtar apo pabesimtar. Dhurimi është për secilin njeri, i Lartësuari i jep secilit për t'a provuar. Pa marrë parasysh, nëse ajo dhuratë është për ty e mirë ose e keqe. Ti mendon se ajo që t'u dhurua është e keqe në jetën tënde, por edhe sikur njëqind të tjera të jepeshin, do të preferoje atë. Dhurimet e All-llahut janë për t'a lehtësuar jetën në univers. Por, në të njëjtën kohë, është prezente shfaqja e Fuqisë së All-llahut xh.sh., në mënyrë që mos t'a harrojmë All-llahun, sepse (në të kundërt) do t'u besonim shkaqeve.

E tërë vazhdimësia e universit varet prej shkaqeve, pastaj ndërhyr shfaqja e Fuqisë në një ngjarje prej ngjarjeve, sa për t'a tërhequr vëmendjen njerëzimit se, dhuruesi i shkaqeve është Shfaqur dhe është i Fuqishëm. Shkaqet, të cilat i krijoi All-llahu xh.sh., nuk mund të konsiderohen rregulla të Fuqisë së Tij. Ne, doemos, në jetën tonë duhet të lidhemi me All-llahun, e jo me shkaqet e proceseve natyrore, të cilave Ai iu dha mundësinë, atyre dhe shumë krijesave të tjera.

Në situata të tilla, së pari duhet të përkujtojmë se, ajo që na ndodh prej All-llahut, por që vjen përmes dorës së robërve të Tij, duhet t'a kuptojmë se ajo ishte prej All-llahut xh.sh., ajo ishte përcaktuar për ne, pastaj Ai e kaloi atë në dorën e robit. Mos t'a harrojmë Dhuruesin, e të adhurojmë shkaqet. Dhe ta kemi parasysh se, kur të na kaplojë nganjëherë mërzia dhe të kemi arritur deri na atë gjendje, sa të vlerësojmë se nuk kemi zgjidhje, pra deri këtu ishin mundësitë dhe forcat tona, të cilat janë të paafta të shkojnë më tutje, duhet t'a përkujtojmë shfaqjen e Fuqisë

ekzistuese dhe do të shohim se prej atij momenti, mërzia do të na largohet, sepse Fuqia e All-lahut është pa kufij dhe pa rregulla.

Shfaqja e Fuqisë vërteton rrjedhat dhe i përkujton njerëzimit të mos largohet nga All-llahu xh.sh., dhe ndërhyt që të ndihmojë të dobëtin kundër të fortit, të pamundurit kundër të mundurit.

All-llahu është i Vetëm dhe i Pashoq. Ai është në gjendje të bëjë atë që dëshiron dhe kur të dëshirojë, dhe ka mundësi që secilit njeri t'i përgjigjet për nevojën që ka, pa e dëmtuar Atë fare në pushtetin e Tij. Pushtetin e Tij, askush nuk mund t'a kërcënojë, sado i madh të jetë pushteti i tyre (njerëzve), prandaj ne nuk duhet t'i frikësohemi botës materialiste, përderisa jemi me All-llahun dhe përderisa jemi në (rrugë) të drejtë.

All-llahu është i Vetëm, Atij askush nuk i ngjason dhe Ai nuk ka shoqërues. Gjithashtu, askush nuk mund të jetë më superior se Ai. Të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh statutin dhe pozitën e tyre në botë, janë robërit e Tij dhe, të gjithë ne, do të shkojmë tek Ai, pas përfundimit të kësaj jete.

Shfaqja e Fuqisë së All-lahut na jep guxim në këtë univers, të jemi të gatshëm të përballemi me secilin shkatërrues. Ne rreshtohemi në anën e të dëmtuarit, derisa ai t'a marrë të drejtën e vet. Nëse dikush mundohet të na frikësojë me anën e shkaqeve të proceseve natyrore, apo me pamjet e kësaj jete, apo me pozitë, pushtet, apo pasuri, me të cilat All-llahu xh.sh. e ka begatuar ndonjë rob, prej robërve të Tij, të përkujtojmë se All-llahu i Lartëmadhëruar, ashtu si ia ka dhënë, ashtu edhe ia merr, ashtu si e ka ngritur ashtu edhe e ul, prandaj të qëndrojmë me të drejtën, e të mos na mashtrojnë shkaqet, sepse ato janë të shkuara.

Shfaqja e Fuqisë paraqitet nga bindja e thellë e imanit. Ajo na bën të besojmë bindshëm me çka i Lartësuar do të shpërblejë besimtarin në ahiret, prej begative të Tij, përgjithmonë. Atë që syri s'e ka parë, e as veshi s'e ka dëgjuar, e as zemra se ka përjetuar. Na bën t'a përkujtojmë vazhdimisht dhe pandërprerë se, All-llahu është i Vetmi që mundet, dhe Ai është veprues.

LIGJËRIME MBI KAPTINËN MERJEM

Nuk e shoh të përmyllur shfaqjen e Fuqisë, veçse atëherë kur të kemi regjistruar edhe disa ligjërimi mbi këtë kaptinë. Shfaqjen e Fuqisë së All-llahut të Lartësuar do t'a kuptojmë atëherë, kur të shpjegohet shembulli i caktuar i kaptinës Merjem, që ka të bëjë me Isain, birin e Merjemes (paqa e All-llahut qoftë mbi këta të dy). Merjemja ishte ajo, e cila u zgjodh për shfaqjen e Fuqisë. Vetë përzgjedhja e saj, së pari, duhet të kuptohet si shfaqje e Fuqisë, edhe virgjiniteti i saj, gjithashtu, është shfaqje e Fuqisë. Më pas përzgjedhja e saj e dytë, duhet të kuptohet si shfaqje e Fuqisë, edhe lindja e Isaut, të birit të Merjemes është shfaqje e Fuqisë, po kështu edhe Pejgamberia e tij duhet kuptuar si shfaqje e Fuqisë, gjithashtu ngritja e tij në qiell është Shfaqje e Fuqisë...

Të gjitha këto ndodhi, drithërojnë botën materialiste. Protagonistët të këtyre ngjarjeve ishin çifutët, sepse ata jetonin në atë kohë. Historia, çifutët, i njeh si popull materialist. Ata gjykimet e tyre i kanë ngritur mbi bazat e ligjeve materialiste. Adhuresi i tyre është floriri. Edhe pse ata e kishin parë (Shfaqen e Fuqisë), me sytë e tyre, dhe e kishin përjetuar shpëtimin e tyre nga Faraoni,

i cili i ishte afruar (tepër afër) detit dhe në këtë rast, All-llahu xh.sh., ua shfaqti Fuqinë e Tij, në kohën e duhur dhe vendin e duhur, përkundër kësaj, ata skalitën një viç prej floriri dhe e morën atë për adhurues. Kur ata, nuk kishin se ç'ka të hanin në shkretëtirë, All-llahu xh.sh., iu dërgoi shpezë që quheshin Menna dhe Selva. Ata ushqeheshin me ushqime, që nuk ishin të njohura për ta, (e këto) ishin vepra jashtë të gjitha paragjyqimeve të tyre.

Sido që të ishte, ata furnizoheshin drejtëpërdrejtë nga All-llahu xh.sh., por çuditërisht, ata filluan të kërkojnë ushqim, që kishte prejardhje nga toka. Ata, si duket, nuk ndjeheshin të sigurtë me ato ushqime, të panjohura më herët. Ata besonin vetëm ato (objekte), që kishin prejardhje materialiste. Kur All-llahu i Lartëmadhëruar dërgoi Talutin, për mbret të çifutëve, ata i thanë: ai nuk posedon pasuri, që të bëhet mbret. Kështu është jeta e tyre, ata mohojnë begatitë e All-llahut, sepse janë materialistë. Ata ikin nga çdo idealizëm, këta janë ata, që i kanë mbytur 'nebijët' – 'lajmëtarët' e All-llahut xh.sh., kur ata iu sillnin atyre programe idealiste. Ata, gjithmonë, janë në kërkim të të besuarit se materia është e përjetshme dhe absolute.

Duhet t'a kemi të qartë dhe t'a dallojmë fjalën 'nebij' – 'lajmëtar' dhe shprehjen 'resul' – 'i dërguar' i All-llahut. I dërguar është ai, që është dërguar nga All-llahu xh.sh., me program qiellor dhe ka mbështetje të drejtëpërdrejtë nga Ai. All-llahu i mbron këta të dërguar dhe askush nuk mundet t'ju bëjë atyre asgjë. Ndërsa 'nebij' – 'lajmëtar' i All-llahut është ai, i cili nuk ka program nga qielli, por ka karakter të mirë dhe informon drejt mbi librin e të dërguarve të All-llahut të mëhershëm. Ai, këtë informim, e bën qartë e mirë dhe e praktikon si duhet. Ka ndodhur që, disa prej këtyre lajmëtarëve, që ishin me moral të lartë, të jenë viktima të çifutëve. Atyre u është kërkuar që t'u përmbaheshin rregullave të tyre çifute, e jo të vinin me gjëra të "reja", që nuk ishin me përmbajtje materialiste.

Para se të filloj ligjëratën time, rreth kaptinës kur'anore – 'Merjem', dua të sqaroj një gjë, që konsideroj se është me shumë rëndësi. Së pari, duhet t'a dimë se kur i Lartësuari i dërgon të Dërgurit e Tij, ata duhet të jenë prej qenies njerëzore. Pse duhet të jetë njeri? Sepse dërgesa e All-llahut i është drejtuar kësaj krijese, që e kupton fjalën: vepro ose mos vepro. Ky është një lloj programi, që është zgjedhur nga All-llahu i Lartëmadhëruar, për këtë qenie, në planetin tokë.

Duket se kjo formë jetese është për një jetë të mirë dhe të sigurt. Por, i Lartësuari, nuk e lë pa e zbatuar programin Tij, këtë e bën që t'a shohin të gjitha krijesat se si, Ai e zbaton programin sipas natyrshmërisë (së tyre) njerëzore. Ai është prezent vazhdimisht, që pastaj (njerëzit) të mos kenë kurrfarë arsye të ankohen, e të thonë: O Zot ne nuk mundeshim, ose të thonë: O Zot, ai program ishte mbi mundësitë tona njerëzore. Për këtë arsye, iu dërgonte Dërgues, nga vetë qenia njerëzore, pra, prej llojit të vet atyre. Që vetë ata të shohin se si zbatohen ato rregulla dhe, njëkohësisht, të shohin se ato janë të përballueshme. Kështu që, bashkëkohësit e tyre, të dëshmojnë secili për veten e vet, në Ditën e Gjykimit, dhe të mos kenë kurrfarë arsye ankimi, atë Ditë.

Pra, i dërguari duhet të jetë njeri, dhe kjo është një çështje, që nuk pranon kurrfarë alibie tjetër. Sikur, i dërguari të ishte ndonjë krijesë që nuk i përkiste qenies njerëzore, do të dëgjoheshin ankesat e atyre, që nuk do t'a ndiqnin programin e tij. Sigurisht, që kishin për të thënë: si mendoni që ne t'iu ndjekim ju, kur ju nuk jeni qenie njerëzore si ne. Arsyet e tyre, para masës, do të ishin të forta se këta (të dërguar) janë jonjerëzorë dhe, gjithashtu, ata do të kërkonin që Zoti t'iu dërgojë të dërguar prej qenies së vetë llojit të tyre njerëzor. Ankesat e tyre, do të vazhdonin duke thënë se ne ata janë vetëm njerëz të thjeshtë, dhe forcat e tyre nuk janë ekuivalente me të tyret (krijesave jonjerëzore). Ftesa e tyre nuk do të pranohej sepse jonjerëzorët nuk do të mund t'i kuptojnë

preokupimet tona, sepse fuqitë nuk i kemi të barabarta dhe me siguri (njerëzit) do thonin: O Zoti ynë, nëse dëshiron të na dërgosh programin Tënd, që të jetë i zbatueshëm për ne, na dërgo një Dërgues që të jetë njeri si ne, e mos na dërgo qenie jonjerëzore, sepse Ju, në këtë situatë, po kërkonin nga ne që të zbatojmë diçka, që është mbi mundësinë tonë. Për këtë arsye, është vendosur prerazi që të dërguarit të jenë prej qenies njerëzore, në mënyrë që forcat e tyre (të dërguarve), të jenë ekuivalente me ato të besimtarëve. Kështu (besimtarët) do të mundeshin të merrnin shembull të mirë (prej të dërguarve), pa pasur frikë se ata nuk do të mund t'i zbatonin rregullat.

Pas kësaj hyrjeje të gjatë, le t'i kthehemi tani ligjëratës sonë. Së pari, do të mundohem t'a përshkruaj ngjarjen, ashtu siç na e rrëfen All-llahu xh.sh., tregimin e Merjemes a.s. dhe gruas së Imranit, në Kur'anin Kerim.

“Kur gruaja e Imranit tha: O Zot, unë këtë që kam në barkun tim, do t'ia përkushtoj vetëm (madhërisë) Tënde, që të shërbejë vetëm Ty. Prandaj, pranoje nga unë, sepse Ti, vërtet, je i Gjithëdëgjueshëm dhe i Gjithëditur”⁹⁰

Pra, kur gruaja e Imranit mbeti shtatzënë, ajo para lindjes nuk e dinte se çfarë fëmije do t'i lindte, mashkull ose femër. Sido që të ishte, atë fëmijë të shumëpritur, ajo ia kishte përkushtuar All-llahut xh.sh., që t'i shërbente vetëm Atij. Ajo ishte një grua besimtare, dhe ishte ndjenja (e lartë) e imanit të saj, që bëri që ajo të shprehte dëshirën e saj për t'ia dhuruar, për shërbim, pasardhësin e saj, All-llahut xh.sh.

⁹⁰ Kur'an, 3/35

“E kur ajo e lindi (fëmijën) tha: Zoti im! Unë linda femër dhe, (pa dyshim se) All-llahu e dinte se çfarë kishte lindur ajo, (por ajo nuk ishte e kënaqur, ngase) mashkulli nuk është si femra, (megjithatë) unë e emërova atë Merjem dhe e dorëzoj këtë dhe pasardhësin e saj, në mbrojtjen Tënde nga Djalli i mallkuar”⁹¹

Gruaja e Imranit shfaqti dhembje, sepse kishte lindur femër e jo mashkull. Kjo kishte pritur mashkull, sepse, sipas saj, mashkulli do t’a propagandonte dhe përhapte programin e All-llahut, për robërit e tij, më mirë. Por ja që, ajo kishte lindur femër, dhe kështu iu drejtua All-llahut xh.sh: “Unë linda femër dhe, (pa dyshim se) All-llahu e dinte se çfarë kishte lindur ajo, (por ajo nuk ishte e kënaqur, ngase) mashkulli nuk është si femra...”

Mashkulli ose djali kanë mundësi t’i përballojnë vuajtjet e jetës më shumë se femrat. Shpalosja e programit të fesë së All-llahut, është e rëndë dhe femra nuk ka fuqi. I Lartësuari ia ktheu përgjigjen asaj, duke ia përkujtuar asaj shfaqjen e Fuqisë. Oj gruaja e Imranit, Unë e di se çfarë linde ti. Unë jam Ai, i cili i krijoj ato që ju keni në mitra, dhe jo vetëm që i krijoj ato, por i Di të gjitha imtësitat e jetërave të tyre, që prej lindjes deri në vdekje. Prandaj, e di se sa vjetë do të jetojë fëmija yt, sasinë e riskut që i është caktuar, a do të jetë prej të shpëtuarve apo prej të ndëshkuarve, a do të posedojë pasuri, apo jo. Di gjithçka që do t’i ndodhë, që prej sëmundjeve, gjatë gjitha etapave të jetës së tij, etj. Di secilën lëvizje të tij, e madhe apo e vogël qoftë, gjatë gjithë jetës së tij. Jo vetëm kaq, por Unë e krijoj edhe pamjen e tij, dhe e di pamjen e tij, para të gjithëve në botë. Dituria ime i tejkalon të gjithë dituritë e botës (dijet që kanë arritur të zbulojnë shkencëtarët) se ç’kanë gratë në mitra. Prandaj, sikur All-llahu të dëshironte t’i falte djalë, gruas së Imranit, do t’ia

⁹¹ Kur’an, 3/36

falte, por shfaqja e Fuqisë së Madhe, kishte filluar që prej momentit të parë, kur u krijua Merjemja, në mitrën e nënës së saj, dhe atë e krijoi femër, që nëna e saj t'i drejtohej qiellit, e të thoshte: “dhe e dorëzoj këtë dhe pasardhësin e saj në mbrojtjen Tënde nga Djalli i mallkuar”, që kishte për qëllim: O Zot, mos lejo që djalli t'a mashtrojë dhe t'a sundojë Merjemen dhe pasardhësit e saj.

TAKIM ME FUQINË

Nga kjo që theksuam më sipër, del një pyetje shumë e rëndësishme. Nga e dinte nëna e Merjemes se, ajo do të kishte pasardhës? A mos vallë, e paralajmëroi i Lartësuar, se çfarë do të ndodhë, apo ishte një lutje, si të gjitha lutjet e nënave? Askush nuk e di nëse e ka paralajmëruar All-llahu xh.sh., nënën e saj, se çfarë do të ndodhë me Merjemen. Nuk kemi kurrfarë të dhëne të shkruar në Kur'anin Kerim, nga All-llahu xh.sh., për këtë paralajmërimin. Por si duket, duhet të jetë një lutje si e gjitha nënave.

Këtu filloi hapi i parë i takimeve të Merjemes me shfaqjen e Fuqisë. All-llahu i Lartësuar ia pranoi lutjen, si një thirrje e mirë që i drejtohet Atij. Ky pranim nuk është sikur përzgjedhja, për të cilën do të flasim më poshtë. Hapi i parë i këtij rrugëtimi, duket se është një mrekulli e madhe për t'a shfaqur Fuqinë e All-llahut të Lartësuar. Ai, iu kishte premtuar çifutëve, se do t'a kenë prezente

shfaqjen e Fuqisë, me qëllim që të largohen nga besimi i tyre materialist “...dhe e rriti atë me një edukatë të shkëlqyer...”⁹².

Merjemen e dërguan në një vend, që ishte dedikuar vetëm për adhurim. Midis priftërinjve dhe besimtarëve pati një garë se, kush do të kishte fat të përkujdesej për të. Ishte një fillim dhe pritje e mirë, prej tyre. Ata ndiheshin të privilegjuar që do të përkujdeseshin për të, sepse ndienin respektim dhe kënaqësinë e All-llahut xh.sh. Për këtë, përfundimisht, u vendos që (kjo çështje) të përcaktohej me short. Kur ata hodhën shortin, fati e deshi që ai të ishte Zekerija a.s. Kështu, kishte dëshiruar All-llahu xh.sh., dhe ai hyri në faltore tek Merjemja, për të adhuruar edhe ai All-llahun e Lartëmadhëruar.

Zekerija duhej të kujdesej për gjithçka, që ajo kishte nevojë. Kur shkoi për t’ia dërguar ushqimin Merjemes, ai shkoi deri tek mihrabi⁹³ për t’ia lënë dhe, njëkohësisht, dëshiroi të sqarohej me të. Ajo, kur e pa, për momentin, e ndërpreu lutjen. Por, Zekerijai u befasua, në mihrab pa diçka që e habiti. Dhe, kjo habi, do të vazhdonte sa herë që ai shkonte tek vendi i lutjes së saj – në mihrab. Aty shikonte se (vazhdimisht) kishte ushqim, (dhe me vete mendoi se) me siguri dikush po ia sillte asaj! Habia më e madhe ishte se aty, jo vetëm që kishte ushqim, por pemët dhe perimet e verës gjendeshin aty në kohën e dimrit, dhe ato të dimrit, në kohën e verës. Ishte edhe një çudi tjetër, sado të haje, ato nuk mbaronin dhe nuk vyshkeshin, e as nuk kalbeshin.

⁹² Kur’an, 3/37

⁹³ Mihrab, fjalë arabe që nënkupton vendin në të cilën drejtohen besimtarët gjatë lutjes

Nga pikëpamja e Zekrijait, si njeri, kjo ishte një gjë shumë e çuditshme. Kjo ishte përzgjedhja e parë për Merjemen. Ajo ishte veçuar nga All-llahu xh.sh. me shfaqje të Fuqisë. Ai kishte paraparë që t'i jepte asaj ç'ka të dojë dhe pa ndonjë shkak, derisa erdhi koha e mrekullisë, kur Merjemja do të mbetej shtatzënë me Isain a.s., pa ndërhyrjen e shkaqeve njerëzore. Kjo ishte një parapërgatitje, për t'u mos u hamendur, apo për t'u mos u frikësuar nga ajo, se çfarë do t'i ndodhte. Ajo, duhej të mos dyshonte dhe të mos mendonte se ishte një mashtrim. Kjo duhej të jetë arsyeja, se përse ajo ishte përzgjedhur, që nga fillimi i jetës së saj, të parajetonte me shenjat e Fuqisë. Përzgjedhja e dytë e saj, ishte se ajo do të dallohej nga të gjitha gratë e botës. Ajo do të mbetej shtatzënë pa ndërhyrjen e mashkullit, bile pa e prekur njeri.

Për këtë arsye, shfaqja e Fuqisë filloi, duke ia dërguar riskun Merjemes, pa ndërhyrjen e shkaqeve të proceseve natyrore. Kjo mund të konsiderohet se, ishte një fillim i hyrjes së ngjarjes edhe më të madhe nga All-llahu xh.sh. Përzgjedhja e parë ishte parangjarja, ndërsa përzgjedhja e dytë, ishte pasi, ajo do të veçohet nga të gjitha gratë e botës. Meqenëse Zekerija ishte përgjegjës dhe kujdestar i saj, ai filloi të dyshojë. Ai e dinte fare mirë se Merjemja ishte e ndershme, ishte e përcaktuar vetëm për të adhuruar, sepse ajo nuk dilte nga dhoma e saj. Ajo, gjithnjë, vazhdonte të rrinte në ruku dhe sexhde⁹⁴ për All-llahun xh.sh., por duke qenë se ishte qenie njerëzore, Zekerija u detyrua t'a pyesë: "...prej nga ty kjo...", o Merjeme?

Këtu, All-llahu xh.sh., na sinjalizoi me disa shenja fisnike, se në të (në ineresimin e treguar) gjendet mirësia e mbarë gjithësisë. Sikur të gjithë kryefamiljarët ose kujdestarët e ndonjë grupi

⁹⁴ Ruku dhe sexhde janë shprehje arabe që praktikohen gjatë namazit. Pozicioni përulës duke qenë në këmbë quhet ruku ndërsa përulja ulur dhe vendosja e kokës në tokë quhet sexhde.

njerëzish të interesoheshin, gjendja jonë do të ndryshonte. Kur ai sheh diçka jo të zakonit, në këtë rast kemi ushqimin që nuk i përkiste fuqisë njerëzore, detyrimisht duhet të pyesë prej nga erdhi ky ushqim në shtëpi! Kjo pyetje nuk duhet të kuptohet në sensin negativ, por në atë pozitiv. Sikur të gjithë njerëzit të ishin të tillë, që t'i pyesnin familjarët e tyre (për mënyrën se si i kanë fituar gjërat që i sjellin në shtëpi), çdo gjë në botë do të ishte në rregull.

Ajo që ndodh, në praktikën tonë të tanishme, është se prindi ose kujdestari i familjes i sheh fëmijët e tyre të sjellin në shtëpi gjëra, të cilat nuk u përkasin atyre p.sh. ndonjë fustan të shtrenjtë, ose një shumë parash, ose diçka shumë të shtrejtë, që kryefamiljari nuk ka pasur mundësi t'a blente, dhe ai hesht. Sikur të ishin prindërit e vendosur, dhe t'i pyesin me plotë seriozitet: prej nga këto, këtu tek ju? - ata, detyrimisht, do të përgjigjeshin dhe ose do të thonin të vërtetën, ose do të gënjenin.

Ata, duke e njohur natyrën e prindit të tyre, para se t'a shtrinin dorën në haram, do t'a dinin se do të zbuloheshin menjëherë prej tyre, dhe se, gjithashtu, veprimi i tyre do të përfolej në familje. Por, kur babai i mbyll sytë, e shikon se fëmijët e tij kanë diçka të huaj dhe nuk i pyet nga i kanë marrë ato gjëra, ata me këtë lloj heshtje, vetëm sa e ndihmojnë shkatërrimin në shtëpi dhe në botë.

Ky ajet na tregon se sa i kujdesshëm ishte Zekirija, ndaj sjelljeve dhe lëvizjeve të Merjemes, edhe pse e dinte se ajo ishte besimtare e njohur dhe gjithnjë ishte në vendin e lutjeve të All-llahut xh.sh. Nëse ai nuk do t'a bënte këtë, atij nuk do t'i falej moskujdesi i tij. Zekirija nuk i tha vetes se Merjemja është një femër besimtare e përkushtuar dhe ajo nuk bën keq. Ky që po vërej (ushqimi i shumëllojshëm) duhet të jetë diçka, që ajo nuk e bën atë (nuk ia merr ndokujt

fshehtas), me siguri çdo gjë (duhet të jetë) në rregull. Por, ai nuk mbeti vetëm me mendimin e tij, por e pyeti për të qenë qind për qind i sigurtë për prejardhjen e atij ushqimi. Merjemja ju përgjegj: “...këto janë prej All-llahut, vërtet All-llahu e furnizon kënd të dëshirojë pamasë (pa llogari)”⁹⁵

Ishte një përgjigje shumë befasuese për Zekerijënë, ai atë nuk e priste. Përgjigja e saj befasuese, ishte përballë fytyrës së tij, me prezantimin e shfaqjes së Fuqisë së All-llahut xh.sh., i Cili i jep atij, që dëshiron, çfarë të dëshirojë dhe pa u mbështetur në shkaqet e proceseve natyrore. Kur Ai, i thotë një gjëje ‘Bëhu’, ajo bëhet. Pas kësaj përgjigje të papritur, Zekerijain e ngacmoi një dëshirë e kahmotshme. Ai nuk kishte pasardhës dhe gruan e kishte shterpe. Si lajmëtar i Zotit që ishte, ai kishte frikë se nuk do të kishte pasardhës të vetin. Mospasja e pasardhësit, e kishte preokupuar gjatë gjithë jetës dhe nga frika, se populli do t’a devijonte rrugën pas vdekjes së tij, ai filloi të mendojë sërish. Dëshira e tij ishte që, dikush pas tij, të vazhdonte t’i mësonte (popullit) moralin dhe karakterin njerëzor.

Atë e ngacmoi thellë në shpirt shfaqja e Fuqisë. Në vete tha: përderisa All-llahu e ushqen cilin të dojë, kur të dojë, pse mos t’a lus Atë, që të më falë një djalë? Meqenëse, tek Ai, nuk ndikojnë shkaqet e proceseve natyrore, Ai do të ishte në gjenjde të më falë atë, që Ai do të dëshironte.

⁹⁵ Kur’an, 3/37

MREKULLI PREJ KRIJUESIT

Atje, në mihrabin e Merjemes:

“Mu aty (në vendin e mihrabit) e luti Zekerijahu Zotin e tij, duke i thënë: O Zot, më fal mua, nga Vetja Jote një pasardhës të mirë, vërtet, Ti e dëgjon lutësin (kur ai lutet)”⁹⁶

Pra, duke qenë në mihrabin e Merjemes, Zekerijai i ngriti duart nga qielli, dhe tha: O Zoti im, nga ky vend që është shfaqur Fuqia Jote dhe për hir të asaj që Ti po e furnizon Merjemen me ushqim që nuk e njeh njerëzimi, dhe për hir të asaj Fuqie të shfaqur këtu nga Ti, më dhuro mua një pasardhës të mirë dhe dëgjoje lutjen time. Nuk vonoi pak, ndërsa Zekerijai ishte duke u falur, në mihrabin e Merjemes zbriti një melek dhe i tha: “Vëtet, All-llahu të përgëzon ty me Jahjanë, i cili do të jetë i vërtetuar me fjalën e All-llahut, zotërues, ruajtës (i vetvetes), lajmëtar (i All-llahut - pejgamber) dhe prej të mirëve”⁹⁷

Meleku zbriti nga qielli dhe e përgëzoi me djalë, dhe jo vetëm kaq, por i tregoi edhe të ardhmen e tij, dhe çfarë do të bëhet. Meleku nuk i mjaftoi vetëm t’a përgëzonte se All-llahu do t’i falte djalë, por shtoi duke i treguar se ai do të jetë zotëri, pejgamber dhe i mirë. Ky lloj lajmi ishte mrekulli, nga dituria e Krijuesit, para se (fëmija) të lindej. Pra, para se të mbetej gruaja e tij shtatëzanë. Atij iu tha se, gruaja jote do të mbetet shtatëzanë, do të lindë, por jo vetëm që do të lindë, por kjo

⁹⁶ Kur’an, 3/38

⁹⁷ Kur’an,3/39

foshnje do të rritet, do të bëhet zotëri i popullit të tij, dhe gjithashtu peygamber dhe prej të mirëve. Këtë komentim e shohim më të drejtë, kur bëhet fjalë, për thënien e All-llahut xh.sh.: “...dhe Ai e di se ç’ka në mitër...”. Ai po e lajmëron Zekerijain se gruaja e tij do të lindë. Vërtet, ajo mbeti shtatëzanë. Pasi kaluan disa muaj të shtatëzanisë, ai sihariq tani, po bëhej realitet, dhe se djaloshi e kishte ardhmërinë të njohur. E gjithë kjo, ndodhi, para se të mbetej shtatëzanë.

Në momentin kur iu shfaq meleku, Zekerijau u dridh, nga takimi me shfaqjen e Fuqisë edhe pse iu përkujtuan shkaqet e dhurimit, por si duket ai e kishte kuptuar gabimisht. Për t’u vërtetuar më mirë, e pyeti përsëri, duke i ngritur duart drejt qiellit, për të dytën herë, dhe tha: “O Zot, si të kem unë djalë, kur jam i shtyrë shumë në moshë dhe (gjithashtu) gruan e kam shterpe”⁹⁸

Zekerija i ngriti duart drejt qiellit dhe përsëriti: ‘O Zoti im! Unë po përgëzohem me diçka, por, të lutem, (dëshiroj) të vërtetohem sepse dua të di nëse të kam kuptuar mirë për sa dëgjova. O Zoti im! Unë jam plakur dhe gruaja ime asnjëherë nuk ka lindur’. Shkaqet sipas proceseve natyrore ishin pengesë e dyfishtë për të. Pengesa e parë ishte tek vetë Zekerijai, sepse ishte i shtyrë shumë në moshë. Nga ana e tij, kushtet nuk ishin të volitshme për të pasur fëmijë, por edhe sikur të ishte Zekerijai në rregull, gruaja e tij ishte shterpe. Ajo nuk kishte lindur gjatë tërë jetës së saj. Ajo nuk kishte lindur në rininë e saj. Prandaj, (Zekerija vazhdon lutjen) ‘o Zot, dua të di nëse dëgjova saktë, se unë do të kem fëmijë, kur derisa isha i ri, nuk e kisha atë gëzim. Gjithashtu, edhe gruaja ime ishte shterpe, dhe nuk kishte fat të mbetej shtatëzanë. A tani, ajo, do të mbetet shtatëzanë!? E unë tani, t’a bëj atë kur unë nuk kam mundur t’a kem në rininë time?!’ Në këtë gjendje, Zekerija u dridh prej mungesës së shkaqeve, ai, pra, kishte takim me shfaqjen e Fuqisë dhe ai e kishte, këtë

⁹⁸ Kur’an, 3/40

takim, për të parën herë. Ishte takim i fuqishëm, dhe ai mendonte se mos e kish kuptuar gabim melekun, ose se mos kish këtua diçka tjetër. Atij i thuhet, prapë, nga ana e All-llahut xh.sh.: “Kështu ka thënë Zoti yt, kjo për Mua është e lehtë, të kisha krijuar edhe ty më parë, kur ti ishe asgjë”⁹⁹

Ndërsa në kaptinën Ali Imran:

“Kështu All-llahu vepron atë që dëshiron...”

Këtu, i Lartësuari dëshiroi t'i përkujtojë Zekerijait, dy gjëra shumë të rëndësishme rreth shfaqjes së Fuqisë, duke i thënë atij: “All-llahu vepron atë që dëshiron”. Vepra e Tij nuk varet prej rregullave dhe shkaqeve, ajo është dëshira e All-llahut. Nëse universi udhëhiqet prej shkaqeve, Ai është krijuesi i tyre, prandaj i krijuari nuk mundet t'a kushtëzojë Krijuesin. All-llahu është Krijuesi i shkaqeve dhe ato nuk munden t'a kufizojnë Fuqinë e Tij. Ai vepron sipas dëshirës së Tij, pa pasur kurrfarë pengese nga të gjitha fuqitë vepruese në botë. Proceset natyrore janë të krijuara nga All-llahu xh.sh., dhe veprojnë sipas një rregulli në jetën e përditshme. Pastaj i tregoi edhe një të vërtetë tjetër, duke i thënë: ti po habitesh për sa të informuan melekët, se si mund të ndodhë kjo që Unë të paralajmërova. Ti nuk duhej të habitesh, sepse atë që ti e konsideron të vështirë ose të pamundur, ajo për Mua është e lehtë, është shumë e thjeshtë, sepse Unë kisha krijuar më parë këtë gjithësi dhe ç'ka brenda saj. A mendon se, për të krijuar një fëmijë është e vështirë për mua? Nëse ti habitesh, nga kjo vepër që është e thjeshtë për Mua, atëherë shikoje veten, derisa të të largohet habia. Të krijoja ty më parë, kur ishe asgjë, të krijoja nga hiçi, e pse habitesh kur Unë

⁹⁹ Kur'an, 19/9

do të krijoj fëmijën tënd?! Pra, kur Unë, ty të krijova nga hiçi dhe t'a dhashë jetën, a mos vallë është e vështirë për Mua, të të dhuroj fëmijë?!

DHURIMI PA NDONJË SHKAK

Ishte kjo, një përgjigje nga lart për Zekerijanë, kur ai ishte në mihrabin e Merjemes. Pas kësaj ndodhie të shfaqjes së Fuqisë, gjëja e parë, që iu kujtua ishte pafajësia e Merjemes. Në atë moment, e hoqi dyshimin e ushqimeve të llojllojshme që i vinin asaj. Aty e kuptoi se shfaqja e Fuqisë ka mundësi të dhurojë pa ndërhyrjen e shkaqeve. Këtë që e themi e argumentojmë me vetë dhurimin e djalit të Zekerijas, pa ndërhyrjen e shkaqeve. Kjo që i ndodhi Zekerijas, ishte bërë për t'a arsyetuar dhe pastruar Merjemen a.s., nga dyshimet që munden t'i mvisheshin nga qenia njerëzore. Ajo, se çfarë i ndodhi Zekerijait, u bë në mihrab, tek Merjemja, dhe këtë (All-llahu) e bëri që të bindet se All-llahu e furnizon atë që dëshiron, pa llogaritur fare. Kështu që, tani e tutje, nuk kishte nevojë që ai, ose dikush tjetër, të pyeste se çfarë lloj risku i kishte dhuruar All-llahu, Merjemes.

Ajetet e All-llahut, vazhdojnë të na tregojnë tregimin e saj:

“(kujtoje) Kur melekët i thanë: (Merjemes) O Merjeme! Perëndia të ka zgjedhur ty, të ka pastruar ty dhe të ka privilegjuar ty mbi të gjitha femrat e botës. O Merjeme! Bindju Zotit tënd! Bëji sexhde dhe ruku bashkë me ata që përulen!”¹⁰⁰

Këtu, i zbritën meleket Merjemes për t’a informuar se All-llahu e ka zgjedhur dhe e ka pastruar (pafajësuar) dhe, gjithashtu, e ka zgjedhur mbi të gjitha gratë e botës. Përzgjedhja e parë, kishte të bënte me jetën e përditshme të saj, sepse i shfaqej Fuqia e All-llahut xh.sh. vazhdimisht. Këtë e kishte bërë për t’a përgatitur për momentin që do t’i vinte asaj për lindjen e Isaut a.s. Ai e kishte dliresuar, sepse kishte ndaluar të ndikonin shejtanët tek ajo. Asaj i ishte dhënë këshilla që, të ishte pandërprerë me besimtarët, të cilët bëjnë ruku dhe sexhde për All-llahun xh.sh. Pastaj, ndodhi përzgjedhja e dytë, ajo u veçua nga të gjitha gratë e botës. Ajo do të lindte fëmijë pa pasur kontakt me mashkull.

Pikërisht, (për shkak të përmendjes së emrit të saj) Merjemja ishte privilegjuar. Ne kemi vërejtur se Kur’ani Kerim, kur flet për ndonjë ngjarje që është mrekulli prej Tij, nuk i jep emrat se kush ishte protagonist i ngjarjes. A thua pse? Sepse këto janë pjesë përbërëse të imanit. All-llahu nuk do që njerëzimi të merret me personin, por me ngjarjen. Sikur të tregonte emrin e plotë, mrekullitë do të merrnin karakter individual dhe nuk do të kishin pasur qasje, të tjerët. Në këtë rast, All-llahu xh.sh. e përjashtoi Merjemen, duke e përmendur emrin e saj. All-llahu e ka theksuar emrin e plotë të saj, Merjemja bija e Imranit, sepse mrekullia e lindjes së një femre pa ndërhyrjen e mashkullit, nuk do të përsëritet. Ishte një ngjarje që nuk do të përsëritet, tek asnjë femër e botës. Gjithashtu,

¹⁰⁰ Kur’an, 3/42-43 (Sipas përkth. të Prof.Hasan I. Nahit)

vërejmë se këtu, i Lartësuar i nuk e ka përdorur shprehjen gratë e tokës, por e ka përmendur shprehjen gratë e botës. Kjo jep të kuptohet se bëhet fjalë për gratë e qenies njerëzore, së xhinëve dhe të gjitha krijesave të tjera të All-llahut xh.sh. Kjo që i ndodhi Merjemes, nuk do t'i ndodhë, më kurrë, askujt. Zgjedhja e saj ishte një mrekulli: të lindë nga femra pa mashkull!

Mbaroi përzgjedhja e parë. Disa vite në vazhdim, Merjemja i kaloi duke ju lutur All-llahut xh.sh. Kështu veproi, derisa erdhi koha e dëlirësisë e cila u bë me anë të shfaqjes së Fuqisë. Ajo kishte të gjitha privilegjet e mundshme, sepse furnizohej drejtëpërdrejtë dhe pa llogari nga All-llahu xh.sh. Gjithashtu, kishte edhe mbrojtjen nga shejtanët, njerëzit dhe xhin-ët. Pas gjithë kësaj kohe, erdhi përzgjedhja e dytë, kur asaj i erdhi meleku dhe i tha: “Vërtet, All-llahu të përgëzoi nga Fjala e Tij (me një djalë), emri i tij është Mesih, Isa i biri Merjemes”¹⁰¹

Ky ishte sihariqi i parë për Merjemen dhe paralajmërimi i fiksuar, se çfarë do të bëhet prej lindjes së Isaut, të birin të Merjemes a.s.

Merjemja e mori përgëzimin, por edhe pas të gjitha atyre takimeve permanente që kishte me shfaqjen e Fuqisë, si risku që i vinte nga ana e All-llahut xh.sh., si edhe ajo kishte kaluar shumë vite duke e adhuruar All-llahun xh.sh. dhe kështu me këto veprime dëlirësohej vazhdimisht, po ashtu ajo ishte e mbrojtur nga shejtanët, por megjithatë, pas gjitha këtyre parapërgatitjeve, ajo ndjeu frikë në momentin kur e mori lajmin. E frikësuar tani, iu drejtua drejt qiellit dhe tha: “O Zot, si të kem unë djalë, kur mua nuk më ka prekur njeri!”¹⁰²

¹⁰¹ Kur'an, 3/45

¹⁰² Kur'an, 3/47

Edhe ajo, sikurse Zekerija, filloi të hapë diskutimin rreth shkaqeve të proceseve natyrore, kur ajo, gjatë gjithë kohës, kishte jetuar nën shfaqjen e Fuqisë, në mihrab të faltores. Asaj, si duket, nuk i ishte dukur gjithëpërfshirëse shfaqja e Fuqisë në krijim dhe tha: O Zoti im, si mund të lindi, kur mua nuk më ka prekur asnjë njeri? Mua nuk më është afruar asnjë mashkull, si mund të mbetem shtatzënë!? Pas kësaj thënie, asaj i përgjigjet All-llahu xh.sh.:

“Tha: kështu, All-llahu krijon ç’të dëshirojë, kur ai përcakton një gjë, Atij i mjafton të thotë ‘Bëhu’ dhe ajo bëhet”¹⁰³.

I Lartësuar i nuk i tregoi asaj se si do të bëhet ai, sepse krijimi është një prej veprimeve të Tij dhe, për këtë, vetëm Ai e di se si. Askujt prej krijesave, më parë, nuk u ishte treguar se si bëhet krijimi. Kështu, më herët, edhe Ibrahim i a.s. e kishte pyetur All-llahun xh.sh.: “ O Zot, më trego se si i ngjall të vdekurit...”¹⁰⁴

Edhe këtij, All-llahu xh.sh., nuk i tregoi se si i ngjallte të vdekurit, e as nuk i tregoi sekretin e jetës dhe të vdekjes.

Por atij, ia tregoi praktikën se i ngjall të vdekurit, me anë të Fuqisë së All-llahut. Ibrahim i mori një shpend dhe e copëtoi atë në copëza dhe ato i vendoi në pjesë të ndryshme, në disa kodra të qytetit, pastaj e thërriti atë shpend. Ai po e shikonte se si ato copëza i erdhën, u bashkuan dhe (ai shpend) u bë i gjallë. Ky ishte eksperiment praktik, se si ngjallen të vdekurit. Por me këtë veprim,

¹⁰³ Kur’an, 3/47

¹⁰⁴ Kur’an, 2/260

nuk ju dha (tregua) sekreti. All-llahu xh.sh. nuk ia tregoi Ibrahimit a.s. mënyrën e jetës dhe vdekjes.

Kështu veproi edhe me Merjemen, edhe asaj nuk ia tregoi sekretin, kur ajo e pyeti se si do të kishte djalë, kur ajo nuk kish pasur kontakt me asnjë mashkull. Asaj i tha: “...kështu, All-llahu krijon ç’të dëshirojë...”,

Pra, mos u habit, oj Merjeme, se All-llahu ka mundësi të krijojë çfarë të dëshirojë. Ai t’a ka treguar shfaqjen e Fuqisë me dërgimin e riskut dhe tani do të tregojë këtë Fuqi në përzgjedhjen e Tij. Mos u habit oj Merjeme, se a nuk e ka krijuar All-llahu xh.sh., Ademin a.s., pa mashkull dhe pa femër? A nuk e krijoi Havën nga mashkulli, pa femër. Pra, për të Lartësuarin, nuk ka kufizime. Ai tani është në gjendje të krijojë fëmijën nga femra pa mashkull, sikurse është tani shembulli i Isës, birit të Merjemes. Por, gjithashtu, Ai krijoi edhe prej kontaktit të mashkullit dhe femrës, dhe kjo qenie quhet krijesë prej shkaqeve të proceseve natyrore. Nuk kemi pse të habitemi, All-llahu xh.sh., krijon atë, ç’ka Ai dëshiron, dhe kur Ai urdhëron për diçka, Ai nuk mbështetet në shkaqet e proceseve natyrore, por Ai e shfaq Fuqinë e Tij dhe i thotë ‘Bëhu’, dhe ajo bëhet. Prandaj ti, oj Merjeme, mos u habit me sihariqin tim, nga ana e melekëve, sepse All-llahu është në gjendje të krijojë Isain, edhe pa të prekur njeri.

PSE ERDHI MELEKU

Meleku shkoi tek Merjemja i ngarkuar me detyrë. Asaj i është paraqitur në formën e njeriut. Dikush nga njerëzit mund të pyesë, përderisa meleku e përgëzoi Merjemen me fëmijë, dhe përderisa All-llahu i Lartësuar e ka përfshirë nën shfaqjen e Fuqisë, dhe përderisa kur Ai i thotë një gjësendi ‘Bëhu’ dhe ai bëhet, atëherë pse duhej që meleku të vinte tek Merjemja dhe të shndërrohej në formë të njeriut? Këtu, kemi një urtësi të madhe, nga ana e All-llahut xh.sh. E vërteta është se meleku, kur i erdhi Merjemes në formë të njeriut, ishte i ngarkuar që t’i thoshte asaj se, ai ishte i dërguar prej Zotit të saj, për t’i dhënë një fëmijë të zgjuar, dhe të largohej (zhdukej) befasisht pa e prekur. Sikur të mos ndodhte kështu, ajo kishte për të dyshuar. Ajo do të kishte menduar, se mos vallë ky njeri e kish alivanosur (në ndonjë farë mënyre) dhe e kish prekur në kohën, kur ajo ka qenë e përhumbur, ose ka qenë duke fjetur. Kjo formë, do t’a bënte atë, që të mos ishte e bindur në atë, se çfarë kishte ndodhur në realitet me të. Por, përderia asaj i shkoi meleku dhe ai ishte shndërruar në formën e njeriut, dhe përderisa ai i kish treguar se ishte i dërguar nga All-llahu, (për t’i dhënë lajmin) se Ai do t’i dhuronte një djalë të zgjuar, dhe përderisa ai nuk e preku fare, ajo u bind menjëherë për atë se çfarë i ndodhi asaj, dhe ajo e kuptoi se kjo ishte një prej shumë shfaqjeve të Fuqisë së All-llahut, e jo prej ndodhive të njeriut. Për këtë arsye, i Lartësuari dëshiroi t’ia përforcojë asaj zemrën për herë të dytë, pasi ajo, fillimisht, u frikësua apo u trondit nga përgëzimi që i bëri meleku. Vërtet, njeriu kur nuk e pret një gjë, atëherë fytyra i ndryshon dhe natyrisht shpreh habi, dhe (me të drejtë Merjemja) tha: si mund të më ndodhë një gjë e tillë, kur unë nuk kam kontaktuar me ndonjë mashkull? Ishte mëse i nevojshëm ky lloj përforcimi, nga All-llahu xh.sh. për Merjemen, sepse ajo me këtë përvojë do të dinte se si të

ballafaqohej me çifutët, kur ata do t'a sulmonin. Sikur të mos t'a kishte të qartë se çfarë i ndodhi dhe sikur të mos e dinte se (ajo çka ndodhi) ishte prej Fuqisë së All-llahut xh.sh., ajo do të tronditej fare.

Kjo ngjarje ishte e panjohur sepse (një gjë e tillë) nuk kishte ndodhur (kurrë më parë) në historinë e njerëzimit. Këtu do të kishim përplasje mendimesh dhe asnjëri nuk do të dukej (mendim) logjik. Për këtë arsye, ajo duhej t'a kishte shumë të qartë dhe të ishte shumë e bindur, që kur të takohej me familjen dhe shoqërinë që e rrethonte, të mos frikësohej kur ata do t'a mohonin dhe do t'a përgënjeshtrojnë tregimin e saj. Ajo duhej të ishte e bindur dhe t'iu thoshte atyre se, Isai ishte vepër (krijesë) që buroi nga dëshira e All-llahut xh.sh.. Kjo ishte arsyeja se përse, ajo duhej të dinte (paraprakisht) për shfaqjen e Fuqisë, sepse ndodhitë e përziera midis materializmit dhe idealizmit janë delikate. Tek Merjemja, (Shfaqjen e Fuqisë) e kemi në rastin e furnizimit të saj, pastaj dënimin e saj me anën e lutjeve deri sa u bë që qenia njerëzore t'a përjetojë atë, sepse bëhet që të shoh atë që të tjerët nuk janë në gjendje t'a shohin. Më pastaj erdhi informacioni nga ana e melekut, pastaj në bindjen e plotë të Shpirtit ose melekut, i cili që i dërguar nga ana e All-llahut xh.sh. në formën e njeriut dhe në largim (zhdukjen) e tij para saj, pa e prekur fare, por dhe përkundër të gjitha këtyre, ajo tha: “O Zot, si të kem unë djalë, kur mua nuk më ka prekur njeri, gjithashtu nuk isha imorale”¹⁰⁵.

Për të dytën herë, ajo u kthye tek shkaqet e proceseve natyrore. All-llahu xh.sh. iu përgjigj:

¹⁰⁵ Kur'an, 19/20

“...ajo për Mua është e lehtë dhe, (le t’a konsiderojnë) njerëzit se ishte argument dhe mëshirë nga Ne, ndërsa kjo (vepër) është punë e kryer”¹⁰⁶

Këtu shihet se si All-llahu xh.sh. i përgjigjet Merjemes në mënyrë më të prerë, pasi ajo shfaq habinë për të dytën herë. I Lartësuar i tha: kjo për Mua është e lehtë, dhuroj atë çka dua, pa ndërhyrjen e njerëzimit dhe ky fëmijë do të jetë argument për njerëzimin, ose mrekulli nga All-llahu xh.sh., për krijesat e Tij, që të largohen prej materializmit, që njerëzit kanë filluar t’a besojnë. Gjithashtu, kjo ishte mëshirë për të gjithë ata, që e përcjellin këtë rrugë dhe kjo (punë) do t’u ndihmonte në programet e tyre, duke qenë si shembull për ta, dhe kjo do t’a shpëtonte nga devijimi popullin çifut dhe materializmin e tyre : “...ndërsa kjo (vepër) është punë e kryer”. Dëshira e All-llahut ishte t’i tregonte Merjemes se, kjo punë kishte marrë fund, ishte vendim i prerë dhe ajo nuk kishte alternativë tjetër. Pas gjithë asaj parapërgatitje, ajo duhej të ishte e bindur në zemër, se kur i Lartësuar dëshiron një gjë, i thotë ‘Bëhu’ dhe ajo bëhet, prandaj kjo punë kishte marrë fund. Ajo nuk kish fuqi të thoshte as ‘po’, as ‘jo’. Kështu, ajo mbeti shtatëzanë në sajë të shfaqjes së Fuqisë. Ajo iku larg kontakteve me njerëzit, pasi kishte frikë të ballafaqohej me ta, edhe pse tani ajo kishte bindje të plotë se ajo që ndodhi, ishte argument nga All-llahu xh.sh. Megjithatë, kishte frikë se si do t’u përgjigjej dhe si t’ua shpjegonte çifutëve shfaqjen e Fuqisë, kur ata nuk e njihnin këtë fushë, sepse ata ishin materialistë. Materia nuk e shfaq detajisht trupin, ajo nuk ka transparencë të plotë, ajo mbështetet vetëm në ngurtësinë e saj, ajo nuk sheh më larg se materia e pastërt, ajo nuk i njeh të fshehtat. Si do të shkonte tek ai popull, e t’iu thoshte atyre se

¹⁰⁶ Kur’an, 19/21

kjo ishte nga shfaqja e Fuqisë së All-llahut? Si do t'a besonin, kur ata nuk kishin dituri (rreth kësaj çështjeje)?

MERJEMJA U FRIKËSUA

Ballafaqimi me bashkëvendasit e vet e frikësonte pa masë Merjemen. Ajo u detyrua të merrte një rrugë të gjatë për t'a lindur fëmijën. E kishte shumë të vështirë t'iu shpjegonte shfaqjen e Fuqisë, kur ata nuk kuptonin asgjë prej saj. Kjo ishte një mrekulli prej mrekullirave të shfaqjes së Fuqisë, ajo kishte bindje në ngjarjen që do të ndodhte, në bazë të shumë argumenteve (të tjera) që i ishin shfaqur asaj, nga All-llahu xh.sh., më parë. Përgëzimin që ia bëri melekui, pastaj shfaqja e melekut sërish, ia vërtetoi bindshëm asaj ndodhinë, pasi ai (meleku) se preku fare, si dhe fjala e All-llahut xh.sh.: “ndërsa kjo (vepër) është punë e kryer”, të gjitha këto, e bënë atë të fuqishme dhe bindëse, dhe ajo nuk kishte frikë se kishte bërë ndonjë imoralitet, por, megjithatë, si do t'iu prezantohej bashkëvendasve të saj!? Si do t'ua shpjegonte ajo, se çfarë ndodhi me të, dhe si t'i bindte ata që t'a besonin?

I Lartëmadhëruari, i kishte parasysh të gjitha këto. Atij nuk i shpëton asgjë pa e ditur, sepse ai e njeh krijesën e Vet. Ai e dinte se kur Merjemja do të përballej me çifutët, ajo do t'u tregonte se kjo ishte nga shfaqja e Fuqisë, por ata nuk do t'a besonin dhe nuk do t'a dëgjonin, gjithashtu do të shpifnin lloj lloj shpifjesh. Në këtë kohë, asaj i erdhi zgjidhja prej qiellit. I Lartësuar i tha asaj: Ti, mos fol, sepse Unë dua që ti, të mos flasësh! Ti, sado të orvatesh që t'i bindësh, ata do të

përgojnë dhe do të shpifin kundër teje. Por, ai i cili do të flasë, do të jetë foshnja, i cili sapo ka lindur. Unë do të bëj që ai të flasë para masës, për t'iu treguar shfaqjen e Fuqisë. Kur do t'a shohin atë, atëherë do të besonin, sepse nuk ka fëmijë në botë që të ketë folur menjëherë pas lindjes së tij, madje edhe pas një viti. Unë do të bëj që, Isai, i biri Merjemes, të flasë menjëherë pas lindjes së tij.

Pse bëhej kjo? Për arsye mrekulie?! Jo! All-llahu xh.sh. është përmbi të gjithë dhe Ai nuk ka nevojë për t'a dëshmuar mrekullinë e Tij. Por, Ai, për të mirën e tyre e paraqiti Shfaqjen e Fuqisë tek foshnja e sapolindur, mbase ata do t'a kuptonin se ishin në humbje, dhe kështu, t'i ndienin mëkatet e tyre të mëdha, për shpifjen ndaj Merjemes.

Pra, Isai, biri i Merjemes foli, dhe shikoni se çfarë fjalimi preçiz na paraqet i Lartësuari, në Kur'anin Kerim: “Dhe nga poshtë saj u dëgjua një zë: Mos u pikëllo, Zoti yt bëri që poshtë teje të kesh ujë të rrjedhshëm (burim uji)”¹⁰⁷

Pra, Isa a.s., biri i Merjemes, në momentin e lindjes, pas pak minutash foli, ai foli para se nëna e tij t'a ledhatonte. Mos u brengos se Zoti yt bëri që poshtë teje të ketë dritë, që do të udhëzojë në drejtësi.

Këto fjalë të Isait a.s., ishin përgjigje për Merjemen e cila po mendonte, se si do të ballafaqohej me bashkëvendasit e vet dhe cili do të ishte epilogu (i atij ballafaqimi). Kjo situatë, për të, ishte shumë e vështirë, derisa mendja i shkante: “Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj (ngjarje) e të isha

¹⁰⁷ Kur'an, 19/24

harruar përgjithmonë”¹⁰⁸. Në momentin kur ajo po dëshironte vdekjen, sepse e dinte se çfarë e priste nga bashkëvendësit e saj, se si ata do t’a pritnin me fyerje, me shpifje dhe (kur po mendonte) për të gjitha vuajtjet e mëtutjeshme që do t’i vazhdonin, pra, në kulmin e këtyre momenteve të vështira për të, foli biri i saj, Isai, duke i thënë nënës së vet: “Zoti yt bëri që poshtë teje të kesh ujë të rrjedhshëm (burim uji)”, pastaj vazhdoi edhe më tutje duke e këshilluar nënën. Ajo, në ato momente kishte nevojë për ujë dhe ushqim, sa për t’a marrë veten dhe sa për t’a forcuar veten për të ardhmen, dhe i tha: “Dhe shkunde trungun e palmës, se ajo do të lëshojë mbi ty hurma të freskëta e të pjekura. (Kështu pra) Ha e pi dhe freskohu (bëhu e kënaqur)...”¹⁰⁹

Pastaj erdhi edhe ajeti tjetër, më me peshë për të, nga All-llahu xh.sh.: “...dhe po të takosh ndonjë njeri, thuaji: unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj (do të përbahem nga të folurit), dhe kështu sot nuk do t’i flas asnjë njeriu”¹¹⁰

Kështu, i tha Isai, i biri Merjemes, nënës së tij nga Shpirti i Shenjtë. I mbështetur nga drita prej All-llahut të Lartësuar, i tha: Askush nuk kërkon prej teje të flasësh, sepse sado të përpiqesh t’a justifikosh veten, nuk do të kesh sukses. Nuk do të jesh në gjendje për t’i bindur të gjithë, pasi ata janë larg njohjes së shfaqjes së Fuqisë. Ndërsa unë kam ardhur për t’ua larguar ato ide materialiste, që ata adhurojnë. Ato që unë posedoj janë shfaqjet e Fuqisë. Sado të përpiqesh, askënd nuk do të mund t’a bindësh. Fjala jote, sado e drejtë, nuk do të ketë sukses, prandaj thuaj: “...unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj (do të përbahem nga të folurit)...”.

¹⁰⁸ Kur’an, 19/23

¹⁰⁹ Kur’an, 19/25-26

¹¹⁰ Kur’an, 19/ 26

Kjo nënkupton se Merjemja kishte vendosur të mos fliste, pra se në emër të All-llahut xh.sh., do të përmbahej nga të folurit dhe nuk do t'i fliste asnjë njeriu. Ai, i cili do të flasë, do të debatojë dhe do t'iu përgjigjet argumenteve tuaja është kjo foshnje e vogël, që ka lindur pak orë më parë. Ky do të jetë ai, i cili do t'iu përgjigjet, me qëllim që të jetë për ju argument materialist dhe i prekshëm. Ky pra, para jush, është i dërguar me anën e shfaqjes së Fuqisë së All-llahut xh.sh., sepse ju nuk besoni veçse materien, prandaj edhe argumenti (për t'iu bindur juve) është material. Për t'iu përgjigjur mashtrimeve tuaja, I Lartësuar i zgjodhi për ju mrekullinë prej të njëjtut lloj, të cilit ju i besoni. Njëkohësisht, do të jetë argument i All-llahut xh.sh. për ju, sepse nuk do të keni mundësi t'a mohoni këtë mrekulli dhe as t'a fshihni këtë argument.

Kjo mundësi, që iu ofrua Merjemes, filloi t'ia qetësojë asaj zemrën. Ajo e kuptoi se asaj, i ishte thënë se ishte femra më e zgjedhur nga gjitha femrat e botës, dhe asaj filloi t'i vijë shpirti sërish, sepse e kuptoi se nuk paska qenë e anashkaluar. Ajo tani do të ketë me vete një argument, i cili do t'a shfajësonte atë dhe do të ishte bindës. Pra, kjo foshnje e vogël e dobët, do të bëhej dëshmitar i shfaqjes së Fuqisë dhe Madhësisë së All-llahut xh.sh. dhe vërtetësisë së Merjemes.

PËRBALLJA ME MREKULLINË

Ajo, pra, u qetësua dhe u bind vetëm atëherë kur e kuptoi se i Lartësuar i kish dërguar me të (foshnjen), edhe argumentin materialist. Tani, argumenti që kishte me vete, nuk linte fare dyshim se ajo ishte në (rrugë) të drejtë, prandaj iu qetësua zemra, dhe e mbushur plot energji të reja mori

djalin dhe shkoi tek bashkëvendasit e saj. Kur'ani Kerim, thotë: “Duke e bartur atë (foshnjen) shkoi tek bashkëvendasit e vet. I thanë: Oj Merjeme, na erdhe me një vepër shumë të shëmtuar. Oj motra e Harunit, babi yt nuk ishte keqbërës, e as nënën s’e kishe lavire (imorale)”¹¹¹.

Që në fillim, i ndodhi përballja, të cilën Merjemja e kishte pritur. Bashkëvendasit e saj, çifutët, para se të dëgjojnë nga ajo ndonjë fjalë, e sulmuan me fjalë shumë fyese. Ndërsa ata, për të cilët kemi thënë se nga natyra e tyre ishin popull materialist, nuk pritën që ajo të nxjerrë qoftë edhe një fjalë të vetme nga goja e saj. Të paktën t’ia jepnin mundësinë që t’u sqaronte atyre, se çfarë ndodhi me të. Do të ishte shumë logjike, që kjo të ndodhte, por nuk habitemi me çifutët. Ishte e mundur që të paktën t’a pyetnin për foshnjën, pasi shumë lehtë mund të ndodhte që ai të mos ishte fëmija i saj. Është shumë e arsyeshme t’a kishte gjetur dikund, si një fëmijë të braktisur dhe, për t’a shpëtuar nga rreziqet, e kishte marrë me vete. Ndoshta kishte qenë jetim, i kish humbur prindërit dhe Merjemja e mori dhe e solli tek populli i saj. Çifutët nuk do të ndiheshin të poshtëruar, sikur t’i merrnin parasysh të gjitha këto raste të mundshme. Por, gjëja e parë që i shkoi ndërmend këtij populli, ishte ajo më e keqja. Ata e pritën me shantazhe dhe e sulmuan atë me shpifjen më të madhe të mundshme, duke ia përmendur veprimet dhe sjelljet e mira të prindërve dhe vëllait të saj Harunit.

Ata, e bënë këtë krahasim, duke pasur për qëllim (të tregonin) se edhe kjo duhej të ishte e drejtë sikur edhe familja e saj, me virtyte të larta, me moral dhe me karakter të fortë. Por ata, që në fillim, e sulmuan me shprehje shumë të rënda dhe fyese. Nga Kur’ani Kerim, mësojmë se sa të pamoralshëm ishin çifutët dhe sa të nxitueshëm ishin në gjykimin e tyre. Ata u bazuan në

¹¹¹ Kur’an, 19/ 27-28

supozimet negative të këqija, për shkak se ishin nxitës të së këqijave, përhapës të intrigave dhe shpifës. Gjithashtu, Kur'an i na mëson se këta kishin qenë që i kishin vrarë nebijët-lajmëtarët e All-llahut xh.sh. Kjo vepër e shëmtuar e tyre vinte nga urrejtja, e cila nuk i linte ata të mendonin mirë dhe me kohë.

Atëherë, pas gjithë kësaj, ç'bëri Merjemja? Ajo vetëm bëri shenjë me gishtin tregues kah Isai a.s., që e mbante në duar. Populli u habit, nuk pritnin një përgjigje të tillë prej saj. Ata prisnin që ajo të fliste, të mbrohej, t'iu thoshte se jam e pafajshme, ose të paktën le të shpjegohej. Ky ishte supozimi i tyre, se çfarë duhej të ndodhte prej saj. Por, panë diçka të papritur prej gjestit të saj, ajo bënte shenjë drejt foshnjës. Atyre, iu ishte larguar nga mendja shfaqja e Fuqisë, sepse veprimet e tyre mbështeteshin në shkaqet e proceseve natyrore. Ata u tronditën nga përgjigjia e saj, dhe nga habia iu drejtuan asaj duke i thënë: “Si t'i flasim atij, që është foshnje djepi ?!”¹¹².

Ata, në formë tallje, sikur donin t'i thonin asaj se: ti po turpërohesh të flasësh, jo, jo thuaje atë se ç'ke për të thënë, e lëre atë shenjë të gishtit. Ne duam të dëgjojmë nga ti, sepse nuk kemi se si t'i flasim kësaj foshnjeje që sapo ka lindur. Ai kishte lindur para një ditë, ose dy ditëve.

Si mund të kërkosh nga ne të bisedojmë me këtë, na thuaj si të flasim me të, a flet ky?! Nuk ka njeri me logjikë të shëndoshë, që ka besim materialist, që të besojë se foshnja e porsalindur mund të flasë.

Por, i Lartëmadhëruari, bëri që Isai a.s., i biri Merjemes të flasë. Ai foli duke qenë foshnje. Foli për t'iu treguar për shfaqjen e Fuqisë së All-llahut. Sipas rregullave të proceseve natyrore, të

¹¹² Kur'an, 19/ 29

vendosura nga All-llahut për qeniet njerëzore, foshnjët nuk fillojnë të flasin para një viti. Në këtë rast, Lartëmadhëria bëri përjashtim, Ai bëri që foshnja e porsalindur të flasë. Ai nuk foli fjalë boshe fëmijësh, por fjalët e tij ishin fjalë të një burri të pjekur dhe ishin shumë logjike. Ai filloi t'u përgjigjet pyetjeve të tyre, dhe të fliste me ata, sikur të ishte një burrë me mendje të mprehtë, për çdo gjë.

MREKULLIA DHE URTËSIA

Pse ju erdhi kjo mrekulli? Pse All-llahu xh.sh. bëri që, ai popull materialist, të besojë se çfarë i ndodhi Merjemes? Sikur ajo t'a lindte foshnjën sikurse të gjitha gratë e tjera, ai fëmijë nuk do të fliste asnjë fjalë. Sikur edhe të ishte rritur goxha shumë, nuk do të prisnin aso shprehje me logjikë shumë të shëndoshë. Në të kishte shprehje rrënjëqethëse, të pjekura, logjike, argumentuese dhe me plot kuptim. Por, përderisa Isai, i biri i Merjemes, foli një ose dy ditë pas lindjes së tij, kjo linte të kuptohej se kjo foshnje nuk ishte lindur sikurse foshnjët e tjera, që lindin prej bashkimit të mashkullit dhe femrës. Ajo (lindja e tij) ishte një mrekulli, fjalët e tij treguan se tek ajo (Merjemja) ishte në pyetje një gjë krejtësisht tjetër, dhe kishte të bënte me një Fuqi mbinatyrore.

Vetvetiu, lihej të kuptohej se atë nuk e kishte prekur asnjë mashkull, pasi Isai a.s. ishte krijuar me shprehjen 'Bëhu'. Sikur Merjemja të kishte pasur kontakt me ndonjë mashkull, fëmija saj do të ishte i thjeshtë, si gjithë të tjerët dhe do të kishte një lindje normale. Do të ishte shumë e logjikshme që, në momentin kur Isai a.s. foli, ata të kuptonin se para tyre ishte një mrekulli, në të

cilin shfaqej ndërhyrja mbinatyrore dhe duhej të besonin çdo gjë që t'iu thoshte Mejremja dhe t'a pranonin Isain të dërguar të All-llahut xh.sh.

Çfarë iu tha Isai, biri Merjemes? Fjala e parë, që ju tha, ishte: “Unë jam rob i All-llahut, më ka dhënë Librin dhe më bëri lajmëtar (të së vërtetës-nebij)”¹¹³.

Lajmi i parë prej tij ishte, se ai ju tregoi se është i privilegjuar me dërgesën e All-llahut, duke ju thënë se ai ishte rob i All-llahut, që të mos shpifin njerëzit më vonë për lindjen e tij, sepse barra e tyre është më e madhe se e tij. Ai iu tregoi se është rob prej robërve të All-llahut, njeri dhe i dërguar i Tij. Pastaj vazhdoi të thotë: “më ka dhënë Librin dhe më bëri lajmëtar (të së vërtetës-nebij)”. I Lartëmadhëruari më ka dhuruar një Libër, të cilin do t'ua prezantoj. Libri i veçantë, që do të vijë nga qielli për ju. Kjo ishte mrekullia e parë e Isait a.s., që kur filloi të flasë. Ai u paralajmëroi të ardhmen duke qenë në djep. Ai u tha se, i Lartëmadhëruari më ka dhënë një libër për ju, për t'iu udhëzuar në rrugën e drejtë.

Ai më bëri edhe nebij dhe mbi të gjitha më ka dhënë urtësinë, e ju po e shihni këtë urtësi, duke qenë se unë po flas me ju. Këto fjalë, që po ua them nuk janë të një foshnje të rëndomtë, por, të një burri i cili ka urtësinë dhe posedon fuqi të debatojë dhe të hapë polemika me ju, për gjithçka që dëshironi. Nebijiteti, shpalosja e sekreteve dhe libri i paralajmëruar, duke qenë që në djep, ishin mrekullia e dytë e shfaqjes së Fuqisë për të. Që në këtë kohë, ju tregoi atyre se të folurit e tij si foshnje, nuk është mrekullia e vetme e tij, por ai ka edhe urtësinë.

¹¹³ Kur'an, 19/ 30

“Më ka bërë të begatshëm (dobiprurës) kudo që të jem dhe më ka porositur me namaz, zeqat derisa të jam gjallë”¹¹⁴

Ai vazhdoi t’u tregojë atyre se, All-llahu i Lartëmadhëruar i ka mundësuar atij që të bëjë mirë ngado që të shkojë. Ngado që të shkojë ai, do të shfaqet bereqeti dhe do të ketë bollëk. Kështu më ka porositur All-llahu që t’a adhuroj Atë, me besim të plotë, derisa të jem gjallë. Secilit njeri, i është obliguar adhurimi, deri sa të jetë gjallë, derisa t’a mbajë trupi shpirtin. Kjo është koha kur njeriu ka mundësi të shprehet pro ose kundër urdhërave obligative. Para ardhjes në këtë jetë dhe pas vdekjes, njeriu nuk ka lirinë e zgjedhjes, ai është i detyruar. I lartëmadhëruari, në Kur’anin Kerim, thotë: “Për t’i këshilluar të gjallët...”¹¹⁵

Pra, Kur’ani është për të gjallët, e jo për të vdekurit. Askush prej atyre, që kanë mëkatuar në këtë botë, nuk mund të thotë se unë do të bëj adhurim të vërtetë, pasi të vdes, dhe kështu do t’i shlyej mëkatet e kësaj bote. Të gjitha veprimet e bijve të Ademit ndërpriten pasi të vdesin. Le ta dijë secili veten e vet. Në momentin e agonisë, në momentin kur fillon të dalë shpirti nga trupi, birit të Ademit i paraqiten veprat e tij, e në atë moment, nëse do t’a ketë përfundimin e mirë, do të buzëqeshë dhe do të ketë lehtësime trupore.

Vërtet, nëse këtij personi ia përkujtojmë të kaluarën, do të shohim se ishte një njeri me të kaluar të mrekullueshme. Ndërsa, sikur të kishte të kaluar të keqe, përfundimi tij do të ishte i mundimshëm, do të kishte vuajtje dhe fytyra do t’i prishej. Në kohën e agonisë, dy dëshmitë dhe

¹¹⁴ Kur’an, 19/ 31

¹¹⁵ Kur’an, 36/ 70

gjuha do t'a tradhtojnë. Që nga ai moment, ai do t'a dijë se është prej të dënuarve me zjarr. Pra, kur të vijë momenti i agonisë, ai do t'a kuptojë saktësisht se është i vdekur. Ato, janë momentet e para të jetës tjetër. Kështu, ishin fjalët e Isait a.s., birit të Merjemes, i bindur se është nebij dhe nuk mund t'i ikë përgjegjësisë. All-llahu i Lartëmadhëruar kishte kërkuar nga ai, duke e porositur, që t'a adhurojë singërisht derisa të ishte gjallë.

Isai, biri i Merjemes, vazhdoi t'a plotësojë porosinë e All-llahut xh.s., duke thënë: "...dhe (më ka porositur) të jem mirënjohës me nënën time..."¹¹⁶. Nuk e kishte porositur të ishte mirënjohës ndaj prindërve të tij. Kjo vlente për çifutët, që të kuptojnë përsëri se, Merjemja kishte sjellë me vete mrekullinë e All-llahut xh.sh. Sikur Isai a.s., të ishte krijuar prej kontaktit të mashkullit dhe femrës, do t'i ishte thënë të ishte mirënjohës ndaj prindërve, por atij iu tha të ishte mirënjohës ndaj nënës së tij, që të jetë dëshmitar i vërtetësisë së formës së krijimit, pasi ai nuk erdhi prej (bashkimit të) mashkullit dhe femrës, por nga shfaqja e Fuqisë tek Merjemja, pa e prekur atë asnjë mashkull.

DO T'IU MJAFTONTE MREKULLIA

Mendoj se, këtu, duhet të ndalemi pak. Kur Merjemja shkoi tek populli i saj me foshnjen dhe Isai foli duke qenë në djep, kjo mrekulli do të kishte mjaftuar për t'i bindur çifutët, se ajo që i kishte

¹¹⁶ Kur'an, 19/ 32

ndodhur asaj, nuk ishte diçka e zakonshme. Sikur, mbarë njerëzimi, të mendohej për t'a bërë një gjë të tillë, nuk do të mundej me anë të proceseve natyrore. Por i Lartëmadhëruari, e dinte inatin e çifutëve dhe mendjemadhësinë e tyre kundrejt të vërtetës dhe animin e tyre në drejtimin e gabuar. Megjithatë, dëshiroi që t'u sillte atyre më shumë argumente. Vetëm e vetëm t'a përforconte pozitën e Merjemes për gjithçka, që ata mund të thonin. Jo vetëm që bëri që foshnja të flasë, por kjo foshnje u tregoi atyre se ai kishte lindur prej femrës, të cilën nuk e kish prekur asnjë mashkull.

Këtë ua tregoi atyre, me anë të fjalimit të tij, se ai ishte i dërguar dhe peygamber. Ai kishte mbështetje të drejtëpërdrejtë nga All-llahu xh.sh. me mrekullitë e Tij, që prej lindjes së tij. Ai kishte për detyrë t'u tregonte edhe mesazhin dhe programin. Këtu, kemi argumentin, që vërteton besnikërinë e tij, kur ai iu tha se: 'i është mirënjohës nënës së tij', e nuk tha të prindërve të tij, e me këtë, ai e vërtetonte mrekullinë e Merjemes. Kështu, i Lartësuari, u jepte çifutëve argument pas argumenti, për shfaqjen e Fuqisë. Gjithashtu, e vërtetonte edhe dërgesën e Isait a.s., edhe pse ata (çifutët) paraqiteshin arrogantë dhe jobesimtarë.

Isai a.s., vazhdoi duke ju thënë: "...e nuk më ka bërë kryelartë dhe të padëgjueshëm"¹¹⁷. Pra, unë nuk kam ardhur për të shprehur arrogancë dhe mendjemadhësi. Nuk kam ardhur për t'iu sjellë probleme, vuajtje, për t'iu shkatërruar dhe për t'iu detyruar për gjëra të këqija. Gjithashtu, nuk kam ardhur që të përhapim frikë dhe vëllavrasje, por kam ardhur nga mëshira e All-llahut xh.sh., si Mëshirë prej Tij, për t'ju udhëzuar me programin, që ju e kishit braktisur dhe që keni filluar të ndiqni teket dhe pasionet tuaja.

¹¹⁷ Kur'an, 19/ 32 sipas Sherif ef. Ahmetit

Ato rregulla, që ndiqnin ata, ishin njerëzore, ishin të bazuara në pasione, prandaj mos u mbështetni në to, e largojuni atyre përfundimisht. Erdha tek ju, mëshirë prej Tij, që t'iu lejoj disa gjëra që ia kishit ndaluar vetes. Në të ka mëshirë dhe mirësi prej All-llahut xh.sh., Ai e ka larguar hidhërimin e Tij ndaj jush dhe ju ka larguar disa prej vështirësive, që ju ishin obliguar nga All-llahu i Lartëmadhëruar. Unë erdha tek ju, që t'i largoj të gjitha këto, me mëshirën e All-llahut. Konsiderojeni si mëshirë (prej Zotit, që ju mundësoi) kthimin në programin (e Tij të drejtë), që të jeni në gjendje të shkoni rrugës së drejtë, që t'iu largojë nga hidhërimi dhe dënimi i Tij.

Erdha tek ju, që t'ua lehtësoj jetën tuaj dhe t'iu lejoj edhe disa gjëra që iu ishin ndaluar. Gjithashtu, erdha edhe me një mëshirë tjetër (nga ana e Zotit për ju) që t'ju nxjerr nga ideologjia materialiste, në të cilën jeni zhytur, për t'iu dhënë vizionet metafizike dhe për t'iu treguar disa sekrete të All-llahut xh.sh. Ju duhet t'a besoni Atë dhe të udhëzoheni prej Tij. T'a dini se krahas botës materiale, qëndrojnë botëra (të tjera), por, ju keni edhe sekretin e shpirtit që nuk është materie, së cilës ju po i besoni dhe të cilën (botën materiale dhe rregullat e saj) e keni marrë në vend të Zotit.

Ju keni All-llahun xh.sh., i Cili me Fuqinë e Tij, ju mundëson të gjitha ato gjëra, që ju i dëshironi. Mos e anashkaloni këtë program, e të besoni botën materiale, se do të jeni të humbur.

All-llahu nuk më bëri tiran, por Ai më dërgoi mëshirë për ju. Ai nuk më dërgoi të padëgjueshëm, që t'iu gjykoj ju, e pastaj të dënoheni dhe të vuani. Ai më dërgoi të jem në mesin tuaj, që ju të jeni të kënaqur prej Tij dhe Ai të jetë i kënaqur me ju. Ai ishte i kënaqur me mua në këtë botë dhe (do të jetë i kënaqur me mua) në ahiret, dhe nuk më ka bërë prej atyre, që do të jenë të dënuar, të cilët kanë shkaktuar hidhërimin e All-llahut në këtë botë, dhe do të fitojnë dënimin e Tij në ahiret.

Pasatj, Isai a.s., vazhdoi duke ju thënë: “Selami (shpëtimi prej All-llahut) është me mua ditën kur u linda, ditën kur do të vdes dhe ditën që do të dal (prej varrit) i gjallë!”¹¹⁸ Ky verset, ka në vetvete kuptime shumë të thella. Mendoj se, këto tri ngjarje, janë polemizuar më së shumti në botë. Dita e lindjes dhe forma e lindjes. Dita e vdekjes dhe ngritja në qiell dhe Dita kur do të dalë i gjallë. Pra, ajo Ditë, kur do të ringjallet (Isai a.s.) në kohën e fundit (para shkatërrimit të botës), për t’i udhëzuar njerëzit, ose ringjallja në Ditën e Kijametit.

Edhe sot e kësaj dite, debati rreth këtyre tri pikave vazhdon të jetë i freskët dhe kjo do të vazhdojë kështu, deri në Ditën e Kijametit. Edhe sot, vazhdon debati midis të krishterëve dhe çifutëve rreth lindjes së Isait, të birit të Merjemes. Akoma vazhdojnë argumentet mbi lindjen e tij, të cilat janë të kundërta me njëra tjetrën, midis tyre. Akoma paraqiten teori filozofike.

Filozofët, të cilët shkruajnë rreth fesë, vazhdojnë të sjellin transmetime dhe ide të kundërta, rreth lindjes së Isait, ndërkohë që Kur’ani i ka përgënjeshtuar ose mohuar fare qëndrimet e tyre. Transmetimi, që vjen nga ana e All-llahut, është i vërtetë, ndërsa të tjerët, vetëm sa duan të kundërshtojnë. Por, mjerisht, teoritë dhe filozofitë vazhdojnë njëra pas tjetrës. Atyre, do të duhej t’iu mjaftonte ajo, që na tregoi i Lartëmadhëruari nga Shfaqja Fuqisë së Tij, rreth lindjes së Isait a.s. (Do të mjaftonte) Vetë fjala e foshnjes dhe mrekullirat që (Zoti) i mbështeste tek ai, si edhe Xhebraili, i cili nuk i largohej Isait a.s., para polemikave dhe shpifjeve që i mvisheshin prej çifutëve.

¹¹⁸ Kur’an, 19/ 33 sipas Sherif ef. Ahmetit

Por, edhe pse ishin të gjitha këto mrekulli, si: prezenca Hyjnore tek lindja e Isait, kërkesat e tij rreth shpirtërores, apo sekretet dhe Shfaqjen së Fuqisë që kishte me vete, polemika rreth Isait a.s. vazhdon të jetë e nxehtë. Nëse i shpalosim librat sot, do të shohim se ato i pëmbajnë këto polemika, duke sjellë argumente dhe kundërgjegje. Një argument e anulon argumentin tjetër. Edhe pse ky debat vazhdon, Isait a.s., i është dhënë shpëtimi dhe siguria prej All-llahut që në ditën e lindjes dhe pafajësia prej All-llahut xh.sh., prej të gjitha polemikave që do të ndodhin.

Gjithashtu, debatohet edhe rreth vdekjes së Isait a.s. Kur'ani Kerim na tregon se Isai nuk ishte kryqëzuar, por All-llahu xh.sh. e kishte ngritur atë. Pa dyshim se rreth shprehjes 'e ka ngritur' duhet të ndalemi më shumë. Por, ajo që është me rëndësi, është se Isai a.s., prej lindjes së tij, deri në vdekjen e tij, kish mbështetjen e Fuqisë së All-llahut xh.sh.

Lindja e tij, të folurit i tij qysh se ishte foshnje e posalindur, ishin mrekulli, edhe gjërat e tjera, të cilat i bëri si peygamber, që të gjitha duhet t'i adresohen mrekullisë. Që të gjitha ato, kishin mbështetje nga shfaqja e Fuqisë së All-llahut xh.sh. Ato ishin vepra, në të cilat nuk përfilleshin proceset natyrore. Përse duhet që ngritjen e tij në qiell, t'a shkëpusim nga të gjitha mrekullitë e tij të tjera? Pse të besohet shfaqja e Fuqisë në lindjen e tij dhe mrekullitë e tjera të tij, e të polemizohet rreth vdekjes së tij dhe shkuarjes në qiell, duke ia atribuar (këtë të fundit) proceseve natyrore?

Mesazhi i tij mbështetet, për të gjitha ndodhitë, me logjikën e shfaqjes së Fuqisë së All-llahut xh.sh., e jo me logjikën e proceseve natyrore. Nuk duhet të pranojmë se një pjesë e jetës së Isait a.s., ishte nga shfaqja e Fuqisë, e pjesën tjetër t'ia atribuojmë proceseve natyrore, pasi kështu do t'a kundërshtonim vetveten dhe do t'a ngatërronim logjikën. Ne duhet t'a marrim të tërë jetën e

Isait a.s., që prej lindjes, peygamberisë dhe ngritjes së tij në qiell, si veprime të kryera nga shfaqja e Fuqisë, i cili kur shfaq dëshirën, mjafton t'i thotë 'Bëhu' dhe ajo bëhet, dhe mos t'a ngatërrojmë me shkaqet e proceseve natyrore, që njohim ne.

PSE ATËHERË POLEMIKË?

Shtrohet pyetja: pse të polemizohet rreth ngritjes së Isait a.s., në qiell? A ishte ajo me trup, apo vetëm me shpirt? Ne, gjithashtu, (ngjashmërisht) me një ngjarje të tillë, kemi të bëjmë edhe me mrekullinë e të dërguarit tonë, Muhammedit s.a.v.s. Ai udhëtoi me trup, deri në Sidretu al Munteha, pastaj u kthye në tokë përsëri. Kjo ngjarje, na është e vërtetuar shumë bindshëm, jo vetëm nga i Dërguari s.a.v.s., por për këtë rast na tregoi edhe Vetë i Lartëmadhëruari, në Kur'anin Kerim. A mundet ndokush, t'a ndalojë shfaqjen e Fuqisë së All-llahut xh.sh., që Ai t'a ngrejë Isain a.s., në qiell me trup?

Ai, i cili beson bindshëm në shfaqjen e Fuqisë së All-llahut, (është i bindur se), Atë nuk mund t'a kushtëzojë askush, Atë nuk e pengojnë rregullat dhe kufijtë tanë, Atë se pengon asnjë shkak, e as shkaktues, derisa vepra i atribuohet All-llahut xh.sh. Ishte Ai, i Cili e mori Muhammedin s.a.v.s., në qiell dhe ishte Ai, që e ngriti Isain a.s. Ajo, që është më kryesorja dhe më e rëndësishmja për ne, është se ne duhet t'a ndajmë mendjen për ndodhinë. Nëse ajo është vepër prej veprave të All-llahut xh.sh., ne nuk duhet të kemi kurrfarë polemike rreth saj. Atij nuk i ngjason askush prej të gjitha krijesave, që ne i dimë, e nuk i dimë. Vepra e Tij, nuk ka të bëjë me kohën dhe hapësirën, e

as me ligjet tona, sepse Ai është Krijuesi i të gjithëve ne, Atij i mjafton të thotë për diçka 'Bëhu', e ajo bëhet menjëherë.

Pra, këtu, nuk kemi përse të polemizojmë. Çdo debat është i logjikshëm dhe i arsyeshëm, atëherë kur kemi të bëjmë me vepra, që u përkasin mundësive njerëzore, ose me ata që kanë fuqi të kufizuar. Nëse kemi të bëjmë me një vepër, që është prej All-llahu xh.sh., nuk ka përse të debatojmë dhe nuk kemi përse të polemizojmë. Kështu, është edhe rasti rreth shfaqjes së Isait a.s., në kohën e fundit, i cili do të vijë në prag të përfundimit të kësaj jete. Në rastin e parë, kemi dallim midis mrekullisë së Muhammedit s.a.v.s. dhe mrekullisë së Isait a.s. Këtu kemi dallim kohor dhe hapësinor. Muhammedi s.a.v.s. u ngjit në qiell, pastaj u kthye në tokë për një kohë relativisht të shkurtër, ndërsa Isai a.s., do të vazhdojë të mbetet (në qiell) një kohë shumë më të gjatë. Allahu i Lartësuar nuk ka të bëjë asgjë me të kuptuarit e kohës, ashtu siç e kuptojmë ne. Shprehja kohë, për Të, nuk ekziston.

Pas gjithë kësaj që thamë, po kthehem përsëri, që t'a përsëris edhe një herë, pasi mendoj se kjo vepër duhet të specifikohet mirë. Kur kemi të bëjmë me gjëra tokësore, duhet t'i cilësojmë dhe t'i atribuojmë si vepra tokësore. Kur ne bëjmë dallime midis nesh, atëherë ku mbetet vepra që vjen prej All-llahut xh.sh.? P.sh.: Një gosti që bëhet nga ministri, apo presidenti i shtetit, ka dallim nga ajo e një njeriu të rëndomtë. Njeriu nuk ndihet njëloj nëse ka ftesë prej presidentit, ose një ministri, në krahasim me ftesën e një personi të rëndomtë. Vetëvetiu, e di se dollia e organizuar nga presidenti, është e tipit të lartë dhe ajo bëhet në një vend shumë luksoz dhe në të ka njerëz prestigjioz të shtresës së lartë, nga vendi dhe të huaj.

Ndërsa ceremonia e të varfërit, mbahet në një vend të thjeshtë, ka pak njerëz, të cilët janë të thjeshtë. Në të dyja rastet e kam përdorur logjikën vepruese. Me këtë u mundova të bëj një dallim, edhe pse ky dallim është shumë i varfër me atë, që kemi të bëjmë ne, midis Fuqisë së All-llahut xh.sh. dhe ceremonisë së njeriut. E si të sjellim shembull për Atë, të cilit nuk i ngjason askush?

Por, i Lartësuari na ka treguar në Kur'anin Kerim, për këto tri pika, dhe na ka treguar se rreth lindjes së Isaut, ngritjes e tij në qiell dhe ringjalljes do të polemizohet deri në Ditën e Kijametit. Për këtë arsye, i Lartësuari e ka shfajësuar Isain a.s., nga kjo polemikë dhe prej çdo gjëje që do të flitej për të, pas ngritjes së tij në qiell.

Kur ne flasim për mrekullitë e Isait a.s., duhet të kemi parasysh një gjë shumë të rëndësishme. I Lartëmadhëruari, i dha mrekulli të ndryshme atij, dhe secilën mrekulli e dalloj nga tjetra. Por, të gjitha, ishin në sajë të mbështetjes prej Fuqisë së All-llahut. I Lartësuari, në Kur'ani Kerim, vendosi këto fjalë në gojën e Isait a.s.: “Erdha tek ju me argumente nga Zoti juaj. Që unë të krijoj për ju, nga balta, formën e zogut dhe kur t’i fryj atij, do të bëhet zog (i vërtetë) në emër të All-llahut. Gjithashtu, do t’i shëroj të verbërit, të lebrosurit dhe do t’i ngjall të vdekurit, në emër të All-llahut. Do t’u informoj se çfarë hani dhe çfarë fshihni në shtëpitë tuaja. Vërtet, këto janë argumente për ju, nëse jeni besimtarë...”¹¹⁹

Shohim se, i Lartësuari i mundësoi Isait a.s., që të bëjë mrekulli të ndryshme. Në disa prej tyre, duhej patjetër të shtoej thënia “...në emër të All-llahut...”, ndërsa në disa mrekulli të tjera, nuk e

¹¹⁹ Kur'an, 3/ 49

dëgjojmë t'a ketë përdorur këtë shprehje, edhe pse Isai ishte i dërguar dhe i mbështetur nga Zoti i tij. Këtu kemi disa mrekulli, të bëra me emrin e All-llahut, dhe disa mrekulli, që janë të bëra vetëm me mbështetjen e All-llahut. Isau a.s., kur krijonte prej balte, së pari i jepte formën e zogut, pastaj i frynte dhe ajo (copë balte) shndërrohej në shpend të vërtetë.

I Lartësuar, na e përmendi këtë, pasi jeta filloi prej asaj balte, në emër të All-llahut. Ky lloj krijimi, ishte në sigurinë dhe garancinë e drejtëpërdrejtë të All-llahut xh.sh. Ky krijim, që u bë nga Isai a.s., është një prej sekreteve të All-llahut. Këtë nuk ia zbuloi asnjë prej robërve të Tij. Për këtë ishte e domosdoshme shprehja "...në emër të All-llahut..." . Kjo jep të kuptohet se, krijimi nuk është bërë nga vetë mrekullia, por nga në thënia: "...në emër të All-llahut...".

Ajeti kur'anor, vazhdon: "Gjithashtu, do t'i shëroj të verbërit, të lebrosurit dhe do t'i ngjalli të vdekurit, në emër të All-llahut." Shërues është All-llahu i Lartëmadhëruar, nuk ka shërues tjetër. Këtë e vërtetojmë duke u bazuar në thënieën e Tij: "...dhe kur të sëmurem, Ai do të më shërojë...". Kështu ishte edhe me ngjalljen e të vdekurve në emër të All-llahut xh.sh., i Cili jep jetën dhe e merr atë.

Këto ishin disa prej mrekullive, për të cilat na informoi All-llahu xh.sh. sepse Ai ishte veprues i Vetëm. Ai nuk ka shoqërues në këto veprime. Edhe pse këto mrekullira, janë realizuar nëpërmjet duarve të të dërguarve të Tij, ato janë bërë në emër të drejtëpërdrejtë të All-llahut, sepse vetëm Ai jep jetë, vetëm Ai merr jetë, dhe vetëm Ai është shërues i sëmundjeve.

Pastaj, vijojnë mrekullitë e tjera pasuese: "Do t'u informoj se çfarë hani dhe çfarë fshihni në shtëpitë tuaja. Vërtet, këto janë argumente për ju, nëse jeni besimtarë...". Këto ishin argumentet e All-llahut për Isain a.s. Kjo ishte një dhunti, që ia kishte dhënë All-llahu xh.sh. dhe këto i bënte

nga vetja, duke pasur mbështetjen e All-llahut xh.sh., pasi kuptohet se Isai e kish mbështetjen e Tij, si vërtetim të besnikërisë së dërgesës së Tij.

Nëse kishte mbështetje prej All-llahut, nuk kishte përse të mbante sekret rreth atyre gjërave. Mrekullitë, Isai a.s. i bënte nga vetja (duke pasur mbështetjen e All-llahut xh.sh). Pra, paskemi mrekullira që All-llahu xh.sh. ia kishte mundësuar Isait a.s. që t'i bënte ato, por që ishin nën ruajtjen e sekretit (nga ana e All-llahut xh.sh) dhe paskemi mrekullira që All-llahu xh.sh. ia kishte mundësuar Isaut a.s., që t'i bënte ato dhe t'a dinte sekretin e tyre. Sekretet e ruajtura nga All-llahu xh.sh. për Vetën e Tij, ishin krijimi, vdekja dhe ngjallja e të vdekurve. Asnjë të dërguari, nuk ua kishte treguar formën se si bëheshin ato.

Edhe pse shfaqja e Fuqisë ishte prezantuar pak orë pas lindjes së Isait a.s., dhe (pas një periudhe të gjatë kohore) u prezantua përsëri tek ngritja e tij në qiell, mund të konsiderohet se po ajo Fuqi, e cila ishte prezantuar pak orë pas lindjes, po e njëjta Fuqi ishte prezantuar edhe në ngritjen e tij në qiell. Por këto nuk i bindën çifutët, e ata as që ju besuan atyre, por përkundrazi, ata vazhduan me këmbëngultësi në besimin e tyre materialist, edhe pse i shihnin me sytë e tyre mrekullitë dhe shfaqjen e Fuqisë.

Ata filluan edhe më shumë t'a nënçmojnë atë, dhe t'a përgënjeshtrojnë dërgesën e tij. Sa herë që ju vinte mrekullia, e mohonin atë dhe nuk përqëndroheshin në veprimet e tij. Fatkeqësisht, kjo ishte natyra çifute. Kështu, kishte ndodhur edhe me Musain më parë, ai ju kishte mundësuar atyre të shihnin shumë mrekullira, por ata qëndronin në fe, vetëm për një kohë të shkurtër, pastaj ktheheshin në avazin e tyre të vjetër të mosbesimit. Mrekullitë ose shfaqja e Fuqisë, nuk i ndryshonte ata aspak, ajo nuk i largonte nga materializmi i tyre, për t'u kthyer drejt së mirës nga i

Lartëmadhëruari. Pasionet e tyre ishin (përqëndruar) në grumbullimin e arit dhe pasurive të ndryshme. Ata vazhdojnë me këtë avaz, deri në ditët e sotme. All-llahu i ka mallkuar ata me mosbesim.

DHE NUK BESUAN!

Isai a.s. e ndjeu se me ta diçka nuk ishte në rregull, se edhe pse ju kishte prezantuar gjithë ato mrekulli, dhe atyre u ishte dhënë rasti t'i shihnin ato me sy, e ato ishin mjaft fakte bindëse, megjithatë ata nuk besuan. Ai ndjeu se ata i largoheshin besimit të All-llahut xh.sh., dhe për këtë i Lartësuar i tha:

“ Kur ndjeu Isai mosbesimin e tyre tha: kush janë ndihmuesit e mi tek All-llahu? Havarijunët (apostujt) thanë: ne jemi ndihmëtarët e All-llhut, besuam All-llahun dhe ti dëshmo se ne jemi muslimanë”¹²⁰

Si duket Isai a.s., e ndjeu mosrespektimin prej çifutëve dhe përfundimisht gjykoi se këta janë pabesimtarë të papërmirësueshëm dhe shumë kokëfortë. Kur ai u bind se këta nuk kanë ndërmend t'iu binden mrekullive të të dërguarit të All-llahut xh.sh., dhe se të gjitha ato argumente nuk iu bënë përshtypje atyre, ai vendosi që, që prej asaj kohe, të merret vetëm me burra të fjalës dhe besimtarë. Këta, të zgjedhurit e tij, do të kishin për detyrë që të mbanin mbi supe programin

¹²⁰ Kur'an, 3/ 52

e All-llahut dhe t'a shpërndanin atë nëpër besimtarët e mbarë botës, pas largimit të tij. Isai a.s., ishte i bindur se çifutët nuk besojnë, pasi ai kishte bërë përpjekje të panumërta, për t'i afruar e për t'i bindur ata.

Por çdo gjë ishte e kotë, edhe pse iu kishte dhënë një sërë argumentesh, edhe pse ata kishin pranë vetes programin e All-llahut, me të cilin do të shpëtonin nga dënimi i dhembshëm. Ajo që bënte ai, ishte për të mirën e beni israelëve¹²¹. Por, përkundrazi, ata nuk jepnin shenja të përmirësimit, madje sa vinte e u shtoej urrejtja dhe mosbesimi. Prandaj, Isai a.s. filloi t'iu drejtohej Havarijunëve¹²² për t'i mësuar drejt e mirë, duke ua prezantuar programin e zbritur prej All-llahut xh.sh., që kur ai (Isai a.s.) të largohej prej kësaj bote, ata (apostujt) të ishin të aftë dhe të sinqertë për këtë fe. Ai i përgatiste mirë ata, sepse e dinte se çifutët do t'i kundërshtonin, do t'i tallnin e do t'i përgënjeshtrojnë ata, rreth fjalëve të All-llahut. Këta apostuj morën përsipër t'a vazhdonin misionin e tij dhe t'a shpërndanin atë nëpër botë.

Isai a.s. ishte shumë i kujdesshëm, gjatë jetës së tij ai ishte përpjekur që t'a kryente misionin e tij siç duhet, prandaj kur vërejti se çifutët nuk kishin ndërmend të përmirësoheshin, ai iu drejtua apostujve, i mësoi ata për mësimet qiellore dhe mori prej tyre betimin se, ata do t'ia përcjellin njerëzimit thirrjen e fesë. Ata do të orvateshin pas Isait a.s., të ishin po aq të suksesshëm sa edhe mësuesi tyre, derisa t'i mposhtnin çifutët dhe të mos kishin drotje se ata do të shuanin këtë dritë, pas tyre.

¹²¹ Beni – nga arabishtja fëmijë, Israel - nga hebreishtja robër të Zotit

¹²² Havarijunë - apostuj

Me kaq, do t'a kisha përfunduar ligjërimin rreth kaptinës së Merjemes dhe Isait a.s. Mesazhi i Isait a.s., konsiderohet si mishërim - personifikim i shfaqjes së Fuqisë së All-llahut të Lartëmadhëruar.

Shfaqja e Fuqisë ishte prezente, prej fillimit të revelatës, deri në fund të saj: që prej momentit të lutjes së gruas së Imranit, e cila e ndjeu (fëmijën) në barkun e saj, pastaj lindja e femrës, pastaj lutja e saj pasi e dinte se femra nuk është si mashkulli dhe përgjigja që ju kthye nga All-llahu se Ai e dinte më së miri se ç'kishte në barkun e saj; pastaj filloi përzgjedhja e Merjemes, veçimi i saj me shfaqjen e Fuqisë ndaj gjërave materialiste, e cila furnizohej nga risku i All-llahut xh.sh., që i vinte në mihrab, në vendin e faljes; pastaj vullneti i All-llahut që këtë shfaqje të Fuqisë t'a shikonte Zekrijai a.s., i cili e pyeti Merjemen: 'Nga të erdhi ky ushqim!?'; pastaj dhurimi i fëmijës atij (Zekerijait), edhe pse ai ishte në moshë shumë të shtyrë dhe përveç kësaj gruaja e tij ishte shterpë; më pas ishte edhe dliresimi Merjemes me anë të lutjeve që ajo bënte regullisht në sexhde dhe ruku, me të cilën afrohej afër Tij; pastaj ishte përzgjedhja e dytë e saj: ajo u veçua nga të gjitha gratë e botës dhe nga të gjitha krijesat, prej qenieve njerëzore dhe xhinëve, për të lindur fëmijë pa pasur kontakt me mashkullin.

Kjo përzgjedhje ishte e veçantë, sepse ajo është e vetmja prej grave, që i është përmendur emri në Kur'anin Kerim. Në të gjitha ajetet Kur'anore, është theksuar emri: "Merjemja, bija e Imranit"¹²³, ose "Isau, biri i Merjemes"¹²⁴. Në secilin ajet, emri saj është përmendur përpara të tjerëve, me përjashtim, kur në ajet është përmendur edhe biri i saj Isai, emri saj është shënuar pas Isait a.s. Kur'ani kur përmend emrin e dikujt për të mirë, ai, ndër ne, konsiderohet si pejgamber. Secili

¹²³ Kur'an, 66/ 12

¹²⁴ Kur'an, 5/ 78

transmetim kur'anor, kur tregohet ka në konsideratë imanin, sepse për All-llahun nuk ka rëndësi personi, por ngjarja, e sidomos, në veçanti, kur (personi për të cilën flet ngjarja) është i gjinisë femërore. Këtu kemi një përjashtim, në tregimin e Merjemes a.s., All-llahu xh.sh., për shkak se e veçoi atë me mrekullinë, e cila nuk do të përsëritet deri në Ditën e Kijametit, e theksoi emrin asaj. Ajo, vërtet, u veçua nga të gjitha krijesat e botës.

Lindja e Isait a.s., birit të Merjemes ishte argument i shfaqjes së Fuqisë së All-llahut. Kur Ai shpreh vullnetin për diçka, vetëm i thotë 'Bëhu', e ajo bëhet. Isai a.s., lindi prej femrës pa mashkull, por para se të ndodhte kjo, All-llahu e kishte përgatitur psikikisht Merjemen. Më pas, për t'u vërtetuar (të tjerëve, që e akuzonin nënën e tij) se ai ishte lindur pa baba, All-llahu xh.sh. bëri që ai (Isai a.s.), duke qenë foshnje, të flasë. Më pas, atë e përcollën mrekullitë e njëpasnjëshme të mbështetura nga All-llahu xh.sh. Disa prej tyre ishin drejtëpërdrejtë në emër të All-llahut.

Ai formësonte nga balta formën e zogut dhe atë e shndërronte në shpend të gjallë, i ngjallte të vdekurit dhe i shëronte të sëmurit. Të gjitha këto, i bënte në emër të All-llahut xh.sh. Ndërsa disa të tjera, i bënte sipas dhuntisë që ia kishte dhënë All-llahu xh.sh. si peygamber i All-llahut. Ai informohej me sekretete të gjithësisë, të cilat ishin argument dhe vërtetim i besueshmërisë së dërgesës së tij. Ai i informonte njerëzit se çfarë kishin ngrënë dhe çfarë oriendish posedonin brenda shtëpive të tyre.

Edhe përkundër të gjitha këtyre mrekullive të qarta, dhe përkundër asaj se Isai a.s. ishte dërguar si mëshirë (nga ana e All-llahut) për çifutët, megjithatë ata nuk e besuan. Bile shprehnin urrejtje ndaj tij. Kur ai e ndjeu mosbesimin e tyre, tuboi një grup apostujsh, apo nxënësish të tij, dhe filloi t'u

mësojë nga revelata e All-llahut xh.sh., që më vonë, ata të bëheshin bartësit e revelatës së All-llahut ndër njerëzit e tjerë. Ata e pranuan atë amanet të rëndë.

Për të qenë më i kuptueshëm, mendoj se jam i detyruar që t'a shpjegoj mrekullinë e Krijimit. Pra kjo, do të jetë tema e kapitullit të ardhshëm.

MREKULLIA E KRIJIMIT

Kur'ani Kerim është mrekulli e vazhdueshme. Kur'ani është mrekulli, që prej ditës së parë të revelimit të tij, e deri në ditët tona të sotme. Ai, gjithashtu, mbetet mrekulli edhe për të ardhmen, deri në Ditën e Kijametit. Mrekullitë e Kur'anit, gjithnjë shfaqen me risitë e tij, ai furnizon secilën gjeneratë veç e veç. Risitë e një gjenerate, janë të ndryshme nga ato të gjeneratës tjetër. Kjo është një e vërtetë shumë e rëndësishme, gjithmonë kur flitet për mrekullitë e Kur'anit, duhet t'a kemi këtë parasysh.

Kur'ani nuk komentohet sipas kuptimit, askush nuk mund të thotë se kjo është fjala e fundit e komentimit të Kur'anit. Ato duhen kuptuar si ligjërime të imanit, që prezantohen nga dijetarë, që merren me studimin e Kur'anit Kerim. Komentimin e plotë të Kur'anit nuk e di askush, përveç All-llahut xh.sh., por ligjërimet, rreth ajeteve kur'anore, që dalin nga zemra besimtare mund të regjistrohen. Sikur të ishte i mundur komentimi i Kur'anit, atë do t'a bënte i pari, i Dërguari i All-llahut xh.sh, ai do t'a komentonte atë, sepse atij iu revelua. Por i Dërguari i All-llahut, u tregoi

njerëzve, ose atyre që duan të merren me komentimin e tij, se cilën rrugë duhet të ndiqnin. Ai tregoi se cilat do të ishin sevapet (shpërblimet) dhe dënimet për ata, që e lënë atë.

Këto janë kufijtë e All-llahut xh.sh., në lirinë që i ka dhënë njeriut për të zgjedhur. Mirëpo, përse sekretet të cilat ishin në Kur'an, i Dërguari i All-llahut s.a.v.s., nuk dëshiroi t'i komentojë, por ato i la të përgjithësuara, duke qenë se, ai i dinte fare mirë ato shpjegime? Përse e bëri këtë? Përgjigja është se, logjika e asaj kohe, nuk do mund t'i kishte pranuar kurrë. Kur'ani nuk është zbuluar për të na dhënë sekretet e ekzistencës, megjithëse ato janë të shkruajtura në Kur'anin Kerim. Ato janë shkruar për t'a furnizuar secilën gjeneratë, sipas ngritjes së inteligjencës dhe përparimit të tyre. Kështu që, (njerëzve) iu mundësohet që Kur'ani t'u jetë (atyre) furnizues i vazhdueshëm, që prej kohërave më të hershme, e deri në Ditën e Kijametit.

Kur'ani në vetvete përmban mrekullira, ato i gjen edhe në një shkronjë. Ato i gjen në përzgjedhjen e fjalëve dhe kuptimeve, ato i përshtaten mendjes së secilës gjeneratë. Por, ajo që është me rëndësi, Kur'ani, iu ligjëron të gjitha niveleve të njerëzve. Ai iu ligjëron dijetarëve dhe injorantëve, atij që di të lexojë dhe atij që nuk di të lexojë. Kur t'i hedhim një vështrim ligjëruesve që janë qenie njerëzore, shohim se si ata prezantohen dhe cili është niveli i shprehjeve të tyre. Stili tyre është i ndryshëm, ndryshe flasin në mesin e intelektualëve, dhe ndryshe në mesin e njerëzve të thjeshtë, të cilët nuk kanë lexuar ndonjëherë.

Thuhet se për çdo gjë, duhet të ekzistojë njësi matëse e veçantë. Pra fjalimi do të ndryshojë (sipas nivelit të dëgjuesve). Por, nëse shkojmë në xhami, do të shohim se në të, ka intelektualë, gjysëmintelektualë dhe analfabetë, të gjithë janë të ulur në të njëjtën hapësirë. Kur lexohet Kur'ani, shoh se si drithërohen trupat e tyre. Kjo vjen, ngase të gjithë e kuptojnë në formën e vet,

atë ligjërim dhe të gjithë emocionohen nga ngacmimet në shpirtërat të tyre. Këtë, askush nuk i di, me përjashtim të Tij. Është fjalë e All-llahut. Secili person, që prezenton aty, sado intelektual të jetë, ndien kënaqësi të thellë në brendinë e tij, kur e dëgjon atë (Kur'anin). Duhet të jetë shumë e vështirë t'iu ligjëroje të gjithëve njësoj, dhe t'iu flisje atyre për problemet e botës, sipas nivelit të tyre intelektual.

Pra, Kur'ani nuk është reveluar për të na treguar sekretet e ekzistencës, por ato (sekrete) janë regjistruar në të, për t'ia prezantuar njerëzimit mrekullinë Hyjnore. Për secilën etapë, ai (Kur'ani) jep risi, sado që të përparojë shkenca. Ne asesi, nuk duhet t'i ndërlidhim gjërat, midis zbulimeve njerëzore me fjalët e Zotit në Kur'an. Ato (fjalët e Zotit) nuk duhet të kenë lidhje (të mbështeten) me zbulimin e teorive shkencore, cilatdo qofshin ato. Ajo që do të duhet të bëhet, është e kundërta, duhet që shkenca të mbështetet dhe të vërtetohet nga versetet e Kur'anit Kerim.

Çdo teori e vërtetuar nga shkencëtarët, nëse është në kundërshtim me versetet Kur'anore, dijeni se ajo teori nuk është e saktë. Ai, që e reveloi Kur'anin, është All-llahu i Lartësuar dhe Ai është edhe krijuesi i universit, dhe sipas kësaj, nuk mundet që i krijuari t'i njohë gjërat dhe sekretet e Krijuesit. Kjo është një prej pikave shumë të rëndësishme, për të gjithë ata, që orvaten t'i lidhin, mrekullitë e Kur'anit me teoritë tokësore.

Jeta dhe vdekja, janë veçori të vetë All-llahut xh.sh. edhe kur iu jepte të Dërguarve, ndonjë mrekulli prej mrekullirave të Tij, iu thoshte: "...në emër të All-llahut...". Isai thoshte "...dhe do t'i ngjall të vdekurit në emër të All-llahut..." gjithashtu "...unë do të krijoj për ju, nga balta, formën e zogut dhe kur t'i fryj atij bëhet zog (i vërtetë), me emër të All-llahut...". Ai, gjithashtu, thoshte: "...Gjithashtu do t'i shëroj të verbërit, të lebrosurit dhe do t'i ngjall të vdekurit, në emër të All-

llahut...”, gjithashtu “...Do t’iu informoj se çfarë hani dhe çfarë fshihni në shtëpitë tuaja....”. Vërehet se mrekullitë e jetës dhe vdekjes gjithmonë kishin prapa shprehjen “...në emër të All-llahut...”.

Kishim edhe mrekulli të tjera, sikurse shërimi i verbërisë, lebrës etj., që kishin mbështetjen e All-llahut xh.sh., që të vërtetohej besnikëria e tij dhe mesazhi i All-llahut xh.sh. Mrekullia e krijimit është cilësi vetëm e All-llahut xh.sh., por fatkeqësisht, kemi njerëz të cilët duan të polemizojnë mbi këtë temë, duke thënë se njeriu e ka prejardhjen prej majmuni.

Kemi teori të shumta ‘shkencore’, që kanë për qëllim t’a njollosin krijimin e All-llahut xh.sh. Ndërsa ne ju themi atyre: Sipas jush, nëse njeriu e ka prejardhjen prej majmuni, pse nuk vazhdoi ky lloj transformimi që prej mijëra e mijëra viteve? Pse nuk u gjend, ose nuk u dëshmuar deri më sot, asnjë lloj njeriu tjetër, përgjatë historisë, duke u transformuar nga majmuni në njeri? Cili element e veçoi majmunin, e jo krijesat e tjera? Si është e mundur të ndodhë transformimi, pa asnjë të dhënë shkencore, e as që është dëgjuar për të më parë? O Lartëmadhëri, ne e dimë se supozimet dhe parafytyrimet nuk janë argument.

Nëse njeriu do t’a kishte prejardhjen prej majmunit, do të duhej të shndërrohej edhe në forma të tjera, e sikur kjo të kishte ndodhur ndonjëherë, ajo do të ishte dëshmuar të paktën një herë. Ajo do të duhej të përsëritej, por ja, që ne, nuk e kemi dëshmuar këtë kurrë përgjatë historisë sonë njerëzore. Cili qe shkaku, që e ndërpreu këtë evolucion? E përse (ky evolucion) nuk po vazhdon të ketë vazhdimësi vepruese, sikurse çdo veprim tjetër jetësor? Ajo që e ka ndaluar atë, është në realitet vetë mosndodhia e transformimit asnjëherë. Ai nuk ka ekzistuar kurrë, me përjashtim tek iluzionistët, tek ata që kanë parashtruar supozime tendencioze, kinse me argumente shkencore.

Sikur kjo të ishte e vërtetë, shkencë bashkëkohore do të kishte mundësi që t'a bënte transformimin nga majmuni në njeri, të paktën edhe në formë falso.

Kur i Lartëmadhëruari e Krijoi jetën, na tregoi edhe rrugën e krijimit dhe mrekullitë e saj. Ai tha se: 'Unë kam Krijuar çdo gjë në çift'. Sipas kësaj thënieje, kuptojmë se të gjitha krijesat në botë, kanë filluar prej çiftit mashkullor dhe atij femror. Pastaj ka filluar procesi i shtimit të tyre. Secili që mendon ndryshe, bie në kundërshtim me realitetin dhe të vërtetën shkencore se, jeta fillon me kontaktimin e çiftit mashkull-femër. E ky ishte fillimi i krijimit.

SEKRETET E KRIJIMIT

Disa njerëzve nuk iu mjafton thënia e All-llahut xh.sh. rreth krijimit. Ata, vazhdimisht, mundohen të arrijnë në çdo mënyrë deri tek sekreti i All-llahut xh.sh. edhe pse (kjo çështje) nuk është në kuadër të tyre. Ne gjithmonë kemi potencuar se, All-llahu na ka dhënë prej diturisë, aq sa neve na nevojitet, ndërsa për ato për të cilat nuk na ka treguar, atë e ka bërë për të mirën tonë, mosnjohja e tyre neve nuk na dëmton fare. P.sh. mosnjohja jonë, se si u krijua dielli, nuk ndikon fare tek ne, kjo nuk na dëmton neve as bujqësi, as në ngrohje dhe as në shfrytëzimet tona të tjera të ditës, për t'a avancuar dhe rritur riskun ose për nevojat tona të tjera të përditshmërisë sonë.

Njëlloj sikurse që ndodh edhe me elektricitetin. Mosnjohja e sekreteve të rrymës elektrike, mua personalisht, nuk më pengon që t'a shtyp prizën dhe të ndriçohet vendi, për t'i kryer nevojat e mija gjatë natës. Gjithashtu, mosnjohja e sekreteve të telefonit, nuk më pengon që t'a shfrytëzoj

atë, të flas me cilin të dua. Kështu, shembuj të këtij lloji, kemi shumë në botë. Ato (objektet apo dukuritë) i shfrytëzojmë duke mos e ditur fare, se çfarë sekrete përmbajnë ato në vetvete. Ato, i shfrytëzojnë dijetarët dhe injorantët, në të njëjtën mënyrë, dhe me kapacitet të njëjtë.

Por, shohim që njeriu merret me hulumtimin atyre gjërave të fshehta, që janë të veçuara nga All-llahu xh.sh., bile edhe me hulumtimin e sekreteve të shpirtit. Ata nuk do të mundën të arrijnë asgjë me këto përpjekje, sepse ai (shpirti) nuk është materie. Ai nuk mund të futet nëpër laboratorët tona të ndryshme (për t'u ekzaminuar). Janë bërë shumë përpjekje, po derdhen shumë para, dhe përfitimi i tyre, është vetëm mundi dhe përvoja e fituar, sepse në fakt nuk është arritur asgjë. Nuk do të arrijnë (të hulumtojnë sekretet e shpirtit) sepse ai nuk është materie, kur (shpirti) bashkohet me trupin jep lëvizjen. Ai del prej aty dhe kthehet aty, pa ndonjë vështirësi.

Ti nuk e di vendin e shpirtit në trupin tënd, në cilën pjesë të tij, ai është. A mos vallë është në zemër, në tru, në duar, në këmbë, etj? I tërë trupi lëviz me anë të shpirtit, por kjo lëvizje është e përgjithshme, sepse njeriu nuk ka mundësi t'a përcaktojë vendin e saktë të shpirtit, bile edhe kur shpirti del nga trupi, pesha e atij trupi nuk pakësohet.

Fryma pra, është lidhja e shpirtit me trupin për të dhënë jetën. Kur shpirti takohet me trupin, i jep fuqi lëvizjes, zhvillim, dhe të gjitha gjërat që i nevojiten jetës njerëzore. Kur ai largohet prej trupit (materies), materia kthehet qetësisht në natyrën e vet, në formën e ngurtë. All-llahu i Lartëmadhëruar e ka ruajtur për Vete sekretin e jetës dhe sekretin e vdekjes, sepse Ai është Krijuesi i jetës dhe vdekjes. Të gjitha përpjekjet në këtë sferë, janë dituri, të cilat nuk na shërbejnë neve aspak. Mosnjohja e sekreteve të shpirtit dhe të krijimit, ne nuk na pengon aspak që t'a

jetojmë dhe përjetojmë jetën në tokë. Kjo që po them nuk nënkupton se, hulumtimi i këtyre temave është i ndaluar.

Njerëzit janë të lirë të hulumtojnë sipas vullnetit të tyre, por ajo që ne refuzojmë është sjellja e teorive të sendërtuara mbi supozime dhe hulumtime të papërfunduara, tendencioze, që kanë përqëllim njollosjen dhe shpifjen ndaj fesë. Supozimet nuk na pasurojnë aspak për realitetin e gjësendeve. Kur njeriu pretendon të thotë se njeriu e ka prejardhjen prej majmunit, të paktën le t'a argumentojë sipas kritereve shkencore materialiste. Kjo nuk ka ngjarë sepse është në kundërshtim me thënien e All-llahut xh.sh., se: krijesat janë bërë prej secilit çift, atij mashkullor dhe femëror.

Kur shkencëtarët na kanë sjellë argumente shkencore, ne i kemi pranuar ato, por kur ata na ofrojnë supozime dhe shpifje, natyrisht se ne i refuzojmë ato. Tregimet, që janë theksuar në Kur'anin Kerim janë realitete të përhershme, ato nuk mund të bien ndesh me krijimin, sepse Ai, që i ka thënë ato, është vetë Krijuesi i tyre.

Tani të shohim krijimin e Ademit a.s. I Lartësuari All-llah, na ka treguar se Ai e krijoi njeriun prej balte. Pra, prej elementeve të tokës, apo dheut, në të cilën ne jetojmë. Hulumtimet shkencore kanë vërtetuar se toka humusore përbëhet prej 18 elementeve. Që të gjitha këto elemente gjenden tek njeriu. Pastaj, i Lartëmadhëruari, i fryu atij prej shpirtit të Tij. Shpirti ishte me emrin e All-llahut xh.sh.

Këtë, shkenca nuk ka arritur, dhe as që do të arrijë ndonjëherë, të na tregojë. Kështu u krijua Ademi a.s., pastaj prej Ademit, All-llahu xh.sh. krijoi Havën. Kur ua paraqiti melekëve Ademin, ju

tha se ka krijuar zëvendësin e Tij¹²⁵ në tokë. Melekët i thanë: po krijon diçka që do të shkaktojë trazira dhe do të derdhë gjak, ndërsa ne jemi duke u lutur vazhdimisht me tespih?! Sipas thënieve të melekëve, na paralajmërohet se ata (melekët) kanë njohur gjallesa të tjera, para njerëzimit, në këtë rruzull tokësor. Këto krijesa të tjera, sikurse xhinët p.sh., kanë shkaktuar trazira dhe kanë derdhur gjak, dhe melekët e kishin këtë përvojë. Ata janë bazuar, mbi këtë të dhënë. Gjykimi tyre ishte i bazuar mbi një përvojë të kaluar, dhe pasi u krijua njeriu, ata e shprehën (këtë gjykim). Ata (melekët) përvojat i krahasojnë me atë se çfarë ju ka mundur All-llahu xh.sh. të njohin nga veprat e Tij.

All-llahu ia mësoi Ademit të gjitha emrat, ia mësoi emrat, për të cilat do të kishte nevojë, në jetën e tij në tokë. Pa marrë parasysh, nëse ato ishin të gjitha të dhëna shkencore, ato u deponuan në mendjen e Ademit. Ato deponime, duhet të dalin prej pasardhësve të tij, pjesë-pjesë, gjeneratë pas gjenerate. Ajo ishte dituria e parë, që Ademi a.s. përdori, kur ai zbriti në tokë. Nuk ka dyshim se dituria e Ademit a.s., erdhi prej All-llahut xh.sh., Ai pra e mësoi njeriun.

¹²⁵ Fjalën zëvendës i Tij - Khalif, disa dijetarë e zëvendësojnë me shprehjen mëkëmbës i Tij. (shënim i përkthyesit)

MENDJA E TRASHËGON DITURINË

Këtu duhet të ndalemi pak. Ishte, pra, vullneti i All-llahut xh.sh. që dijen do të trashëgonte njeriu t'a bënte të ndarë (shkallë-shkallë), sepse ai (njeriu) do të jetë trashëgimtar i civilizime (të njëpasnjëshme). Njeriu është gjallesë, që ka mundësi të fillojë t'a fitojë diturinë, prej aty ky ka ngecur babai ose gjyshi i tij. Ti ke mundësi t'a pajisësh me dituri fëmijën tënd, prej kulmit të diturisë tënde. Pastaj fëmija jot, do t'a tejkalojë këtë dituri dhe do t'ia transferojë atë fëmijës së tij, pra përvojën që e ka marrë nga babai i tij dhe diturinë shtesë, që e ka arritur vetë.

Kështu, civilizimet përcillen gjeneratë pas gjenerate, duke u mbështetur në të kaluarën, duke projektuar të tanishmen për të ardhmen. Këto veçori i përkasin vetëm qenies njerëzore dhe kjo është dhuratë prej All-llahut xh.sh. Këtë veçori nuk e kanë kafshët. Ti mund të merresh me ushtrimin e majmunit ose elefantit, ose cilitdo prej kafshëve, dhe për secilin duhet të përdorësh metoda të tjera të të ushtruarit, gjegjësisht të mësuarit. Për t'a bërë një veprim, atij i duhet që dikush t'a ushtrojë (mësojë). Ai (njeriu) mund të ketë sukses me këtë kafshë, por kjo kafshë nuk është në gjendje t'ia përcjellë atë çka mësoi, vëllezërve ose këlyshëve të tij, bile askujt tjetër prej llojit të vet. P.sh. majmuni, i cili ka mësuar diçka, nuk ka mundësi t'ia mësojë atë këlyshit e vet, që ky t'i shtojë kësaj diturie edhe dituri të tjera dhe t'ia përcjellë ato këlyshëve të tij, ashtu sikurse ndodh me njeriun.

Pra, trashëgimia e civilizimit i mbetet vetëm qenies njerëzore. Këtë veçori, i Lartësuari, e nguliti në mendjen e njeriut dhe i dha mundësi atij të përparojë. Ai (njeriu) duhet t'a dëshmojë se i ka shfrytëzuar argumentet e All-llahut xh.sh., në tokë. Sikur të mos ishte kjo trashëgimi (prej brezave të mëparshëm), njeriu do të kishte mbetur sikurse njeriu i parë, ashtu siç ai kishte qenë në fillim,

dhe nuk do të kishim përparim. Sikur njeriu mos t'a posedonte cilësinë e trashëgimisë, ai nuk do të ishte në gjendje t'a përcillte diturinë, apo përvojën e fituar tek fëmijët e tij.

Edhe fëmija do të zhvillohej sipas jetës dhe përvojës, që do t'ia ofronte natyra dhe kështu do të vazhdonim të gjithë me radhë, pa mundur të përcillej përvoja e të parëve tanë. Në këtë mënyrë, njeriu kishte për të mbetur primitiv, ashtu si ishte krijuar në fillim. Por, trashëgiminë e civilizimit, i Lartëmadhëruari, e vendosi vetëm në mendjen e njeriut, dhe i bëri të mundshëm atij që t'a realizojë këtë përparim shkencor të mahnitshëm, që sot e kemi. Sikur dikush të thoshte: shlyejeni atë që njerëzimi ka arritur prej diturisë, që ia dhuroi All-llahu në këtë tokë, ne atij do t'i thonim: jo që nuk mundemi vetë, po sikur edhe t'a kishim forcën e mbarë njerëzimit nuk do t'a bënim dot, por kthehuni dhe falenderojeni All-llahun xh.sh., dhe bëjini Atij sexhde, sepse All-llahu, është Ai, i Cili e veçoi mendjen tonë (njerëzore) dhe i mundësoi trashëgiminë shkencore. (O njeri!) Sikur t'a kishe mendjen e majmunit, do të kishe mbetur primitiv, ashtu siç je krijuar, e nuk do të kishe mundur të bëje asnjë hap përpara, dhe të arrije në këtë dituri, që të është dhënë ty.

Falenderimet e para, për gjithë këtë përparim njerëzor, i takojnë All-llahut xh.sh., i Cili i dhuroi mendjes njerëzore cilësinë e përparimit, sepse ia mundësoi trashëgiminë mendore. Nëse duhet t'i bëjmë dikujt sexhde falenderimi, për begatitë që na janë prezente prej zbulimeve shkencore ose përparimit teknologjik, ne duhet së pari t'i bëjmë sexhde All-llahut xh.sh. i Cili na dhuroi mendjen prodhuese, me të cilën mundemi t'a realizojmë këtë (përparim teknologjik) dhe i Cili na ka mundësuar që të përfitojmë nga ky përparim shkencor.

Atyre, që orvaten t'a shfrytëzojnë këtë përparim shkencor kundër fesë, ju themi: së pari, kthehuni në themel të problemit, dhe gjykoni se kush e realizoi këtë përparim shkencor. Diturinë, njeriut, ia

servoi All-llahut xh.sh., përndryshe, si munda ai t'a fitojë vetë diturinë? Natyrisht që atë e fitoi nga virtyti i tij i të qenurit njeri, që ishte dhuratë nga All-llahut xh.sh. Njeriun, All-llahu xh.sh. e dalloi me mendje, e cila ka fuqi përfituese-transmetuese, sespe njeriu gjithnjë observon dhe përfiton në sajë të saj.

Ajo (mendja) përfiton nga dituria e kaluar, dhe e shton (diturinë e tashme) për (t'a transmetuar në) diturinë e ardhme. Pastaj, dituria e ardhme do të transmetohet (tek brezat e ardhëm, në mënyrë të pandërprerë)... Këtë, All-llahu xh.sh., ia mundësoi vetëm njeriut. Sikur mendja e njeriut, të ishte p.sh. sikurse e gjallesave të tjera, njeriu nuk do të arrinte t'a transmetonte diturinë dhe nuk do të kishim civilizim. Ai, i cili e krijoi këtë mendje njerëzore, dhe ia dhuroi asaj këto veçori, është All-llahu i Lartësuar dhe askush nuk mund të polemizojë rreth këtij realiteti.

Pra, pasi All-llahu xh.sh. ia mësoi Ademit të gjitha emrat e sendeve, ua paraqiti ato (sende apo objekte) melekëve, duke ju thënë atyre: M'i thuani emërtimet e këtyre gjërave! Melekët nuk dinin se si t'i përgjigjen, dhe thanë: I Lartësuar, ne nuk kemi dituri përveç asaj që na ke mësuar. Këtu, i Lartësuari, dëshiroi të na tregojë për një të vërtetë shumë të rëndësishme. Melekët janë krijesa të krijuara prej drite, ndërsa njeriu prej balte. Drita është materie e tejdukshme, ndërsa balta është materie e ngurtë, por All-llahu e dalloi (e lartësoi) Ademin, i cili ishte i krijuar prej balte me dituri, dhe kështu ai u bë mbi melekët, të cilët janë të krijuar prej dritës. Askush, përveç All-llahut xh.sh., nuk mund të bëjë që t'i japë atij, që është më i ulët diçka, dhe me të, t'a bëjë më të ngritur se ata që janë, ose pretendojnë se janë më lartë, dhe t'i bëjë që të xhelozojnë krijesat e tjera.

Melekët e pranuan dhe e kuptuan se dituria e Ademit, që i ishte dhënë prej All-llahut, e bënë atë më të ngritur se ata. Ata iu bindën All-llahut xh.sh., kur Ai i urdhëroi t'i bëjnë sexhde Ademit.

Këtu kemi të bëjmë me një çështje të përgjithshme, prej së cilës njerëzit ndikohen shumë. Ajo është se, All-llahu ka ndaluar që t'i bëhet sexhde dikujt tjetër, përveç Tij. Si ndodhi atëherë, që Ai t'i urdhërojë melekët që t'i bëjnë sexhde Ademit, kur kjo është e ndaluar? Atyre (njerëzve, që polemizojnë për këtë çështje) u themi: ju nuk jeni duke e kuptuar se ç'farë ka ngjarë. Melekët nuk i bënë sexhde Ademit, sexhdja këtu nuk ka të bëjë fare me vetë Ademin, por (u krye) për (të zbatuar) urdhërin e All-llahut xh.sh.

Për shembull, ne jemi të urdhëruar të kthehemi drejt Qabes gjatë lutjeve tona, dhe bëjmë sexhde (në atë drejtim), por ne nuk i drejtohem vetë Qabes, por (drejtohem për hir të) respektit dhe urdhërit të All-llahut xh.sh., që të bëjmë sexhde në drejtim të kibles. Të gjitha urdhërat fetare, sikur sexhdja, haxhi, namazi, dhe agjërimi, që të gjitha janë zbatim i urdhërave të All-llahut xh.sh. Ne falemi pesë herë në ditë, sepse zbatojmë urdhërin e All-llahut xh.sh për kryerjen e namazit, po ashtu agjërojmë muajin e Ramazanit, për t'a zbatuar urdhërin e All-llahut xh.sh., për kryerjen e agjërimit. Gjithashtu, japim një pjesë prej pasurisë sonë, për shkak të zbatimit të urdhërit të All-llahut xh.sh., për dhënien e zekatit. Po ashtu shkojmë edhe në haxh (për të përmbushur urdhërin e All-llahut), të gjitha këto gjëra nuk i bëjmë prej vullnetit tonë.

Drejtimi ynë nga kibla, kryerja e namazit në kohët e përcaktuara, mbajtja e agjërimit dhe kryerja e haxhit, të gjitha këto, i bëjmë në këtë mënyrë, sepse jemi të urdhëruar nga All-llahu xh.sh. për t'i bërë në këtë formë, edhe pse posedojmë lirinë e veprimit për t'i bërë, ose për mos t'i bërë. Kjo sexhde dhe ky nënshtrim është respekti që ne i shfaqim All-llahut të Lartëmadhëruar.

URDHËRAT E ALL-LLAHUT - MJAFTOJNË

Unë, personalisht, jamë në kundërshtim me të gjithë ata që mendojnë se urdhërat e All-llahut xh.sh., janë vetëm formalitete të kësaj bote. Disa njerëz mendojnë se namazi është një lloj fiskulture, por unë them: Jo! Namazi është shprehje e respekt-nënshtimit ndaj urdhërit të All-llahut. Sikur të ishte një lloj fiskulture, atëherë do të bënim fiskulturë dhe nuk do të faleshim. Disa të tjerë mendojnë se agjërimi është një përjetim i ndjenjave të atyre njerëzve që janë të uritur, gjithashtu, edhe këtyre unë ju them: Jo! Edhe kjo është shprehje e respekt-nënshtimit ndaj urdhërit të All-llahut xh.sh.

Sikur të ishte të përjetuarit e ndjenjës së urisë, atëherë nuk do të urdhërohej që të agjërojë edhe personi i varfër e i pafuqishëm. Kështu edhe me haxhin, flitet se ai është një kongres midis muslimanëve. Edhe këtyre ju themi: Jo! Është zbatim i urdhërit të All-llahut xh.sh. Sikur të ishte vetëm një kongres muslimanësh, do të besonim se kongreset tona islame do t'u mjaftonin muslimanëve dhe nuk do të kishte nevojë të shkohej në haxh.

Çdo veprim në fe, përmban lirinë e veprimit ose të mosveprimit, por ne, ato i bëjmë me urdhërin e All-llahut, pa ndërhyrë filozofia njerëzore. Unë kthehem drejt kibles, sepse kështu më urdhëroi All-llahu xh.sh. Gjithashtu e kryej namazin, agjëroj, jap një pjesë prej pasurisë, sepse Ai më urdhëroi për këto, pa pasur asnjë lidhje, këto që unë i kryej, me fiskulturën, apo me ndjenjën e urisë, apo siç i quajnë disa: formalitete të kësaj bote. Me këtë, ata mundohen të arsyetojnë (moszbatimin) obligimin e All-llahut.

Kur i Lartëmadhëruari na thotë: 'Bëjeni këtë!', kjo na mjafton që t'a bëjmë, pa pyetur për arsyen. Kur Ai na thotë: 'Mos e bëni!', edhe kjo do të na mjaftonte që mos t'a bëjmë, pa pyetur fare cila është arsyeja. Për ne, do të mjaftonte vetëm paraqitja e urdhërit nga Zoti i botërave, dhe ai do të ishte shkak që ne t'i përmbahemi Atij, e këtu nuk duhet të ketë asnjë shkak tjetër. All-llahu është Krijuesi, Ai është i Cili na tha: Më adhuro duke bërë kështu, e ashtu, dhe tjetrën bëje kështu... Ai na tregoi mënyrën dhe formën e adhurimit, që ne të jemi më afër Tij.

Këtë ne e konsiderojmë si mëshirë prej Tij, sepse me të Ai na e lehtësoi këtë rrugë. Ai na tregoi neve, çfarë të adhurojmë dhe si duhet t'a bëjmë atë, për të qenë sa më afër Tij. Kur ne e zbatojmë atë, kjo merret si shenjë falenderimi për All-llahu xh.sh., i Cili na e tregoi dhe na e ndriti rrugën neve, se si t'a adhurojmë Atë. Kjo që bëri është privilegj për ne, për një jetë më të mirë që do t'a gëzojnë robërit e Tij në këtë botë, dhe në ahiret.

Melekët i bënë sexhde Ademit a.s., në shenjë respekti ndaj urdhërit të All-llahut xh.sh., i Cili i urdhëroi që t'i bëjnë sexhde Ademit. Ato nuk i bënë sexhde Ademit, sepse ai ishte njeri ose krijesë si të tjerët, por i bënë sexhde urdhërit, i Cili i urdhëroi të bëjnë sexhde. Në këtë rast, Iblisi bëri mëkat. Iblisi është një krijesë që është krijuar prej zjarrit, sikurse edhe xhinët. Ai ishte prej xhinëve të afërt dhe shumë të devotshëm. Por ai, nga xhelozia e madhe, shfaqti mendjemadhësi. Ai refuzoi të bëjë sexhde, dhe tha: "A t'i bëj sexhde këtij, që e krijove prej balte!"¹²⁶

Rreth kësaj është bërë një debat i madh. Iblisi mëkatoi, ai refuzoi t'i bënte sexhde Ademit dhe All-llahu e largoi nga xhenneti, e mallkoi deri në Ditën e Kijametit, dhe i premtoi se do t'a dënojë

¹²⁶ Kur'an, 17/ 61

dhembshëm në Ahiret. Gjithashtu, edhe Ademi bëri mëkat, pasi hëngri nga pema e ndaluar. Atij (All-llahu) ia pranoi pendimin dhe nuk e nxorri prej mëshirës së vet, por atë e zbriti në tokë dhe i dha udhëzim nga Vetja e Tij, për secilin që e dëshiron t'a ndjekë atë udhëzim. Disa njerëz pyesin se pse All-llahu ia fali Ademit, e nuk ia fali Iblisit? Ju them atyre se dallimi, midis këtyre dy mëkateve, është shumë i madh.

Të ndalojmë pak këtu. Sikur, i Lartëmadhëruari, të mos na kishte treguar me shumë qartësi se Iblisi është larguar dhe përzënë nga mëshira e Tij –Raxhim, ndoshta do të kishim thënë se Iblisi është i ngarkuar, por mëkatoi. Por, All-llahu ia dha mundësinë atij, që të kthehet në programin e All-llahut xh.sh. dhe Ai do t'ia pranonte pendimin, do t'a falte atë, dhe edhe ai do të bëhej prej të falurve, sepse All-llahu është falës i gabimeve. Ai dëshiroi që të shkëpusë prej nesh çfarëdo lloj vesveseve të Shejtanit. Atë e dënoi me vendim absolut, i cili nuk kthehet (anullohet) më. Pse? Sepse mëkati i Iblisit ishte shumë i madh, dhe nuk kishte si të falej.

Iblisi e refuzoi urdhërin e All-llahut të Lartësuar, dhe kur Ai e përzuri prej mëshirës së Tij, ai nuk u pendua, por tha: 'Pasha Madhërinë Tëndë, do t'i mashtroj që të gjithë ata'. Këtu, duhet që ne t'a vërejmë dhe të kemi kujdes, sepse ai bëri një betim të madh, kjo tregon për zgjuarsinë e Iblisit. Ai nuk gjeti zbatues tjetër, i cili do t'i dënojë mëkatarët në tokë, përveç Madhërisë së tij të Lartëmadhëruar¹²⁷ All-llahu i Lartësuar është i Plotëfuqishëm, Ai në këtë Plotëfuqi të Tij, nuk ka nevojë për askënd nga krijesat e Tij, përkundrazi, krijesat kanë nevojë për Të, sepse All-llahu është i Pasuri Absolut.

¹²⁷ Secilin mashttrim që do t'a bëjë Iblisi, do t'a arrijë me vullnetin e All-llahut. Nëse ne e meritojmë që ai të na mashtrojë, All-llahu do t'ia plotësojë dëshirën Iblisit. Shënim i përkthyesit).

Fjala ‘i Pasuri Absolut’ domethënë se Ai është më i pasur se të gjitha krijesat e Tij, prej njerëzve, xhinëve, melekëve, tokës e qiellit sepse të gjithë janë të Tij, dhe prej këtij betimi, pra betimit në emër të Madhërisë së Tij, Iblisi do të mundohet t’a zbatojë betimin e tij, për t’i thënë All-llahut xh.sh. se ai nuk ka nevojë për të gjithë këto, e as për krijimin e tyre, e as për riskun e tyre, dhe deri në Ditën e Kijametit ai do të përpiqet që t’i mashtrojë ata.

MASHTRIMI DHE NJERIU

Ç’është mashtrimi? Mashtrimi është largimi i njerëzimit nga rruga e drejtë, duke ua zbukuruar veprat e shëmtuara, shfrytëzimin e programit të Zotit, ndaj lirisë për të vepruar ose për të mosvepruar, duke ju ofruar njerëzimit “mirësi dhe kënaqësi”.

E mira dhe kënaqësia ndryshojnë tek njerëzit. Kemi të mirë apo dobi, e cila është afatshkurtër dhe dobi, e cila është afatgjatë. Le t’ia bëjmë mendjes sonë më të kuptueshme këtë pikë. Të supozojmë se po na ofrohen dy mundësi. Njëra na fton në mësim dhe studim, për të arritur rezultate të mira, etj., ndërsa tjetra të ofron lojra të ndryshme dhe mosshkuarje në shkollë. Që të dyja mundësitë i ofrojnë të mirën vetvetes, por mënyra e mirësisë është ajo, që ndryshon.

I pari, e sheh mirësinë në studim, për të arritur rezultate të larta, ndërsa tjetri dëshiron të kënaqet për secilën ditë që jeton. Kur të rriten, ata të dy, rrugët do t’i kenë të ndryshme, ky i fundit do të përfundojë në hajdutëri, sepse i ka kërkesat të mëdha, për një jetë më të “mirë”. Ky është dallimi midis këtyre të dyve, dallimi në perceptimin e të kuptuarit të mirësisë ose kënaqësisë.

Besimtari të mirën e sheh tek ajo, që është e qëndrueshme në këtë botë dhe ahiret. Ai shpreh dëshirën dhe mundohet që të bëjë mirë, në të dyja këto botë. Pra, çdo gjë, që i bën mirë në këtë botë, do t'a refuzonte sikur ajo t'a pengonte për të fituar botën tjetër. Ndërsa, mosbesimtari kënaqësinë e dëshiron sa më shpejtë të jetë e mundur. Për këtë arsye, ai bën çdo gjë për të arritur të mirat e kësaj bote, duke mos llogaritur aspak për botën tjetër.

Nëse i jepet rasti të arrijë ndonjë pasuri, qoftë edhe në formë të ndaluar, ose prej formave të tjera që nuk janë të ndaluara, ai nxitimthi i qaset asaj. Pastaj atyre iu vjen vdekja dhe secili do të shohë se çfarë ka bërë. I pari paraqet të mirat për në ahiret dhe do të pajiset me ato të mira, ndërsa i dyti, nuk ka se çka të paraqesë për në ahiret, dhe do të dënohet.

Pra, programi i Iblisit nuk të ndalon, që ti të punosh për t'a fituar ahiretin tënd. Ai mundohet të ndikojë tek ti, vetëm në zbukurimin e jetës tënde në këtë botë. Ai mundohet të të bindë në çdo mënyrë (për të tërhequr) nga të mirat materiale, dhe të të shpjerë në harresë për begatitë e ahiretit. Ky ishte qëllimi i Iblisit, kur ai u betua me shprehjen 'Pasha Madhërinë Tënde'. Ai depërton tek secili njeri, përmes derës së lejuar nga All-llahu xh.sh.

Sikur të ishte vullneti i të Lartësuarit, që mbarë njerëzimi të udhëzohej në rrugë të drejtë, pozita e shejtanit do të shuhej përfundimisht. Ai nuk do të kishte kurrfarë shansi dhe mundësie, që të mashtronte ndonjë njeri. Për këtë arsye, ai (shejtani) e përjashtoi mundësinë se mund të ndikonte tek: "...përveç robërve të Tu, të cilët janë të sinqertë..."¹²⁸ Pozita e tij është, ashtu siç është shprehur ai vetë: O Zot, do t'i tërheq nga vetja, me përjashtim të atyre, të cilët Ti i ke veçuar me

¹²⁸ Kur'an, 15/ 40

udhëzimin Tënd. Tek këta persona unë nuk kam fuqi, sepse Fjala Jote është mbi të gjithë ne, e askush nuk mund të përballët para pushtetit Tënd.

Pastaj, Iblisi, sikur tha: Unë do t'i shpie ata drejt rrugës së keqe, sepse ajo rrugë mua nuk më intereson. Unë nuk shkoj nëpër lokale ku pihet alkooli, e as nëpër shtëpi publike, e as nëpër kazino, ku luhet bixhozi. Vendi im është nëpër institucionet, ku respektohet fjala All-llahut xh.sh., nëpër objekte të kultit, këtu është vendi im dhe aty unë përpiqem që t'i mashtroj njerëzit.

Ky është vendi i vërtetë i punës sime, që të ndikoj tek këta njerëz, t'i nxjerr ata nga respektimi Yt, derisa të arrij që të gjithë njerëzit të mendojnë prapësira. Këta do të jenë ndihmuesit e mi, pa ndikuar pastaj mashtrimi im drejtëpërdrejtë tek ta. Secili njeri dëshiron që t'a shpreh dashurinë ndaj All-llahut xh.sh., prandaj detyra ime është që këta t'i largoj nga kjo ide, pasi: "...atyre do t'u vë pengesa nga rruga Jote e drejtë..."¹²⁹ e nuk tha "do t'i pengoj nga rruga e shtrembër".

Kjo na tregon, se sa i madh është mëkati i Iblisit. Ai është betuar dhe e sfidon All-llahun xh.sh. me mëkat. Ai ia ktheu përgjigjen All-llahut, duke i thënë: unë nuk i bëj sexhde atij, që e krijove nga balta. Iblisi konsideronte se duhej të ishte më me reputacion tek All-llahu xh.sh., dhe kështu nuk iu nënshtrua urdhërit të Tij. Atij, i dukej vetja se gjithashtu edhe ai ishte në pozitë për të urdhëruar, dhe e refuzoi urdhërin e All-llahut, kur iu tha: bëni sexhde, ai i tha: jo nuk bie në sexhde. Këtu vërejmë se, Iblisi nuk i tha: nuk bëj sexhde asnjëherë, por i tha nuk bëj sexhde për këtë krijesë, që e krijove prej balte. Ai, këtu, u pozicionua sikur të ishte i barabartë me diturinë e

¹²⁹ Kur'an, 7/ 16

All-llahut, duke i thënë se: këtë e krijove nga balta, dhe unë nuk i bëj sexhde atij, sepse unë e di, se jam më i mirë se ky.

Më urdhërove të bëj sexhde! Jo, unë nuk e bëj këtë, sepse mendja ime dëshiron të barazohet me Tënden, dhe ndërsa këtë e krijove prej balte, ndërsa mua më krijove prej zjarri, unë konsideroj se jam më i vlefshëm se ky.

Ky ishte një gabim aq shumë i madh, sa që nuk mund të falej. Por ekziston dhe rruga tjetër, ajo e pendimit. Iblisi në vend se të merrte, tani, rrugën e pendimit, atij filloi t'i rritej mendja dhe tha: "Pasha Lartëmadhërinë Tënde, do t'i mashtroj të gjithë ata ..." ¹³⁰. Unë nuk do të lejoj që këta të të adhurojnë Ty, o Zoti im. Do të jem vazhdimisht me besimtarët, që të ndikoj në prishjen e moralit dhe karakterit të tyre, atyre do t'ua zbukuroj rrugën e keqe dhe do t'i largoj nga programi Yt. Ata, të cilët janë të mirë, atyre nuk mund mund t'iu afrohem sepse janë nën sigurinë dhe mbrojtjen Tënde. Unë jam i krijuar, ndërsa Ti je Krijues.

Kështu, edhe pse e dinte se ishte fundosur në mëkate, ai e ndjeu se nuk mundet t'iu afrohet robërve të Tij të singertë, që janë nën udhëzimin e Tij.

¹³⁰ Kur'an, 38/ 82

INSISTIMI NË MËKATE

Tani të shohim se sa këmbëngulës ishte (Iblisi) në vazhdimin e mëkatit të tij. Ai, vazhdoi me arrogancën e vet, duke thënë: "...pastaj atyre do t'ju qasem nga para dhe nga prapa, nga e djathta dhe nga e majta ..." ¹³¹.

Pra, Iblisi tha se do t'iu shkoj nga para dhe nga prapa, nga e djathta dhe nga e majta e tyre, por ai nuk tha se do t'iu afrohem nga lartë apo nga poshtë këmbëve të tyre. Nuk tha asgjë për këto dy anë që kishin mbetur, edhe pse këto, janë brenda gjashtë drejtimeve të njohura. Ai e dinte mirë se, mbi njeriun është vertikalia Hyjnore, dhe vendi i sexhdes së njeriut është në vendin e këmbëve, që është vendi lutjeve. Kështu shejtani nuk mundet kurrësesi të qaset në vertikalen e sipërme, nga ana që vjen Dituria Hyjore. Gjithashtu, nuk mundet kurrësesi të qaset edhe në vertikalen tjetër të poshtme, sepse ajo pjesë njihet si vendi i sexhdes dhe i lutjeve.

Me këto dy drejtime u kompletuan të gjashta orientimet, pra Iblisi nuk paska mundësi të vijë nga pozicioni i sipërm dhe nga ai i poshtëm. Është për t'u habitur, nëse i hedhim një vështrim teorive materialiste. Në të gjitha kohërat do të hasim se idetë vijnë nga këto katër kahje. Ata, në fjalimet e tyre, mbështeten në shprehjet, ky është përparim, apo prapambeturi (kthim prapa), ose djathtist apo majtist. Këto janë katër teoritë ateiste, prej të cilave vjen Iblisi. Por ne, nuk jemi në asnjë prej këtyre pozicioneve. Nuk jemi prej përparimtarëve që thërrasim në analiza (programe...) ateiste, e as liberale.

¹³¹ Kur'an, 7/ 17

Gjithashtu, nuk jemi të prapambetur, që të bazohemi në traditat e të parëve – etërve tanë. Nuk jemi djathtist, sipas traditave të kohës, e as majtist sipas tekeve të kohës. Por ne jemi Ummeti Muhammedan, që i përkasim vertikales, që për çdo çështje e konsultojmë nga qielli, prandaj nëse i nënshtrohemi Urtësisë së All-llahut të Lartëmadhëruar, dijeni se nuk i jemi nënshtruar nivelit tonë njerëzor, e as jemi të poshtëruar nga një krijesë si ne, por dijeni se i jemi bindur dhe nënshtruar Atij, që është mbi ne, Atij që i janë nënshtruar të gjitha krijesat me vullnetin e tyre në jetën e kësaj bote, dhe në mënyrë të pavullnetshme në ahiret.

Ne, gjithsesi, do t'i nënshtrohemi All-llahut xh.sh. Ajo që kërkohet prej nesh është t'a praktikojmë programin e All-llahut xh.sh. Këtu nuk shohim kurrfarë nënçmimi dhe poshtërimi, por ne jemi të barabartë me krijesat më të mëdha, që krijoi All-llahu xh.sh., bile mund të themi, ndoshta, se jemi më të vlefshëm se të tjerët, në bindje. Nëse dikush të thotë se adhurimi është poshtërim, i themi: jo, s'është e vërtetë, por të poshtëruar janë ata, që largohen prej rrugës së programit të All-llahut xh.sh.

Nëse ne ndjekim rrugë tjetër, e jo programin e All-llahut xh.sh., do të poshtërohemi nga qeniet njerëzore, që janë sikur ne. Do të mashtrohemi në jetën tonë të përditshme dhe gjithnjë do të jemi të poshtëruar. Nëse i nënshtrohemi ose i bindemi vetëm All-llahut të Lartëmadhëruar, do të jemi në mesin e të gjitha krijesave dhe me të njëjtën pozitë. Jemi me kokë të ngritur përpara të gjithëve, sepse secili njeri, sado i lartë që të jetë, i është nënshtruar programit të All-llahut, ose me vullnetin e tij të lirë në këtë botë, ose pa vullnetin e tij në ahiret.

ANALFABETIZMI I MUHAMMEDIT S.A.V.S.

Nga e gjithë kjo që thamë më sipër, kuptohet se pse i Lartësuar i zgjodhi të Dërguarin e Tij, të jetë analfabet. Ky duhej t'a barte mesazhin e fundit Hyjnor, prej qiellit për planetin tokë. Ç'kuptim ka shprehja analfabet? Kjo do të thotë se ai (pejgamberi) nuk ishte influencuar nga mjedisi i tij. Nuk kish marrë kurrfarë kulture, nga askush prej krijesave të llojit të vet, as kulturë lindore, e as perëndimore. Nuk kish lexuar asnjë filozof, e as ndonjë teori.

Nëse kemi (të bëjmë me) një njeri të tillë, që nuk ka lexuar asgjë nga qenia e llojit të njëjtë të tij njerëzor, e as nuk ka marrë dituri nga kulturat botërore, çdo gjë që ai prezanton, është mrekulli dhe duhet të përqafohet, sepse ka zbritur nga sipër, prej All-llahut të Lartëmadhëruar. Pra, analfabetizmi i Muhammedit s.a.v.s., ishte nder dhe dëshmi. Ai ishte nder për të, sepse ai transmetoi Kur'anin, i cili ishte mrekullia, me të cilin e dridhi tërë botën. Ishte dëshmi, sepse askush nuk mund të thotë se shkrimi i tij e ka prejardhjen nga filozofët lindorë apo ata perëndimorë, por, ato ishin fjalë të reveluara nga All-llahu i Lartëmadhëruar.

Kur'ani, mrekullia e të cilit është e vazhdueshme, prodhon vazhdimisht ide për qenien njerëzore, deri në Ditën e Kijametit. Kur ai vjen nëpërmjet një të Dërguari analfabet, kjo dëshmon se ai është program qiellor. Pejgamberi s.a.v.s. u veçua nga të tjerët (me një mrekulli) që nuk do të përsëritet më, sepse kjo është një mrekulli që e veçon Kur'anin, që iu revelua të Dërguarit të All-llahut. Ndërsa, nga ne kërkohet që t'a studiojmë, t'a lexojmë dhe të meditojmë mbi krijesat e All-llahut në tokë. Pse? Sepse, askujt prej nesh, nuk iu revelua Kur'ani, ose ndonjë libër prej qiellit. Revelata ka përfunduar me shpalljen e Kur'ani Kerimit dhe me pejgamberin i fundit

Muhammedin s.a.v.s. I Lartësuari nuk na ngarkoi me ato virtyte, që kishte i Dërguari i Tij, por Ai kërkoi nga ne që t'a lexojmë dhe studiojmë Kur'anin.

Sikur i Dërguari i All-llahut s.a.v.s., t'a kishte sjellë Kur'anin në sajë të njohurive të tij, prej një civilizimi, filozofie, apo teorive të ndryshme që ishin në botë, me siguri që (Kur'ani) kishte për të pësuar ndryshime dhe reforma të mëdha, nga origjinali tij. Me siguri që, do të kishim edhe lëvizje të ndryshme ndër gjenerata. Për këto ndryshime, pabesimtarët do të kishin thënë se, Kur'ani Kerim është libër i shkruar nga dituria njerëzore.

Analfabetizmi e vërteton lidhjen e Muhammedit s.a.v.s. me qiellin, sepse dituria tokësore nuk kishte asnjë ndërhyrje në këtë program. Ky program, në fakt, nuk kishte asnjë projekt njerëzor, por i vinte Muhammedit s.a.v.s. prej qiellit (shkallë-shkallë) deri tek programi (i plotë), i cili i është njohur mbarë njerëzimit. Kur'anin duhet t'a njohin që të gjithë. Kjo pra, argumenton se ajo, që i revelohej Muhammedit s.a.v.s., ishte prej All-llahut xh.sh.

Përderisa shejtani kishte thënë se do t'i mashtroj (njerëzit), kjo nënkuptonte se ai insistonte në mëkate të mëtutjeshme, prandaj themi se një mëkat dallon nga mëkati tjetër: dallimi midis insistimit në mëkat dhe pendimit ndaj tij. Kjo është ajo që, All-llahu dëshiroi që ne t'a kuptojmë.

MËKATI NDRYSHON

Të dy, si Ademi ashtu edhe Iblisi, janë krijesa të All-llahut xh.sh. dhe që të dy ata mëkatuan. Që të dy gabuan. Por mëkatet dallojnë. Mëkati i Ademit u fal, ndërsa mëkati i Iblisit nuk u fal. Iblisi e refuzoi urdhërin e Urdhëruesit. Ai ishte mbushur plot mendjemadhësi kundrejt urdhërit të All-llahut. Ai ishte shumë arrogant, përderisa filloi të debatojë me All-llahun xh.sh., sepse me këtë arrogancë ai e barazoi diturinë e tij me atë të All-llahut. Prandaj, e meritoi largimin e tij nga xhenneti dhe e meritoi të mallkohet.

Ndërsa Ademi, e pranoi gabimin dhe tha: O Zoti im, unë bëra gabim, Ti je në të drejtë dhe gjithë çka the është e vërtetë, por qenia ime u gjend e dobët dhe nuk arrita të përmbahem. Ky është dallimi midis këtyre mëkateve. Tek i pari u shfaq mendjemadhësia, ndërsa tek i dyti u shfaq pendimi. Për të dyja kemi argumente. Argumente, që t'a kuptojë njerëzimi mbarë, se kemi mëkat që falet, dhe mëkat që nuk falet, nga All-llahu xh.sh.

Kur njeriu gabon dhe gabimi i tij kalon në menjdemadhësi dhe ai nuk pendohet, e më pas pozicionohet duke e barazuar dijen e tij me dijen e All-llahut dhe vazhdon duke bërë ligje, duke i lejuar vetes ato gjëra, që i janë ndaluar dhe duke ia ndaluar ato që i janë lejuar, dhe duke pretenduar se ai është Zot, - personat e tillë nuk hyjnë në mëshirën e All-llahut xh.sh. Por, nëse pendohet për sa mëkatoi, dhe pranon se ai është i dobët, dhe se All-llahu është Krijues, dhe se çdo thënie e Tij është e vërtetë, personi i tillë do të hyjë në mëshirën e All-llahut dhe mundësinë e faljes.

I Lartësuar i kur e krijoi Ademin, e njohu me armikun e tij - Shejtanin. Atij ia bëri me dije se ky është shejtani, ki kujdes, se ky do të të shpierë, në të ardhmen, në tokë. Kij kujdes se mos po mashtroresh. Pse? Sepse mashtrimi i tij do të të shpierë në një jetë, që nuk është e mirë. Nëse e ndjek atë (shejtanin) do të vuash, do të bëhesh hajdut, kriminel, etj. Do të bëhesh lakmues i pasioneve njerëzore do të bëhesh për t'u mëshiruar prej të gjithëve në këtë botë dhe ahiret.

Edhe përkundër gjithë kësaj, All-llahu i Lartëmadhëruar, e krijoi qenien njerëzore që t'a dijë dobësinë e vet. Për këtë, All-llahu thotë: "...ndërsa njeriu u krijua (si qenie) e pafuqishme..."¹³². Dobësia ose pafuqia, këtu nënkupton se, njeriu e ka të vështirë t'a përcjellë programin e All-llahut xh.sh., edhe pse mund t'a ketë jetën e mirë. Njeriu nga natyra e tij është i ngutshëm, atij i nevojitet çdo gjë, prandaj mundohet t'i rrëmbejë për një kohë të shkurtër, mundësisht rekord. Sikur të kishte durim, ai pa dyshim kishte për t'i marrë të gjitha ato.

Ai duhet që t'i përmbahet programit të All-llahut xh.sh. Sikur t'a bënte këtë, do të merrte disa fish më tepër, por ja që natyra e tij është e ngutshme, dhe njeriu dëshiron t'i ketë ato, për një moment tepër të shkurtër. Ai dëshiron pavdeksinë në tokë, por ai nuk është i pavdekshëm, dëshiron pasuri, që nuk i përshtatet nevojave të tij. Nëse ajo nuk ndahet prej teje, do të ndahesh ti, prej saj. Por dije se, që të dyja të shpiejnë në zhdukje dhe do të bëhesh i paaftë të arrish tek ajo

¹³² Kur'an, 4/ 28

(pavdekësia në tokë). Shejtani, duke e ditur këtë dobësi të njeriut, arriti t'a mashtrojë Ademin në xhennet. Ai e bindi se duhet të hajë nga pema¹³³, që atij ia kishte ndaluar All-llahu xh.sh.

Pema këtu paraqitet si shenja kryesore e mëkateve. Pavdekësia dhe pasuria e pashterrur, paraqiten si shenja të lakmisë njerëzore. Ishte një përvojë, e cila na dha të kuptojmë dy gjëra.

E para është se, njeriu duhet të dijë se çfarëdo që vjen nga shejtani nuk është e vërtetë, por i del e kundërta e asaj çfarë ai (njeriu) kërkon. Shejtani mundohet t'ia zbukurojë njeriut mbytyjen e një njeriu tjetër. Mundohet t'a bindë atë se, (krimi) nuk do të merret vesh dhe do t'i shpëtojë drejtësisë. Kur ai e bën krimin, pas disa orëve, bie në duart e drejtësisë. Pse? Sepse vetë shejtani e përkrah të keqen, ai do që edhe mëkatari t'a pësojë në të njëjtën kohë. Ai ka armiqësi tepër të madhe ndaj njeriut. Ai beson se njeriu ishte shkaktari kryesor i nxjerrjes së tij nga xhenneti dhe mallkimit që iu bë prej All-llahut xh.sh. në këtë botë dhe në ahiret. Të gjitha këto gjëra, shkaktojnë neveri të paimagjinuar tek shejtani kundër njeriut. Ajo çka mendon ai, është vetëm gjetja e mënyrës se si t'a shkatërrojë njeriun, duke iu orvatur në forma dhe kënde të ndryshme. Ai, gjithmonë, ia zbukuron veprat e këqija njeriut. Kur njeriu mëkaton, shejtani largohet prej tij. Ai e braktis atë, në gjendjet dhe në momentet më të vështira të jetës së tij.

All-llahu xh.sh., me Vetë mëshirën e Tij na tregoi që të jemi shumë të kujdesshëm dhe të pastrohemi nga vesvesja e shejtanit. Ai, i Lartësuari, na dha shumë shembuj praktikë. Ai na tregoi

¹³³ Askund nuk kam lexuar që ajo pema ishte molla. Ndërsa ne shpesh herë themi se Ademi hëngri nga molla. Ky supozim nuk është islam, ai më shumë duket të jetë krishter! S'do mend se edhe ne kemi jetuar një kohë në këtë fe dhe mbase është ngulitur tek mendja jonë se ajo pemë ishte molla.

se si ndodhi rasti i Ademit a.s. Na mësoi cila është vesvesja e shejtanit dhe cilën metodë dhe formë të mashtrimit përdor ai. Praktika na mësoi se, çdo gjë që vjen prej premtimeve të shejtanit nuk është e vërtetë, gjithçka që vjen prej tij është e pakapshme dhe nuk arrihet asnjëherë. Mëkati i shejtanit ndryshon prej Frymës¹³⁴ që ka prirje të keqe. Kur Fryma që ka prirje të keqe dëshiron të mëkatojë, ajo do të insistojë në te derisa do t'a përvetësojë qenien njerëzore për ta kryer atë vepër. Ajo, është po ai mëkat, prandaj ajo nuk ndryshon e as nuk zëvendësohet. Ndërsa mashtrimi i shejtani është diçka tjetër, ndryshon prej kësaj (Fryme të keqe). Ai e do mëkatin, thjesht si mëkat.

Kur ai e gjen njeriun në disponim dhe të fuqishëm, ai mundohet të depërtojë nëpër rrugë të tjera. Ai nuk ndalet vetëm me një formë mashtrimi, ai mundohet të gjejë rrugë të tjera dhe u jep ngjyrimë dhe nuanca të ndryshme, vetëm e vetëm për të na mashtruar. Ai e dëshiron besimtarin mëkatar, në çdo formë prej formave, për të bërë të këqija. Nëse një derë i mbyllet, mundohet të trokasë nga dera tjetër. Kështu, ai vazhdimisht sillet përreth njeriut besimtar, duke u munduar t'a mashtrojë nga të gjitha anët. Ai nuk e lë të qetë atë, derisa ai të gabojë. Por, All-llahu xh.sh., nga mëshira e Vet, ia tregoi (besimtarëve) rrugën e shejtanit dhe format prej të cilave ai mundohet të vijë, gjithashtu ia tregoi edhe rrugën e pastërt dhe të shpëtimit.

¹³⁴ Fryma- arabisht Nefsi. Arabët shpirtin e quajnë Ruh ndërsa Nefs -frymën. Pra këtu kemi të bëjmë me Frymën njerëzore

NJERIU DHE ARMIKU TIJ

Kështu, All-llahu xh.sh. e krijoi njeriun dhe atij ia tregoi armikun e tij në tokë. Gjithashtu, ia tregoi formën të cilën e ndjek shejtani, duke i përkujtuar se ai (shejtani) nuk mendon për të mirën e njeriut kurrën e kurrës. Roli i tij është se si t’ia ç’programojë njeriut, programin e Zotit dhe se si, të gjejë metoda që t’a shpierë atë, deri në mëkat. All-llahu i Lartëmadhëruar na ka treguar se me leximin e Kur’anit, shejtani largohet prej njeriut.

Kemi disa njerëz që thonë se edhe ata, gjithashtu, e lexojnë Kur’anin, por që shejtani i hamend dhe i shqetëson ata, edhe pse ata e lexojnë Kur’anin. Ju themi: kemi diçka që quhet ‘veprues’ dhe diçka tjetër që quhet ‘pranues’. Të gjithë ne e dëgjojmë Kur’anin, por shkalla e pranimit nuk është e njëjtë. Secilit i pranohet leximi, sipas shkallës së imanit. Këtë thënie e vërtetojmë, duke u bazuar në versetin kur’anor, në të cilën All-llahu xh.sh thotë: “...ka prej tyre që (shtiren se) të dëgjojnë ty, e kur ata largohen prej teje, i pyesin ata, që iu është dhënë dituria: çfarë thoshte ai (pak) më parë!?”¹³⁵

Ata pyesin për Kur’anin, sepse tek ata nuk ndikon leximi i tij fare. Kur’ani është veprues i vërtetë, por pranuesi është inegzistent. Mendoj se këtë duhet t’a shpjegoj pak më thjeshtë. Le t’a zemë se tek ti vijnë tre persona. Secili prej tyre e ka shkallën e të pamurit të ndryshëm. I pari është symprehtë, i dyti mesatar, ndërsa i treti e ka të pamurit të dobët. Nëse i vendosim pranë një mjeti që do të mund të vërehen atomet dhe i pyesim se çfarë janë duke parë brenda? Secili prej tyre do të përgjigjet ndryshe, sepse secili shikon aq sa i mundësojnë sytë të shohë, edhe pse para tyre

¹³⁵ Kur’an, 47/ 16

është i njëjti instrument. Çështja është aty, se secili prej tyre është bazuar në atë, që ka parë sipas forcës të të pamurit të tij.

Bile kemi gjëra, që japin përshtypje të kundërta, kur pranuesi (objekti mbi të cilin bie veprimi) është i ndryshëm. Kur i fryjmë duart nga të ftohtit, ne kemi për qëllim që t'a ngremë shkallën e nxehtësisë për t'i nxehur ato, por kur ne e fryjmë gotën e çajit, ne kemi për qëllim që t'a ftohim atë. Veprimi ishte i njëjtë: nxjerrja e frymës nga goja, por objekti mbi të cilin bie veprimi është i ndryshëm. Pra, nga kjo që thamë, shihet se ndikimi i veprimit është i kundërt. Veprimi i parë, kishte për qëllim ngritjen e nxehtësisë, ndërsa veprimi i dytë, kishte për qëllim ujlën e nxehtësisë, edhe pse veprimi që u përdor ishte i njëjtë.

Kështu është edhe me zemrat, disa janë të hapura ndaj imanit dhe e angazhojnë vetveten për t'a respektuar All-llahun xh.sh. dhe formojnë programin e jetës (në përputhje me urdhëresat e All-llahut), ndërsa disa e shtyjnë vetveten në rrugën e pasioneve. Për këtë, i Lartësuari thotë: “ Thuaj: ai (Kur’ani), për ata që besojnë, është udhëzues dhe shërues, ndërsa për ata që nuk besojnë, iu është bërë barrë në veshët e tyre dhe ai për t’a është i verbër”¹³⁶

Me këtë, i Lartëmadhëruari, deshi të na tregojë se veprimet mund të jenë të njëjta, por pranimi i tyre është i ndryshëm. Për t’a pranuar Kur’anin, duhet patjetër që të paraqiten parakushtet e pranimi të tij. Duhet të pastrohet njeriu nga ngacmimet, që e largojnë nga programi Hyjnor dhe të largohet nga mashtrimet, që mund t’a shpiejnë në gabime.

¹³⁶ Kur’an, 41/ 44

Njeriu, në përballjen me shejtanin duhet t'a kuptojë se si ai (njeriu), ashtu edhe shejtani, janë që të dy krijesa të All-llahut. Përderisa përballlet me të veç e veç, beteja do të përfundojë varësisht prej forcave që ka njeriu dhe forcave që ka shejtani. Nëse njeriu, gjatë përballjes me të, është i pajisur me mbështetjen e All-llahut xh.sh., shejtani nuk mund t'i bëjë atij asgjë të keqe. T'a sqarojmë këtë pikë, pak më gjërësisht.

Le t'a zemë se një fëmijë i vogël ecën në rrugë vetëm, dhe takon dy fëmijë të tjerë të vegjël, të moshës së tij. Nëse ata do të kacafyten midis vete, do të përdorin forcat, që i kanë në dispozicion. Por, sikur ky fëmijë të ishte me babain e tij, madje një baba të fuqishëm, a do të kishin guxim ata dy fëmijët e tjerë që t'i afroreshin? Jo. Ata do të iknin dhe nuk do të dëshironin që të përballeshin me të. Pse? Sepse kacafytja nuk do të ishte e barabartë midis fëmijëve. Midis tyre ishte një forcë e pakrahasueshme.

Kështu, edhe jeta jote është përplot beteja. Nëse je në lidhje me Zotin tënd, është e pamundur që dikush të të mposhtë, sepse e ke fuqinë e All-llahut me vete. Ai, që mundohet të të përçmojë ose të të poshtërojë, ia bë të keqen vetes së vet. Kur mund të jesh humbës dhe i poshtëruar? Atëherë kur je larg Zotit tënd. Kur je larg Tij, ti duhet të kesh parasysh vetëm forcat që ti posedon. Fuqitë duhet të jenë të barabarta dhe do të fitojë ai, i cili është më i fuqishëm. Ti, nëse nuk bazohesh në Fuqinë e All-llahut xh.sh., je humbës, sepse e ke spostuar anash, Atë që të garanton fitoren, Atë që nuk ka forcë që t'a mposhtë dhe Atë, që askush nuk mund të arrijë deri tek Fuqia e Tij, dhe me këtë veprim tëndin, ti e ke larguar veten nga fuqia më e madhe e mundshme në jetën tënde, i Cili mund të të nxjerrë pa problem nga secila krizë e jetës tënde.

Ti e ke evituar fuqinë e vërtetë në univers! Je larguar nga Ai, i cili bën ç'të dëshirojë! Mos thuaj pastaj, se ç'ndodhi, kur të pësosh disfatë. Sikur të mendoheshe vetëm një çast, do t'a dije shkakun dhe do të mësoje se ke shkelur mbi të mirat, se e largove forcën më të madhe prej armatimit, prandaj mos u habit, dhe të flasësh vete me vete, se si të ndodhi të humbasësh, sepse shkakun, ty, të është shumë i njohur.

SHEJTANI NUK KA PUSHTET MBI NE

Kur njeriu e pranon Kur'anin me gjithë shpirt dhe kërkon vazhdimisht nga All-llahu xh.sh., mbrojtje prej shejtanit, këtij të fundit nuk i mbetet kurrfarë force. Kundër besimtarëve, ai nuk ka forcë t'iu bëjë kurrfarë të keqe, prandaj shejtani, në Ditën e Gjykimit, do të deklarojë para gjithëve: “Unë nuk kisha kurrfarë pushteti ndaj jush, me përjashtim, kur unë ju kam ftuar, ju më jeni përgjigjur mua...”¹³⁷

Pas kësaj që thamë, njeriu e fillon vetë veprën e keqe, që në hapat e parë të qenjes së tij njerëzore. Shejtani, asnjëherë, nuk mundet t'a detyrojë njeriun që të mëkatojë. Ai nuk mundet, gjithashtu, t'a përdorë pushtetin e vet tek ata, që nuk duan të veprojnë keq, apo të mëkatojnë. Së pari, vetë njeriu i dorëzohet dhe e pranon (mashtimin e shejtanit), pra njeriu, së pari, bindet për veprën që do t'a bëjë. Bindja, tek ky person, tani nuk është pasojë e vërtetësisë së bindjes, por e

¹³⁷ Kur'an, 14/ 22

mashttrimit. Ajo (bindja e shtrembëruar) tek njeriu nuk prezantohet qetësisht, por ajo futet brenda tij, me një lloj mendjemadhësie.

Ai (shejtani) ia kopjon mendjen atij, dhe e nxitë të mendojë se ai mundet t'a vendosë vetë caktimin (gjykimin) e atij mëkati. Kur atij (shejtanit) i jepet mundësia dhe kur arrin t'a mashtrojë (njeriun), që prej këtu, ai (njeriu) fillon të veprojë së bashku me shejtanin, pra, fillon “ceremonia”. Kjo lidhje bashkëpunimi, mbase do të zgjasë me vite të tëra. Në fund, njeriu do t'a kuptojë se asgjë nuk paska arritur nga ky bashkëpunim, sepse përfundimi i tij do të jetë e kundërta e asaj që ai ka menduar. Ai mbetet pa askënd, do të jetë i poshtëruar dhe i përbuzur nga shoqëria, dhe do të jetojë me një hidhërim të thellë. Ai nuk ka gjumë të qetë, ndërsa ditët i kalon plot mërzi. Nuk gjen qetësi, dhe gjithë ajo pasuri, që e ka grubulluar nuk i shërben për asgjë, sepse ajo nuk i ofron kënaqësi.

Nëse dëshirojmë të jetojmë jetë të mirë, të cilën na e ka skicuar i Lartëmadhërishmi në tokë, së pari duhet t'a kuptojmë se nuk kemi ardhur këtu që të veprojmë keq, gjithashtu as që të mëkatojmë ndaj All-llahut. Çdo gjë, e bëjmë nga vullneti ynë dhe me kërkesat tona për ato gjëra. Mbase ato kërkesa do të pranohen shumë shpejt, po edhe sikur të mos pranohen, ne prapë, duhet të qëndrojmë larg veprave të këqija. Prandaj mos t'i besojmë askujt, që na mëson se njeriu ka prirje për të vepruar keq. Por, le t'a dimë se e meta është tek ne. Mos t'i besojmë askujt, p.sh. nëse dikush na mëson që të japim mito, apo rushfet për të realizuar ndonjë tender, ose na mëson se duhet t'ia 'lehtësojmë' sinqeritetit për të na 'shkuar punët mbarë'. Nuk do t'a detyrojmë dorën të vjedhë dhe nuk do të shkojmë në rrugë të keqe.

Duhet t'a dimë se All-llahu i Lartësuar, sikur të dëshironte që ne të jetonim pa intrigues, dhe pa shkaktues së vesvese, Ai mund t'a bënte këtë. Gjithashtu, sikur të dëshironte që ne të ishim të detyruar t'i nënshtroheshim, Ai, edhe këtë, do t'a bënte pa ndonjë vështirësi.

Por Ai dëshiroi që, me lirinë tonë, t'a adhurojmë pa shtrëngesa. Përderisa kjo është dëshira e Tij, ne detyrimisht jemi midis besimit dhe mëkatit. Në këtë mes, kemi kënaqësinë e kaluar dhe të shpejtë të mashtrimit, dhe gjithashtu, të vërtetën. E gjithë kjo bëhet për t'a plotësuar lirinë (e zgjedhjes me vetëdije të plotë), e cila është një e vërtetë reale. Me shpresë se, kjo liri e zgjedhjes, do të jetë rruga për në xhennet dhe rruga për një jetë të mirë, në këtë botë.

Për këtë arsye, prezenca e shejtanit dhe tentimet për mashtrime dhe gjithçka që kemi në këtë botë, janë domosdoshmëri të patjetërsueshme të nënshtimit ose bindjes. Sikur këto të mos ekzistonin, njeriu do të ishte i nënshtuar me pahir, pa rrugëdalje tjetër. Njeriu nuk do t'a kishte njohur Urtësinë e shpërblimit dhe të dënimit, e as urtësinë e krijimit të jetës së kësaj bote dhe të ahiretit.

Prezenca e mashtrimeve të kësaj bote, sikurse janë keqbërja, vesvesja e shejtanit etj., është një urtësi e madhe për jetën tonë, në këtë botë. Sepse përzgjedhja bëhet në prezencën e dy argumenteve (të ndryshme), në të cilën njeriu bën lirshëm zgjedhjen e tij midis atyre të dyjave. Sikur të mos ishin zbukurimet e shejtanit (që na shtyjnë) për të bërë mëkat, nuk do t'a kishim njohur dashurinë e All-llahut në zemrat tona (mëshirën e Tij të pakufishme për të na falur). Njeriun, shpeshherë, kur atij i paraqitet ndonjë vepër, e mashtron lehtësia dhe mënyra tërheqëse, kënaqësia e së cilës është jetëshkurtër.

Por ka, gjithashtu, edhe shumë të atillë që e njohin realitetin dhe i refuzojnë këto kënaqësi, duke pasur parasysh kënaqësinë e All-llahut. Kjo bindje, do të ishte një konstatim i drejtë, dhe një prej shkallëve më të larta të besimit. Për këtë arsye, Hyjnia duhet të adhurohet dhe çdo gjë, që njeriu bën, duhet t'ia atribuojë Atij, dhe çdo gjë, që All-llahu na ka treguar se është e keqe, duhet t'a evitojmë prej jetës sonë. Kjo do të ishte peshorja e veprave tona, dhe njësia matëse e bindjes, tek qenia njerëzore.

Të marrim një shembull, që do të jetë më i kuptueshëm. Supozojmë se ju, si nënë, keni marrë një ftesë për një ceremoni prestigjioze të nivelit të lartë, me karakter botëror. Në momentin kur keni veshur rrobat më të mira, befasisht mësoni se fëmija juaj është sëmurë. Ka inflamacion, ngritje të lartë të temperaturës, apo diçka tjetër. Natyrisht, gjëja e parë që do të bierë ndër mend është t'a thërrasësh mjekun, për të shikuar se çfarë ka fëmija. Kjo gjendje, nënën, e sjellin para dy opsioneve, në të njëjtën kohë.

Opsioni i parë, ajo mendjen dhe dëshirën e ka të prezentojë në ceremoninë e shumëpritur dhe opsioni i dytë, të qëndrojë pranë fëmijës për t'a kryer detyrën e nënës. Fitues, në këtë rast, do të jetë dëshira e opsionit më të madh. Nuk do t'i kishim këto krahasime, sikur ajo të mos ishte e ftuar në ceremoni dhe njëkohësisht, sikur fëmija e saj të mos ishte sëmurë. Përndryshe, si do të kishim mundur të dimë, nëse ajo ishte një nënë e flaktë për fëmijën e saj, apo nëse ajo do t'a linte atë në duart e shërbëtores, apo të ndonjë të afërmi të saj, e të shkonte në ceremoni, duke mos e humbur kohën e saj.

Ne, nuk do t'a dinim, sikur të mos ishin para nesh, këto dy opsione, në të njëjtën kohë. Kështu, ngjajshëm, është edhe me: të mirën dhe të keqen, me bindjen dhe mëkatën, me vesvesen e

shejtanit dhe dashurinë ndaj All-llahut. Të dy opsionet duhet të janë prezente tek qenia njerëzore dhe në të njëjtin moment. Kjo na jep mundësinë për t'a ditur masën e adhurimit të All-llahut, apo masën e kundërshtimit të kësaj dashurie.

MËSHIRA DHE SPROVA

I Lartësuarit All-llah ishte i mëshirshëm me ne, në sprova. Ai, nuk na krijoi ne, pa na ushtruar më parë. Bile, Ai na krijoi dhe na ushtroi, e na dha të kuptojmë se çfarë do të ndodhë. Ndërsa shejtani mëkatoi para Ademit dhe më pas e shtyri edhe atë në mëkat. All-llahu xh.sh., Ademiti ia kishte ndaluar ngrënien e një peme, duke i thënë se: kjo pemë të është e ndaluar, sepse ajo të bën dëm dhe të shkatërron. Shejtani, duke përdorur logjikën e gënjeshtreve, i tha se kjo pemë është pema e përjetësisë dhe pasurisë së pashterrshme.

Shejtani filloi t'ia shpjegojë rëndësinë e kësaj peme, duke i thënë se All-llahu t'a ka ndaluar ngrënien e kësaj peme, sepse Ai do që të mos bëhesh i përjetshëm dhe pasanik. Ademi, para vetes, kishte urdhërin dhe thënien e vërtetë të All-llahut, dhe në anën tjetër, kishte gënjeshtrenë dhe premtimet e shejtanit. Megjithatë, Ademi u tregua i dobët. Shfaqti dobësinë, përpara lakmisë së përjetësisë dhe pasurisë, edhe pse ai jetonte në xhennet. Hante pa ndonjë mund dhe pa asnjë lodhje, kalonte nëpër vende të ndryshme të xhennetit pa ndonjë pengesë dhe në atë vend, ku e kapte uria, gjente ushqim çfarë të dëshironte ai. Por duket shumë qartë se, lakmia e njeriut është e

madhe, ajo nuk ka kufij. Edhe pse All-llahu ia kishte plotësuar të gjitha nevojat njerëzore, atij i kishte ngelur lakmia në vete, kështu që shejtani arriti të hyjë tek ai, nga kjo pikë e dobët.

Sprova përfundoi me mëkatimin e Ademit. All-llahu xh.sh. e kishte nderuar atë. Por, Ademi gaboi vetë, duke u hamendur në thënien e All-llahut. Ai, i Lartësuar i kishte plotësuar të gjitha nevojat e jetës së tij, dhe i kish mundësuar atij që t'i arrinte ato, pa ndonjë lodhje, por Ademi dëshiroi që të kishte diçka, edhe më shumë në veten e vet. Dëshira e tij ishte që të posedonte diçka, edhe më të madhe. All-llahu ia kishte ndaluar atij pemën, për shkak se kjo ishte për të mirën e tij. Në të kundërtën, sikur t'a thente urdhërin e All-llahut, ai do të vuante.

Ademi a.s. nuk kuptoi e këtë, gjithashtu nuk e kuptoi se ajo që i ishte ndaluar nga All-llahu xh.sh., ishte për të mirën dhe vetëm për të mirën e tij. Kur All-llahu e krijoi atë prej balte, i urdhëroi të gjithë ata, që ishin më të lartë se ai në krijim, melekët dhe xhinët, t'i bëjnë sexhde. Ai duhej t'a kuptonte këtë respekt të treguar ndaj tij. Ai duhej t'a dinte se Zoti i tij, e kishte nderuar atë, duke i urdhëruar krijesat, më të larta në krijim se Ademi, që t'i përulëshin atij. Ai nuk ia dëshironte të keqen, por përkundrazi, atij ia dëshironte të mirën, se përndryshe nuk kishte pse t'a nderonte.

Sikur All-llahu t'ia dëshironte të keqen Ademit, nuk do t'a bënte, dhe nuk do t'i urdhëronte melekët që të nënshtrohen në sexhde për Ademin. Këtë nder dhe respekt, Ademi duhej t'a kishte parasysh, gjithashtu, edhe ne duhet t'a kemi parasysh këtë gjë. All-llahu i Lartësuar na ka nderuar dhe na ka dalluar nga krijesat e tjera të Tij. Prandaj, nuk mundet asesi të kuptohet se ky nderim rrjedh nga urrejtja. Ky nder, rrjedh nga dëshira për një të mirë më të madhe.

Ne duhet të nisemi nga kjo pikë, të logjikojmë dhe t'a pranojmë programin e All-llahut xh.sh. Dhe ne duhet t'a dimë bindshëm se, çdo thënie e Tij, që thotë 'vepro', duhet bërë sepse është e

mirë dhe sepse Ai na e do të mirën, ndërsa kur Ai na thotë ‘mos e bëni’, ajo është e keqe, dhe nuk duhet t’a kryejmë, sepse All-llahu nuk na e do neve të keqen.

Kemi edhe një tjetër dëshmi që tregon armiqësinë e shejtanit. Kjo armiqësi na është e njohur nga mënyra e refuzimit, të urdhërit të All-llahut, për t’i bërë sexhde njeriut. Kjo e dhënë do të na mjaftonte të dimë se shejtani është armiku ynë i përбетuar.

Kur ai mundohet të t’a rritë vesvesen për t’a bërë ndonjë punë, ai dëshiron të keqen tënde, ai me të mundohet të të ndalojë prej veprave të mira. Këtë përvojë ne e kemi nga Ademi a.s., i cili e kishte provuar (mashttrimin e tij) në xhennet dhe mësuam se si Ademi ishte treguar i ligësht dhe gaboi, duke i ngrënë frytet e pemës. Por, menjëherë, doli në shesh e vërteta. Sikur të mos kishte ngrënë Ademi, prej pemës së ndaluar, ne mbase deri në ditët tona të sotme do të vajtonim duke thënë, ah, sikur t’a kishte ngrënë atë pemë. Do të thonim se tani do të ishim të përjetshëm.

Pra, do të bëheshim të përjetshëm dhe do të kishim pasuri të pashteruar. Ndoshta do të kishte qenë shejtani ai, i cili do të na vërtetonte (nxiste për të menduar për) këtë! Por, përderisa Ademi hëngri nga pema dhe doli në pah se, çdo gjë që kishte thënë shejtani kishte qenë gënjeshtër, ai e paska mashtruar. Qëllimi i tij ishte që t’a nxirrte Ademin prej xhennetit. Ai, as nuk u bë i përjetshëm, pasi që hëngri prej pemës, e as nuk u bë pronar i pasurisë së pashterrshme. Por, ajo që ndodhi ishte se, atij iu zbulua avreti (lakuriqësia), ose organet seksuale. Ai vrapoi deri tek një pemë, dhe u mbulua me gjethet e saj.

Pra, e vërteta u shfaq menjëherë, kur atij iu shfaq në vete ndjenja e turpërimit, si pasojë e mashtrimit të shejtanit. Ai nuk arriti nga ajo, kurrfarë përfitimi, përkundrazi iu keqësua situata edhe më shumë, ai u largua nga xhenneti. Shejtani, gjithmonë, tenton t’a turpërojë njeriun me lakuriqësi. Ai

përpiqet sa më shumë t'a përhapë këtë turp, anekënd botës. Këtë e ka bërë që prej krijimit të Ademit, e do të vazhdojë t'a bëjë deri në ditën e Katakлизмës.

MËSHIRA E ALL-LLAHUT ËSHTË SHTRIRË

Kështu kishte ndodhur. Para se të zbriste Ademi në tokë, i Lartësuari i kishte dhënë urdhër (të mos i afrohej pemës), ndërsa shejtani e mashtroi dhe e shtyri atë, të mëkatojë. Nga kjo u kuptua se, All-llahu xh.sh., ia donte të mirën, ndërsa vesveset e shejtanit ishin përplot gënjeshtra dhe mashtrime, pa asnjë të vërtetë. All-llahu i Lartëmadhëruar ishte mëshirues kur na mësoi për këtë mashtrim, Ai na i tregoi në Kur'anin Kerim këto tregime, mbase do të vetëdijësohemi dhe do t'a kuptojmë të vërtetën se, All-llahu xh.sh. na e do të mirën.

Ai nuk na e do të keqen dhe nuk i pëlqen që ne të dënohemi në ahiret. Kur ne e duam All-llahun xh.sh., padyshim që edhe Ai, na do dhe na mbron. Mëshira All-llahut xh.sh., për njeriun, është shtrirë edhe në tokë. Ai ia mësoi njeriut fjalitë e pendimit, për t'ia shlyer mëkatet dhe për t'ia falur gabimet. Këto i bëri me një kusht, që qenia njerëzore të pendohet, sikurse u pendua Ademi, e jo të ketë mendjemadhësinë e Iblisit. Ai, gjithashtu, na tha: Kur t'a ndieni veten të dobët, kërkonin ndihmë nga Unë, (për t'iu mbrojtur) prej shejtanit, dhe Unë do t'iu mbroj nga ai. Gjithashtu, na tha: Para se t'a filloni ndonjë punë, thoni 'Bismil Lah'. Nëse, ajo punë nuk do jetë e mirë, nuk ka për të filluar me shprehjen 'Bismil Lah'.

Njeriu turpërohet të thotë ‘Bismil Lah’, për një vepër të keqe. Ai, gjithashtu, na mësoi të themi ‘Bismil Lahir Rahmanir Rahim’¹³⁸, sepse i Lartësuar i krijoi për ne mëshirën. Kur ne bëjmë ndonjë punë, dhe e kemi në mendje All-llahun xh.sh., Ai do të na dhurojë neve mirësi në këtë botë dhe, gjithashtu, do të na shpërblejë në ahiret. Mjerë ai që s’turpërohet, nëse ka mëkatur duke e përmendur All-llahun xh.sh. Ai duhet të turpërohet për veprat që fillojnë me ‘Bismil Lah’! All-llahu xh.sh. nuk i urren, e as nuk ndryshon (qëndrimin) ndaj krijesave të Tij. Kur njeriu mëkaton ndaj Tij, Ai nuk thotë, tani Unë do t’a dëboj këtë rob nga mëshira Ime dhe nuk do të pranoj asgjë prej tij. Kur robi i Tij, në momentin që thotë ‘Bismil Lahir Rahmanir Rahim’, kërkon nga Ai që t’ia pranojë (pendimin), Ai menjëherë do t’ia pranojë. Kur njeriu mëkaton, dhe në çast kujtohet se Ai, është ‘Rahman’¹³⁹ dhe ‘Rahim’¹⁴⁰, pra se Ai ia pranon pendimin secilit mëkatar, atëherë ai kthehet drejt All-llahut (duke i kërkuar falje dhe mëshirë). I Lartësuar i nuk urren, nuk zemërohet e as nuk ndryshon. Ti je një rob prej robërve të Tij, dhe kur të kthehesh tek Ai, do t’a gjesht Atë ‘Rahman’ e Rahim’.

All-llahu xh.sh. kur caktoi dënimin, për gabimet e bëra, kjo do të thotë se Ai e caktoi ekzistencën (e gabimeve), përndryshe: pse të caktonte dënimet për gjërat që nuk ekzistojnë? Ashtu si e ka caktuar gabimin, ashtu e ka caktuar edhe pendimin. Ai ka hapur një derë për mëkatarët, dhe prej asaj i fal ata.

¹³⁸ Në emër të All-llahur Mëshiruesit Mëshirëplotit

¹³⁹ Mëshirues në këtë botë

¹⁴⁰ Mëshirues në ahiret, pa këtë botë

Pra, kur ndodh që mëkatojmë, nuk duhet të ligështohemi, por të kërkojmë falje dhe All-llahu do të na mëshirojë, pasi Ai, i Lartësuar, është ‘Rahman’ e ‘Rahim’. Fjala ‘Rahim’ është marrë nga fjala ‘Rahman’. Me këtë fjalë, i Lartësuar, sikur do të na thotë neve: Unë juve dua të mirën, edhe pse ju mëkatoni. Për arsye se ju, bëni mëkat, Unë vetes Sime i kam thënë se jam ‘Rahman’, prandaj kur të ndodh që të mëkatoni, mos u turpëroni të pendoheni ndaj Meje dhe të gjeni shpëtim në Rahmetin Tëm.

Kështu, po e shohim se sa e lartë është dashuria e All-llahut, ndaj nesh. Së pari, Ai kërkoi që universi t’i nënshtrohet atij (njeriut), kërkoi që atij t’i nënshtrohen krijesat që janë më të ngritura se ai, siç ishin melekët, dhe atyre (njerëzve) ju thotë: Unë ju dua juve, prandaj ju dhashë begati, prandaj çdo gjë që ju them është për të mirën tuaj dhe pasojeni atë rrugë, ndërsa ato që ua kam ndaluar, janë të dëmshme për ju, dhe largojuni atyre.

Pas gjithë kësaj, duhet t’a kuptojmë se duhet të mësojmë nga përvojat e gabimeve tona, ndërsa nga ana tjetër, duhet t’a kuptojmë besnikërinë dhe dashurinë e All-llahut, së bashku me Rahmetin e Tij ndaj nesh. Dijeni se Ai, e ndaloi Ademin të hajë nga pema, sepse ajo ishte e dëmshme për të. Por, shejtani e mashtroi, dhe ky (mashttrim) ishte gjithashtu i dëmshëm. Pra, fjala e All-llahut xh.sh., ishte për të mirën tonë, ndërsa ajo e Iblisit ishte për të keqen tonë.

Këtë teori, njeriu e provoi dhe e vërtetoi në praktikë. Pastaj njeriu, u dërgua në tokë që t’a barte me vete pendimin dhe të hajë me mijëra pemë. I Lartësuar, sikur na thotë se, do t’a hapi derën e pendimit, nëse jeni prej atyre që pendoheni, dhe nuk do t’a marr nga ju Rahmetin. Unë do t’i ushqej të gjithë njerëzit, besimtarë dhe jobesimtarë, mëkatarin dhe të devotshmin. Kjo është nga

Rahmeti Im, ndaj robërve të Mi. Mbase mëkatarit të ditës së sotme, do t'i përkujtohet begatia dhe Rahmeti Im, e do të bëhet prej të nënshtruarve dhe do të kthehet drejt Meje.

Mendoj se fjalën 'Rahim' duhet t'a shpjegoj më gjërësisht. Emri i All-llahut ose cilësia e Tij 'Rahim' ka kuptim më të veçantë se cilësia e Tij 'Rahman'. Disa njerëz mendojnë se cilësia e All-llahut xh.sh., ka shndërrime në gjendje fuqie dhe dobësie. Ndonjëherë, është Rahman e ndonjëherë Rahim. Ne u themi atyre se e kanë gabim. Shndërrimet dhe transformimet janë prezente tek cilësitë e njeriut. All-llahu xh.sh. nuk ka gjendje të dobët apo të fortë, tek Ai cilësitë janë konstante, ndërsa ajo që ndryshon ka të bëjë me krijesën.

T'a shpjegojmë këtë pak më gjërë. Të supozojmë se një njeri ha shumë bukë. Ne i themi atij grykës, ose të supozojmë se dikush ha pak bukë, por pesë ose gjashtë herë në ditë. Gjithashtu edhe këtij i themi grykës. Tek ky, që ha pak bukë, por pesë ose gjashtë herë në ditë, ekzagjerimi është në vetë ndodhitë dhe në përsëritjen e ndodhisë. Nëse jeni kurioz t'a dini ndryshimin midis cilësisë të All-llahut, 'Rahman' dhe 'Rahim', themi: Atij i themi 'Rahman', sepse Ai është mëshirues (Rahman) si për besimtarin ashtu edhe për jobesimtarin, në këtë botë. Pra, numri i atyre, që hyjnë në mëshirën dhuruese të All-llahut, sa i përket kësaj bote, janë të gjitha krijesat. Të gjithë hyjnë në mëshirën dhuruese të All-llahut, në të qenurit e Tij Zot, pra Ai është mëshirues (Rahman).

Por, në ahiret është mëshirues (Rahim) sepse All-llahu i nxjerr pabesimtarët nga kjo mëshirë, dhe kjo mëshirë mbetet vetëm për besimtarët. Pra, cilësia nuk ndryshon, por ai që ndryshon është ai, që përfshihet në këtë cilësi. Në këtë botë, secili rob pranon nga Rahmeti i All-llahut, duke qenë se është Rahman, por në ahiret ky numër zvogëlohet dhe ndërlikohet me cilësinë, ose me përfshirjen

e cilësisë në një numër më të vogël, se që ishte përfshirë në këtë botë. Kjo cilësi, e cila vlen vetëm për në ahiret, quhet 'Rrahim'.

Pra cilësitë e All-llahut janë statike, por këto cilësi përcillen nga ndryshimet sipas gjendjes së krijesës së All-llahut. Nga thënia kur'anore: “...dhe Zoti yt nuk është dëmtues për robërit...”¹⁴¹, kuptohet se është mohuar cilësia e padrejtësisë (dhulm), por nuk është mohuar cilësia e dënimit (adhab) të Tij, sepse Ai mund të jetë dënues, por jo dëmtues.

Numri i krijesave të All-llahut nuk është i kufizuar për ta. Sikur All-llahu të ishte dëmtues, qoftë edhe sa grimca, do të bëhej dëmtues i shumë prej atyre (njerëzve) që kanë dëmtuar. Por askush nuk është prekur me dëmtim prej Tij, bile as sa grimca. Për këtë arsye, All-llahu ia ka ndaluar Vetes (dëmtimin) qoftë edhe një grimcë, sepse Ai nuk është dëmtues. Pra, në këtë numër të madh dëmtimesh, nga All-llahu xh.sh. nuk buron asnjë dëmtim (padrejtësi), qoftë edhe sa grimca.

ALL-LLAHU DHE MËKATARI

Pra, çdo veprim i ynë duhet të fillojë me 'Bismil Lah'. All-llahu na dhuron begati dhe sevape, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Ai na mbron nga shumë gjëra, na ruan nga gjithçka.

¹⁴¹ Kur'an, 41/ 46

Kur njeriu mëkaton për të parën herë, atë e dënon me një dënim të kufizuar dhe të vogël. Nëse ai pendohet tek All-llahu xh.sh., dhe duke i ngritur duart nga qielli, thotë me zë lutës: ‘Falëm o Zot!’, All-llahu i Lartëmadhëruar e fal atë. Nëse njeriu e ndien veten paksa larg rrezikut, ai përsëri kthehet në mëkat. Ndoshta kthehet në një mëkat tjetër edhe më të madh, prej atij të parit, nga harresa, ose shtiret se i ka haruar ato ditë të këqija, të vështira ose nën presion. Kur ai e kupton se sërish ka gabuar, drejtohet drejt qiellit me duart e ngritura lart dhe thotë: ‘Më fal o Zot!’ Do të ishte e drejtë, sikur të mos hapeshin dyert e qiellit për mëkatin e dytë, e as të mos i pranohej asnjë lutje, me të cilën do t’i drejtohej All-llahut xh.sh.

Kjo do të ishte drejtësi. Por, mëshira e All-llahut i tejkalon të gjitha hidhërimet e tjera. Prandaj dyert e qiellit hapen dhe lutja (duaja) i pranohet. All-llahu ia zbulon gabimet, por edhe e mëshiron. Nëse ai e ndien se përsëri ka shpëtuar, ai (njeriu) përsëri kthehet në gabim, por tani në mosbesim (kufr). Përsëri, i Lartësuar, nga mëshira e Tij, vazhdon t’i trokasë atij për t’ia zgjuar kujtesën, e i thotë: ‘Zgjohu, or i mjerë, se je duke e shkatërruar veten, kthjellu se nuk ke fuqi, Fuqia e vërtetë më përket vetëm Mua’. Por mashtrimi vazhdon t’a kaplojë njeriun. Tani me më shumë vështirësi, duke ia përkujtuar argumentet e Tij, ai (njeriu) kthehet (i penduar).

Përsëri i hapet edhe njëherë (dera e mëshirës), por tani (i hapet) një derë e vogël dhe me shumë vështirësi, ose me hidhërim. Njeriu, përsëri, i kthyer drejt qiellit, me duart e ngritura lart, tani me një pikëllim më të madh, duke ngritur zërin thotë: O Zot, më fal! Do të ishte drejtësi, nga ana e All-llahut të Lartëmadhëruar, nëse këtë here të mos t’a pranonte. Do të ishte plotësisht e drejtë, që të mos t’i hapeshin dyert e qiellit. Megjithatë, mëshira e All-llahut ndërhyr përsëri, dhe ajo do t’ia evitojë edhe kësaj here vështirësitë dhe ankthet. Kur njeriu e ndien veten se ka shpëtuar, përsëri kthehet në mosbesim. Por, megjithatë, All-llahu prapë ia hapë atij derën me hidhërim,

sepse ai është i vendosur të vazhdojë në mosbesim. I Lartësuar i bëri të mundur, që ai t'a shihte mëshirën e All-llahut disa herë me radhë, gjithashtu ia largoi ankthet dhe vështirësitë disa herë me radhë.

Nëse përkujtojmë tregimin e Musait a.s., shohim se i Lartësuar i mori Faraonin, së pari, me fjalë të buta. I Lartësuar i, duke e mësuar Musain dhe Harunin, iu tha:

“ Shkoni (ju dy) tek Faraoni, sepse ai i kaloi të gjitha kufijtë, i thuani atij fjalë të buta, mbase do t'a pranojë këshillën ose do të frikësohet”¹⁴²

Faraoni i kishte kaluar kufijtë, ai pretendonte se ishte hyjni në tokë, nuk e adhuronte All-llahun, prandaj All-llahu i dërgoi atij pejgamber për t'a udhëzuar në rrugë të drejtë dhe që t'a përkujtonte vazhdimisht All-llahun. Ai nuk i tha të Dërguarit: 'Shko, këputja krahët Faraonit dhe merrja mbretërinë, sepse do të jesh nën mbrojtjen Time'. As nuk i tha atij se: 'Faraonin do t'a gëlltisë toka dhe pasurinë e tij, do të t'a jap ty'. Por, shohim një sjellje të lartë të Mëshirës Hyjnore, kur i Lartëmadhëruari, thotë: 'Shko tek ai tiran, që e ndien veten hyjni dhe që nuk adhuron All-llahun, e përkujtoja atij të vërtetën, me fjalë të ëmbla e të buta'. Këto fjalë, mbase, do të bëhen shkak që ai të gjejë arsye për popullit, për t'a pranuar gabimin, e të më besojë të paktën nga frika.

Këtu shohim se sa e do All-llahu xh.sh robin e tij. Edhe pse kish mëkatuar, Ai e trajtoi atë me butësi dhe me mençuri, edhe pse ishte në gjendje t'a përmbyste me një goditje. Vallë, a mund të ketë ndonjë mëshirë më të madhe se kjo? Askush prej mëshiruesve, nuk mund t'a kapërcejë më shumë (mëshirën e shfaqur), se ç'bëri i Lartësuar i me robin e Tij mëkatar. Jo vetëm kaq, por ne

¹⁴² Kur'an, 20/ 43

besimtarëve All-llahu na ka udhëzuar, që mëkatarit t'ia mbulojmë mëkatet e tij edhe pse ne ia dimë ato, për të mos e turpëruar atë. Pse? Mbulesa e mëkatit kërkohet prej nesh, se mos ndoshta, do të jenë shkas që ai të pendohet dhe do të kthehet përsëri në rrugë të Zotit.

Sikur të përhapej mëkati, ai për t'a arsyetuar vetveten do të humbej edhe më shumë. Mbase mundej të egërsohej edhe më shumë dhe situata do të acarohet edhe më shumë. Por, kur ai e sheh se mëkati i tij u mbulua nga All-llahu xh.sh., ndoshta do të rikthjellohet në vetvete, do të pendohet, dhe do të kthehet përsëri drejt All-llahut.

Kjo është mëshira e All-llahut (për të na falur), kur ne mëkatojmë, sepse i Lartësuari nuk do që t'a dënojë askënd. Çfarë do të arrijë i Lartësuari me dënimin tonë?! Por, fatkeqësisht njeriu këmbëngul në mëkate dhe kjo kokëfortësi, atë e fut në zjarr. Njeriu e ndien veten mendjemadh në këtë botë, dhe sa herë që All-llahu e furnizon me begatitë e Veta, ai mburret dhe bëhet më mizor. Në vend se të bierë në sexhde, e t'a falenderojë All-llahun, ai sillet si hyjni, duke kërkuar që të luftojë me All-llahun dhe begatitë e Tij. Pra, ky është mosbesimi i njeriut dhe kjo është mëshira e All-llahut të Lartëmadhëruar.

FARAONËT PËRSËRITEN

T'i qasemi sërish tregimit të Musait dhe Faraonit. Musai i foli me një gjuhë të butë, por ajo nuk ndikoi fare tek ai, përkundrazi ai u paraqit edhe më i ashpër se ç'ishte. Ai filloi t'a demonstronte

forcën e tij me magjistarët, por All-llahu xh.sh. i mundi magjistarët. Ata ishin të parët, që e besuan. Kjo mrekulli do t'iu mjaftonte të gjithë të pranishmëve, edhe Faraonit për të besuar.

Shansi tjetër i Faraonit, që të besonte ishte kur magjistarët i bënë sexhde Zotit të Musait. Faraoni duhej t'a kuptonte se Musai nuk ishte magjistar, por i dërguar – peygamber i Zotit, por fatkeqësisht ai u inatos edhe më shumë, dhe dukej se do t'i bënte robërit e tij të vuanin edhe më shumë seç vuanin. Fillimisht, ai urdhëroi që të mbyten përkrahësit e tij (magjistarët që e besuan Musain a.s.). Pasuan ditët në vazhdim, dhe sa herë që Musai sillte ndonjë argument prej Zotit, ai e mohonte.

Faraoni nuk ndalej së munduari popullin e Musait, madje ai tani, urdhëroi që të vriteshinn fëmijët e popullit të Musait, dhe gratë e tyre të robëroheshin. Megjithatë, i Lartësuari, i dërgonte Faraonit argumente të parreshtura me anë të Musait, për t'ia përkujtuar Fuqinë e Tij, edhe pa prezencën e Musait a.s.. Popullit të Faraonit, All-llahu ua shndërroi ujin në gjak, iu paraqiti bretkosa të shumta, karkalecë, të gjitha këto ishin shenja se atë po e përcjell një dënim i vogël. Në vend që ai të besonte, t'a njihte Fuqinë e All-llahut xh.sh., të pendohej, dhe të kuptonte se All-llahu është veprues i pakufishëm, dhe se Ai bën atë që dëshiron, faraoni vazhdoi përsëri të këmbëngulte në mosbesimin e tij.

Atij do t'i kish mjaftuar të kërkonte nga Musai, që t'a luste All-llahun, se ata ishin besimtarë, dhe ai pasi t'a kishte bërë këtë lutje, atyre do t'u ishte evituar dënimi. Por, Faraoni vazhdonte me avazin e vjetër të mosbesimit, edhe pse atij i vinin argumente të reja, që ia përkujtonin Fuqinë e All-llahut xh.sh., se Ai është Sunduesi i botëve dhe qiellit.

Se Fuqia e tij është reale dhe e pakufizuar. Fuqia e tij realizon çdo gjë, pa pengesa. Dallimi midis Fuqisë së Tij dhe fuqisë tënde është se ti posedon fuqi, por ajo nuk është e mjaftueshme për t'i realizuar të gjitha dëshirat e tua. Mund të jesh tregëtar i mirë dhe i njohur, por nuk ke vendstrehim të mjaftueshëm për të gjithë, atë që posedon. Ndodh të jesh inxhinjer i shkëlqyer, por nuk posedon kapital të nevojshëm për të realizuar ndonjë projekt gjigant, që ke përpiluar. I Lartësuar, i posedon të dy këto Fuqi. Ai posedon të gjitha elementet për veprim.

Kur Faraoni i mori argumentet e dënimit, qëllimi i All-llahut xh.sh., ishte që t'ia përkujtojë atij Fuqinë e Tij, mbase do të kujtohej dhe pendohej. Por, kur ato argumente mbaronin së vepruari, ai mendonte se tani çdo gjë mori fund dhe nuk do të kishte më dënim tjetër, duke menduar se shpëtoi plotësisht. Ai mashtrohej se ajo që ndodhi, nuk do të përsëritej më. Përsëri, i Lartësuar, ia përkujtonte atij sërish, dhe ai (faraoni) prapë shkonte me vrap tek Musai dhe i thoshte atij që t'a luste Zotin e tij, që t'ia ndalte dënimin, por pasi ndalej veprimi i dënimeve, ai kthehej në avazin e vjetër, duke ushtruar zullum mbi qytetarët.

Këto ishin insistimet në mosbesim, dhe insistimet në mëkate, dhe këto dy insistime, nuk e bëjnë të kënaqur të Lartëmadhëruarin. Tregimi i Faraonit, për ne, nuk është i panjohur. I Lartësuar i këtë ia përkujton secilit rob të Tij mosbesimtar. Ai i kërkon atyre se si të luten dhe se si t'i drejtohen Atij, por kur atyre ju largohet stresi dhe ankthi, i harrojnë ato të mira.

Kështu do të vazhdojë derisa All-llahu, t'ua hapë atyre derën, që është dera e dënimit të madh. Atëherë do t'a përkujtojnë All-llahun, por do të jetë tepër vonë. Kur Faraoni u gjend në det dhe po përmytej, shfaq i imanin e tij, por koha e tij veç kishte përfunduar pa sukses. All-llahu, ia kishte hapur atij shumë herë dyert e Rahmetit të Tij, i tregoi shumë argumente të cilat do t'a

bënin besimtar, bile shumë besimtar, por fatkeqësisht, faraoni këmbënguli në mosbesimin e tij. Për këtë arsye, All-llahu xh.sh., shprehu vullnetin e Tij, për të na rikujtuar se, insistimi nuk është prej virtyteve të besimtarit, por prej virtyteve të mëktarëve mosbesimtarë.

I Lartësuarit thotë: “Edhe ata që bëjnë vepra të këqija (të shëmtuara) ose dëmtojnë vetet e tyre, e përkujtojnë All-llahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre...”¹⁴³

Të kërkuarit falje, është pendim dhe keqardhje ndaj mëkatit. I Lartëmadhëruari, thotë: “dhe nuk insitojnë në atë, që kanë vepruar”¹⁴⁴, ata kanë ndaluar së vazhduari në mëkat.

Pra, secila punë e besimtarit duhet të bëhet në Emër të All-llahut, ‘Bismil-lah’, sepse All-llahu është Ai, që ia nënshtroi njeriut të gjitha gjërat. Ai që fillon me ‘Bismil-lah’, kërkon nga All-llahu që t’a ndihmojë në realizimin e atij veprimi. Nëse në çdo punë që bëjmë, e kemi në mendje All-llahun xh.sh., Ai do të të ndihmojë dhe do të jetë me ne.

Përmendja e vazhdueshme e emrit të All-llahut, e bën zemrën që të ketë frikë-respekt dhe njerëzit nuk mëkatojnë. Kur ne e përmendim Atë, ne e dimë se Ai është vazhdimisht me ne, na dëgjon dhe na sheh. Kur ne e kemi parasysh këtë, dhe ngrihemi të bëjmë një punë, që është e dëmshme për të tjerët, All-llahu sikur na thotë: jo, mos e bëj këtë, se kjo punë nuk të përket ty. Këtu pastaj ndërhyjnë legjislacionet (rregullat e caktuara nga Zoti), ato nuk ndërhyjnë për gjëra të kota, por veçse për të mirën e njeriut.

¹⁴³ Kur’an, 3/ 135

¹⁴⁴ Kur’an, po aty

Njeriu nga natyra mundohet të arrijë çdo gjë, jo vetëm atë që e posedon ai, por edhe ato që posedojnë dhe të tjerët. Por All-llahu i thotë atij jo, se po të mbroj me ligjin Tim, i cili s'është (për të mbrojtur) veçse për pasurinë tënde; po të mbroj me Rahmetin Tim, duke qenë se ti je një individ dhe si ti ka shumë. Nëse shpreh vullnetin Tim, që ti të armiqësohesh (me të tjerët) për pasuri, atëherë thuajse Unë ju kam dëshiruar të gjithë (të tjerëve) armiqësi ndaj pasurisë tënde. Unë e kam ndaluar armiqësinë e pasurisë individuale, dhe armiqësinë e pasurisë, në përgjithësi.

Unë ua kam ndaluar, edhe milionave të tjerëve, të kenë pjesë në atë që ti posedon, ose në çdo gjë tjetër që posedojmë në botë. Kur Unë veproj kështu, të mbroj ty dhe pasurinë tënde. Unë të ndaloj edhe ty, të armiqësohesh me dikënd, sepse Unë kam Fuqi të hakmerrem, dhe se Unë mund të bëj çfarë të dua.

Kështu është mrekullia e krijimit nga All-llahu i Lartëmadhëruar. Mëshirë për njerëzimin dhe mirësi prej All-llahut.

Ne duhet që Atë t'a Lavdërojmë, t'a falenderojmë dhe t'a respektojmë. Ne themi 'Falenderimi i takon All-llahut', sepse e dimë se toka, qielli dhe ç'ka në to prej riskut, begative, argumenteve dhe krijimi, që nga dita e krijimit deri në Ditën e Kijametit, është Mirësi prej All-llahut. Kjo nuk kuptohet si shtesë e nevojave të Tij, sepse Ai nuk ka fare nevojë për to, sepse Ai ka pasuri absolute. Kur Ai na jep ndonjë begati, Ai e jep sepse Ai nuk ka nevojë që t'i mbetet Atij. Ai është më i pasur se gjithçka sa neve dimë, Ai është absolut.

Mrekullia e krijimit në vete përmban mëshirë, dritë, mirësi dhe ka pëlqimin e All-llahut të Lartëmadhëruar. Ajo përmban çdo gjë që ne kemi nevojë, këtë shpresë e kemi të gjithë, duke filluar prej Ademit a.s., deri në ditët e sotme, si dhe ata që do të na pasojnë. Shohim se sa e

madhe ishte dashuria e All-llahut për ne, se sa gjithëpërfshirës ishte rahmeti i Tij ndaj nesh. Gjithashtu, shohim se sa mosmirënjohës ishte njeriu ndaj begative të All-llahut. Sikur ta dinim saktësisht, se çfarë na është caktuar nga All-llahu do ta shihnim se koha është shumë e shkurtër. Gjithashtu, edhe sikur ta veçonim të tërën, ne, do ta falenderonim Rahmetin e All-llahut. Njeriu nga njëherë nuk sheh edhe pse sytë i ka të hapur dhe nuk dëgjon edhe pse veshët i ka në gjendje të rregullt.

El Hamdu Lil-lah, Lavdi All-llahut që më mundësoi përfundimin e këtij përkthimi.